



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 29,30 PRILL DHE 4 MAJ 2010

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE
29. 30. APRILA i 4. MAJA 2010. GODINE

PRILL – APRILA
2010

Seancën e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

I nderuar kryeministër, zëvendëskryeministra dhe ministra të Kabinetit qeveritar,
I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Konstatoj në sallë janë të pranishëm 94 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për të filluar punën.

Ju njoftoj se në pajtim me rregullat 6.2 dhe 23 të Rregullores së Punës së Kuvendit, Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me shefat e grupeve parlamentare ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Ndërkohë, Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e përbashkët me shefat e grupeve parlamentare ka vendosur që rendi i ditës të plotësohet me dy pika shtesë, si vijon:

1. Shqyrtimi i Propozim – vendimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarit të Komisionit Kosovar të Konkurrencës, dhe
2. Shqyrtimi i Propozim – vendimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarit në Bordin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit,

Lus deputetët që me ngritje dore të deklarojnë për plotësimin e rendit të ditës.

Kush është “për”? Faleminderit! A ka “kundër”? A ka abstenim? Nuk ka. Faleminderit!

Konstatoj se Kuvendi miratoi plotësimin e rendit të ditës me dy pika shtesë, të cilat do të radhiten në pikën 22 dhe 23 të rendit të ditës.

Para se të fillojmë me rendin e ditës, përshëndes dhe ju dëshiroj punë të mbarë deputetëve të ri: Ismajl Kurteshit, Rexhep Hotit dhe Basri Musmuratit, të cilët zëvendësojnë deputetët e deritashëm: Hajredin Kuçin, Fehmi Mujotën dhe Memli Krasniqin, të cilët i falënderoj për punën e tyre të deritashme si deputetë. Faleminderit!

Para se të fillojmë me rendin e ditës, kemi dy apo tri kërkesa. Kërkesën e parë e ka deputeti Gani Geci.

GANI GECI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar Kabinet qeveritar,

Unë do të ngreh një çështje të rëndësishme, mjaftë të rëndësishme, e cila ka të bëjë me protokollin e shtetit.

Ne jemi shtet i ri, një shtet që ende si kemi bërë 3 vjet, një shtet që po mundohemi të jemi funksional.

Të nderuar deputetë, në përrurimin e rrugës së kombit, që është bërë në Vërmicë, në mes të kryetarit të Republikës së Kosovës dhe në mes të kryeparlamentarit ka qenë një burrë, që unë nuk e di kush ka qenë. Me protokoll shtetëror nuk është dash të ulet aty. Ai burrë është i dyshuar për urdhërdhënie për vrasje të ndryshme, e ai është Azem Sylja.

Të nderuar deputetë, kush e ka ftuar, kush e ka ulë në mes të dy burrave më të mëdhenj të shtetit tonë? Kjo është një çështje shumë e rëndësishme. I gjithë stafi dhe policia e

hetuesia janë duke u marrë me zbardhjen e veprave kriminale që i ka bërë dikush dhe një i dyshuar për vepra kriminale ulet në mes të dy burrave të shtetit të Republikës së Kosovës për të dhënë të kuptohet që unë jam më i forti, unë jam bos i dhe të tjerët që guxojnë të më dalin mua përpara, do të pësojnë shumë keq. Ju faleminderit!

KRYETARI: Naim Rrustemi, e ka fjalën.

NAIM RRUSTEMI: Faleminderit!

Çështja që unë do ta ngrejë ka të bëjë me Rregulloren e Punës së Kuvendit të Kosovës. Disa herë gjatë fjalimeve të mia kryetari i Kuvendit, po edhe kryesuesi i seancës kanë ndërhyrë me dhënie të përgjigjeve, me miratim apo me mohim. Duke u bazuar në Rregulloren e Punës së Kuvendit të Kosovës, një e drejtë të tillë nuk i atribuohet kryesuesit të seancës. Ju kisha lutur që ose të ndërpritet kjo praktikë, ose të trajtohet si replikë. Në rast se trajtohet si replikë, të më jepet mundësia që të replikoj, një. Unë e kuptoj kërkesën për një moralizim kolektiv kështu në tërësi por, ju lutem, këto nuk janë ide progresive. Mund të trajtohen vetëm nga këndvështrimi i ideve të pastra komuniste, kështu që, ju lutem, intervenimet që ndodhin pas fjalimeve të mia, ose të ndërpritet, ose të trajtohen si replikë dhe të më respektohet e drejta e deputetit. Faleminderit!

KRYETARI: Edhe prej teje faleminderit!

Profesor, a je lajmëruar? Riza Smaka e ka fjalën.

RIZA SMAKA: I nderuari zotëri kryetar i Kuvendit,
I nderuari zotëri kryeministër, zëvendëskryeministra, ministra,
Të respektuar deputetë dhe deputete,

60.000 pensionistë të Republikës së Kosovës nëpërmjet përfaqësuesve legjitim të vet (edhe mua, ndoshta edhe dikujt tjetër ia kanë dërguar), më janë adresuar me apelin shkrimor të 17 – 18 marsit të këtij viti, duke theksuar se situata dhe gjendja sociale, juridike e pensionistëve kosovarë, të moçmërisë, invalidor e familjar, nga viti 1999 e deri më sot, nga institucionet respektive të vendit tonë nuk është trajtuar seriozisht as meritorisht!?

Kompensimet për pensione janë nëpërkëmbshëm dhe mjerisht të ulëta, në kundërshtim me moralitetin, me solidaritetin, me reciprocitetin, me fundamentet e sistemeve të sigurimeve pensionale, për afërsisht 100 herë më të ulëta nga pagat e anëtarit të menaxhmentit të Trustit Pensional, ndryshe, të financuar administrativisht po nga kontributet e atyre pensionistëve.

Në vitin 2010 pensionet mesatarisht janë ngritur vetëm 12,5% ose 5 euro!? Pakënaqësia, zhgënjimi dhe dëshpërimi i pensionistëve, tok me familjarët e tyre, lexo dhe kupto, afër 300.000 persona, qytetarë kosovarë, janë buzë pikës së vlimit dhe përfundimisht duke kërkuar që urgjentisht të miratohet Ligji për sigurimin dhe mbrojtjen pensionale e invalide, si dhe të harmonizohen racionalisht lartësitë e pensioneve të moçmërisë, invalide e familjare, që nuk ka, me pagat në administratën shtetërore, përkatësisht publike, në radhë të parë me pagat e administratës dhe të menaxhmentit të Trustit Kursimor Pensional të Kosovës.

“Pensionistet kosovarë” me bazë dhe shkak të arsyeshëm kërkojnë që urgjentisht dhe seriozisht të harmonizohen (nëpërmjet akteve ligjore e nënligjore) “pensionet “ me pagat (enorme të larta) të administratës së Trustit Kursimor Pensional, e aq më parë të

menaxhmentit të po atij Trusti (të cilat janë ekstremisht paarsyeshëm, madje pamoralshëm të larta – në dëm të parësë së kursyer të të punësuarve)...

Përfundimisht, edhe në këtë rast dhe vend apelojmë që apeli i “pensionistëve kosovarë” i prezantuar këtu, të merret në shqyrtim dhe vendosje serioze, e mbi të gjitha – të drejtë...!

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Të lajmëruar të tjerë nuk kemi.

Vazhdojmë me rendin e ditës. I falënderojmë deputetët për fjalët që i kryen.

Pika e parë e rendit të ditës:

1. Miratimi i Procesverbalit të seancës plenare të mbajtur më 16 prill 2010

Pyes, nëse keni vërejtje në këtë procesverbal? Driton Tali.

DRITON TALI: Unë kam për transkript, nëse më lejohet?

KRYETARI: Urdhëro?

DRITON TALI: Për transkript, thashë, është bërë një lëshim, mendoj se nuk është për nivelin e Kuvendit. Fjala apo fjalia e Lui XIV: “L’etat c’est moi”, nuk është shkruar si duhet. Mendoj se jemi në një nivel të tillë që duhet të transmetohet ashtu siç është dhe pastaj vazhdon “L’etat c’est premier ministër”, e tjera, e tjera. Është shkruar shumë keq këtu. E di se tjetër kush do ta lexojë transkriptin. Faleminderit!

KRYETARI: Kërkojmë nga administrata që ta ndryshojë transkriptin. Konstatoj se Kuvendi miratoi Procesverbalin e seancës plenare të mbajtur më 15 prill 2010.

Pika e dytë e rendit të ditës:

2. Koha për pyetje parlamentare

Në pajtim me Rregullën 26.1 të Rregullores së Punës së Kuvendit, koha për pyetje të deputetëve për Qeverinë është e kufizuar në 50 minuta.

Procedimi i pyetjeve do të bëhet sipas kohës së parashtruar dhe numrit rendor të pyetjeve.

Fillojmë me pyetjen e parë. Deputeti Driton Tali, pyetje për ministrin Ahmet Shala.

DRITON TALI: Faleminderit!

Këtë pyetjeja ia kam pas adresuar Iv de Kermabos, po mbasi ai s’po merret me korrupsion, atëherë po ia bëj zotit Shala.

Zoti Shala, më 25 shkurt të këtij viti patët deklaruar lidhur me garancionin bankar prej 16.200.000 eurove se në ART është garancioni bankar prej 16.200.000 euro dhe është valid deri në vitin 2011. Pyetja është: - A janë deponuar këto 16.200.000 euro në Thesarin e Kosovës, ashtu siç e kërkon ligji? Nëse po, po ashtu na tregoni pse nuk janë të deponuar deri më tani, pra që nga viti 2007, domethënë që rreth 3 vjet këto 16.200.000 euro në Thesar nga ART-ja. Dhe, po ashtu, a na tregoni se nëse nuk janë të deponuar që 2

muaj, pse nuk janë deponuar dhe kur pritet të deponohen ato 16.200.000 euro të parave të Kosovës, domethënë të garancionit apo të operatorit të Telefonisë së dytë mobile.

KRYETARI: Zoti ministër, e ke fjalën!

MINISTRI AHMET SHALA: I nderuar kryetar i Parlamentit,
I nderuar kryeministër, zëvendëskryeministra, kolegë ministra,
Të nderuar deputetë,
I nderuari deputet Tali,

Pas pyetjes suaj apo të Naimit, sa di unë, nuk e di cili e keni bërë, duke qenë se ART-ja, pra Agjencioni Rregullativ i Telekomunikacionit është organ i Kuvendit të Republikës së Kosovës, në kapacitetin tim, si ministër i Ekonomisë dhe i Financave, i kam dërguar letër më 19.03, kryesuesit të Bordit, Ekrem Hoxhës, me të cilën kam kërkuar që të marrë të gjitha veprimet e domosdoshme që ai garacion të materializohet. Të njëjtën shkresë ia kam dërguar edhe Parlamentit, në mënyrë që ju si parlamentarë, përkatësisht si Kryesi e Parlamentit, që jeni mbikëqyrës dhe autoritet mbi autoritetin rregullativ, t'i merrni të gjitha masat.

Konsideroj se këtu përfundojnë kompetencat e mia, si ministër i Ekonomisë dhe Financave dhe, edhe atëherë, dhe sot po kërkoj që ART-ja, si organ i Kuvendit, t'i marrë të gjitha masat dhe të veprojë konform obligimeve, të procedurave dhe të ligjit që e ka për të realizuar një garacion të cilin e ka pasur në dispozicion dhe që e ka në dispozicion sipas informatave që unë i kam marrë nga kryetari i Bordit. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, ministër! Deputet, ke pyetje shtesë? Urdhëro!

DRITON TALI: Zoti Shala, përgjegjësinë dhe fajet pra na i paska zoti Jakup Krasniqi me Kryesinë, të cilët nuk e kanë kërkuar atë çek, atë garacion bankar të shkojë në vend ku duhet. Po e them këtë sepse, sipas fjalorit politik të Oksfordit, deputetët e pavarur përgjegjësitë i kanë të kufizuara, do me thënë fajet i paska Kryesia, Dhoma e Sipërme e Parlamentit apo Dhoma e Lordëve, përndryshe që po i thonë, që nuk e kanë lokalizuar këtë garacion bankar. Po thoni se ma mirë këta ka qenë, në vend se të bëjnë eskurzione nëpër Kosovë, ta hulumtojnë çekun ku ka mbetur. Ashtu po thoni ju, apo jo?

KRYETARI: Ju faleminderit, deputet, për ngritjen e shkallës së përgjegjësisë së Kryesisë së Parlamentit!

Deputetja Synavere Rysha, pyetje për kryeministrin, zotin Hashim Thaçi. Deputete, e ke fjalën!

SYNAVERE RYSHA: Ju faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar zoti kryeministër!

Kosova ka mbi 155 prona jashtë territorit të saj. Nga 55 ndërmarrje shoqërore, pra asete në ish republikat jugosllave, kryesisht në Serbi dhe Mal të Zi, si nga Trepça, KEK-u, "Agrokosova", "Eksimkosi", Bankkosi dhe shumë ndërmarrje shoqërore. Çfarë po bënë Qeveria, apo më konkretisht a ka ndërmarrë Qeveria ndonjë hap konkret për kthimin e këtyre pronave kompanive në fjalë të Kosovës në përgjithësi?

KRYETARI: Zoti kryeministër, e keni fjalën!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Ju faleminderit, i nderuar kryetar!

E nderuara deputete,

Të nderuar deputetë,
I nderuar Kabinet qeveritar,
Çështja e menaxhimit dhe administrimit të ndërmarrjeve publike dhe shoqërore, siç e dini, ka qenë pjesë e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit, si pjesë e UNMIK-ut, ndërsa pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përgjegjësia për menaxhimin e ndërmarrjeve shoqërore është rregulluar me Ligjin mbi themelimin e Agjencionit Kosovar të Privatizimit, ku përgjegjësia për administrimin e ndërmarrjeve shoqërore, në vend të aseteve të cilat gjenden jashtë vendit, bien mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Ju e dini se në bazë të këtij ligji, kjo agjenci funksionon si një organ i pavarur publik, i cili ushtron funksionet dhe përgjegjësitë në mënyrë plotësisht të pavarur. Për punën e vet Agjencia i përgjigjet drejtpërsëdrejti Kuvendit të Republikës së Kosovës. Kjo çështje është ngritur disa herë, mund t'ju them, nga autoritetet e Qeverisë dhe do të jetë pjesë e interesimit dhe të punës së përhershme të Qeverisë së Republikës së Kosovës, në bashkëpunim të vazhdueshëm me faktorin ndërkombëtar, në mënyrë që prona e Kosovës, kudo që gjendet, të shfrytëzohet për të mirën e qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Të nderuar deputetë, pasi që rrethanat dhe relacionet e shtetit të Kosovës me atë të Serbisë janë çfarë janë, ne kemi bërë të gjitha ato që kemi pasur mundësi të bëjmë dhe në kuadër të kësaj kanë qenë edhe vizitat e ministrit të Ekonomisë dhe të Financave në Mal të Zi, ku kanë filluar negociatat për këtë çështje në nivel shtetëror. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, kryeministër!
Deputete, ke pyetje shtesë?

SYNAVERE RYSHA: Zoti kryeministër, edhe pse Agjencioni Kosovar i Privatizimit ka më tepër se një vit që është themeluar dhe është themeluar në bazë të Kushtetutës, është shumë e qartë se është institucion i pavarur, megjithatë është edhe Qeveria ajo përgjegjëse për kthimin e këtyre pronave, sepse marrëveshjet më tepër i takojnë Qeverisë, sesa agjencioneve, duke pasur parasysh se kjo çështje duhet të zgjidhet me rrugë diplomatike, marrëveshje të mirëkuptimit dhe marrëveshje të ndryshme. Prandaj, në asnjë mënyrë kjo nuk ju largon nga përgjegjësia juve si kryeministër. Por, të shpresojmë se në të ardhmen do të punohet më tepër. Ju faleminderit!

KRYETARI: Kryeministër!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Keni të drejtë plotësisht që përkushtimet duhet të rriten. Por, në relacionin me Serbinë, mos kërkonin nga unë që tash të bëjë gjëra të pamundura, që nuk mund t'i bëjmë askush nga ne për shkak të relacioneve apo mos relacioneve që janë në mes shtetit të Kosovës dhe shtetit të Serbisë. Ndërsa, me Malin e Zi kanë filluar kontaktet dhe janë në rrugë të mirë, është një diskutim jashtëzakonisht produktiv fillestar. Por, Agjencioni i Privatizimit nuk i përgjigjet Qeverisë, por Kuvendit. Kështu që jam pjesë e shqetësimit tuaj, por edhe të përgjegjësive të përbashkëta shtetërore. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, kryeministër!
Deputeti Naim Rrustemi, pyetje për ministren Justina Shiroka – Pula.

NAIM RRUSTEMI: Ju faleminderit!

Është raportuar se KEK-u, jo vetëm që ka blerë rrymë me çmime të larta, me paratë e tatimpaguesve të Kosovës, por ata i kanë dhënë tender kompanisë “GEN-i”, nga Beogradi edhe pa licencë për import të energjisë elektrike. Sipas Ligjit për energjinë elektrike, për importin e energjisë elektrike kërkohet që të posedohet licencë nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë. Pyetja: Cilat janë arsyet për mosrespektimin e Ligjit dhe a keni ndërmarrë ndonjë masë për parandalimin e veprimeve të ndaluara me ligj?

KRYETARI: Ministre!

MINISTRJA JUSTINA SHIROKA – PULA: I nderuar kryeparlamentar, kryeministër, zëvendëskryeministra, deputetë, ministra, Si zakonisht, zotëri Naimi vazhdimisht i bën pyetjet e njëjta. Vetëm desha t’ju informoj, ju shumë mirë e dini se KEK-u e ka një Bord apo ka drejtor të bordeve. Ne, si Ministri e Energjisë dhe e Minierave nuk kemi kurrfarë kompetence dhe nuk e menaxhojmë KEK-un. Sa iu përket obligimeve dhe përgjegjësi të cilat i kanë marrë dhe kanë blerë rrymë prej kompanive të cilat nuk janë të licencuara, me siguri përgjigjet drejtori dhe kryetari i Bordit dhe janë auditorët të cilët do ta menaxhojnë KEK-un. Ne, si Ministri, nuk kemi kurrfarë përgjegjësie, ju atë shumë mirë e dini, por nuk e di pse vazhdimisht ia bëni të njëjtat pyetje Ministrisë së Energjisë dhe Minierave. Ju, në çdo mbledhje të Kuvendit, e dini se çka përgjigjem unë dhe cilat janë raportet të cilat i kam me ligje. Pasi çdo gjë lexoni, atëherë mirë është t’i lexoni edhe ligjet dhe sipas ligjeve e dini cilat janë kompetencat dhe përgjegjësitë e Ministrisë së Energjisë dhe të Minierave.

KRYETARI: Ju faleminderit, ministre! Naim, më duket nuk ke pyetje shtesë! Fjala deputetit, Naim Rustemi!

NAIM RRUSTEMI: Na ka sjell ministrja në pozicion tragji-komik, se paratë megjithatë po shkojnë. Për sa i përket pyetjes, pse vazhdimisht të njëjtat, është se ju nuk po e kryeni detyrën saktë dhe ka nevojë për konsekuencë, konsistencë në veprimet e juaja. Në rast se nuk ka përgjegjësi, konsistencë dhe përgjegjësi në shpenzimin e parasë publike dhe në rast se Ministria e Energjisë dhe e Minierave nuk ka asnjë përgjegjësi në menaxhim dhe administrim të KEK-ut, në rast se nuk ka asnjë rol në atë drejtim, për çka qenka Ministria e Energjisë dhe e Minierave? Dhe, e dyta, ne nuk dimë si deputetë kujt t’ia bëjmë pyetjen. A ka mundësi që t’ju lusim juve që të kërkoni nga Bordi që ta respektojë ligjin. Nëse nuk donë të marrin masa tjera ata që janë përgjegjës për sundimin e ligjit, atëherë t’i përbejmë në Zot, në Perëndi – ndaluni, mos vidhni shumë!

KRYETARI: Ministre!

MINISTRA JUSTINA SHIROKA – PULA: Mirë është të lexohen ligjet, të përcillen ligjet të cilat janë aprovuar në këtë Kuvend dhe të shihet se cili është përgjegjës para ligjit.

KRYETARI: Ju faleminderit, ministre!

Deputeti Nait Hasni, pyetje për ministrin Nenad Rashiq. Deputet, e ke fjalën!

NAIT HASANI: Përshëndetje, kryetar!

Kryeministër, ministra, zëvendëskryeministra,

Zoti ministër, shteti zviceran iu ka ndërprerë punëtorëve sigurimet, të ardhurat për mbajtjen e familjes.

Çështja: A ka Ministria strategji të mbrojtjes së punëtorëve tanë në Zvicër dhe në vende të perëndimit, që pas 1 prillit është shndërruar në një situatë të pakënaqshme sociale dhe politike?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën!

MINISTRI NENAD RAŠIĆ: Poštovani predsedniče,
Poštovani premijeru,
Poštovani zamenici premijera,
Kolege ministri,
Damo i gospodo, narodni poslanici,
Poslaniče, ja sam više puta pokušavao da informišem u detalje ceo proces i informisanja od strane švajcarske Vlade, a takođe i naših delovanja koje smo imali u ovom pravcu.

Ponoviću još jednom, od 1. aprila je prekinuta mogućnost korišćenja penzionog sistema Švajcarske za građane Kosova, ukoliko njihovo mesto boravka nije u Švajcarskoj. Znači, oni građani koji tamo zarade svoju penziju, ukoliko bi se vratili da žive na Kosovo, znači to njihovo pravo ne bi bilo u mesečnim ratama kao standardna penzija, nego bi to pravo bilo preneseno na mogućnost da svoje pare uzmu, odnosno transferišu na bankovne račune na Kosovu, ili eventualno čak bila i mogućnost da to mogu da rade i u kešu. Uglavnom, taj fond koji oni odvajaju, ne gubi se, taj fond se samo transformiše iz monetarnog sistema Švajcarske u kosovski sistem, kao prva stvar.

Drugo, reagovali smo odmah. Na kraju godine je bilo jedno usmeno objašnjenje, jedna usmena najava od strane ambasadora i mi smo odmah posle toga reagovali na način da se napravi još jedan ugovor, sada sa Kosovom, naravno, jer je ugovor koji je funkcionisao do sada bio sa bivšom Jugoslavijom. E sada, u tom nekom našem nastojanju, na žalost, ja moram da kažem da možda ne postoji visoka dobra volja od strane Švajcarske, švajcarskog parlamenta, u ovom slučaju, jer se proces još uvek naznačava na tehničkom nivou, odnosno mi smo tog prvog dana imali tehničku grupu, koja bi u poseti Švajcarskoj samo utvrdila detalje ugovora koji treba biti obnovljen i ponovno potpisan. To se desilo pre dva, dva i po meseca. Ja i dalje ne znam šta se čeka, šta je tu prepreka, ne mogu da shvatim, iako se uporno i sa strane ambasadora Švajcarske na Kosovu, a takođe i našeg ambasadora u Švajcarskoj, tvrdi da se radi na tome, čekamo još malo. Ja stvarno ne znam šta je to – još malo. U svakom slučaju, ja sam ponovo, i pismo koje sam dobio od našeg ambasadora, Naima, u Švajcarskoj...

KRYETARI: Mirë, edhe pak fjalë ministrit!

MINISTRI NENAD RAŠIĆ:... koji mi je danas, čak što više pre 10 minuta, dostavio pismo njegovih aktivnosti u Švajcarskoj i ja bih rado, ako vi hoćete da vam pismo i predam, tako da budete informisani u detaljima. U svakom slučaju, od prvog dana smo radili na ovome i nastavljamo da radimo. To jeste za nas prioritet, ali opet ponavljam, možda neke stvari su van naših kompetencija i ne možemo da utičemo na njih. Hvala!

KRYETARI: Ju faleminderit! Deputet, ke pyetje shtesë? Jo. Ju faleminderit! Deputetja Gjylnaze Syla, pyetje për kryeministrin zotin Hashim Thaçi.
Deputete, e ke fjalën!

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti kryetar!

Kryeministër, kanë kaluar më shumë se një vit nga vjedhja e dëshmime, gjegjësisht e provave në Dhomën e Dëshmime në Policinë e Kosovës. Rasti nuk është zbardhur ende. Duke marrë parasysh se ky është veprim i krimit të organizuar, pasojat e mosndriçimit të tij shkaktojnë dëme të mëdha për Kosovën, sidomos në aftësinë e saj për të luftuar krimin e organizuar.

Prandaj, ju pyes, cilat veprimet janë marrë gjatë kësaj kohe për të zbardhur rastin?

Ju kujtoj se ia kam bërë pyetjen edhe më herët ministrit Pajaziti, por asnjëherë nuk ka ardhur para Kuvendit për të shpjeguar, prandaj pres nga ju që të jepni sqarimin adekuat. Faleminderit!

KRYETARI: Përgjigjen kryeministri e ka deleguar te ministri i Punëve të Brendshme, Bajram Rexhepi.

MINISTRI BAJRAM REXHEPI: I nderuar kryetar i Parlamentit, I nderuar kryeministër, zëvendëskryeministra, kolegë ministra, Të nderuar deputetë, Natyrisht që është një brengë e madhe për të gjithë vjedhja në Dhomën e Dëshmime, që ka kaluar më tepër se një vit dhe në fillim të mandatit tim kam kërkuar informatë se deri ku kanë arritur hetimet në lidhje me këtë rast. Jam i informuar nga Shtylla e hetimeve të krimit dhe kundër krimit të organizuar se pas hetimeve që i ka bërë kjo shtyllë, kjo lëndë për shkak të ndjeshmërisë dhe kapaciteteve profesionale, është transferuar në kompetencë të EULEX-it, që do të thotë se Shtylla e hetimeve do të bashkëpunojë me sa ka informata në këtë drejtim. Informata më detaje nuk na kanë dhënë për shkak të senzitivitetit të hetimeve. Kanë disa pista të hetimeve, mirëpo këto janë në fazën ende të hetuesisë, janë bërë disa intervistime dhe ne kërkojmë që kjo të përmbyllet sa më shpejt. Jemi të interesuar të gjithë dhe në momentin kur kemi të dhëna sigurisht që do të veprohet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!
Deputete, a ke pyetje shtesë?

GJYLNAZE SYLA: Zoti ministër, nuk mjafton të kërkon, ju jeni ekzekutiv, duhet të punoni ta zbardhni rastin. Pos kësaj, ish- ministri juaj, po e lexoj transkriptin, pati thënë kështu: “Në bazë të raporteve dhe të dinamikës aktuale të procesit hetimor, ju siguroj se së shpejti priten rezultate konkrete në këtë drejtim”. Në qoftë se prioriteti i Qeverisë, ashtu siç deklarohet, është sundimi i ligjit, luftimi i korrupsionit dhe i krimit të organizuar, a mbetet kjo vetëm fjalë?

KRYETARI: A keni përgjigje, ministër? Mirë, faleminderit! Vazhdojmë.

Deputeti Emrush Xhemajli, pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi. Deputet, e ke fjalën! Nuk është këtui deputeti. Mirë, vazhdojmë.

Deputeti Riza Smaka, pyetje për ministrin Ahmet Shala. Deputet, e ke fjalën!

RIZA SMAKA: Zotëri, ministër, bankat komerciale në vendin tonë, gjithnjë, nuk i sigurojnë depozitimet bankare të klientëve. Normat interesante për grantimin e kredive, kryesisht në saje të marrëveshjeve monopoliste, kordinueshëm i mbajnë shumë të larta

dhe për aq janë destimulative, në një anë, në anën tjetër, referuar normave interesore të depozitimeve, po ashtu, në bashkërenditje jo parimore, të njëjtat i praktikojnë tepër të ulëta dhe kohë pas kohe arbitrarisht i reduktojnë.

Ju lutem, zotëri ministër, si e konsideron Ministria e Ekonomisë dhe e Financave këtë problem, që ndryshe, është në disfavor të ekonomisë së tregut, si dhe të depozitimeve dhe të ngritjes së kapaciteteve financiare të nevojshme për investime? Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën!

MINISTRI AHMET SHALA: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuari deputet Smaka,

Zhvillimi i sektorit bankar në Kosovë gjatë këtyre viteve ka treguar një sukses të konsiderueshëm duke ofruar shërbime bankare në harmoni me kërkesën e shoqërisë kosovare dhe konform mundësive të konkurrencës së saj.

Suksesi i sektorit bankar mund të vërehet edhe nga fakti që tani në Kosovë kemi 7 banka komerciale, të cilat kanë kaluar, nëse mund të them, testin më të madh që i ka ndodhur edhe globit në 70 vjetët – 80 vjetët e fundit.

Edhe përkundër zhvillimit shumë pozitiv të këtij sektori, ne kemi pasur rastin e bankrotimit të një banke, ku, në mungesë të Ligjit për sigurimin e depozitave, janë shfrytëzuar dispozitat nga Rregullorja 199/21, për të siguruar që të gjithë depozituesit të rimbursohen në një afat shumë të shpejtë kohor. Këto zhvillime besoj që janë mirë të njohura edhe për juve dhe opinionin publik.

Me qëllim të sigurimit të infrastrukturës më të sofistikuar ligjore në këtë fushë, ne tani kemi finalizuar pothuaj se draftin e Ligjit për sigurimin e depozitave, i cili ligj do të sigurojë depozitat e të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës deri në një shumë të caktuar.

Në bashkëpunim me Bankën Gjermane KfV, kemi siguruar një donacion prej 5 milionë eurove për themelimin e këtij fondi, si dhe kemi paraparë që Qeveria e Republikës së Kosovës të kontribuojë me 10 milionë euro si kapital fillestar, i cili do të shpërndahet në 3 vjetët e ardhshme sipas një dinamike të cilën jemi duke e negociuar me Bankën Gjermane dhe shtetin Gjerman dhe besoj se së shpejti ky ligj do të sillet këtu në Parlament.

Ligji në fakt si draft ka qenë i gatshëm po thuaj se edhe në vitin e kaluar, por duke pasur momentin tepër kritik në sektorin bankar, sidomos gjatë nëse mund të them kolapseve të sistemeve bankare të shteteve edhe më të zhvilluara, kemi konsideruar se nuk ka qenë moment i duhur që të sillet ai ligj këtu në Kuvend dhe pasi që t'i harmonizojmë të gjitha veprimet edhe me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe me Bankën Gjermane, besoj që ligjin në një afat shumë të shkurtër do ta sjellim këtu. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Deputet, a ke pyetje shtesë?

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)

RIZA SMAKA: Shala, megjithatë do të isha angazhuar, do të kisha aluduar që Ministria, si segment i ekzekutivit, ta ushtrojë edhe pushtetin kontrollues mbikëqyrës që e ka, ju lutem, kjo është një. Dy, të bëjë atë që mund ta bëjë në të mirë të aplikimit të ligjit antimonopol.

Është fjala për marrëveshje monopoliste, ju lutem, kjo është evidente dhe kjo reflektohet tepër negativisht te të gjitha segmentet e ekonomisë së tregut. Ju falënderohem!

KRYETARI: Faleminderit! Ministër, keni diçka për të shtuar?
Urdhëro, ministër!

MINISTRI AHMET SHALA: Profesor dhe deputet i nderuar, besoj që definicionin për monopolin e kanë elaboruar shumë universitete dhe nuk besoj që ka monopol në qoftë se ke 7 institucione bankare. Megjithatë, edhe një çështje tjetër – organi mbikëqyrës i bankave është organ i pavarur. Ne kemi sistemin shumë të qartë në Kosovë, që konsideroj është sistem goxha i moderuar, është ekzekutivi, janë organet rregullative të cilat janë të pavarura dhe ashtu do të duhej të ishin. Prandaj, janë dy tema të cilat do të doja t'i bisedonim bashkërisht në mënyrë që t'i sqarojmë edhe për opinionin në ndonjë seancë apo radhë tjetër, për të mos lënë keqkuptime të përgjegjësive, por edhe të definicioneve monopolistike, siç e quajtet ju. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Dihet, institucionet janë të pavarura në vendimmarrje, por jo në ajër. Vazhdojmë.

Deputeti Arsim Rexhepi, pyetje për ministrin Bajram Rexhepi.

ARSIM REXHEPI: Zoti kryetar, e tërheq pyetjen për shkak të informatës që kam marrë dje.

KRYETARI: Shumë mirë, deputet! Nuk është mirë të tërhiqni, por s'prish punë!

Deputetja Donika Kadaj – Bujupi, pyetje për kryeministrin, zotin Hashim Thaçi.
Deputete e ke fjalën, apo s'e kemi këtu deputeten. Vazhdojmë.

Deputetja Suzan Novobrdaliu, pyetje për ministrin Skender Hyseni.

SUZAN NOVOBRDALIU: E kisha lutur të mbetet, se është një pyetje shumë me rëndësi dhe e kisha dashur përgjigjen e tij, mirëpo, si duket, ...do të më përgjigjet. Kryeministër, për ju është, më falni!

Zotëri Kryeministër, Renzo Davidi, shef i Zyrës Ndërlidhëse të Komisionit Evropian në Kosovë, në një intervistë të BBC, në gjuhën shqipe, deklaroi: “Në Kosovë ka rritje të korrupsionit dhe të krimit të organizuar dhe institucionet kosovare kanë filluar të humbin besimin në sytë e Brukselit”.

Zotëri Kryeministër, cili është komenti juaj?

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: E nderuara deputete,
Fillimisht, dëshiroj të sqaroj faktin se unë personalisht dhe Qeveria, por të gjitha institucionet e vendit, gjithashtu, jemi në kontakt të rregullt me zyrtarët në Bruksel dhe të gjitha autoritetet e Brukselit në Republikën e Kosovës. Po ashtu kemi bashkëpunim të shkëlqyeshëm dhe të hapur me të gjithë përfaqësuesit, të cilët janë të përfshirë në angazhimet tona mbështetëse dhe këshillimore dhe lehtësuese, mund të them, në

procesin tonë integruet në strukturat e Bashkimit Evropian, duke përfshirë këtu edhe Renzo Davidin.

Ne kemi pranuar vitin e kaluar Raportin e progresit, ku përshëndeten të arriturat në Republikën e Kosovës, ku dalin edhe sfidat, sfidat me të cilat jemi duke u përballur të gjithë, por edhe kur është hapur, do të thotë, kapitulli i perspektivës evropiane për shtetin e Kosovës. Kështu që kemi angazhime të përbashkëta, angazhime këto të cilat do të jenë plotësisht në përputhshmëri me kriteret e qeverisjes së mirë.

KRYETARI: Faleminderit! A keni pyetje shtesë, deputete?

SUZAN NOVOBRDALIU: Zotëri kryeministër!

Edhe ju shpeshherë deklaroni se Qeveria ka zero tolerancë ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit. Kjo do të thotë se ju e pranoni se ka krim të organizuar dhe korrupsion. A mund të na thoni, qoftë edhe dy – tri veprime tuaja që kanë goditur këtë krim dhe këtë korrupsion edhe që ju e pohoni që ekziston.

KRYETARI: Kryeministër, a ke përgjigje?

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Pushtetet janë të ndara, ekzekutivi, gjyqësori dhe legjislativi. Unë zhvilloj angazhimet e mia në përputhshmëri me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Mbështetja ime politike dhe financiare nuk ka munguar, nuk mungon dhe është e vetmja në Kosovë që funksionon, prandaj e kam theksuar dhe e ritheksoj edhe sot këtu fuqishëm – pa reforma në drejtësi nuk do të kemi sukses në implementimin e kriterëve demokratike si parakusht të domosdoshëm për t'u integruar sa më shpejt në strukturat e Bashkimit Evropian. Kur flas për kriteret demokratike, këto kriterë janë qoftë në legjislacion, qoftë në ekonomi, qoftë në politikë. Prandaj, të gjithëve ju ftoj, të bëhemi pjesë të këtyre reformave, t'i kërkojmë dhe t'i realizojmë dhe një nga çështjet prej më kryesore edhe të kësaj seance sot dhe të nesërme, janë edhe projektligjet që janë propozuar, që ndërlidhen drejtpërdrejt me Raportin e progresit dhe çdo ditë e vonuar është jo vetëm përgjegjësi e Kosovës, por edhe e të gjithë neve, edhe e Parlamentit, edhe e Qeverisë, edhe autoriteteve besa lokale, prandaj përkushtimi për zbatimin e kriterëve demokratike që dalin nga udhërrëfyesi ynë për të ardhmen evropiane dhe vizioni ynë për të ardhmen evropiane dhe parakushtet evropiane, është puna e përbashkët. Dhe, te projektligjet, e theksoj edhe një herë, që ndërlidhen me Raportin e progresit, me të ardhmen tonë evropiane, duhet t'i lëmë anash ndasitë politike apo partiake. Këto projektligje nuk janë ndoshta shumë populiste, por janë të domosdoshme për funksionimin e mirëfilltë të qeverisjes së mirë, të institucioneve demokratike dhe të perspektivës sonë evropiane. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Driton Tali, pyetje për ministren Justina Shiroka – Pula ose për ministrin Ahmet Shala.
E ke fjalën, deputet!

DRITON TALI: Faleminderit! Zonja ministre, për shkak se udhëheqësit e seancës së 1 prillit, kur u vendos për Strategjinë e energjisë 2009-2018, në kundërshtim me Rregulloren në fuqi të Kuvendit nuk ma dhanë shansin të pyes kur Qeveria me zor e futi “Kosovën B” në paketë me “Kosovën e re”, me arsyetimin se kështu ishte këshilluar nga këshilltarët e transaksioneve dhe nga konsulentët – miqtë tanë ndërkombëtarë, e tjera, e tjera. Prandaj ju pyes juve tash, zonja ministre, por edhe kushdo tjetër nga Qeveria, le të përgjigjet dhe të na tregoni saktësisht se kush janë këshilltarët e transaksioneve dhe ata

miqtë ndërkombëtarë? Vetëm se ju lutem, mos na thoni se janë po të njëjtit komediantë që në korrikun e vitit të kaluar na dolën para mediave krejt të buzëqeshur dhe na tregonin batuta, shtosa për “Kosovën e re” 2000 megavatesh. Nuk besoj se që i kemi dëgjuar përsëri po të njëjtit ata që deri në fund të shtatorit të vitit 2009 thoshin se “Kosova e re” 2000 megavatesh është shpëtimi i Kosovës, kurse nga dy javë më vonë – jo s’bën t’i ndërtojmë ato kapacitete për shkak të ndotjes së ambientit dhe krizës financiare. Shpresoj se nuk janë po të njëjtit ekspertë që i keni dëgjuar.

KRYETARI: Kryeministri po përgjigjet.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: I nderuar deputet, Tali,
Të nderuar deputetë,

E kam theksuar shpeshherë dhe dëshiroj ta ritheksoj edhe sot. Projektet madhore për zhvillimin ekonomik janë projekte të interesit nacional dhe shtetëror, por edhe të perspektivës sonë evropianë, perspektivës zhvillimore, krijimit të vendeve të reja të punës dhe përgjegjësi të tjera shtetërore. Janë katër-pesë projekte të cilat ne si Qeveria e Kosovës, si Parlament i Kosovës, si institucione të Kosovës, do të marrim vendimin gjatë këtij viti. Janë vendime këto të vonuara, por të domosdoshme dhe ju kisha ftuar të gjithëve, pyetjet për këto projekte madhore t’i drejtoni tek unë personalisht si kryeministër i Qeverisë së Republikës së Kosovës. Këto projekte i udhëheq Qeveria e Kosovës, unë jam kryeministri i Qeverisë së Kosovës. Projektet, edhe për “Kosovën e re” janë prioritete të cilat i kam prezantuar edhe në Kuvend, edhe autostradën, edhe Aeroportin, edhe privatizimin e PTK-së, edhe Hidrocentralin e Zhurit, janë projekte nacionale të cilat do të realizohen gjatë këtij viti. Të lutem!

Sa i përket projektit “Kosova e re” gjithçka është duke shkuar në agjendë të planifikuar, por nuk do të ketë kthim prapa. Vendimi është i Parlamentit. Urdhëroni, ndryshoni ju! E keni votuar, Qeveria e ka mbështetur, është vendimi më i drejtë i mundshëm, dhe ju falënderoj që e keni përsheptuar punën e Qeverisë për të implementuar projektin.

Gjithashtu dëshiroj të theksoj edhe çështjen tjetër të ngritur për debat sa i përket trasesë së autostradës. Ne kemi pasur ide, të lutem, kemi pasur ide sa i përket këtij projekti. Tani ky projekt ka filluar së realizuari. Kurrë një projekt i tillë, ajo ide e tillë nuk ka ardhur për t’u diskutuar në Parlamentin e Kosovës. Ne do ta sjellim për ta diskutuar dhe do të vendosim së bashku edhe trasenë, drejtimin, cili do të jetë interesi i zhvillimit ekonomik, cili do të jetë interesi i shtetit të Kosovës. Ne do të vendosim këtu, por deri më tani nuk ka ardhur as nga qeveritë e mëhershme, as nga Qeveria aktuale, do të vijë me kohë. Edhe sa i përket Aeroportit, gjithçka është duke shkuar në angazhimet tona të përbashkëta, konsultuese, natyrisht, me njerëzit të cilët janë të angazhuar në këtë drejtim, aspekte profesionale, po flas, por edhe sa i përket, gjithashtu privatizimit të PTK-së.

Të gjitha këto projekte do të jenë projekte të cilat do të realizohen në përpikërinë më të lartë të respektimit të ligjshmërisë, do të jenë të hapura, të konkurrencës së lirë dhe transparencës maksimale.

KRYETARI: Faleminderit! Deputet, a ke pyetje shtesë? Lexoni Rregullën 28 dhe e dini cila është koha dhe si kryeministri e shfrytëzon kohën, është çështje e kryeministrit. Lexojeni rregullën 28 të Rregullores së Punës të Kuvendit. Nuk ka temë këtu.
Deputet, a ke pyetje shtesë?

DRITON TALİ: Zoti kryeministër, është dashur për ta përfunduar fjalimin tënd të zjarrtë me bum-diada, veç ju mungoi kjo fjalë. Ju thatë, urdhëroni, ndryshojeni! Po ta kisha fuqinë tënde, me gjithë shpirt do ta kisha ndryshuar këtë projekt shumë të dëmshëm për Kosovën që e ke shty. Unë të pyeta, kush janë ata këshilltarë, ti nuk ma dhe përgjigjen. Pyeta edhe një herë, a janë po të njëjtit ata komediantë që na dilnin në televizor për të na kallëzuar për 2000-shin sa i mirë është projekti, s'na tregove a janë të njëjtit? Sidoqoftë, pse zoti Kryeministër kurrë s'na bën Ligjin për privatizimin e KEK-ut, të Postës. E kemi kërkuar, unë, atë ditë, në atë seancë nga dhjetë herë e kam kërkuar, e kam shkruar letrën. U injorua totalisht kështu, u merreshe me mua dhe nuk ma jepnit fjalën për replikë. Pse s'na e sillni Ligjin për privatizimin e KEK-ut, pse s'na sillni Ligjin për privatizimin e Postës? A mendoni që ka diçka më strategjike, më të rëndësishme për Kosovën, se sa qymyri i Kosovës, se sa KEK-u, se sa Posta, se sa ato xehe pak që i kemi? Nëse mendoni se ka...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit, deputet, kryeministri përgjigjet!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Fuqinë apo jo fuqinë politike edhe në Parlament e përcaktojnë qytetarët, jo as ti, as unë, por e përcakton vizioni i qytetarëve dhe natyrisht i leadershipit politik. Po e rikonfirmoj edhe këtu, agjenda në të gjitha këto projekte është e planifikuar, e konsultuar. Sa i përket këshilltarëve të transaksionit unë nuk merrem me ato çështje të aspekteve dhe procedurave tjera profesionale në ministrinë përkatëse. Prandaj, dua të theksoj, mos u shqetëso, nuk do të ketë rikthim prapa në ekonominë e planifikuar socialiste, por do të ketë vetëm ekonomi të lirë të tregut. Do të ketë, të lutem, do të ketë vazhdim të realizimit me përpikëri me agjendën që e kemi për "Kosovën e re" dhe kjo do të ndodhë. Kjo është punë e kryer, siç është ëndërruar se nuk do të mund të fillojë autostrada, ajo ka filluar dhe do të vazhdojë. Gjithashtu edhe sa i përket Aeroportit, edhe sa i përket privatizimit të PTK-së, por edhe kam lajmin tjetër të ri, që do të vazhdojë me projektin shumë serioz të hidrocentralit të Zhurit. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Faleminderit! Deputet Tali, është mirë ti ta formosh një grup që pastaj të bësh kërkesa...

Deputeti Riza Smaka, pyetje për ministrin Mahir Yagcilar.

RIZA SMAKA: I nderuar, zotëri ministër Yagcilar, Përkundër shumë e shumë reagimeve edhe në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe të ekzistimit të bazës legale adekuate për mbrojtjen edhe të shtretërve të lumenjve, gjithnjë, madje pandalshëm dhe për të qenë e keqja edhe më e madhe, kundërligjshëm gërryhen shtretërit e lumenjve në atë mënyrë, ndër të tjera, shëmtohen dhe dëmtohen rrjedhat natyrale ujore, shkaktohen erozione, deri te shterja e tyre. Po ashtu, gjatë transportimeve të rërës, të shtretërve të lumenjve, në masë të madhe dëmtohen rrugët e asfaltuara, madje shkaktohen aksidente trafiku, jo të rralla. Fjala është, zoti Ministër, pse nuk aplikohen dispozitat ligjore që janë të qarta, janë decitive, janë të sanksionuara, që janë miratuar në këtë Kuvend? Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën!

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: I nderuar kryetar i Parlamentit,
Të nderuar zëvendëskryeministra,

Të nderuar deputetë, ministra,

I nderuari deputet, zotëri Smaka,

Duke falënderuar për pyetjen, ju njoftojmë se Inspektorati i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, vazhdimisht është në funksion të kryerjes së detyrave të veta që dalin nga dokumentet ligjore në këtë lëmi. Janë inspektuar dhe evidentuar të gjithë operatorët që merren me shfrytëzimin e resurseve të rërës dhe zhavorrit në nivel vendi dhe të njëjtit janë urdhëruar që t'i nënshtrohen procedurës ligjore me pajisje, me pëlqimin mjedisor nga ana e Ministrisë, që obligon Ligji i mjedisit dhe Ligji për vlerësimin e ndikimit në mjedis. Ky intervenim i inspektoratit në masë të madhe ka pasur sukses, mund të them, sepse pjesa dërrmuese e operatorëve kanë aplikuar në Ministri për t'u pajisur me pëlqime mjedisore për veprimtarinë e tyre.

Komisioni profesional i Ministrisë, në bazë të aplikacioneve me dokumentacion nga operatorët, ka dal në terren dhe sipas arsyeshmërisë mjedisore një numri të konsiderueshëm të këtyre operatorëve u janë dhënë pëlqimet mjedisore për mbrojtjen e mjedisit gjatë zhvillimit të veprimtarisë, duke iu dhënë kushte obligative profesionale për t'u përmbajtur mbrojtjes së mjedisit gjatë nxjerrjes së këtyre resurseve të lumenjve.

Të gjithë operatorët tjerë që nuk janë pajisur me pëlqime mjedisore nga ana e Ministrisë, ne i kemi shpallur të jashtëligjshëm, ilegalë dhe ndaj tyre kemi parashtruar fletëparaqitje adekuate nëpër gjykatat komunale dhe po zhvillohen procedura gjyqësore.

Gjatë këtij aktiviteti në monitorimin e situatës nga ana e inspektorëve, situata në terren ishte shumë e pavolitshme, sepse kemi degradime të theksuara nga ana e eksploatuesve ... operatorëve legalë, në fakt të gjitha këto eksploatime bëhen nga një numër shumë i madh të eksploatuesve ilegalë. Ju informojmë se në Inspektoratin e Ministrisë së Mjedisit kemi një numër të vogël të inspektorëve e kjo është e pamundur të mbulojmë tërë territorin e vendit brenda një kohe të caktuar. Prandaj, është shumë e nevojshme që rreth këtij problemi shumë serioz në ndërprerjen e eksploatimeve ilegale, këtij problemi t'i qasemi së bashku me Komisionin e Pavarur për Miniera, me pushtetin lokal, sidomos me komunat dhe të kemi ...

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Deputet, a ke pyetje shtesë? Faleminderit!

RIZA SMAKA: Më parë, që edhe zotëri Shala disi e mohoi, çdo qeveri moderne e ka funksionin administrativ, mbikëqyrës. Nuk është ashtu si u komentua pak më parë. Po të ushtrohej edhe ky funksion, me siguri që edhe Ministria juaj, zotëri ministër, do të kishte qenë shumë më efikase, shumë më eficiente. Unë përshëndes angazhimet dhe përcaktimin tuaj, kam respekt, por jam ithtar i asaj që me të vërtetë të ndërpriten këto veprime ilegale, tepër të dëmshme për ambientin, për shëndetin, për ekonominë. Faleminderit shumë!

KRYETARI: Faleminderit! Faleminderit deputet, faleminderit ministër! 10 minuta pauzë, por i lus të gjithë deputetët, tani i kemi ligjet që duhet t'i votojmë, pas 10 minutave të jemi në sallë.

Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës.

3. Shqyrtimi i dytë i Propozim – Rregullores së Kuvendit

Komisioni për Mandate, Imunitete dhe Rregullore të Kuvendit ka shqyrtuar Propozim – Rregulloren e Kuvendit dhe ka parashtruar raportin me rekomandime për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

Raporti me rekomandime i komisionit funksional iu është shpërndarë deputetëve, më 14 prill 2010.

Para se të procedojmë me votimin e amendamenteve, ftoj kryetarin e Komisionit për Mandate, Imunitete dhe Rregullore të Punës së Kuvendit, deputetin Hydajet Hyseni, që para deputetëve të arsyetojë raportin me rekomandime.

HYDAJET HYSENI: I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Në bazë të rregullave 41, 46, 47 dhe 58 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni parlamentar për Mandate, Imunitet dhe Rregullore, paraqet për shqyrtim të dytë dhe miratim Rregulloren e re të Kuvendit, me ndryshime dhe plotësime të propozuara, të përfshira në Raportin e Komisionit të 10 marsit 2010, si dhe plotësimin e raportit të 22 prillit të këtij viti.

Ndërtimi dhe perfeksionimi i Rregullores së Kuvendit në çdo vend është një proces i gjatë dhe i ndërlikuar, por në Kosovë për arsye të gjendjes specifike ky proces shoqërohej edhe me një sërë ndërlikimesh dhe kufizimesh tejet specifike, për pasojë Komisioni për Rregullore dhe partnerët tanë nuk kanë pasur mundësi të hartojnë një rregullore tërësisht të re dhe për të mos qenë në kolizion me dispozitat përkatëse kushtetuese, si dhe disa nga formulat kufizuese afatshkurtra dhe ato afatgjata të propozimit gjithëpërfshirës.

Një rregullore tërësisht e re, mbetet synim për një të ardhme besoj jo shumë të largët. Në këtë fazë Komisioni ka synuar dhe mendoj ka arritur të realizojë harmonizimin e Rregullores me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, harmonizimin me referencat e saj në dokumentin e zotit Ahtisari, editimin si të përplasjes eventuale institucionale, ligjore me pranimë ndërkombëtare në Kosovë, ashtu edhe pritjes edhe rrjedhimisht vakuimit normativ kuvendor në kapërcjelljen midis dy legjislativave. Krahas kësaj Rregullorja e re mundëson funksionalizimin më të mirë dhe më efektiv të Kuvendit, përmirësimin e funksionit dhe funksionimit të pavarur të ndërlidhur, transparent, të balancuar dhe llogaridhënës midis pushteteve, raportin adekuat dhe përplotësues pozitiv – opozitiv, shumicë – pakicë, përshtatjen dhe saktësimin e afateve në procesin e ligjvënies, si dhe inkorporimin në rregullore të rekomandimeve nga Raporti i progresit.

Besoj shumë, zonja e zotërinj se ndryshimet e bëra do të lehtësojnë jo vetëm procesin e tranzicionit institucional, por edhe funksionimin më të mirë parlamentar dhe ndërinstitutional.

Me gjithë ndryshimet dhe përmirësimet e bëra, Rregullorja e propozuar e Kuvendin le për të dëshiruar, rrjedhimisht edhe për ripunim të mëtejshëm në dispozita të caktuara të saj dhe veçmas në anekset e saj.

Komisioni është përcaktuar që çështja si e strukturave dhe fushëveprimi i komisioneve, të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit, institucionet e pavarura, kompetencat e Kryesisë dhe menaxhimi i Kuvendit, si dhe fjalorthi parlamentar, të jenë objekt i punës së Komisionit për Rregullore, menjëherë pas miratimit të ndryshimeve të propozuara. Faza e ardhshme e ndryshimeve në rregullore besoj do të jetë rast i mirë edhe për përmirësime të tjera të natyrës përmbajtjesore, funksionale, teknike e gjuhësore, me gjithë faktin se edhe ky variant ka pasur një lekturë.

Anëtarët e Komisionit, deputetët nga komisionet tjera, ekspertë të jashtëm, si dhe ekspertë zyrtarë të komisionit, kanë punuar për një kohë të gjatë me përkushtim, në frymë kryesisht konstruktiviteti dhe konsensusi në tekstin e Rregullores.

Përfitoj nga rasti që t'u shpreh mirënjohjen për punën e bërë anëtarëve të Komisionit dhe veçmas drejtuesit të mëparshëm të Komisionit, zotit Ahmet Isufi, si dhe të falënderoj për ndihmën e dhënë ekspertët e Institutit Nacional Demokratik, Organizatën për Siguri dhe Bashkim Evropian, Komisionin Evropian, të ICO, juristëve tanë si dhe stafit administrativ të Departamentit Juridik të Kuvendit.

Besoj se kjo frymë konstruktive, konsesuale do të përshkojë edhe shqyrtimin e sotëm.

Më lejoni kolegë të nderuar deputetë, që duke ju ftuar për mbështetje amendamenteve të parashtruara, të shpreh edhe qëndrimin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, i cili është përcaktuar të mbështetë ndryshimet e propozuar, me gjithë vërejtjet eventuale që ka në dispozita të caktuara të Rregullores.

Me gjithë mangësitë evidente, kjo rregullore do të avancojë padyshim funksionimin demokratik të Kuvendit tonë. Thonë: “ Nuk i bën shteti ligjet, por ligjet e bëjnë shtetin”, do të mund të thuhej edhe në mënyrë analoge e bën Kuvendi Rregulloren, por edhe më shumë e bën Rregullorja Kuvendin. Ju faleminderit për vëmendje!

KRYETARI: Faleminderit!

Në sallë kemi 86 deputetë. Nëse e donë fjalën kryetarët e grupeve parlamentare, ua kisha dhënë fjalën. Nuk ka nevojë. Sipas nenit 76 të Kushtetutës, për Rregulloren e Punës thuhet: Rregullorja e Punës së Kuvendit miratohet me 2/3 e votave të të gjithë deputetëve të tij dhe përcaktojnë organizimin e brendshëm në mënyrën e punës së Kuvendit. Pra, për miratimin e amendamenteve dhe tekstit në tërësi të Rregullores së Kuvendit, kërkohen së paku 80 vota “për”, do të thotë, edhe për çdo amendament edhe për Rregulloren në tërësi kërkohen 80 vota “për”.

Të nderuar deputetë,

Vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara sipas radhës së paraqitur në raport nga komisioni funksional.

Në sallë kemi 86 deputetë.

Kush është pa kartelë? Tre. Faleminderit!

Atëherë, hyjmë në procedurën e votimit.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë amendamentin nr. 1.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 86 vota “për”, 1 “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti nr. 1.

Amendamenti 2

Votojmë tash:

Konstatohet se me 84 vota “për”, 1 “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3

Votojmë tash:

Konstatohet se me 85 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 3.

Amendamenti 4

Votojmë tash:

Konstatohet se me 86 vota “për”, 1 “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 5

Votojmë tash:

Konstatohet se me 84 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 5.

Amendamenti 6

Votojmë tash:

Konstatohet se me 84 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 6.

Amendamenti 7

Votojmë tash:

Konstatohet se me 83 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 7.

Amendamenti 8

Votojmë tash:

Konstatohet se me 82 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 8.

Amendamenti 9

Votojmë tash:

Konstatohet se me 85 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 9.

Amendamenti 10

Votojmë tash:

Konstatohet se me 86 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 10

Amendamenti 11

Votojmë tash:

Konstatohet se me 83 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 11.

Amendamenti 12

Në sallë janë 88 deputetë.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 84 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 12.

Amendamenti 13

Votojmë tash:

Konstatohet se me 86 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 13.

Amendamenti 14.

Votojmë për amendamentin e komisionit funksional.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 8 asnjë vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 14.

Amendamenti 15

Votojmë tash:

Konstatohet se me 81 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 15.

Amendamenti 16

Votojmë tash:

Konstatohet se me 88 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 16.

Amendamenti 17

Votojmë tash:

Konstatohet se me 81 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 17.

Amendamenti 18

Votojmë tash:

Konstatohet se me 85 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 18.

Amendamenti 19

Votojmë tash:

Konstatohet se me 86 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 19.

Amendamenti 20

Votojmë tash:

Konstatohet se me 80 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 20.

Amendamenti 21

Votojmë tash:

Konstatohet se me 83 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 21.

Amendamenti 22.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 85 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 22.

Amendamenti 23

Votojmë tash:

Konstatohet se me 84 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 23.

Amendamenti 24

Votojmë tash:

Konstatohet se me 83 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 24.

Amendamenti 25

Votojmë tash:

Konstatohet se me 85 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 25.

Amendamenti 26

Votojmë tash:

Konstatohet se me 86 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 26.

Amendamenti 27

Votojmë tash:

Konstatohet se me 82 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 27.

Amendamenti 28

Votojmë tash:

Konstatohet se me 74 vota “për”, 1 “kundër”, asnjë abstenim, nuk miratohet amendamenti 28.

Deputetë të nderuar, keni vëmendje, mos harroni të votoni me elektronikë. Do të thotë, amendamenti 28 nuk miratohet.

Vazhdojmë me radhë.

Amendamenti 29

Votojmë tash:

Konstatohet se me 89 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti 29.

Amendamenti 30

Votojmë tash:

Konstatohet se me 87 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti 30.

Amendamenti 31

Votojmë tash:

Konstatohet se me 87 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti 31.

Amendamenti 32

Votojmë tash:

Konstatohet se me 83 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti 32.

Amendamenti 33

Votojmë tash:

Në sallë janë të pranishëm 89 deputetë.

Konstatohet se me 85 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti 33.

Amendamenti 34

Votojmë tash:

Konstatohet se me 85 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti 34.

Amendamenti 35

Votojmë tash:

Konstatohet se me 82 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti 35.

Amendamenti 36

Votojmë tash:

Konstatohet se me 80 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti 36.

Amendamenti 37

Votojmë tash:

Konstatohet se me 86 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti 37.

Amendamenti 38.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 85 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti 38.

Amendamenti 1 nga Raporti plotësues i komisionit funksional. Votojmë tash: Raporti plotësuesi, Amendamenti 1 i raportit plotësues.

Konstatohet se me 84 vota “për”, 1 “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti 1 nga Raporti plotësues i komisionit funksional.

Amendamenti 39.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 84 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti 39.

Amendamenti 40

Votojmë tash:

Konstatohet se me 82 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti 40.

Amendamenti 41.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 85 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti 41.

Amendamenti 42.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 82 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti 42.

Amendamenti 43.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 81 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti 43.

Amendamenti 44.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 67 vota “për”, 6 “kundër” dhe 2 abstenime, nuk miratohet amendamenti 44 i komisionit funksional.

Tani votojmë amendamentin e Komisionit për Integritet Evropian, pa përkrahjen e komisionit funksional.

Votojmë tash:

Votojmë për amendamentin 44 të Komisionit për Integritet Evropian, pa përkrahjen e komisionit funksional.

Regjia, e bën 44 b) amendamentin.

Votojmë tash:

Regjia s’po funksionon.

Të nderuar deputetë,

Do të thotë, propozimi i komisionit funksional nuk shkon. Realisht, ne duhet të votojmë variantin e Komisionit për Integritet Evropian, që është pa përkrahjen e komisionit funksional. Po, amendamentet duhet të votohen, nuk mund të shkojë pa votim.

Lus regjinë të përgatitet për votim të Amendamenti 44, varianti i Komisionit për Integritet Evropian.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 57 vota “për”, 13 “kundër” dhe 11 abstenime, nuk shkon as ky variant. Mbetet varianti i parë. Mbetet varianti ekzistues.

Vazhdojmë.

Votojmë për amendamentin 45.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 81 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti 45.

Lus deputetët të kenë vëmendje në votim, ju lutem!

Amendamenti 46.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 83 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti 46.

Amendamenti 47.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 82 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti 47.

Amendamenti 48.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 83 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti 48.

Amendamenti 49.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 82 vota “për”, 1 “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti 49.

Amendamenti 50.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 85 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti 50.

Amendamenti 51.

Është amendamenti i Komisionit për Integritet Evropian, me përkrahjen e komisionit funksional.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 83 vota “për”, 1 “kundër” dhe 2 abstenime, miratohet amendamenti 51.

Amendamenti 52 i komisionit funksional,

Votojmë tash:

Konstatohet se me 86 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti 52.

Amendamenti 53.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 84 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti 53.

Amendamenti 54.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 80 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti 54.

Amendamenti 55.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 86 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti 55.

Tani kemi Amendamentin 2, nga Raporti plotësues i komisionit funksional.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 82 vota “për”, 2 “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti 2 nga Raporti plotësues i komisionit funksional.

Dhe, kështu, kemi përfunduar votimin e amendamenteve.

Tani radha është për ta votuar Rregulloren e Punës në tërësi.

Prezentë janë 91 deputetë.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 90 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, Kuvendi miratoi Rregulloren e vet, të Kuvendit.

(Duartrokitje)

Vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Kuvendit i kanë parashtruar raportin me rekomandime për shqyrtim në Kuvend.

Para se të procedojmë me votimin e amendamenteve, ftoj kryetarin e Komisionit funksional për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, apo raportuesin e komisionit që para deputetëve të arsyetojë Raportin me rekomandime. Fjalën e ka deputetja Melihate Tërmkolli.

MELIHATE TËRMKOLLI: Deputetë të nderuar, Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media ka punuar Ligjin për Shërbimin Civil, ka bërë një punë po thuaj se nga fillimi dhe krejt kjo si pasojë e asaj që është kërkuar ligji të kthehet në Qeveri për t’u ripunuar, por kjo nuk ka ndodhur.

Nga 105 nene, sa i ka projektligji, janë punuar 203 amendamente. Grupi punues dhe Komisioni kanë bërë, mendoj, një punë grandioze duke pasur parasysh se është fjala për një ligj shumë të rëndësishëm, kanë bërë një punë me përgjegjësi të plotë.

Amendamentet e punuara lidhen me çështjet esenciale, me çështje substanciale të funksionimit të Shërbimit Civil, për një shërbim civil të reformuar, të depolitizuar dhe profesional, duke evituar kështu tendencën e Qeverisë për një shërbim civil jo profesional dhe të politizuar.

Amendamentet janë punuar për 3 muaj, në bashkëpunim të plotë edhe me ekspertët vendorë dhe ndërkombëtarë, në kuptim të harmonizimit dhe përafrimit me standardet evropiane. Kemi punuar me Fondin Monetar Ndërkombëtar, me ekspertët, me DFID-in, SIGMA-n, ICO, Bankën Botërore e të tjerë, sugjerimet e të cilëve Qeveria e Kosovës nuk i ka përfillë dhe duke i shpërfillur këto, na ka nxjerrë edhe një punë shtesë dhe po shihet shumë mirë se edhe me shpërfilljen nga Fondi Monetar çfarë po ndodhë me vendin tonë.

Unë i falënderoj të gjithë ekspertët të cilët na kanë ndihmuar në punën tonë për ta bërë një ligj të mirë.

Punën e komisionit e kanë përcjellë edhe disa pengesa. Kemi humbur një muaj punë për shkak të mungesës së sallave për punë në Parlamentin e Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Ky komision ka humbur një muaj punë, sepse ky Parlament nuk siguron salla për punë për deputetët dhe komisione apo grupet punuese.

Kryetari i Parlamentit ka dalë me një deklaratë publike për gjëja vonesën e ligjeve të këtij komisioni në kohën kur ky komision ka punuar me intensitet të plotë në të gjitha ligjet që i ka pasur dhe i ka duke i punuar. Ai ka kërkuar madje edhe shkarkimin e kryetarit të Komisionit, zotit Esat Brajshorit, në kohën kur ky kryetar e kryen punën e vet me korrektësi të plotë. Deklaratat e kryetarit të Parlamentit janë trajtuar fyese për komisionin, të pabaza dhe joreale. Ka shumë ligje, përfshirë edhe këtë Rregullore që e miratuam sot, e cila është filluar të punohet para dy viteve, ka shumë ligje të cilat janë në procedurë që një vit, një vit e gjysmë e më shumë dhe të tjera për të cilat nuk thuhet asnjë se janë vonuar dhe nuk kërkohet për asnjërin prej kryetarëve shkarkim nga komisioni. Është një qëndrim totalisht selektiv, është një qëndrim diferencues edhe diskriminues nga ana e kryetarit të Parlamentit, ndoshta edhe të Kryesisë.

Janë dhënë rekomandime edhe nga komisione të tjera. Unë po e potencoj vetëm njërin prej tyre. Rekomandimi i Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi është pa koment dhe është i paprecedent, është i pari dhe ndoshta do të mbetet i fundit në historinë e parlamentarizmit në Kosovë që ky komision nuk e ka gjetur madje asnjë amendament të mirë, që qenka i pranueshëm për këtë projektligj. Mendoj se kjo krejt tregon për një urrejtje patologjike, fatkeqësisht, një urrejtje patologjike që ka ndodhur vetëm në kohën e regjimit të Beogradit dhe më vjen shumë keq që mbase ia keni kaluar, madje edhe duke e personalizuar, duke e personalizuar një ligj i cili nuk guxon të personalizohet, sepse është në interesin e qytetarëve të Kosovës, ose së paku do të duhej ta kuptonim si të tillë dhe do të duhej ta kuptonim që ky komision ka punua pikërisht në këtë interes.

Deputetë të nderuar,

Unë ju thërrasë që ta votoni ligjin, në fakt projektligjin me amendamentet e komisionit funksional. Natyrisht, është vendimi i juaj si deputet të Parlamentit, a do të votoni një ligj me amendamente, në interes të qytetarëve dhe në interes të institucioneve, apo do të votoni për urrejtjen patologjike. Unë dua të besoj që do të votoni për të parën. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Vetë fjala që kryetari i komisionit nuk raporton, tregon që ai nuk është aq i gatshëm dhe i aftë ta kryej detyrën e vet. Unë ia japë fjalën Bahri Hysenit. Jo, nuk ka replikë, nuk e ke marrë fjalën me kohë. Bahri Hyseni e ka fjalën!

(Reagim nga salla)

KRYETARI: T'i je kryetar i komisionit dhe duhet ta udhëheqësh komisionin.

(Reagim nga salla)

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti kryetar,

Të nderuar kolegë deputetë,
Të nderuar zëvendëskryeministra,
Anëtarë të Qeverisë,
Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi i ka shqyrtuar shumë me vëmendje amendamentet e komisionit funksional dhe paraprakisht ju them që unanimisht e kemi votuar të gjithë anëtarët e Komisionit për Legjislacion. Dhe, ju them që në këtë takim ka munguar vetëm nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës dhe zoti Bajram Kosumi, ndërsa të gjithë të tjerët unanimisht. Nuk kemi asnjë qëllim, e kuptojmë shumë qartë që Ligji për Shërbimin Civil është i domosdoshëm dhe do të duhej të aprovohej sa më parë.

Por, vetëm para jush po i potencoj disa nga amendamentet.
Së pari, janë 110 dispozita të reja, ndërsa krejt ligji i ka pasur 100 nene. Janë 50 dispozita të cilat janë fshirë nga ligji ekzistues, nga projektligji. Dhe unë po i përmendi vetëm disa çështje, të cilat, po t'i kalonim si komision, Projektligji do të mbetej në sirtarë dhe nuk do të zbatohet asnjëherë.

Vëni re, po e lexoj amendamentin 49, sepse në raportin përfundimtar kanë lëvizur për dy amendamente. Thotë, neni 14.4 fshihet dhe riformulohet: “Anëtarë të komisionit”, është fjala për emërime publike, “nuk do të jenë ministri, deputeti i Kuvendit, shërbyesit civilë ose këshilltari politik në një institucion shtetëror”. Ne po e shtrojmë dilemën, nëse nuk janë këto katër kategori, kush do të jetë?

Vazhdojmë më tutje. Amendamenti 50, që bie tash ndesh komplet edhe me Kushtetutën, por edhe me vetë amendamentin që e lexova dy minuta përpara apo një minutë. Thotë: shtohet pikë e re. Formulimi si vijon: Komisioni ka këtë përbërje: një anëtar emërohet nga presidenti i Republikës së Kosovës. Unë po e shtroj dilemën, kënd ka për ta emëruar presidenti i Republikës së Kosovës kur nuk ka të drejtë shërbyes civilë, s’ka të drejtë këshilltarë, s’ka të drejtë deputetë, s’ka të drejtë ministra. Po e marrim që e emëron dikë prej qytetarëve. Presidenti i Republikës së Kosovës, vazhdon, dy anëtarë nga shoqëria civile propozohen nga presidenti i Republikës së Kosovës. Më nuk flet kush i emëron, por propozohen nga shoqëria civile. Vazhdon më tutje: Kuvendi i Kosovës do të emërojë dy anëtarë, prandaj shtrohet dilema, kënd do ta emërojë Kuvendi i Kosovës, s’ka të drejtë deputetë, s’ka të drejtë shërbyes civilë, s’ka drejtë dhe nga kush do t’i vijë propozimi?

Në rend të parë duhet ta kuptojmë që Kushtetuta e Republikës së Kosovës i jep shumë qartë kompetencat e presidentit të Kosovës dhe nëse duhet 5 institucione të merren për një Komision të Shërbimit Civil, ajo nuk do të jetë e zbatuar në praktikë dhe, fundi i fundit, zyrtarët e lartë publikë apo sekretarët e përhershëm dhe kryeshefat ekzekutiv janë ata të parët të cilët do të kenë barrën pikërisht për shërbimin civil dhe për menaxhimin e institucioneve.

Mandej, amendamenti tjetër 51, thotë: Presidenti i Republikës së Kosovës, në konsultim me kryeministrin, me anëtarët e Kryesisë së Kuvendit e zgjedh kryesuesin e një komisioni. Unë po e shtroj këtë çështje. Ku janë kompetencat e Kryesisë së Kuvendit të vendos për shërbimin civil dhe çka po konsultohen organi më i lartë – Kuvendi me presidentin, me Kryesinë për ta bërë një kryesues të një komisioni që ka të bëjë me intervistat e zyrtarëve publikë, është kundër kushtetuese. Nuk ia lejon as Kryesisë së Kuvendit, as Kuvendit, sepse ne nuk mund t’i zgjedhim shërbyes civilë që i kemi edhe brenda Parlamentit të Kosovës.

Amendamenti 52, vazhdon, thotë: Komisioni është përgjegjës për të gjitha çështjet kontraktuese, në këtë rast, domethënë, Komisioni e merr rolin e organit punëdhënës, është Qeveria. Një komision prej 6 – 7 vetëve, që do të jenë jashtë institucioneve, është edhe punëdhënës.

Më pastaj, amendamenti tjetër, thotë: Në rast se hapet një vend i lirë, për shembull, për një sekretar apo zyrtar të lartë, Komisioni duhet të shpall edhe shpalljen publike. Unë po ju pyes: A mund të bëjnë komisionet të cilat formohen për intervistime të kandidatëve edhe shpallje publike, t'i ftojnë ose në bazë të cilit institucion. Unë nuk do të ndalem në të gjitha amendamentet, por edhe një herë ju them, të nderuar kolegë deputetë, interesi ynë është ta kemi Ligjin e Shërbimit Civil, por ta kemi një ligj që është i bazuar në Kushtetutë, që është i zbatueshëm në praktikë dhe unë nuk po ndalem në të gjitha amendamentet. Unë nuk them që janë 200 amendamente, nuk kanë nevojë. Janë disa amendamente të cilat e përmirësojnë edhe terminologjinë, edhe përmirësojnë diçka, mirëpo janë mbi 50 amendamente, që s'po ndalem, të cilat nuk kemi mundësi pa i harmonizuar, sepse janë kundër kushtetuese dhe nuk do të zbatohen asnjëherë në praktikë, sepse nuk është treguar kënd dhe si duhet me vepruar.

S'po ndalem, ka edhe shumë amendamente tjera. Por edhe një herë po ju them, Komisioni në mënyrë unanime, bile kemi ndërprerë edhe takimin dhe nuk kemi pasur rrugë tjetër. Kemi dhënë rekomandimin për herë të parë, që është pak ndoshta edhe interesant. Por, kemi dhënë një rekomandim që projektligji edhe nëse votohet nga ky parlament, si është votuar në parim, nuk bëjmë asnjë lëshim, sepse Projektligji është hartuar nga ekspertët. Projektligji është shumë i mirë. Ka pasur nevojë, ndoshta, ndonjë modifikim dhe e kemi dhënë edhe një propozim tjetër, që së paku të ulemi, t'i harmonizojmë këto amendamente të cilat nuk mund të zbatohen në praktikë, dhe nëse zbatohen, atëherë do të ishin antikushtetuese. Ju faleminderit!

KRYETARI: Kryetarët e komisioneve tjera, a e donë fjalën? Nuk e donë. Atëherë, shkojmë sipas radhës së deputetëve. Fjalën e ka deputeti Naim Rrustemi. Mirë, më fal Naim! Shefat e grupeve parlamentare. Jo, ndoshta duhet edhe të debatojmë dhe ta marrim një vendim, prandaj për rekomandimet po votojmë, nuk po diskutojmë për të tjerat, por unë nuk dua t'jua mohoj të drejtën deputetëve të flasin në këtë rast. Por, fillimisht, shefat e grupeve parlamentare a e donë fjalën? Ramë Buja e ka fjalën.

RAMË BUJA: Zoti kryetar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Zotëri zëvendëskryeministra dhe ministra,

Unë besoj që nga ky konfuzion i krijuar mes komisioneve do të duhej një kohë për t'u harmonizuar këto gjëra dhe pastaj seancës t'i vijë një qëndrim unik, në mënyrë që deputetët të dinë, ta kenë të qartë mirë se për çka të votojnë. Nuk do të bëj sqarim më shumë për ato 203 amendamente, që janë dyfish më shumë se sa Ligji, por e them që një kohë duhet, dhe unë propozoj, meqë kemi seancë edhe nesër, që nesër, gjer nesër në të vërtetë, të ulën këto komisione bashkë dhe të harmonizojnë qëndrimet e tyre dhe pastaj t'ia sjellin Kuvendit këto qëndrime të harmonizuara dhe pastaj ne t'i votojmë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ismet Beqiri e ka fjalën, pa kartelë ose me kartelë të Arsimit a të Kolës. Mirë. Ismet Beqiri, me kartelën e Kolë Berishës.

ISMET BEQIRI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Unë vetëm po i bashkëngjitëm asaj që na ka krijuar konfuzion kjo pjesa e rekomandimeve të komisioneve. Absolutisht duhet çmuar punën që e ka bërë padyshim edhe komisioni kompetent, megjithatë për t'iu ikur të gjitha këtyre konfuzioneve dhe për të dëshiruar, dhe dëshira e të gjithë neve është që të dalë një ligj ashtu çfarë e meritojnë shërbyesit civilë. Për nesër nuk e besoj që kjo mund të ndodhë, të përgatitet harmonizimi, por unë propozoj, në emër të Grupit, që kjo të ndodhë në seancën e 13 majit. Sot të merret vendim sepse, nëse themi në një seancë të radhës, ekziston ai rreziku që nuk bëhet asnjëherë harmonizimi ose vonohet. Për të qenë në nivel të detyrës të gjithë ne, në përkushtimin që shërbyesit tanë civilë të kenë një ligj të mirëfilltë, propozoj që grupet, gjegjësisht komisionet, gjithmonë duke pasur, unë e kam fjalën edhe për Ligjin që ka të bëjë me pagat e nëpunësve, se lidhen, kanë vlefshmëri ose varshmëri njëra me tjetrën. Duke e çmuar gjithmonë edhe punën e atyre që i kanë bërë amendamentet, por edhe në anën tjetër duke parë se flitet që ka eventualisht edhe amendamente që nuk janë konform, sipas vlerësimit të komisioneve, Kushtetutës, obligim mbetet i këtyre komisioneve, por sot unë ju kisha lutur, propozoj që kjo të caktohet. E dini se është bërë rendi i ditës, e keni bërë zotëri kryetar, dhe nuk është seanca e 13 majit e ngarkuar, andaj unë kisha propozuar që këto dy pika të harmonizoheshin, veçmas kjo e para, të caktohet për 13 maj. Përndryshe, ne jemi shumë në konfuzion. Mund të zgjatet debati, por rezultati ka për të ardhur, ndoshta edhe këtu. Ky është propozimi im dhe i grupit.

KRYETARI: Ardian, e do fjalën? Fjala deputetit Ardian Gjini!

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Unë mendoj se vlen të përcillet edhe mendimin e grupit parlamentar për këtë çështje. Është krijuar konfuzion, është konfuzion. I kemi dy komisione parlamentare, të cilat mendojnë ndryshe. Shihet që është bërë një punë e madhe, se realisht na kemi qenë gjithnjë kundër që të ketë kaq shumë amendamente, mirëpo kur hartohen 200 amendamente prej një komisioni, atëherë me të vërtetë dikush ka punuar. Sidoqoftë, e kemi një situatë në të cilën besojmë se nuk mund ta kalojmë ligjin, ligj i cili është tepër me rëndësi.

Në këtë situatë, ne mendojmë se është mirë që t'iu jepet kohë dy komisioneve, që të kenë mundësi të provojnë t'i harmonizojnë qëndrimet e veta, të provojnë ta filtrojnë ligjin, t'ju jepet edhe një afat. Përndryshe, në këtë situatë, edhe një herë po them, mendojmë se një ligj tepër me rëndësi mund të mos kalojë si duhet, mund të kalojnë amendamente të ndryshme dhe t'i hupet efektiviteti ligjit. Do të thotë, ne e dimë se ligji e ka njëfarë organizimi të vetin. Edhe nëse dikush ka amenduar ligj, ato amendamente janë të lidhura në mes veti dhe nuk mund disa të kalojnë e disa të mos kalojnë në bazë të dëshirës e cila mund të lindë këtu në Kuvend.

Duke e parë këtë rrezik, mendoj se është tejte e domosdoshme që komisionet të provojnë të punojnë bashkë dhe të na e sjellin një ligj i cili mund të jetë funksional, si tërësi. Nëse një gjë e tillë nuk ndodhë, ne nuk mund të kalojmë ligje të këqija. Ka njerëz që thonë – më mirë një ligj i keq, se pa ligj. Mendoj se është teori e gabueshme kjo. Ligji i keq shkakton problem, ligji i keq nuk është si një objekt, s'është funksional. Ligjet e këqija na shkaktojnë shumë telashe në shërbimin civil, na shkatërrojnë shërbimin civil. Kështu që, edhe një herë po e përsëris propozimin, mendoj se e tha në një mënyrë zoti Beqiri. Le të provojnë komisionet të punojnë, të harmonizojnë sa mund të harmonizohet. Nëse kurrësi nuk mund të harmonizojnë, mendoj se për Kosovën është më mirë që ligj të

kthehet komplet, sesa të votohet me copa – copa dhe të mos jetë funksional. Ju faleminderit!

KRYETARI: Esat Brajshori e ka fjalën!

ESAT BRAJSHORI: Kryetar,
Kabinet qeveritar,
Të nderuar kolegë,

Zakonisht kështu marrin udhë punët kur i zoti i shtëpisë krijon një fushatë disa javore dhe mujore. Të lutem, unë jam deputet, kam të drejtën e fjalës. Unë nuk i di arsyet e juaja. Çështja e këtyre projektligjeve, është një çështje me cilën është marrë komisioni shumë seriozisht. Mund të kemi dallim në koncept për ndërtimin e shërbimit civil, që është e drejtë, që duhet të debatohet edhe në mes komisioneve dhe të harmonizohen gjërat. Nuk jemi kundër, kemi debatuar gjatë, kemi bashkëpunuar shumë gjatë por ju, zoti kryetar, keni ngrehur një fushatë të çuditshme, për mua asnjëherë e kuptueshme dhe asnjëherë nuk i kam kuptuar arsyet tuaja në adresë të Komisionit për Administratë Publike dhe në adresën time personalisht.

Më vjen keq, sinqerisht, për nivelin e debatit dhe shumë po mundohem ta ruaj një pikë respekti akoma për juve, që e kam ushqyer shumë gjatë. Unë po iu përgjigjem, po iu përgjigjem sjelljeve tuaja që nuk korrespondojnë me një kryetar të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Sinqerisht, jam munduar ta ruaj një respekt të jashtëzakonshëm. Nuk i kuptoj arsyet, le të jenë në ndërgjegjen tuaj.

Tani kemi ardhur në këtë situatë, kur një Komision për Legjislacion dhe Gjyqësi ka shqyrtuar amendamentet e Komisionit për Administratë Publike dhe ka gjetur, sipas tyre, shkelje të Kushtetutës në disa amendamente. Ne njerëz jemi dhe mund të debatojmë mbi këtë çështje. Nuk është emergjente sa e keni bërë, pavarësisht nga paralajmërimi i grevave. Njerëzit janë të kuptueshëm, kanë biseduar me federatat, sindikatat e federatës të shërbyesve civilë. Nuk mund dhe nuk duhet bërë nën presion gjërat, se kështu përfundojnë zakonisht. Nuk mund të jemi as komisioni ynë më i mirë nga gjithë ky Kuvend, qysh duket nga fillimi. Ka zgjidhje çdo gjë, nëse ka vullnet të mirë, por në qoftë se në fillim ngrihet një fushatë çfarë ka ndodhur, sigurisht që gjërat do të vijnë në këtë pikë. Unë nuk jam për këtë metodë, nuk jam për këtë mentalitet, nuk jam për njëmendësi, sepse kërcënohet demokracia e këtij vendi.

U jam falënderues disave nga kryetarët e komisioneve tjera që më kanë thirr për të dhënë shpjegime dhe kemi përfunduar në një gjetje shumë të mirë te ato nene, te ato amendamente, ku ata kanë pasur vërejtje. E them edhe një herë, është për keqardhje mënyra dhe qasja e juaj, zoti kryetar. Do të kemi raste edhe tjera që të debatojmë, por është një shembull i keq. Ne si grup parlamentar jemi të gatshëm që me shumicë votash të bisedojmë dhe të krijojmë një mundësi harmonizimi në mes komisioneve. Ju faleminderit!

KRYESUESI SABRI HAMITI: Kryetari, Jakup Krasniqi, do që si deputet të flasë.

JAKUP KRASNIQI: Pasi fjala dhe mikrofoni shfrytëzohet për opinionin, jo për punën që duhet bërë, edhe unë po e shfrytëzoj rastin që si deputet t'i drejtohem opinionit dhe jo deputetit që foli.

Mendoj se gjithë ky Kuvend e di që nga fillimi jam përpjekur dhe kam balancuar punën në Kuvend në mes pozitës dhe opozitës dhe konsideroj që më shumë fjalë dhe më shumë hapësirë i kam krijuar opozitës se pozitës, në të shumtën e rasteve. Mendoj që në punën e Parlamentit kam sjellë risi në punë, jo vetëm në Kuvend, por edhe në komunikimin me grupet parlamentare dhe komunikimet me komisionet parlamentare.

Deputeti që foli, është deputeti që më së paku i është përgjigjur mbledhjeve që i ka mbajtur kryetari i Kuvendit me kryetarët e komisioneve, që diku në herë në muaj e kemi mbajtur nga një mbledhje. Do të thotë, është kryetari që më së paku iu është përgjigjur atyre thirrjeve.

Tjetër, unë ju them sinqerisht, nuk kam pasur kurrigjë personale në kritikën që e kam thënë në adresë të komisionit, as me kryetarin e komisionit dhe as me komisionin. Përkundrazi, unë jam përpjekur dhe nuk është hera e parë që kryetari i Kuvendit ka kritikuar kryetarët e komisioneve. Unë po e përmendi që kam kritikuar kryetarin e komisionit që udhëhiqet nga Partia Demokratike, kam kritikuar kryetarin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, që ka qenë kryetar i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë kur ka vonuar punën, por ndërkohë ata e kanë rikthyer dhe kanë punuar mirë dhe ne e kemi falënderuar që i ka kryer ligjet, por e kemi kritikuar. Kemi kritikuar për punë edhe kryetarin e Komisionit për Integritet Evropian, por jo për inat, por thjeshtë krejt në shërbim të punës së Kuvendit dhe, në fund, kam kritikuar punën e kryetarit të Komisionit për Administratë Publike dhe Media, përsëri jo nga pozitat personale, por pse komisioni pas dy muajve ka kërkuar afat shtesë për ligjin. Kryesia e Kuvendit i ka dhënë afat shtesë 15 ditë. Komisioni nuk e ka kryer punën dhe e ka vonuar ligjin gati edhe për 3 muaj. Në Rregulloren e Punës së Kuvendit shkruan: “Nga miratimi i ligjit, në parim, deri në lexim të dytë, janë deri në dy muaj”, Komisioni këtë ligj e ka quar diku rreth 5 muaj, do të thotë i ka kaluar të gjithë kufijtë e lejuar, ka shfrytëzuar kohë më shumë edhe njëherë më shumë se sa që e ka në Rregulloren e Punës. Prandaj, edhe në mbledhjen e fundit nuk ka qenë prezentë, andaj e kam thënë një vërejtje publike, jo për mua, por që Kuvendi të kryej obligimet e veta që i ka me ligj, që i ka me Kushtetutë.

Edhe një arsye tjetër ka qenë pse e kam kritikuar këtë. Arsyeja tjetër është se në Raportin e progresit të vitit të kaluar është kërkuar që ky ligj të miratohet dhe të përshpejtohet. Do të thotë, janë të gjitha këto vonesa që janë bërë, që më kanë shtyrë dhe nuk e kam kritikuar vetëm kryetarin e Komisionit. Në fakt, kam kritikuar grupet parlamentare, që t'i shqyrtojnë anëtarët e tyre që i kanë në këtë komision, për t'i kryer detyrat veta. Dhe, në fund, me gjithë vonesat që janë bërë, s po dua të hyj në shumë parregullsitë që kanë qenë atje, se ndoshta ekspertët që kanë punuar fillimisht në ligj në Qeveri, kanë qenë edhe ekspertë që e kanë prishur ligjin. Kjo është një çështje tjetër dhe ndoshta dikush tjetër do të duhej ta verifikonte këtë dhe jo unë, por po dua të them që jo vetëm këtë komision, por edhe komisionet tjera dhe nga komisionet tjera, në mbledhjet që kam pasur me kryetarët e komisioneve tjera, kam kërkuar që të përshpejtohet puna në amendamentimin e ligjeve, se vërtet kemi nevojë që ta përshpejtojmë miratimin e ligjeve. Në ndonjë rast kam kërkuar që mos të jetë afati 2 muaj, po edhe më shpejt se dy muaj komisionet ta amendamentojnë ligjin dhe kjo jo për çështjen time personale, por që Kuvendi i Kosovës të jetë efikas dhe ky Kuvend duhet të jetë më efikas. Mua më vjen keq që deputeti Esat Brajshori e ka marrë krejt këtë personale. Ai e di shumë mirë që asgjë personale nuk kam, jo vetëm me Esat Brajshorin, po me asnjë deputet të Kuvendit të Kosovës. Andaj, le t'i kryejnë ata punët mirë dhe unë mendoj që do t'i falënderoj për punë. Por, nëse çdo komision e vonon ligjin 5 a 6 muaj, mos të mendojë asnjë kryetar i

komisionit se do të marrë lëvdata. Do të thotë, nëse ai konsideron se e ka kryer detyrën e vet për të prishur një ligj, si kryetar i komisionit, për çka edhe paguhet, është çështje e tij dhe opinionin le ta vlerësojë, le ta vlerësojë edhe ky Kuvend, por mos të qet, mos të mundohet paaftësinë e vet dhe papërgjegjësinë e vet, për çka edhe paguhet për ta udhëhequr komisionin, ta ngarkojë përgjegjësinë te kryetari i Kuvendit. Mendoj se kjo është pak sa e pandershme.

KRYESEUSI SABRI HAMITI: Vazhdoje ti vetë! Ai po lyp replikë, e ke Zenelin, pastaj.

KRYETARI: Po, pasi është me mua replika, e ke fjalën!

ESAT BRAJSHORI: Që në fjalën tuaj të jeni i drejtë, specifikisht ju keni kërkuar nga përfaqësuesi i grupit që të shikojë mundësinë e dorëheqjes sime, me emër! Nuk është fjala për kritika, se kam qenë prezent edhe unë në mbledhjet tjera, kur jam kritikuar. Mendoj se keni shkel kompetencat tuaja si kryetar i Kuvendit, se ky nuk është një Kuvend njëpartiak, që kryetari i Kuvendit mund t'i shkarkojë me radhë kryetarët e komisioneve.

E dyta, më duhet ta them, më vjen keq për nivelin e debatit, seriozisht. E dyta, që është shumë me rëndësi, gjithashtu ju përmendët një fakt të vonesës së këtyre dy projektligjeve. Po, zoti kryetar, nuk fshihet. Jashtë afatit kohor të Rregullores së Punës dhe 15-ditëshit që ju na e keni dhënë, jemi vonuar edhe rreth 3 muaj, por unë dua t'ju dëshmoj juve një gjë tjetër, që ta ballafaqojmë argumentin. Kam një pasqyrë të projektligjeve në dorë dhe mund t'ua deponoj, ku nga leximi i parë në të dytin ka vonesa deri 22 muaj. Ka vonesa të projektligjeve. Në rregull, nëse doni argumente, shkojmë me argumente. Unë s'do të isha fare për këtë nivel debati, si Esat, në mënyrë absolute. 3 muaj, 22 muaj, 10 muaj, me dhjetëra ligje që kalojnë mbi 30 e sa brenda këtij mandati, unë mendoj se është një argument që e përmbys atë se ju fajësoni së tepërmi vonesën prej 3 muajsh. Unë e di që jemi vonuar dhe është shumë keq, por këto kanë qenë mundësitë dhe nuk jemi vonuar se s'kemi punuar, ose të paaftët, por kemi punuar, jemi munduar mirë, është seanca që vendos, janë debatet që vendosin, por jo apriori. Për këto dy elemente desha, nëse mund të them, t'ju korrigjoj.

KRYETARI: Faleminderit! Edhe unë po shfrytëzoj kohën për replikë. Më lejoni, se unë mund ta shfrytëzoj edhe foltoren për replikë. Edhe një herë po them, kjo që u debatua sot, është për mbledhjen e kryetarëve të komisioneve, që është një herë në muajt dhe nuk do të duhej të ngarkohej kjo seancë. Shtyrjen e atyre ligjeve unë e kam gjithnjë në pasqyrë përpara dhe realisht ka ndërhyrje që nganjëherë i vonojnë ligjet për shumë arsye, por në këtë ligj nuk ka pasur kurrfarë ndërhyrjeje, veç ka qenë mungesa e komisionit, ndoshta edhe mungesa e hapësirës, unë nuk e di, por me këtë që e thatë, administrata nuk pajtohet shumë. Megjithatë, ne ia japim fjalën kryetarit të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë, deputetit Lulzim Zeneli.

LULZIM ZENELI: Faleminderit!

Po, në fakt, në situata të tilla nuk mund të procedohet më tutje dhe mbetet e vetmja alternativë që të hiqen prej rendit të ditës dhe të kërkohet prej komisionit harmonizimi i qëndrimeve. Mirëpo, një situatë të tillë kemi pasur edhe në projektligjet të cilat kanë kaluar nëpër këtë Kuvend dhe atëherë kur ka pasur dy komisione kontradikta në qëndrime, fati i një projektligji të tillë ka qenë, fatkeqësisht, që brenda atij mandati s'ka mund të përfundohet. Atëherë, po e marr shembull konkret, ka qenë Projektligji për

ushqimin, i cili njëkohësisht kësisoj është proceduar në Kuvendin e Kosovës dhe fati i atij projektligji e dimë si ka përfunduar në fund.

Unë do të kisha kërkuar të krijohet një praktikë, që projektligjet e tilla për të cilat ka kontradikta në mes dy komisioneve, mos të vijnë në seancë plenare deri sa nuk harmonizohen qëndrimet. Në situata të tilla duhet të harmonizohet, mirëpo konform kompetencave të një komisioni të cilat i posedon. Nëse ka amendamente të cilat vijnë në kolizion me Kushtetutën, atëherë ato duhet të korrigjohen dhe duhet të harmonizohen. Mirëpo, është e pakuptueshme në qoftë se krijohen debate të cilat ndeshen drejtpërsëdrejti të natyrës së kompetencave ekskluzive të një komisioni përkatës.

Unë kërkoj që së bashku, ashtu siç pretenduan edhe kolegët, të largohet prej rendit të ditës sot, të hiqet dhe të futet në rend dite në një seancë, në seancën e parë të ardhshme. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Për Grupin Parlamentar “7+”, deputeti Xhezair Murati e ka fjalën!

ĐŽEZAIR MURATI: Hvala, predsedniče!

Pozdrav Vladinom kabinetu, kolegama, gostima!

Mi podržavamo inicijativu da se odloži usvajanje ovog zakona za 13 maj, ali ipak smo pod sumnjom da li je moguće da se dobro sinhronizuje, jer je današnja sednica pokazala dijametralno suprotne poglede i stavove kada je u pitanju osvajanje ovog zakona, a mi predstavnici manje brojnih zajednica smatramo da ima odredbi u njemu koje su vrlo sporne, a po nas veoma važne. S toga, njegovo odlaganje za 13. ili prva naredna sednica iza toga, je neophodna. Hvala vam!

KRYETARI: Vazhdojmë! Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, fjalën e ka deputeti Petar Miletij.

PETAR MILETIĆ: Hvala, gospodine predsedniče!

Ja sam tražio reč i kao predsednik Komisije za prava i interese zajednica, međutim izgleda da me niste videli.

Ja se slažem sa ovom inicijativom da se ova tačka dnevnog reda, odnosno ovaj nacrt zakona ukloni sa dnevnog reda i da se o ovoj tački dnevnog raspravlja na nekoj od narednih sednica.

Neko ovde danas pomenu da postoje dve komisije koje imaju dijametralno suprotne stavove oko ovog nacrt zakona, međutim ja bih dodao da ima i treća Komisija koja je predložila jedan amandman i to amandman na član 10, koji je izuzetno važan po interese i prava zajednica i duboko zadire u prava zajednica.

Koliko znam, Komisija za javnu administraciju, lokalnu vlast i medije je bila protiv ovog našeg amandmana, dok Komisija za pravosuđe je bila za.

Ja bih želeo samo u par rečenica da pojasnim ovaj naš stav, iako ne bih da previše dužim, pošto mi se čini da je većina poslaničkih grupa bila za to da se ovaj zakon uvrsti u dnevni red nekih od narednih sednica. Međutim, ovaj naš amandman 35. na član 10, koji se tiče prijema u javnu službu, je izuzetno važan za sve zajednice na Kosovu i rekao bih da on ima za mandat da obezbedi promociju i zaštitu prava vitalnih interesa zajednica na

Kosovu. I on je potpuno u skladu sa Ustavom Kosova i to u skladu sa stavovima 2. i 3. člana 78. Ustava Kosova, takođe i sa članom 61. Ustava Kosova, tako da ukoliko ne bi smo usvojili ovaj amandman, bojim se da bi se ogrešili o Ustav Kosova.

Takođe, u konsultacijama sa ICO, Komisija je potvrdila da prema sveobuhvatnom predlogu za rešenje statusa Kosova, Kosovo ima obavezu da garantuje adekvatnu zaštitu prava zajednica i njihovih pripadnika za pravičnu zastupljenost prilikom zapošljavanja u javnim organima i javnim preduzećima na svim nivoima. To je sveobuhvatni predlog za rešenje statusa Kosova, aneks drugi. član 4. tačka 4.

Takođe, Komisija je sa zabrinutošću uočila da prema objavljenoj studiji politike od strane Premijerove kancelarije za pitanja zajednica, to je jedna studija koju bih toplo preporučio svima da je uzmu i da je pročitaju, možete je naći u Kancelariji premijera za zajednice, gde ćete videti da je nivo zastupljenosti manjinskih zajednica u javnim organima daleko od zadovoljavajućeg.

Da ne bih čitao sve gde i koliko ima zastupljenih manjinskih zajednica, pošto vidim da je i atmosfera bila prilično usijana, ja ću reći samo jedan podatak, a to je da u javnim preduzećima koje su obuhvaćene ovom studijom je zaposleno 2,14% nevećinskih zajednica, što je izuzetno malo. I, recimo, da na rukovodećem nivou takođe u tim javnim službama 2,5% pripadaju nevećinskim zajednicama. Na primer, u KEK-u, 1,33% zaposlenih je od manjinskih zajednica. Tako da mi ćemo i ako bude danas, i ako bude na nekoj od sledećih sednica, čvrsto da stanemo iza ovog amandmana i to je, sa zadovoljstvom mogu da kažem, zahtev svih poslanika koji pripadaju nevećinskim zajednicama. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Nën emër të Grupit Parlamentar për Integritet, Numan, e do fjalën? Deputeti Numan Baliq e ka fjalën! Regjia, fjalën deputetit Numan Baliq.

NUMAN BALIĆ: Faleminderit, zotëri kryetar i Kuvendit! Natyrisht se e dua fjalën, ishte një pyetje e panevojshme.

Javio sam se danas da govorim ne samo kao zastupnik i predstavnik Grupe za integraciju, koja predstavlja značajan broj zajednica na Kosovu, nego i kao čovek koji je učestvovao u radu Komisije za prava i interese zajednica i, naravno, Komisije za javnu administraciju.

Ovde želim da podcrtam jednu stvar. Dakle, na jednoj strani mi imamo, da tako kažem, ovo mimoilaženje koje postoji između dve komisije, koje je očigledno i koje polako može da poprima izgled svrstavanja u dva tabora, ali nadajmo se da, ako bog da, neće tako biti i verovatno odlaganje razgovora oko ove sednice, oko ovog zakona.

Na drugoj strani, imamo stav Komisije za prava i interese zajednica, odnosno amandman koji je pomenuo predsednik komisije i koji smatram vrlo važnim. On je govorio o tome amandmanu, međutim izostavio je da kaže suštinu toga amandmana broj 34. na član 10, kome je dodat broj 2. i 3. Suština tog amandmana jeste da se osigura ravnomerna i adekvatna zaposlenost predstavnika ne većinskih zajednica na celome Kosovu na taj način što će njihova zaposlenost biti osigurana na centralnom nivou sa 10%, i na opštinskom nivou, u skladu sa procentom koji date zajednice imaju u ovim opštinama. On se odnosi ne samo na Srpsku zajednicu, nego se odnosi i na Bošnjake, Rome, Turke, Egipćane i tako dalje.

Želim da vas obavestim da znate da su zastupnici svih ovih zajednica, njih 22, jednoglasno u tome da traže da se izglasa ovaj amandman, a da je Komisija za javnu administraciju, u kojoj sam i inače član, odbila ta dva amandmana. Protiv toga smo glasali nas dvoje predstavnika iz ovih zajednica. Tako da želim ovde da podvučem jednu vrlo važnu stvar. Vakum koji će nastati, odnosno neće biti vakum nego prostor, do sledeće sednice, bila ona 13. maja ili nekada drugo, da se iskoristi da se šefovi parlamentarnih grupa, da se osigura njihova podrška i da glasaju za amandman koji predlaže Komisija za prava i interese zajednica, kojim će se avansirati i poboljšati položaj svih zajednica u Zakonu o civilnoj službi. Hvala lepo!

KRYETARI: Faleminderit! Do të thotë, ne dëgjuam shefat e grupeve parlamentare. Propozimi është që të shtyhet për seancën e 13 majit. Por, nëse veç doni, e vazhdojmë debatin, por s'di sa është... Në lexim të dytë, ju e dini që s'ka debat. Megjithatë, është diçka e veçantë. Urdhëro, Naim Rrustemi e ka fjalën!

NAIM RRUSTEMI: Faleminderit, zoti kryetar!

Unë desha në një funksion më të mirë për ta tejkaluar këtë gjendje, sepse me të vërtetë këtu nuk kemi situatë ku kërkohet harmonizim apo pazar me qëndrime të njërit komision me tjetrin. Nuk kemi të bëjmë me harmonizim qëndrimesh. Kemi të bëjmë me dy sisteme totalisht të kundërta. Dallimet janë konceptuale. Njëri komision mbron qëndrimin e sistemit tjetër, të bazuar mbi meritën dhe të mbyllur, që këto komente unë i kam dhënë në leximin e parë, se unë jam çuditur edhe herën e parë kur ka ardhur ligji në këtë formë.

Dhe, gabimi shumë i madh, shumë, shumë i madh i Komisionit për Administratë Publike është pse e ka lejuar ligjin të vijë në lexim të parë, kur e ka pasur një qëndrim kaq të ndryshëm për kërkesën për një shërbim civil të hapur dhe të bazuar në konkurrencë. Fjalët që përdoren “do të harmonizojnë qëndrimet komisionet” janë fjalë të pakuptimta, sepse s'kemi fjalë me “me harmonizim të tyre”. Është çështje politike, është çështje kryekëput politike se çfarë shërbimi civil ne tentojmë të ndërtojmë.

Nuk mendoj se kërkesa për ta sjellë ligjin më 13 maj është kërkesë shumë e arsyeshme. Ligji duhet të vijë nga komisionet me një version të saktë, se kemi të bëjmë me dy versione të ndryshme. Nuk mund të diskutohet nen pas neni. Për shembull, kryetari i Komisionit për Legjislacion e ceku nenin 49. Në njërën anë, njëri komision mbron qëndrimin se duhet pushteti ekzekutiv të sundojë mbi shërbimin civil dhe të influencojë shërbimin civil përmes përzgjedhjes së kandidatëve në Komisionin për Emërimet të Larta dhe në anën tjetër kemi komision totalisht të ndryshueshëm që pretendon të jetë deri diku i pavarur në selektimin e njerëzve me pozicione të larta. Në njërën anë kemi propozimin e parë, ku sekretarët e përhershëm, kryeshefat ekzekutivë, njerëzit e nivelit të lartë zgjidhen dalëngadalë nga brenda shërbimit civil, me fjalë të tjera është sistem i mbyllur i shërbimit civil, në anën tjetër kemi propozimin e Komisionit, ku propozon që të jetë i hapur dhe të bazohet në konkurrencë. Me fjalë të tjera, ne kemi të bëjë me çështje politike. Unë kisha kërkuar nga komisioni, ndoshta edhe nga dy komisionet që të tërhiqen, që t'ia bien Kuvendit një dokument të pastër, ndoshta të trajtohet si lexim i tretë. Sepse, kështu si është, s'ka kuptim. Faleminderit për fjalën e dhënë!

KRYETARI: Faleminderit! Lexim të tretë, pa e kaluar leximin e dytë, nuk ka, ju e dini. Urdhëro, merre fjalën! Deputetja Melihate Tërmkolli e ka fjalën!

MELIHATE TËRMKOLLI: Ju faleminderit!

Unë e di që pika më e ndjeshme për këtë qeveri është i ashtuquajti më herët KERP, i cili fatkeqësisht ka qenë “thembër Akili” në të gjitha qeveritë e deritanishme, sepse asnjëherë nuk ka prodhuar një shërbim civil stabil, në veçanti të niveleve më të larta në shërbimin civil, prandaj kjo ka qenë një përpjekje që edhe këtë nivel të lartë ta fusim në binarë të stabilitetit. Mirëpo kjo nuk i konvenon kësaj Qeverie, sepse është shumë e interesuar që ashtu qysh është duke vepruar sot, në mënyrë arbitrare, pa asnjë rregull kryeministri t’i emërojë dhe t’i shkarkojë shërbyesit civilë. Ky është problemi kryesor.

Ne kemi punuar shumë ngushtë me ekspertët e DFID-it, që mendoj janë dhe mbeten mekanizmi më i specializuar, në veçanti për këto nivele të shërbimit civil dhe kemi ardhur te këto përfundime, që mendoj se nuk e prishin sistemin. Me shumë respekt, zotëri Rrustemi, por nuk janë në kundërshtim me sistemin. Përkundrazi, domethënë, janë në funksion të këtij sistemi, ne nuk e kemi bërë sistem krejt hapur, është e vërtetë që kemi lënë, jemi përpjekur t’i lëmë do vende sepse ka nevojë, ngase mbyllja e sistemit të administratës me këtë nivel qysh është, do të ishte katastrofale për Kosovën në kohën kur ne kërkojmë një reformë të administratës publike dhe në kohën kur krejt nivelet ndërkombëtare kërkojnë ndryshim dhe profesionalizim të administratës publike. Kjo është një.

Mendoj që mendimi i Komisionit për Legjislacion është totalisht jo profesional, s’ka të bëjë kurrgjë me aspektet profesionale edhe s’dua të hyjë aty më tutje të komentoj, janë totalisht profesionale qëndrimet e tyre.

Zotëri kryetar, dua një fjalë të juaj që e thatë këtu, se ndoshta ekspertët që kanë punuar në Qeveri edhe e kanë prishur këtë projektligj duke punuar me Komisionin e Parlamentit. Mendoj që nuk qëndron, është ministri këtu, ekspertët kanë punuar me Ministrinë, e cila ka pasur një version tjetër nga versioni të cilin e ka sjellë Qeveria, sepse Qeveria krejt atë version që është punuar me Ministrinë dhe me ekspertët, e ka prishur, e ka prishur për interesat ditore, prandaj këtu qëndron problemi.

Dhe, sa është vonua ligji? Ligji është vonua 5 – 6 muaj, ju e dini shumë mirë kur e ka tërhequr Qeveria, një herë ministri, një herë kryeministri, janë 6 muaj që është vonuar paraprakisht ligji dhe mos të hyjmë shumë te vonesat, se u banalizua krejt kjo çështje.

Unë desha veç edhe Komisionit për Komunitete dhe Kthim një sqarim t’ua bëj. Ju lutem shumë, është e vërtetë që në mënyrën qysh e ka propozuar ICO, 10% nuk e kemi futur në amendamente për arsye se nuk është e vërtetë se shkelet Kushtetuta. Askund në Kushtetutë nuk thuhet se minoritetet duhet të përfshihen 10%, absolutisht askund. Kemi bërë një formulim, mendoj shumë të drejtë, madje edhe shumë favorizues. Mirëpo, ato të drejtat nuk llogariten pse Komisioni e ka pranuar. Ne e kemi bërë formulimin që do të jetë përfaqësim i barabartë proporcional i minoriteteve në shërbimin civil dhe këta qohen e flasin se nuk paskan të punësuar në KEK, në Aeroport dhe në Postë. Po, zotëri, nuk është shërbim civil ajo, ato janë ndërmarrje publike, ne s’kemi të bëjmë me të punësuarit në këto ndërmarrje publike. Prandaj, kujdes me nocionet elementare të ligjeve edhe nocionet elementare të objektit të ligjeve. Kjo mendoj është ajo që desha ta sqaroj dhe, natyrisht, Parlamenti vendos. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Urdhëro, Bahri Hyseni, pasi e dhashë një herë, merre edhe ti fjalën!

BAHRI HYSENI: Absolutisht, nuk kemi as për të replikuar. Mirëpo, dëgjo, ne po bëjmë ligj dhe ligji duhet të jetë i bazuar në kushtetutë. Dhe, nëse duhet të jetë në kushtetutë,

unë po pyes: - Komisioni funksional si e ka menduar që Kuvendi i Kosovës t'i emërojë dy anëtarë, kush t'ia propozojë, kah të vijë propozimi, cilët anëtarë? Dhe, unë po pyes. Të punohet për institucionet e Kosovës dhe të mos jetë asnjë anëtarë as nga Kuvendi, as nga Qeveria, as nga asnjë institucion shtetëror, çka po bëjmë, është çështja e parë. Është edhe antikushtetuese. Nuk e ka shumë keq Komisioni për Komunitete, ju mbet borxh. Komisioni për Komunitete ka të drejtë. Pse ka të drejtë? Sepse propozimi ka qenë nga sponzorizuesi që duhet ta respektojmë. Ai e ka ndarë shërbimin civil. Shërbimi civil ka qenë për pushtetin qendror dhe pushtetin lokal. Komisioni funksional ka bërë amendament, e ka fshirë fjalën "pushtet qendror" dhe "pushtet lokal" dhe nëse e lexoni përkufizimin në raportin përfundimtar, del kështu: Shërbimi civil është i tërë trupi i personelit administrativ, të punësuar nga institucionet shtetërore dhe publike dhe, natyrisht, i ka dhënë mundësinë Komisionit për Komunitete tash të kërkojë atje te institucionet publike, sepse institucione publike nuk janë tash vetëm pushteti qendror, ekzekutivi, administrata, por janë edhe institucionet tjera. Ne nuk po kërkojmë diçka të veçantë, por po kërkojmë, ja që çka keni bërë? Keni bërë amendament dhe tash e drejta e Komunitetit është, shumë mirë e ka kërkuar dhe bile ne duhet edhe ta mbrojmë, sepse e keni futur edhe institutin apo institucionet publike.

Prandaj, nuk kemi nevojë shumë të debatojmë, është çështje e Kuvendit të vendos. Ne vetëm i kemi ngritur shqetësimet, sepse kështu si ligj nuk mund të implementohet në praktikë dhe ne nuk do të bëjmë as Komision për Emërime të Larta Publike, as kurrigjë me këtë ligj pa i harmonizuar. E mbrojmë prapë qëndrimin që nuk janë 200 amendamente kundër, po ne jemi fokusuar së paku me nja 20 – 30 amendamente, të cilat kurrsesi nuk duhet të kalojnë. Kjo është çështje. Edhe ajo që e kërkon komuniteti, ka të drejtë. Faleminderit!

KRYETARI: Pasi ne e kaluam këtë debat, i kemi edhe 5 deputetë. Nuk di çka do të duhej, kur ne po mendojmë ta shtyjme. Po shkojmë me një votim formal.

Kush është për ta shtyrë, edhe pse po ju them sinqerisht... Jo, në seancën e 13 majit, do të thotë kemi më 13 maj seancë.

Të nderuar deputetë,

Ne, megjithatë, po u japim rast komisioneve që deri më 13 maj amendamentet që mund të harmonizohen, të harmonizohen dhe nëse ka amendamente që nuk mund të harmonizohen, atëherë ne po e lëmë variantin me votim, vendos Kuvendi a t'i votojë a mos t'i votojë. Unë mendoj që më 13 maj këtë ligj duhet ta kryejmë për shumë arsye.

Një, që kemi thjeshtë kërkesa tepër të arsyeshme të nëpunësve civilë, që unë mendoj edhe kjo fjalë duhet të jetë "nëpunës civilë" jo "shërbyes civilë". Prandaj, ne po e lëmë që komisionet, amendamentet që mund t'i harmonizojnë, le t'i harmonizojnë, ato të tjerat që s'mund t'i harmonizojnë, i votojmë ose s'i votojmë ne në Kuvend më 13 maj. Dhe, a po i shtimë dy ligjet, apo vetëm këtë ligj për 13 maj?

Urdhëro! Fjalën e ka deputeti Hajredin Hyseni, pasi që ka qenë në Grupin punës të Ligjit për pagat e Shërbimit Civil.

HAJREDIN HYSENI: Faleminderit, zoti kryetar!

Edhe pse në Ligjin për pagat e shërbyesve civilë ne nuk kemi shumë paqartësi me komisionet tjera, me përjashtim të Komisionit për Buxhet, që ka prurë tash së voni, që ne nuk e kemi trajtuar për amendamentin 46. Ne mendojmë që ky projektligj derivon nga Projektligji për shërbyesit civilë dhe duhet të shtyhen bashkërisht, duhet të shkojnë në

pako. Andaj, edhe vonesa e këtij projektligji ka qenë arsyeja kryesore që këto dy projektligje të vinë në pako dhe duhet të kalojnë bashkërisht në pako. Unë propozoj që të jenë bashkërisht.

KRYETARI: Faleminderit! Unë mendoj që s'duhet të jenë bashkërisht. Gani Koci e ka fjalën!

GANI KOCI: Faleminderit, zoti kryetar!

Megjithatë, Komisioni për Buxhet dhe Financa mendon që këto dy ligje duhet të harmonizohen edhe një herë mes veti, se në qoftë se punohet Ligji për shërbyesit civilë dhe koncepti për pagat është bërë mbi bazë të atyre ndryshimeve atje, atëherë miratimi, që nuk ka shumë problem miratimi i Ligjit për pagat e shërbyesve civilë, po miratimi i këtij ligji tash mund të jetë në konfuzion ose në kolizion me Ligjin për shërbyesit civilë, sepse Ligji për pagat e shërbyesve civilë është bërë mbi bazën, se amendamenti është bërë mbi bazën e ndryshimit të ligjit të parë. Prandaj, janë të lidhura dhe janë shumë të lidhura në mes veti dhe unë mendoj edhe në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa që këto ligje duhet të shkojnë bashkërisht dhe më 13 maj të procedohen bashkërisht këtu. Unë e di që kanë dhënë premtime se do e bëjmë këtë, ose s'do e bëjmë atë, por ju lutem, ka nevojë, se në qoftë se atje pëson një ndryshim, qoftë edhe një përkufizim, atëherë duhet të pësojë ndryshim edhe Ligji për pagat e shërbyesve civilë.

KRYETARI: Mirë, atëherë shkojmë, do të thotë dy ligjet po i shtyjme për 13 maj, por me kusht që më 10 maj komisionet në administratë t'i dorëzojnë raportet me rekomandime, se i duhet administratës të na i sjellin më 13 maj.

Atëherë, kush është "për"? Shumica janë. A ka "kundër"? 1 "kundër". abstenim, 3 a 4. Kështu, me shumicën e votave shtyhet për seancën e 13 majit, edhe pse vërtet është vonë.

A jeni për pauzë deri në ora 15:00, për drekë?

Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
Në sallë janë 62 deputetë, që mund t'ia fillojmë seancës.
Në radhë është pika e gjashtë e rendit të ditës:

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Mjekësinë Ligjore

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për Mjekësinë Ligjore dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Para se të procedojmë me votimin e amendamenteve, ftoj kryetarin e Komisionit funksional për Legjislacion dhe Gjyqësi, apo raportuesin e Komisionit, që para deputetëve të arsyetojë raportin me rekomandime.
Fjalën e ka kryetari i komisionit, deputeti Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti kryetar!

Përsëritje i nderuari zëvendëskryeministër, ministra!

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi e ka shqyrtuar pas leximit të parë në komision funksional dhe me rastin e shqyrtimit në komision funksional ka dëgjua edhe ekspertë

dhe në bashkëpunim edhe me komisionet tjera, që po na mbështesin, i kemi hartuar amendamentet. Deri tash nuk kemi ndonjë opinion nga komisionet e tjera dhe konsideroj që vetëm t'i përkrahni amendamentet, sepse besoj që edhe komisionet tjera të përhershme janë pajtuar me rekomandimet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Pra, në Kuvend kemi 63 apo më shumë deputetë, më duket.

Jemi në procedurën e votimit. Votojmë për amendamentet e propozuara në Projektligjin për Mjekësinë Ligjore.

Amendamenti 1.

Votojmë tash:

Në sallë janë 71 deputetë.

Konstatoj se me 58 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 2 abstenime, miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2.

Votojmë tash:

Konstatoj se më 65 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3.

Votojmë tash:

Konstatoj se më 65 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti 3.

Amendamenti 4.

Votojmë tash:

Konstatoj se më 60 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 5.

Votojmë tash:

Konstatoj se më 58 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti 5.

Amendamenti 6.

Votojmë tash:

Konstatoj se më 63 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti 6.

Amendamenti 7.

Votojmë tash:

Konstatoj se më 62 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti 7.

Amendamenti 8.

Votojmë tash:

Konstatoj se më 62 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 2 abstenime, miratohet amendamenti 8.

Amendamenti 9.

Votojmë tash:

Konstatoj se më 66 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 2 abstenime, Kuvendi miraton amendamentin 9.

Amendamenti 10.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 63 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 10.

Amendamenti 11

Votojmë tash.

Konstatohet se me 66 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 11.

Amendamenti 12, i fundit.

Votojmë tash. Në sallë janë 73 deputetë.

Konstatohet se me 63 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 12.

Ju faleminderit!

Tani është radha për ta votuar ligjin në tërësi. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

Konstatohet se me 70 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, Kuvendi miratoi Ligjin për Mjekësinë Ligjore. Ju faleminderit!

Pika e radhës është:

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbrojtjen e të dhënave personale

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara. Para se të procedojmë me votimin e amendamenteve, ftoj kryetarin e Komisionit FunkSIONAL për Punë të Brendshme dhe Siguri apo raportuesin e Komisionit, që para deputetëve të arsyetojë raportin me rekomandime.

Fjalën e ka kryetari i Komisionit, deputeti Rrustem Mustafa.

RRUSTEM MUSTAFA: I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Projektligji për mbrojtjen e të dhënave personale, është miratuar në lexim në seancën plenare, më 19.10.2009 dhe Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri është caktuar komision funksional për shqyrtimin e këtij projektligji.

Komisioni funksional ka caktuar grupin punues dhe referuese ka qenë nënkryetarja e Komisionit, Suzan Novobrdaliu, e cila ka pasur shumë takime për shqyrtimin e këtij projektligji. Unë bëj thirrje të sponzorizuesit edhe nga këtu, që të kenë kujdes edhe të punohen më mirë projektligjet që vijnë në seanca plenare, që ne të mos kemi shumë punë. Unë, pikërisht për atë se është dashur shumë punë në këtë ligj, kemi kërkuar edhe kohë shtesë. Për shqyrtimin e këtij projektligji, është organizuar një dëgjim publik në muajin dhjetor të vitit 2009, dhe janë mbajtur shumë takime, ku janë ftuar përfaqësues nga shoqëria civile, organizatat ndërkombëtare, si dhe grupet tjera të interesit. Në shqyrtim të këtij projektligji kemi ftuar edhe një ekspert gjerman, Hans Tishler dhe bashkë me të e kemi lexuar ligjin nen për nen, mirëpo meritat kryesore për rregullimin e këtij ligji i kanë profesionistët tanë, profesorët e nderuar nga Universiteti i Prishtinës, të cilët e kanë bërë draftin final dhe ju them se Raporti final me rekomandime për këtë projektligj, i proceduar në Kuvend, përmban gjithsej 83 amendamente.

Unë sot, një ditë përpara, kam folur me referuesin, pra këtij raporti i ofrojmë edhe një përmbajtje dhe një amendament të propozuar me një ndryshim në nenin 82, paragrafi i parë. Fjala: “shërbim civil”, zëvendësohet me fjalën: “punë profesionale”. Gjatë gjithë ligjit përshkruhet ky gabim nuk ndodh, kurse në këtë nen është përsëritur, kështu që na kërkojmë edhe me këtë përmirësim, sot të miratohen komplet amendamentet. Ju faleminderit, zoti Kryetar!

KRYETARI: Ju faleminderit!
Vazhdojmë votimin e amendamenteve.

Amendamenti 1

Votojmë tash.

Konstatohet se me 66 vota “për”, asnjë “kundër”, 3 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 1.

Amendamenti 2

Votojmë tash.

Konstatohet se me 59 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 2.

Amendamenti 3

Votojmë tash.

Konstatohet se me 57 vota “për”, asnjë “kundër”, 3 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 3.

Amendamenti 4

Votojmë tash.

Konstatohet se me 58 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 4.

Amendamenti 5

Votojmë tash.

Konstatohet se me 56 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 5.

Amendamenti 6

Votojmë tash.

Konstatohet se me 54 vota “për”, asnjë “kundër”, 3 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 6.

Amendamenti 7

Votojmë tash.

Konstatohet se me 66 vota “për”, asnjë “kundër”, 3 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 7.

Amendamenti 8

Votojmë tash.

Konstatohet se me 58 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 8.

Amendamenti 9

Votojmë tash.

Konstatohet se me 59 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 9.

Amendamenti 10

Votojmë tash.

Konstatohet se me 64 vota “për”, asnjë “kundër”, 3 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 10.

Amendamenti 11

Votojmë tash.

Konstatohet se me 58 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 11.

Amendamenti 12

Votojmë tash.

Konstatohet se me 61 vota “për”, asnjë “kundër”, 3 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 12.

Amendamenti 13

Votojmë tash.

Konstatohet se me 62 vota “për”, asnjë “kundër”, 4 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 13.

Amendamenti 14

Votojmë tash.

Konstatohet se me 63 vota “për”, asnjë “kundër”, 4 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 14.

Amendamenti 15

Votojmë tash.

Konstatohet se me 64 vota “për”, 2 “kundër”, 1 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 15.

Amendamenti 16

Votojmë tash.

Konstatohet se me 59 vota “për”, 1 “kundër”, 1 abstenim, Kuvendi miratoi amendamentin 16.

Amendamenti 17

Votojmë tash:

Konstatohet se me 63 vota “për”, asnjë “kundër”, 3 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 17.

Amendamenti 18

Votojmë tash.

Konstatohet se me 66 vota “për”, 1 “kundër”, 2 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 18.

Amendamenti 19

Votojmë tash.

Konstatohet se me 59 vota “për”, 1 “kundër”, 2 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 19.

Amendamenti 20

Votojmë tash.

Konstatohet se me 66 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, Kuvendi miratoi amendamentin 20.

Amendamenti 21

Votojmë tash.

Konstatohet se me 65 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 21.

Amendamenti 22

Votojmë tash.

Konstatohet se me 66 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 22.

Amendamenti 23

Votojmë tash.

Konstatohet se me 65 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 23.

Amendamenti 24

Votojmë tash.

Konstatohet se me 60 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 24.

Amendamenti 25

Votojmë tash.

Konstatohet se me 64 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 25.

Amendamenti 26

Votojmë tash.

Konstatohet se me 61 vota “për”, asnjë “kundër”, 3 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 26.

Amendamenti 27

Votojmë tash.

Konstatohet se me 61 vota “për”, asnjë kundër, 3 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 27.

Amendamenti 28

Votojmë tash.

Konstatohet se me 64 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 28.

Amendamenti 29

Votojmë tash

Konstatohet se me 62 vota “për”, asnjë “kundër”, 3 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 29.

Amendamenti 30

Votojmë tash.

Konstatoj se me 65 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 30.

Amendamenti 31

Votojmë tash.

Konstatoj se me 64 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 31.

Amendamenti 32

Votojmë tash.

Konstatoj se me 65 vota “për”, asnjë “kundër”, 3 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 32.

Amendamenti 33

Votojmë tash.

Konstatoj se me 60 vota “për”, asnjë “kundër”, 4 abstenime, Kuvendi miratoi amendamenti 33.

Amendamenti 34

Votojmë tash.

Konstatoj se me 63 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 34.

Amendamenti 35

Votojmë tash.

Konstatoj se me 59 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, Kuvendi miratohet amendamenti 35.

Amendamenti 36

Votojmë tash.

Konstatoj se me 63 vota “për”, asnjë “kundër”, 3 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 36

Amendamenti 37

Votojmë tash.

Konstatoj se me 57 vota “për”, asnjë “kundër”, 3 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 37.

Amendamenti 38

Votojmë tash.

Konstatoj se me 67 vota “për”, asnjë “kundër”, 4 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 38.

Amendamenti 39

Votojmë tash.

Konstatoj se me 61 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 39.

Amendamenti 40

Votojmë tash.

Konstatoj se me 64 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 40.

Amendamenti 41

Votojmë tash:

Konstatoj se me 63 vota “për”, asnjë “kundër”, 4 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 41.

Amendamenti 42

Votojmë tash.

Konstatoj se me 60 vota “për”, asnjë “kundër”, 3 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 42.

Amendamenti 43

Votojmë tash:

Konstatoj se me 58 vota “për”, asnjë “kundër”, 4 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 43.

Amendamenti 44

Votojmë tash:

Konstatoj se me 59 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 44.

Amendamenti 45

Votojmë tash:

Konstatoj se me 63 vota “për”, asnjë “kundër”, 3 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 45.

Amendamenti 46

Votojmë tash.

Konstatoj se me 62 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 46.

Amendamenti 47

Votojmë tash.

Konstatoj se me 65 vota “për”, asnjë “kundër”, 4 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 47.

Amendamenti 48

Votojmë tash.

Konstatoj se me 60 vota “për”, asnjë “kundër”, 5 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 48.

Amendamenti 49

Votojmë tash.

Konstatoj se me 63 vota “për”, asnjë “kundër”, 3 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 49.

Amendamenti 50

Votojmë tash:

Konstatohet se me 66 vota “për”, asnjë “kundër”, 5 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 50.

Amendamenti 51

Votojmë tash:

Konstatohet se me 62 vota “për”, asnjë “kundër”, 3 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 51.

Amendamenti 52

Votojmë tash:

Konstatohet se me 63 vota “për”, asnjë “kundër”, 3 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 52.

Amendamenti 53

Votojmë tash.

Konstatohet se me 63 vota “për”, asnjë “kundër”, 3 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 53.

Amendamenti 54

Votojmë tash.

Konstatohet se me 65 vota “për”, asnjë “kundër”, 3 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 54.

Amendamenti 55

Votojmë tash.

Konstatohet se me 62 vota “për”, 1 “kundër”, 4 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 55.

Amendamenti 56

Votojmë tash.

Konstatohet se me 61 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 56.

Amendamenti 57.

Votojmë tash.

Konstatohet se me 61 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 57.

Amendamenti 58.

Votojmë tash.

Konstatohet se me 63 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, Kuvendi e miratoi amendamentin 58.

Amendamenti 59.

Votojmë tash.

Konstatohet se me 64 vota “për”, asnjë “kundër”, 3 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 59.

Amendamenti 60.

Votojmë tash.

Konstatohet se me 60 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 60.

Amendamenti 61.

Votojmë tash.

Konstatohet se me 61 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 61.

Amendamenti 62.

Votojmë tash.

Konstatohet se me 62 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 62.

Amendamenti 63.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 64 vota “për”, asnjë “kundër”, 3 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 63.

Amendamenti 64.

Votojmë tash.

Konstatohet se me 63 vota “për”, asnjë “kundër”, 4 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 64.

Amendamenti 65.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 62 votë “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 65.

Amendamenti 66.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 63 vota “për”, asnjë “kundër”, 3 abstenime, Kuvendi miratoi amendamenti 66.

Amendamentin 67.

Votojmë tash.

Konstatohet se me 60 vota “për”, asnjë “kundër”, 4 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 67.

Amendamenti 68.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 63 vota “për”, 1 “kundër”, 3 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 68.

Amendamenti 69.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 56 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 69.

Amendamenti 70.

Votojmë tash.

Konstatohet se me 64 vota “për”, asnjë “kundër”, 3 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 70.

Amendamenti 71.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 57 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 71.

Amendamenti 72.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 63 vota “për”, asnjë “kundër”, 3 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 72.

Amendamenti 73.

Votojmë tash.

Konstatohet se me 65 votë “për”, asnjë “kundër”, 3 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 73.

Amendamenti 74.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 61 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 74.

Amendamenti 75.

Votojmë tash.

Konstatohet se me 67 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 75.

Amendamenti 76.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 66 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 76.

Amendamenti 77.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 61 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 77.

Amendamenti 78.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 65 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 78.

Amendamenti 79.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 62 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, Kuvendi miratoi amendamentin 79.

Amendamenti 80.

Votojmë tash.

Konstatohet se me 65 votë “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, Kuvendi miratoi amendamentin 80.

Amendamenti 81.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 71 vota “për”, asnjë “kundër”, 4 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 81.

Amendamenti 82.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 62 votë “për”, 1 “kundër”, 2 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 82.

Amendamenti 83, i parafundit.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 64 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 83.

Në radhë është amendamenti plotësues, amendamenti 84, i Komisionit funksional.

Në nenin 32, paragrafi 2, fjala “shërbim civil” zëvendësohet me fjalët “punë profesionale”. A jeni dakord? Faleminderit!

Votojmë tash.

Konstatohet se me 70 vota “për”, 1 “kundër”, 4 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin e 80 të plotësuar, sot.

Dhe, tani është radha ta votojmë ligjin në tërësi.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

Prezent janë 83 deputetë.

“Për” kanë votuar 72, “kundër” asnjë, 3 abstenime, Kuvendi miratoi Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Ju falënderoj për vëmendjen!

Vazhdojmë me pikën e tetë të rendit të ditës:

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tatimin në pronën e paluajtshme

Në bazë të Rregullës 35 pika 1 të Rregullores së Punës, janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim në parim të këtij projektligji.

Ftoj ministrin e Ekonomisë dhe të Financave, zotin Ahmet Shala që në emër të Qeverisë, para deputetëve të Kuvendit, ta prezantojë Projektligjin. Ministër, e ke fjalën!

MINISTRI AHMET SHALA: I nderuar kryetar,

Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë,

Në kuadër të Strategjisë legjislative për vitin 2010, Ministria e Ekonomisë dhe Financave ka përpiluar Projektligjin për tatimin në pronën e paluajtshme. Ky projektligj është punuar me një përkushtim të madh të ekspertëve vendorë dhe me ndihmën e ekspertëve ndërkombëtarë, ku trupi i ekspertëve ka ofruar një kornizë gjithëpërfshirëse ligjore për menaxhimin dhe administrimin e tatimit në pronë, bazuar në standardet dhe praktikatat më

të mira të Bashkësisë Evropiane dhe të përvojave të regjionit. Kjo fushë deri më tani ka qenë dhe ende është e rregulluar me Rregulloren e UNMIK-ut numër 2003/29, e ashtuquajtur Rregullore për tatimin në pronën e paluajtshme e cila rregullore do të shfuqizohet me hyrjen në fuqi të këtij ligji.

Kjo iniciativë e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave për ndryshimin dhe plotësimin e kësaj baze ligjore në këtë fushë, ka rrjedhur si pasojë e zhvillimeve të vazhdueshme progresive politike dhe ekonomike në Kosovë. Projektligji ka për qëllim përmirësimin e procedurave dhe shtimit të efikasitetit të administrimit të tatimit në pronë, të cilat janë paraqitur si domosdoshmëri e kohës. Në materien e vet ky projektligj definon me sa vijon, ndër të tjera, natyrisht:.

Subjektet të cilat i nënshtrohen pagesës së tatimit në pronë të paluajtshme, si dhe subjektet dhe personat, të cilët nuk i nënshtrohen tatimit në pronë të paluajtshme në përputhje të plotë me legjislacionin modern dhe me Konventën e Vjenës për privilegje dhe imunitete, gjë e cila nuk ka qenë e rregulluar me Rregulloren paraprake.

Ky ligj po ashtu përcakton shkallën e tatimit, e cila do të jetë në bazë vjetore prej 0,5 deri në 1% të vlerës së pronës së tregut. Çdo kuvend komunal ka të drejtë të caktojë tarifat tatimore në bazë të ligjeve sipas politikave që ata kanë përbrenda kufijve që i përcakton ligji.

Tatimet dhe tarifat do të lëvizin, varësisht prej kategorive të pronës, si për shembull: pronë rezidenciale, pronë e banuar, komerciale, bujqësore dhe kategoritë tjera, duke përfshirë edhe kategoritë e pronave të institucioneve religjioze.

Ky ligj në mënyrë shumë më eksplicite se sa Rregullorja e deritashme përcakton dhe ngrit përgjegjësitë e komunave për administrimin e tatimit në pronën e paluajtshme në mënyrën më efikase dhe ekonomike, sidomos duke i dhënë komunës përgjegjësi të plota në menaxhimin e informatave tatimore mbi pronën dhe futjen e të dhënave në bazën qendrore, në vlerësimin e pronës në mënyrë autonome, në vjeljen e vullnetshme dhe vjeljen e detyruar të tatimit në pronë si dhe ankesat administrative të shkallës së parë.

Ky ligj po ashtu qartëson procedurat e ankesave dhe organin kompetent për zgjidhjen e ankesave në shkallë të dytë, një e drejtë e cila deri më tani nuk ka qenë e qartë me rregulloren në fuqi.

Me këtë projektligj po ashtu kemi rregulluar edhe mënyrën e shpërndarjes së faturave tatimore dhe periudhën kohore gjatë të cilës do të shpërndahen faturat tatimore, masat sanksionuese për ata që nuk paguajnë me kohë tatimin në pronë, duke marrë për bazë arritjet pozitive, besoj që janë inkorporuar edhe elemente stimuluese për komunat në mënyrë që të vazhdojë trendi i njëjti i vjeljeve në nivelin komunal.

Me këtë ligj po ashtu synojmë të bëjmë përmirësimin e shërbimeve ndaj tatimpaguesve, me qëllim që të hyrat nga tatimi në pronë të grumbulluara të derdhen në llogari të komunës dhe të përdoren nga ajo në përputhje me ligjin 03 L-049 për financimin e pushtetit lokal.

Projektligji përmban 26 nene dhe është i hartuar në përputhje me praktikën, siç e thashë të legjislacionit të Bashkimit Evropian dhe përvojat më të mira të regjionit.

Të nderuar deputetë,

Do t'ju ftoja që ta mbështetni këtë ligj, ndërsa ne do të jemi të përkushtuar që nëpër komisione të bashkëpunojmë në qoftë se ka nevojë ndonjë ndryshim ose plotësim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ju dy flisni kur t'ju vijë radha. Fjala është për kryetarin ose raportuesin e Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa, nëse e do fjalën. Nuk e doni fjalën! Atëherë, kalojmë te shefat e grupeve parlamentare. Kush e do fjalën në emër të Grupit Parlamentar të partisë Demokratike. Deputetja Safete Hadërgjonaj e ka fjalën.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin për tatimin në pronë e paluajtshme dhe është i mendimit se ky projektligj duhet të kalojë në lexim të parë, sepse me këtë projektligj rregullohet vendosja e tatimit mbi pronë e paluajtshme dhe njëkohësisht përcaktohen standardet dhe procedurat, të cilat duhet t'i respektojnë komunat gjatë administrimit të këtij tatimi.

Edhe pse çështja e tatimit në pronë ka qenë e rregulluar që nga viti 2003 me Rregulloren e UNMIK-ut numër 2003/29, shumë çështje nuk kanë qenë mjaft të qartësuar, si procedurat e ankesave dhe institucionet që merren me to, me qëllim të një administrimi më efikas të tatimit në pronë, nuk kanë qenë të rregulluara në mënyrë ligjore aq sa ka qenë të nevojshme kompetenca e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave dhe kompetencat e komunave për shpërndarjen e faturave tatimore, si dhe disa çështje tjera me interes në këtë fushë.

Me këtë projektligj janë qartësuar këto çështje dhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, është i mendimit se është ofruar një kornizë gjithëpërfshirëse ligjore për menaxhimin dhe administrimin e tatimit në pronë për shtetin dhe për komunat të bazuara edhe në standardet ndërkombëtare.

Në këtë projektligj janë përcaktuar dhe qartësuar procedurat për përmirësimin e shërbimeve ndaj tatimpaguesve, me qëllim që të hyrat nga tatimi në pronë të derdhen në llogaritë komunale dhe të përdoren për komuna, nga komunat në pajtim me Ligjin për menaxhimin e financave të pushtetit lokal.

Projektligji është hartuar në pajtim me legjislacionin e Bashkësisë Evropiane, por duke pasur parasysh njëkohësisht edhe sistemin juridik të Kosovës, projektligji ka kosto financiare të përballueshme për buxhetin e Republikës së Kosovës, kështu që Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka përkrahur këtë projektligj dhe kontributin e vet do ta japë përmes anëtarëve në Komisionin funksional në amendamentimit e këtij projektligji. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputete! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, Armend Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Nevoja për shndërrimin e Rregullores së UNMIK-ut 2003/29 për tatimin mbi pronën e paluajtshme në ligj të Kosovës, pas miratimit edhe në të kaluarën të paketës fiskale, ka qenë më se e domosdoshme, në këtë rast, për një administrim efikas të tatimit në pronë, duke marrë parasysh disa elemente të cilat përmirësojnë dhe kanë për synim kryesor një administrim më të mirë dhe menaxhim të tatimit në pronën e paluajtshme. Me plotësimet në këtë ligj, të cilat do të jenë si ndryshimi i datave të pagesës së kësteve, krijimi i hapësirës ligjore për shpërndarje të faturave të tatimit në pronë dhe rishikimi i institucioneve të cilat do të lirohen nga tatimi, qartësimi i procedurave të ankesave dhe harmonizimi edhe me akte tjera dhe në bazë të Ligjit mbi administratën tatimore dhe procedurat, tregon se ky ligj i plotëson kushtet dhe kriteret për miratim, në parim. Prandaj, Grupi Parlamentar i LDK-së e përkrah dhe angazhohet maksimalisht që ky ligj të procedohet me kohë, sa më shpejt. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit edhe për racionalizëm! Fjalën e ka, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, kush tjetër përveç Haki Shatrit.

HAKI SHATRI: Faleminderit, kryetar!

Meqenëse esencialisht nuk ka ndonjë ndryshim të materies së këtij dokumenti me rregullore të UNMIK-ut të cilat janë aktualisht në fuqi, ne konsiderojmë se me këtë dokument as nuk është pretenduar nga propozuesi ndonjë reformim i kësaj sfere të sistemit fiskal. Disa përmirësime sipërfaqësore, siç është qartësimi i procedurave dhe mënyra e shpërndarjes së faturave të obliguesve e tjera, por edhe vetë procesi i konvertimit të rregulloreve të UNMIK-ut në ligj, për Grupin Parlamentar të Aleancës janë të pranueshme, prandaj ne për këtë dokument në këtë formë siç është ofruar, e përkrahim, por konsiderojmë që ka nevojë për një dokument i cili do ta reformojë më tutje këtë pjesë të sistemit fiskal. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, fjalën e ka deputetja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!

Grupi Parlamentar i Aleancës Kosova e Re, në parim e përkrah Projektligjin për tatimin në pronën e paluajtshme, duke marrë parasysh se deri më tani në Kosovë është përdorur Rregullorja e UNMIK-ut dhe, fatbardhësisht, edhe me një vonesë bukur të mirë, më në fund erdhi në Kuvend të Kosovës ky projektligj.

Në tërësi, mund të them se projektligji është punuar mirë. Ka mundësi që disa vërejtje të shkojnë në komisionin parlamentar adekuat, në të cilin është, mirëpo vërejtja primare e imja në këtë projektligj dhe e Grupit Parlamentar të AKR-së është shkalla e tatimit. Ministër, pasi je këtu, duke marrë parasysh se të gjithë jemi tatimpagues të shtetit të Kosovës dhe shkalla prej 0.05 deri 1% të vlerës së pronës në treg, atëherë më mirë qenka të rrimë me qira se t'i kemi shtëpitë tona. Të kisha lutur në mënyrë shumë të sinqertë që t'i mbledhësh tatimet e të gjithë qytetarëve të Kosovës, që kjo vlerë të bie prej 0.05% deri 0.5% nëse do që të gjithë qytetarët e Kosovës të jenë tatimpagues të rregullt. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ishalla edhe deputetët janë të rregullt! Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Naser Rugova e ka Fjalën, ose Besa. Atëherë, fjalën e ka deputetja Besa Gaxherri.

BESA GAXHERRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë e ka shqyrtuar me vëmendje këtë ligj. Tashmë të gjithë e dimë se kjo fushë ka qenë e rregulluar me rregulloren e UNMIK-ut 2003/49, por natyrisht ky ligj e plotëson vakumin që e ka pasur rregullorja e UNMIK-ut. Kryesisht, në ligj implikimet buxhetore janë rreth 100.000 euro. Unë mendoj se duhet ta shqyrtojmë, sidomos në Komisionin e Buxhetit dhe të shikojmë në rishqyrtim të buxhetit të Kosovës që t'i sigurojmë këto para, sepse në ligj të shikohet për vitin 2011, ka mundësi të sigurohen dhe për këtë vit të fillojë menjëherë të implementohet ligji. Ndoshta janë disa vërejtje, për shembull, në disa nene theksohet se shumë fusha pretendohen të rregullohen me akte nënligjore, që mendoj se ndoshta mund t'i rregullojmë në ligj, se është edhe për ju, edhe për qytetarët më mirë.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë e përkrah, në parim, këtë ligj dhe do të japë kontributin e vet në komisionet funksionale. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, shumë! Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, deputeti Enis Kervan e ka fjalën!

ENIS KERVAN: Faleminderit, zoti kryetar!

Kendi alanında belediyelere tam yetki veren taşınılmaz mülk vergisi Yasa Taslağı, bugüne kadar UNMİK Yönetmeliği'nin düzenlemiş olduğu alanı dolduracağını ve var olan eksiklikleri tamamlayacağını göz önünde bulundurarak ,7+ Parlamenter Grubu, Yasa Taslağını destekleyecektir. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së Miletqi, e do fjalën! Fjalën deputetit Petar Miletqi!

PETAR MILETIĆ: Samo jedna primedba, pošto u 8. tački u dnevnom redu na srpskom piše – prvo razmatranje Nacrta zakona o porezu na dodatnu vrednost. Verujem da je tehničke prirode i verujem da je nenamerna, ali eto, prosto da administracija odnosno oni koji rade ovo da vode računa. Hvala!

KRYETARI: Mirë, është e saktë. Do të thotë, gabimi është në agjendë. Faleminderit, Miletqi! Në emër të Grupit Parlamentar për Integritet, deputetja Vezira Emrush e ka fjalën.

VEZIRA EMRUŠ: Hvala na datu reč! Kada je u pitanju ovaj zakon na nepokretnu imovinu, moramo da kažemo da je to velika praznina danas na Kosovu u zakonskoj legislaturi i da je zakon jako potreban. Međutim, kada analiziramo sam zakon, ja se posebno obraćam komisijama koje će raditi na amandmanima, funkcionalnim komisijama, zato što je to zakon koji može da zadire u interese zajednice kada je u pitanju nepokretna imovina. Mi znamo kakva je situacija. Mora ovaj zakon, nije prilagođen kosovskim uslovima, da ima identifikaciju korisnika, sadašnjeg korisnika kada je nepokretna imovina, kao što je zemljište, stan, kuća i da se zakon ne poziva stalno na neko ko nije korisnik trenutno, znači da zakon identifikuje korisnika nepokretne imovine.

Još jednu primedbu imamo. Ja sam analizirala procenat plaćanja, na ime plaćanja poreza na imovinu. Moram da kažem da je to procenat od 01% do 05% u balkanskim zemljama. Mi smo krenuli sa pragom od 5%, to što ne možemo da ostvarimo, znamo da je najsiromašnije stanovništvo ovde na Kosovu i ja apelujem da to bude od 01 najviše do

05% po opëstinama koje su razvijeni. Normalno da će biti definisanja imovine, da li su to ruralne ili gradske oblasti, da se ovo na zakonu dosta radi, da se identifikuju znači pravi korisnici i prava vrednost za plaćanje. Da napravimo jedan funkcionalan zakon koji će moći da funkcionise i da puni budžet na opštinskom i na centralnom nivou. Mi ništa nemamo od toga ako napravimo zakon koji ne možemo da ostvarimo ili da primenjujemo. Znamo sada na Kosovu da je opšta situacija neplaćanja poreza i moramo da napravimo jednu dobru matematiku, jednu dobru računicu u ovom zakonu kako bi zakon bio primenljiv. Toliko od naše grupe. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! E kemi vetëm një deputet të lajmëruar për diskutim dhe ky është deputeti Naser Rugova, që e ka fjalën.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti kryetar!

Projektligji për tatimin në pronën e paluajtshme është vërtet një projektligj i rëndësishëm, i cili në radhë të parë definon edhe pronarët, bën një kategorizim të vlerës së pronave dhe i kontribuon shumë buxhetit të pushtetit lokal. Ky ligj cakton tatimin mbi pronën e paluajtshme dhe parashtrohet në njëfarë forme edhe standardet dhe procedurat që janë të obliguara komunat t'i respektojnë gjatë administrimit.

Vërejtja ime është te përqindja e tatimit në pronë. Duhet të vlerësohet sipas kategorizimeve të vlerësuar drejt, zoti ministër, dhe vërtet edhe disa kolegë deputetë këtu e ngritën këtë shqetësim, sepse ende nuk kemi vlerësime adekuate, qoftë të tregut, qoftë një standardizim të caktuar të zonave për çka tatimore t'ajtojnë pronë. Këtu besoj që gjatë punës së mëtejshme dhe procedurave të këtij projektligji duhet të kemi kujdes.

Një vërejtje tjetër apo paqartësi e kam te neni 13, paragrafi 1. Ministria e Ekonomisë dhe Financave duhet të lëshojë akt nënligjor, me të cilin parashtrohen standardet unike të vlerësimit, sipas të cilave komuna vendos vlerën e pronës në treg. Edhe këtu duhet të harmonizohet, të precizohet konkret edhe me udhëzim administrativ, sepse iu lehtëson vjeljen e këtyre taksave dhe pushtetit komunal që mos të ketë konfuzione, thjeshtë të jenë strikte dhe te paragrafi 2, çdo komunë përcakton vlerën e tregut të pronës që është nën juridiksionin e saj, në pajtim me standardet e përcaktuara në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni. Këtu duhet të bëhet ai kategorizimi i vlerësimit dhe normimit të pronës së paluajtshme dhe, vërtet, ky ligj shumë i rëndësishëm për vjeljen e taksave, sidomos siç aplikohet në vendet e zhvilluara, do të ndihmojë shumë për komunitetin dhe pushtetin lokal atje. Ju faleminderit shumë!

KRYETARI: Faleminderit, deputet! Nuk kemi të lajmëruar të tjerë për diskutim. Tani mund të shkojmë në procedurën e votimit. Lus regjinë dhe deputetët të bëhen gati për votim dhe votojmë tash. Prezent janë 67 deputetë.

Konstatohet se me 53 vota "për", asnjë "kundër", 6 abstenime, Kuvendi miratoi, në parim, Projektligjin për tatimin në pronën e paluajtshme. Ju faleminderit!

Drejtimin e seancës e merr zoti Sabri Hamiti, anëtar i Kryesisë së Kuvendit

KRYESUESI: Vazhdojmë me pikën e rendit të ditës, pika e nëntë. Mirëpo, ministrja ka kërkuar që kjo të shtyhet për më vonë, meqë e kishte një takim të domosdoshëm. Atëherë, kalojmë në pikën e dhjetë:

10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Metrologjinë

Në bazë të Rregullës 35.1 të Rregullores së Punës, janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim, në parim, të projektligjit. Ftoj ministrin e Tregtisë dhe Industrisë, zotëri Lutfi Zharkun, që në emër të Qeverisë ta paraqes projektligjin para deputetëve. Urdhëro, zoti ministër!

MINISTRI LUTFI ZHARKU: I nderuar kryesues,

Të nderuar kolegë ministra,

Të nderuar deputetë,

Misioni i sistemit të Metrologjisë në Kosovë është vendosja dhe sigurimi i matjeve të sakta dhe të besueshme në tërë territorin e Kosovës me qëllim të mbrojtjes së jetës, të shëndetit të popullatës, të mjedisit të konsumatorëve dhe të resurseve natyrore, si dhe të mbështetjes së cilësisë së prodhimeve dhe të shërbimeve vendore.

Përkundër të arriturave të mëdha në këtë fushë, janë vërejtur disa vështirësi sa i përket zbatimit të ligjit aktual në fuqi, e të cilat janë të domosdoshme të ndryshohen me qëllim të avancimit të mëtejshëm të sistemit të Metrologjisë si parakusht për zbatimin e shumë udhëzimeve dhe të standardeve teknike të BE-së.

Disa dispozita të ligjit aktual paraqesin dualizëm dhe përzierje të përgjegjësiave dhe të kompetencave ndërmjet Departamentit të Metrologjisë dhe Institutit të Metrologjisë, duke pasuar edhe me ndërhyrje të kompetencave ndërmjet këtyre institucioneve. Përderisa ligji aktual e përcakton Departamentin e Metrologjisë si përgjegjës për vendosjen dhe udhëheqjen e Metrologjisë në vendin tonë, disa dispozita, çështje të përgatitjes së udhëzimeve administrative, punët organizative dhe profesionale i bartin në Institutin e Metrologjisë.

Ligji për Metrologjinë është propozuar të ndryshohet në disa pjesë për të mundësuar punë adekuate dhe më të optimizuar, siç janë çështjet e organizimit, ridefinimin e rolit të institucioneve të metrologjisë, zbatimin e qasjes modulare për vlerësimin e konformitetit, për instrumentet jo automatike dhe për instrumentet matëse. Sa i përket qasjes modulare, projektligji do të përshtatet me qasjen hap pas hapi, duke zbatuar në fazën e parë vetëm udhëzimet që mund të kenë ndikim më të madh në mbrojtjen e konsumatorit dhe në aspekte tjera të jetës dhe që mund ta adresojnë në mënyrë adekuate nga numri i stafit të Departamentit të Metrologjisë dhe mundësive buxhetore.

Gjatë hartimit të këtij projektligji jemi bazuar në dokumentin e Organizatës Ndërkombëtare për Metrologji Ligjore, sfidave të theksuara në Raportin e progresit të Komisionit Evropian, si dhe në Draftin e studimit mbi rishikimin funksional të Ministrisë, të njohur si Projekti Freedom, e të cilat kryesisht rekomandojnë bartjen e kompetencave të caktuara nga organet shtetërore në subjektet tjera jo publike.

Me ligjin e ri është paraparë delegimi i kompetencave për verifikimin e mjeteve matëse ligjore te subjektet e autorizuar për fusha të caktuara të Metrologjisë, konform kërkesave teknike të standardeve, ashtu që Departamenti do të kryejë vetëm mbikëqyrjen metrologjike, praktikë kjo e zhvilluar në të gjitha shtetet e rajonit e më gjerë, të cilat aktivitete nuk kanë qenë të mundshme dhe të parapara në mënyrë të qartë me ligjin në fuqi.

Projektligji i propozuar mundëson forcimin e statusit të Departamentit të Metrologjisë në nivelin të cilin e kanë të gjitha shtetet evropiane, e që mundëson zbatimin më efikas të

funksioneve profesionale, organizimin funksional të laboratorëve testues dhe kalibrues në Laboratorin Qendror të Metrologjisë së Kosovës, si dhe përcakton qartë strukturën e njësive të specializuara në kuadër të Departamentit.

Në projektligjin e propozuar janë paraparë kompetenca për institucione të cilat nuk kanë qenë të formuara dhe të parapara me ligjin në fuqi dhe kjo ka bërë që një pjesë e madhe e neneve në ligjin aktual të pësojnë ndryshime.

Projektligji ka për qëllim rregullimin e sistemit të njësive matëse, etalon për matje, procedura të vlerësimit të konformitetit të mjeteve matëse, kërkesat metrologjike për produktet e parapaketuara, autorizimet në fushën e metrologjisë, mbikëqyrjen metrologjike si dhe përgjegjësitë e Departamentit të Metrologjisë.

Të nderuar deputetë,

Miratimi i Projektligjit për Metrologjinë do t'i mundësojë Kosovës një avancim të sistemit të metrologjisë si pjesë e infrastrukturës shtetërore të cilësisë. Duke qenë të vetëdijshëm për rëndësinë e këtij projektligji, ju propozoj që ta shqyrtoni dhe ta miratoni në këtë seancë plenare. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!

E hap diskutimin për Projektligjin, në parim.

Nuk shoh paraqitje të kryetarit, as të raportuesit të komisionit funksional. Nuk shoh as interesim të kryetarëve të komisioneve tjera, prandaj kërkoj deklarime të shefave të grupeve parlamentare. Thërras përfaqësuesin e PDK-ës, zonjën Nerxhivane Dauti, deputete.

NERXHIVANE DAUTI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

I nderuar zoti ministër,

Me Ligjin për Metrologjinë rregullohen çështje me rëndësi që kanë të bëjnë me sistemin e njësive matëse, procedurat e vlerësimit të konformitetit të mjeteve matëse, kërkesat metrologjike, autorizimet në fushën e metrologjisë dhe përgjegjësitë e Departamentit të Metrologjisë.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e mirëpret dhe e përshëndet sjelljen në Kuvend të këtij ligji me rëndësi të veçantë në fushën e metrologjisë. Ky ligj zbatohet në fushat që kanë të bëjnë me mbrojtjen e shëndetit, mbrojtjen e konsumatorit, sigurisë së përgjithshme teknike, transaksionet e mallrave dhe shërbimeve.

Vlen të theksohet se aktualisht ekziston Ligji për Metrologjinë numër 02/34, mirëpo ligji aktual ka pasur të pa përcaktuara qartë përgjegjësitë dhe kompetencat ndërmjet institucioneve bartëse të sistemit të metrologjisë. Arsyeja e dytë për një projektligj të ri është paraqitur si nevojë e ngritjes së statusit të Departamentit të Metrologjisë në nivel më të lartë që mundëson zbatimin më efikas të funksioneve profesionale. Me ligjin e ri janë paraparë kompetenca për institucionet të cilat nuk kanë qenë të formuara dhe të parapara me ligjin që është zbatuar gjer më tani dhe kjo ka bërë që një pjesë e madhe e dispozitave juridike që e rregullojnë metrologjinë, në ligjin aktual të pësojnë ndryshime thelbësore.

Një komponentë tjetër e këtij ligji të propozuar, është edhe harmonizimi me direktivat evropiane, konkretisht Direktivën 2004/22 mbi instrumentet matëse, Direktivën 2009/23

mbi instrumentet jo automatike të matjes, vlerësimin e konformitetit, shenjën e konformitetit, si dhe është në pajtim me Konventën e Parisit mbi themelimin e Organizatës Ndërkombëtare për Metrologji Ligjore, të vitit 1955.

Projektligji i propozuar, marrë në përgjithësi, përmban një teknikë juridike të mirë, por megjithatë vërejtja jonë e përgjithshme është se në ligj është lënë një hapësirë e gjerë që me akte nënligjore të rregullohen çështje thelbësore të kësaj materie.

Unë i kam evidentuar, janë përafërsisht 13 vende, kur me akte nënligjore ligji delegon kompetenca, që mendoj se është një sferë shumë e gjerë. Megjithatë, këto do t'i kemi parasysh në komisionin funksional, ku jam anëtarë në këtë komision dhe mendoj se këto do të korrigjohen.

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, unë e përshëndes Ministrinë për punën e bërë, për intensitetin e shtuar në drejtim të miratimit të ligjeve funksionale, të ligjeve të cilat na nevojiten për ekonominë e lirë të tregut.

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike dhe në cilësinë e anëtares së Komisionit për Ekonomi, konsiderojmë se ligji i propozuar duhet të miratohet në shqyrtim të parë, duke e marrë parasysh faktin, rëndësinë e tij të veçantë, ndërsa kontributin profesional, do ta paraqesim në Komisionin funksional. Ju falënderoj për vëmendje.

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja deputete! Për Grupin Parlamentar të LDK-së, deputeti Zef Morina.

ZEF MORINA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, me kujdes e ka shqyrtuar Projektligjin për metrologjinë, i cili është më mirë i përgatitur në krahasim me ligjin aktual. Me qenë se ligji aktual shumë gjëra nuk i kishte të definuar dhe për këtë arsye, ka hasur në vështirësi praktike për t'u zbatuar, mendoj edhe LDK-ja e parasheh që ky ligj shumë gjëra të cilat nuk kanë qenë të rregulluara, tani janë shumë më mirë të precizuara dhe të përgatitura.

Me këtë projektligj, këto gjëra të cilat më herët kanë qenë pothuaj se shumë të paqarta, janë shumë më të rregulluara dhe shumë më të qarta, në mënyrë që edhe ligji do të jetë shumë më praktik për t'u zbatuar, andaj, ne si grup parlamentar e përkrahim dhe përmes anëtarëve tanë në komision do të japim kontributin në amendamentimin e tij. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Morina!

Për Grupin Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, deputeti dhe kolegu Naim Maloku.

NAIM MALOKU: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Ne e kemi mirëpritur si grup parlamentar ardhjen e këtij projektligji në shqyrtim të parë, për shkak se avancohet projektligjin, ligjin që është në fuqi. Mirëpo, më lejoni që shkurt

t'i paraqes disa vërejtje që i kemi hasur gjatë shqyrtimit të këtij projektligji e që kanë të bëjnë me pjesën e Projektligjit nga neni 39 dhe më tutje. Neni 39, paragrafi 2.2, 2.3, 2.4 dhe 2.5, parasheh pezullimin, qoftë te përdorimit të mjeteve matëse ose pezullimin e kryerjes së veprimtarive të subjekteve të autorizuar që kontrollohen, mirëpo në nenin 40, përcaktohet me ligj obligimi për mbështetje të inspektorit gjatë mbikëqyrjes, që subjektet që mbikëqyrën janë të obliguara t'i ofrojnë mbështetje. Ky nen, nuk ka paragrafë që sanksionojnë me ligj refuzimin e ofrimit të mbështetjes. Pra, çka do të ndodhte dhe çfarë veprimi do të kishte ndërmarrë inspektori, në qoftë se një subjekt afarist, po e zëmë, refuzon të mbështesë inspektorin në kryerjen e punëve dhe obligimit që e ka me ligj verifikimin e njësive matëse që përdoren, për shembull me atë subjekt, në atë subjekt afarist.

Mendoj që ky nen duhet ta ketë një paragraf për veprimet e inspektorit në rast se refuzohet kontrolli apo inspektimi i mjeteve matëse.

Tjetër, në paragrafin 4 të po këtij ligji, te po këtij neni, pra neni 40, thotë kështu, citoj: "Inspektori gjithnjë duhet të ketë parasysh se në rast të ndërprerjes së përkohshme sikurse në paragrafin 3 të këtij neni, mos t'i shkaktojë dëme subjektit të mbikëqyrur. Pra edhe ky paragraf, praktikisht e pamundëson objektin e nenit 39, që ka pezullimin e aktiviteteve në subjektin afarist kur pezullohet, zoti Ministër, puna e një subjekti, atëherë do të thotë i shkaktohen dëme atij për shkak se nuk punon... por kjo duhet të qartësohet dhe të harmonizohet dhe ky nen të ketë, do të thotë, të jetë më i kompletuar dhe të ketë inspektori qasje të pa refuzuar në kryerjen e detyrës që e ka, pra inspektimin e mjeteve matëse. Mendoj se të gjithë qytetarët dhe konsumatorët kanë vërejtje të shumta, posaçërisht me njësitë matëse të KEK-ut, që janë pra njësorët të KEK-ut, që janë pra njësorët e KEK-ut dhe posaçërisht ka edhe vërejtje në njësitë matëse që përdoren të volumit nëpër pikat e karburanteve, ku qytetarët çdo ditë furnizohen me lëndë djegëse. Ka dyshime jashtëzakonisht të shumta që mjetet matëse nuk e tregojnë volumen, atë të cilin praktikisht edhe e marrin qytetarët, konsumatorët kur furnizohen.

Unë e ftoj ministrin dhe sugjeroj që të ketë kujdes në këtë pjesë të ligjit, pra ndaj nenit 39, të mos hyjmë pastaj edhe te gjrobat. Pra, duhet të parashihiem gjoba më të larta për subjektet afariste të cilat refuzojnë, për shembull për kontrollin dhe mbikëqyrjen e pajisjeve dhe mjeteve matëse. Në parim, Grup Parlamentar i AAK-së e mbështetë këtë projektligj. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zotëri deputet!
Për Grupin e AKR-së, Myzejene Selmani, deputete.

MYZEJENE SELMANI: Jo, jo Ligji është i... Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ani, çoni dorën kush flet në emër të Grupit?

MYZEJENE SELMANI: Ju faleminderit, zoti kryesues! Është një mosmarrëveshje, të lutem.

Grupi Parlamentar i AKR-së e ka analizuar Projektligjin për Metrologjinë dhe synon që me këtë projektligj, do të bëhet rregullimi i sistemit të njësive matëse, siç është paraparë në projektligj dhe në përgjithësi mund të them kompetencat e Departamentit të Metrologjisë, ku parashihiet plotësim- ndryshimi i ligjit të mëparshëm L-34, me standardet e BE-së, mirëpo njëkohësisht edhe me këtë projektligj, në rast se amendamentohet dhe kalon në shqyrtimin e dytë, atëherë do të bie edhe Ligji për njësitë

matëse dhe do të balancohen këto dy ligje me këtë ligj të ri, pas amendamentimit, mirëpo, vërejtjet e mia në këtë projektligj, do të them se parimisht Grupi Parlamentar i AKR-së e përkrah këtë projektligj, mirëpo si do të shkojë në amendamentim ky projektligj ku parashihet edhe numri i ri i të punësuarve dhe i nevojitet orar shtesë për zbatimin e këtij ligji, ministri duhet ta ketë me dije dhe njëkohësisht thuhet se me këtë ligj, janë paraparë kompetencat për institucionet të cilat nuk kanë qenë të formuara dhe të parapara me ligjin e vjetër, por nuk mund të sqarohet as në memorandum as në ligj shumë qartë se cilat janë këto institucione. Dhe, duke marrë parasysh se jam pjesë edhe e Komisionit Parlamentar për Tregti dhe Industri, besoj që në një konsultim shumë të mirë të gjithë anëtarëve të Komisionit dhe njëkohësisht me plotësime shumë të mëdha, duke marrë rëndësinë shumë të madhe të këtij ligji për qytetarët e Kosovës, ne do të mundohemi që ta bëjmë amendamentimin sa më të mirë të mundur të këtij projektligji. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja deputete!

Për Grupin Parlamentar atë LDD-së, flet deputetja Qamile Morina

QAMILE MORINA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Ministra,

Deputetë të nderuar,

Lidhja Demokratike e Dardanisë konsideron se Projektligji për Metrologji ka rëndësi ngase krijohet mundësia e një sistemi të qëndrueshëm dhe kompatibil i metrologjisë në Kosovë, i cili do të mundësojë matje të sakta dhe të besueshme me qëllim që të mbrojtë jetën, shëndetin e popullatës, kafshëve, mjedisin, konsumatorët dhe resurset natyrore. Do të mundësojë saktësi të mjeteve matëse, me qëllim të ngritjes së cilësisë së prodhimeve dhe shërbimeve vendore për të qenë konkurruese në tregun vendor dhe të jashtëm.

Projektligji për metrologji, është në fakt ndryshim i ligjit ekzistues për metrologji, që është miratuar në vitin 2006. Meqë ligji aktual ka qenë i përcjell me shumë paqartësi, si mungesa e definimit të saktë të përgjegjësive dhe kompetencave të institucioneve dhe subjekteve që formojnë sistemin e metrologjisë ka bërë që ky ligj nuk ka gjetur zbatueshmëri të plotë për shkak të mangësive ekzistuese.

Projektligji për metrologji synon të bëjë definimin e saktë të përgjegjësive dhe të kompetencave të institucioneve dhe subjekteve të cilat formojnë sistemin e metrologjisë në Republikën e Kosovës, si dhe ngritjen e kapaciteteve profesionale, administrative në aspektin e harmonizimit të implementimit të procedurave dhe legjislacionin për vlerësim të konformitetit të instrumenteve matëse me ato të Bashkësisë Evropiane. Duke pasur parasysh që Projektligji për metrologji do të zbatohet në fushat që kanë të bëjnë me mbrojtjen e shëndetit të njerëzve dhe kafshëve, si dhe mbrojtjen e konsumatorit, mjedisit dhe transaksionet e mallrave, ka pasur për synim përafrimin me atë që garanton Traktati i komunitetit evropian dhe aktet tjera sekondare në fushë të metrologjisë. Mirëpo, duke pasur parasysh se për zbatueshmëritë e këtij ligji dhe në fushat tjera, kërkohen konsultime të mëtejme, me dokumente tjera relevante, në mënyrë që të arrihet zbatueshmëria e efektiviteti.

Vërejtjet tona serioze lidhur me zbatueshmërinë e këtij projektligji, është se sipas vlerësimit të implikimeve buxhetore parashihet kostoja shtesë buxhetore, që nuk është trajtuar dhe përfshirë në buxhetin e këtij viti, që do të thotë se Departamenti i Metrologjisë, parashihet të rritet në staf, pastaj trajnimi i këtij stafi si dhe rrije e shpenzimeve të tjera administrative, andaj kostoja buxhetore që vlerësohet në këtë rast

apo edhe kostoja e pidentifikuar, e që mund të paraqitet me rastin e zbatimit të ligjit, nuk mund të financohet në këtë vit. Dhe, kjo kosto buxhetore duhet trajtuar gjatë përgatitjes së kornizës afatmesme të shpenzimeve për vitin 211-2113, por edhe me rastin e përgatitjes së buxhetit për vitin 2011, në të kundërtën Qeveria dhe Kuvendi duhet të përcaktojnë burimet shtesë të financimit për zbatimin e këtij projektligji.

Lidhja Demokratike e Dardanisë, konsideron edhe e miraton në parim, e mbështet në parim këtë projektligj edhe pse jemi të bindur që ky projektligj që ta arrijë zbatueshmërinë e tij, duhet sqarime shtesë nga sponzoruesit e tij për implikime buxhetore. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja deputete!
Në emër të Grupit për Integritet, deputetja Vezira Emrush.

VEZIRA EMRUŠ: Ponovo hvala na datu reč!

Pred nama je opet jedan od jako važnih zakona, Zakon o metrologiji. Ovo kažem iz jednog razloga zato što ovaj zakon znamo da definiše sistem mernih jedinica i kvalitet samih proizvoda. Ovaj zakon faktički utvrđuje čitav sistem nabavke i plasiranja robe na tržištu Kosova i iste van Kosova, sa poštovanjem pojedinih mernih jedinica i poštovanjem kvaliteta robe i proizvoda koji se određuje na osnovu funkcionisanja samog zakona.

Međutim, ovaj zakon znamo da definiše pored kvaliteta proizvoda, i kvalitet usluga, kao što je usluga na ime električne energije, gde mora Ministarstvo za trgovinu i industriju da obrati više pažnje kada su u pitanju merna mesta potrošnje električne energije koja, ja mogu slobodno da kažem, faktički uopšte ne podležu ovom ispitivanju od punih možda 10. godina. Ovaj zakon mora da definiše prave subjekte, fizička i pravna lica koja podležu obavezi zakona. Ove segmente, meni je jako žao, moram da kažem zakon nema, zakon je dobro pisan – opisan, ali nema prave segmente gde moramo da obratimo pažnju. Iako je zakon bitan, od ispitivanja nabavke, od ispitivanja zlata, kažemo do nafte. Znači, sve što dolazi i sve što je životna sredina, i sve što je zaštita potrošača.

Rekla sam da mora jasno da definiše zadatak, da mora jasno da definiše i da se Vlada i Skupština opredele dali će to biti nadležnost Departmana o metrologiji, ili će to biti Institut za metrologiju. Zašto ovo kažem? Mi smo u Prizrenu imali gotov institut, sa gotovom laboratorijom, koji smo stavili van upotrebe, ne znam iz kojih razloga i stavili smo van upotrebe celu kadrovsku službu tamo i napravili smo jedno usko grlo da bi normalno imali, da ne bi imali ova merenja i ovu nadležnost na terenu. Ovaj Zakon mora da se nadje budžetska linija, Vlada mora da nadje, da postavi na noge ovaj zakon. Dali će institut biti na centralnom nivou u Prištini ili u Prizrenu, dali će to biti sa kojim nadležnostima da se krene na terenu da bi mogli da budemo paritet na evropskom tržištu pošto je naš put Evropska Unija. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja deputete!
Deputeti Sadik Idriz, në emër të Grupit “7+”.

SADIK IDRIZ: Hvala, predsedavajući!

Parlamentarna grupa „7+“ u načelu podržava ovaj Nacrt zakona i glasaće za ovaj nacrt. Mi smo u prošlom mandatu imali od prilike šta da kažemo i rekli smo, jer smo se kao grupa zalagali da ostane Institut za metrologiju u Prizrenu, da to bude jedna državna institucija koja neće imati sedišta u Prištini nego u Prizrenu, ali to nije prošlo, nismo

uspeli prošli put. Pokušaćemo amandmanom i na ovaj Nacrt zakona, ako je to moguće, ako nije, mi ćemo dati svoj doprinos kao Parlamentarna grupa u funkcionalnoj i u drugim komisijama, a inače u načelu se slažemo i podržavamo ovaj nacrt zakona. Hvala!

KRYESUESI: I kemi edhe dy deputet diskutues. Para se t'ia jap fjalën deputeti Riza Smaka, unë i them regjisë që t'i bie ziles të kthehen deputetët, se duhet ta votojnë ligjin. Deputeti Riza Smaka, e ka fjalën.

RIZA SMAKA: I nderuar, zotëri kryesues!

Respekt zotëri ministër,

Kolegë të nderuar,

Meriton mbështetje Ministria për Tregti, Industri dhe ministri Zharku për këtë punë që e kanë bërë, na e kanë prezantuar një dokument të rëndësishëm dhe shihet se është investuar punë e mirë. Gjithsesi, nuk ka punë të përkryer. Në parim, disa sugjerime, kështu po e zëmë, për shembull, te neni 45 – Dispozitat ndëshkuese, ndëshkimore. Inspektori i metrologjisë për shkelje të konstatuara, me këtë ligj shqipton, nuk shqiptohen masat, por caktohen. E tash, e marr paragrafin e dytë, ju lutem! Në tri gjuhë, nuk është korrespondent edhe ka terma, si shembull po e marr ekzemplar, ka terma që nuk janë juridike. Po e zëmë, për shembull, konkretisht thotë, me “gjobë”, gjithsesi “dënim me të holla” duhet. Prej 500 deri 1500 euro ndëshkohet subjekti. Cili subjekt, se ka subjekt juridik, ka subjekt fizik, ose disa e përdorin person juridik, person fizik ose në terminologjinë më të re, si të themi kështu, më bashkëkohore – entitet natyral, entitet legal, por gjithsesi do të duhej me konsistencë të ishte, ama në këtë rast të precizohej, i cili subjekt, domethënë, a fizik apo juridik? Mirë, këtu nënkuptohet, por nuk është fjala që ne ta nënkuptojmë, sepse te implemtuesi mund të paraqiten ose, nëse dëshiron mund ta zbatojë ashtu si dëshiron, a në kolizion me intencën e ligjdhënësit.

Më pastaj, qe po e zëmë, kjo është edhe në të tri gjuhët, nuk po korrespondon reciprokisht. Në qoftë se e marrim logjikën, te lartësia e dënimit me të holla, nuk është bash në rregull, sepse përfaqësuesi ligjor, që mund të jetë drejtori, presidenti, administratori, menaxheri, që tani veç e kanë imponuar disa si term, është familjarizuar. Më i përgjegjshmi është për këto kundërvajtje që janë numëruar këtu taksativisht sipas enumeracionit, ai apo ajo, është për ligjshmërinë, për zbatimin e ligjit dhe del se ai do të dënohej me të holla simbolikisht, ndërsa institucioni, entiteti legal, në këtë rast, do të gjobitej shumë lart, që do të ishte e padrejtë, plus asaj nuk do të kishte efekte, se qëllimi është të dënohet ai apo ajo që duhet të dënohet për ta ndier peshën e kundërvajtjes.

Ose te neni 46, ju lutem, po e zëmë, nuk duhet të përmbajë akti ligjor formulimet e këtilla të cilat janë të njohura edhe janë të përcaktuara edhe më mirë në dokumentet e tjera. Po e zëmë, aktiviteti i legjislacionit sekondar, ai është ekskluzivitet i ministrive dhe, ja çka thuhet, po e zëmë. Këtu veç një konstatim. Thotë, neni 46, - Ministria e Tregtisë dhe Industrisë për zbatim të këtij ligji do të nxjerrë akte nënligjore, qe është totalisht e panevojshme, domethënë e panevojshme. Bile ta kishte precizuar, si të them, t'ia lidh kryet dhe të thoshte – brenda tre muajve apo eventualisht gjashtë muajve. Tash, po e zëmë, për ta argumentuar atë që thashë që nuk përkojnë, nuk janë korospodente termat në të tri gjuhët, nuk thuhet, po e zëmë, në anglisht ministries of trade and industry will be promulgated, se promullgimi nuk është adoptimi, promullgimi është krejt diçka tjetër, promullgimin e bën presidenti, kryetari i shtetit në konformitet me Kushtetutën, a adoptimin dihet se kush e bën. Ndërsa, në serbisht nuk shkon fare, nuk aplikohet që thuhet Ministarstvo trgovine i industrije u svrhu implementacije, po primene, domethënë është fjala për terma juridike, se tingëllojnë shumë keq, sidomos për ata që e kanë

materien e jurisprudencës të familjarizuar, se nuk përkon, është me rëndësi që të aplikimi paraqiten problemet. Ka këso rastesh, unë i përmenda zotëri kryesues 2 – 3 raste, këto janë po thuaj se gati të rregullta në krejt tekstin.

Prandaj, me siguri do të duhej të rishikohej edhe gjuhësisht, terminologjikisht po se po dhe ta gdhendin, së pakut me qëllim që njëra gjuhë të ishte si të them bazë, ose do të duhej të thuhej se ky dokument është miratuar në këtë gjuhë, në mënyrë që në dy gjuhë të tjera t'i përshtateshin dokumentit të parë të gjuhës së caktuar, sepse këto kur janë të ndryshme, paraqesin probleme të mëdha në praktikë, aq më parë kur në përmbledhje të ligjeve në “Gazetën zyrtare” thuhet se tri tekstet janë autentike, të tri tekstet aplikohen. Atëherë, për këtë mund të flitet shumë gjatë, çfarë do të ndodhte kur tri tekstet do të ishin të ndryshme dhe, natyrisht, do të vinte opsioni *optint* - për këtë, jo në këtë **rast** ngadalë ti analizoj këto edhe të përcaktohem për cilin tekst, e dua tekstin në gjuhën, bie **fjala këtë, këtë**, të aplikohet në rastin tim. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Et'hem Çeku, a është këtu? Fjalën e ka Dugolli, është i fundit. Dugolli, si eks – ministër i resorit.

BUJAR DUGOLLI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Ky ligj është jashtëzakonisht i rëndësishëm, sepse përveç që e ka rolin për rregullimin e tregut të tregtisë së brendshme, normalisht ndikon pozitivisht edhe në mbrojtjen e konsumatorit dhe të drejtat e konsumatorit që shpeshherë duke mos u zbatuar legjislacioni ekzistues apo rregulla ndërkombëtare ata bien viktimit e mashtrimeve të ndryshme që rrjedhin si rezultat i mospërputhshmërisë apo moszbatimit të dispozitave ligjore.

U tha që këtu ka qenë një ligj i cili është dashur të plotësohet dhe të harmonizohet me standardet ndërkombëtare dhe unë mendoj që edhe në vazhdimësi do të ketë nevojë për harmonizimin e standardeve ndërkombëtare, sepse në procesin që do të futemi për anëtarësim apo procesin e anëtarësimit në BE, do të ketë shumë çështje të cilat ne do t'i harmonizojmë me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Lidhur me këtë çështje, mendoj që unë kam pritur që gjatë leximit të këtij ligji do të shoh që është menduar nga grupi profesionist apo Ministria që të ndërtohet një këshill kombëtar i metrologjisë, i cili do të hartohet nga ekspertët më të mirë që i ka vendi të cilët do të jenë në një procedurë të përzgjedhjes, qoftë nga Qeveria apo nga Kuvendi pse jo, sepse kjo është fushë jashtëzakonisht e rëndësishme i cili në kontinuitet do ta përcillte zbatueshmërinë në aspektin profesional, sepse ministër e dini që ndërrimet kur ka ndërrime, domethënë të qeverisjes shpesh ndodhë që stafi civil diku largohet me vullnet, diku vjen si rezultat i praktikave që tashmë njihen dhe shpesh aspekti profesional mungonte zbatueshmëria apo përputhshmëria me dispozita dhe këtu mund të bie viktimit stafi politik në këtë rast edhe ministri ku në nenin 30 tek autorizimet thuhet: Departamenti i rekomandon ministrit dhe në rast se nuk do të ketë një mbikëqyrje profesionale të cilën mund ta realizojë Këshilli kombëtar i Metrologjisë, atëherë nuk do të ketë veprimtari në të cilat mund të futet ministri në çështjet që nuk i njeh në aspektin profesional dhe mund të bëhen gabime.

Unë mendoj që ndoshta në amendamentimin e mëtutjeshëm në Komision funksional ku mund të ftohen edhe ekspertë, mund të parashihet që të shtohet kjo çështje se me të

vërtetë kjo është fushë shumë e rëndësishme që ekzistimi i një këshilli kombëtar në nivel vendit për mbikëqyrje dhe përcjellje të zbatueshmërisë së saj do të ishte shumë në interes dhe mendoj që mund të bëhet.

Edhe një çështje tjetër e kam që mendoj te aspektet e përkufizimit sa i përket njësive matëse thuhet citoj, nënkupton madhësinë e caktuar e pranuar me marrëveshje për të shprehur në mënyrë sasiore madhësitë të tjera të njëjtës natyrë. Lind pyetja të pranuar me marrëveshje, me çfarë marrëveshje domethënë është një çështje që është lënë pak e mjegulluar dhe mendoj që duhet të sqarohet. Këto i pata unë, përndryshe ligji është i mirë dhe duhet të mbështetet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Dugolli!
Zoti ministër, a ke nevojë me shtua diçka. Urdhëro!

MINISTRI LUTFI ZHARKU: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Sqarimi i parë ka të bëjë me vërejtjen e deputetes Dauti, mendoj sa i përket udhëzimeve administrative besoj se është një praktikë më e mirë që Qeverisë t'i lihet më shumë hapësirë në rregullimin e çështjeve të ndryshme për shkak të vetë procedurës së ndryshimit të ligjit, po edhe një hapësirë, një liri më e madhe e Qeverisë për t' i rregulluar çështjet e caktuara.

Dy çështje që zoti Maloku i përmendi, ka të bëjë me refuzimin e mbështetjes të subjekti, personalisht e kam bërë atë pyetje nga ana e Departamentit apo këshilltarëve ligjorë mu ka thënë që ajo çështje është e rregulluar me ligj tjetër apo kemi raste kur pengohet personi zyrtar në kryerjen e detyrave të tij, dhe mu ka thënë që në këtë ligj nuk ka nevojë se ajo është vepër penale e rregulluar me ligje tjera.

Edhe çështja që t' i shkaktoj dëme subjektit të mbikëqyrur nga pezullimit, ka të bëjë me atë që kemi dashur të mos lëmë një arbitraritet inspektorëve eventualisht mbikëqyrje që ta ndërpres prodhimin apo ta pengojë një subjekt në veprimtarinë e tij që të ketë kujdes rregullisht që ajo të kryhet, po e marrim nëse ka punë sezonale apo në kohën që ka më pak punë.

Çështjet që u përmenden të Institutit të Metrologjinë në Prizren, mendoj se ajo do të rregullohet jo në nivelin që ka qenë apo unë besoj që është çështje që duhet të lihet nga ana e departamentit mënyra e rregullimit të tij më interne.

Sa i përket Këshillit Kombëtar të Metrologjinë të nderuar deputetë, unë besoj që me një dispozitë nuk jam shumë i sigurt, por e kemi lënë një hapësirë ku Departamenti ka të drejtë të krijoj trupa të ndryshme apo forume të ndryshme. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!

Deputet të nderuar,

Ashtu edhe teknika të bëhemi gati për votimin në parim të këtij projektligji.

Ju lutem bëhuni gati votojmë tash:

Të pranishëm janë 71 deputetë.

Konstatohet se me 69 vota "për", 1 abstenon dhe asnjë "kundër", kështu miratohet në parim Projektligji për Metrologjinë.

Në bazë të Rregullores së Punës së Kuvendit, ky Kuvend ngarkon komisionet:

- Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, në funksion të Komisionit funksional,
- Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi,
- Komisioni për Buxhet dhe Financa,
- Komisioni për Komunitete, dhe
- Komisioni për Integritet Evropian.

Komisionet duhet që brenda 2 muajsh nga shqyrtimi i parë, Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandime.

Deputetë të nderuar,

Kalojmë në pikën e njëmbëdhjetë të rendit të ditës:

11. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit të Pavarur të Mediave, për vitin 2009

Unë, këtu tash, meqë një shef i grupit parlamentar ish në konsultim te unë, pak përpara ju kërkoi, a dëshironi ta vazhdojmë punën, apo kërkoj deklaram të shefave të grupeve. Ramë buja.

RAMË BUJA: Mbështes propozimin e Grupit parlamentar të AAK-së që nesër ta vazhdojmë punën në orën 10,00.

KRYESUESI: Kërkoj prej LDK-së që prononcohet.

ISMET BEQIRI: Unë i mbështes propozimet e dy deputetëve të mëparshëm, nesër në ora 10,00.

KRYESUESI: Çka thotë AKR-ja.

RITA HAJZERAJ: Edhe ne si Grup Parlamentar pajtohemi që nesër të vazhdojë seanca.

KRYESUESI: LDD-ja, Lulzim Zeneli.

AAK-ja, ju lutem, Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë propozova, do të thotë, që të vazhdojmë nesër dhe e falënderoj edhe zotin Buja, edhe zotin Beqiri.

KRYESUESI: Mbështetjen e ke, mos pyet. Edhe Xhezair Murati e ka kërkuar fjalën.

XHEZAIR MURATI: Ne jemi për vazhdimin e seancës.

KRYESUESI: E hedh në votim, kush thotë që nesër me plotë elan të vijmë e të punojmë. Shihemi nesër në orën 10:00

E premte, 30 prill 2010, ora 10:00

Seancën drejton: kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë, zëvendëskryeministra, ministër,
Vazhdojmë me punimin e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të filluar më 29 prill 2010, për pikat e mbetura.

Konstatohet se në sallë janë 67 deputetë, që do të thotë janë plotësuar kushtet për të filluar punën.

Vazhdojmë me pikën e nëntë të rendit të ditës, për të vazhduar më pas me pikën e njëmbëdhjetë e kështu me radhë.

Në rend të ditës kemi:

9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për konfliktet administrative

Në bazë të Rregullës 35.1 të Rregullores së Punës, janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe në miratim, në parim, të këtij projektligji.

Ftoj ministren e Administratës Publike, zonjën Edita Tahiri, që në emër të Qeverisë para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë projektligjin.

MINISTRJA EDITA TAHIRI: Mirëmëngjesi!

I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Qeveri e nderuar,

Të nderuar deputetë,

Në përpjekje për të kompletuar infrastrukturën legjislative të shtetit tonë, kam kënaqësinë që para jush të paraqes për aprovim Projektligjin për konfliktet administrative.

Projektligji për konfliktet administrative ka për qëllim që të rregullojë konfliktin administrativ, mbrojtjen gjyqësore të të drejtave të personave fizikë dhe juridikë, si dhe vlerësimin e ligjshmërisë së akteve administrative në procedurën administrative.

Me këtë projektligj rregullohen në tërësi marrëdhëniet në kontestet administrative midis organeve të administratës, palëve dhe gjykatave kompetente.

Ky projektligj ju ofron palëve më shumë garanci procedurale dhe në të njëjtën kohë eliminon ligjet e zbatuara deri më tani.

Projektligji është aprovuar nga Qeveria me vendimin nr. 7/115 të datës 25 mars 2010 dhe sipas procedurës së përcaktuar po i parashtrohet për miratim Kuvendit të Kosovës.

Ky projektligj përmban 64 nene. Pjesa e parë, përkatësisht dispozitat themelore, ku bëjnë pjesë nenet 1,2,3,4,5 dhe 6, përfshin përkufizimet e termave për nevojat e këtij ligji. Po ashtu, përcakton mbrojtjen gjyqësore të të drejtave të personave fizikë, të personave juridikë, si dhe sigurimin e ligjshmërisë së akteve administrative, me të cilat organet e administratës në kuadër të autorizimeve të tyre vendosin për të drejtat dhe detyrimet në çështjet administrative. Pastaj, bën përcaktimin se kush mund të jetë palë në konfliktin administrativ, duke përfshirë gjithë subjektet që konsiderojnë se me aktin përfundimtar administrativ iu është shkelur ndonjë e drejtë apo interes i drejtpërdrejtë i bazuar në ligj. Në këtë grup mund të hyjnë personi fizik, personi juridik, grupi i personave, avokati i

popullit, shoqatat dhe organizatat e tjera, organi i administratës, prokurori publik dhe personi i autorizuar i administratës ose i autoritetit publik.

Sipas këtij ligji, kompetent për zgjidhjen e konfliktit administrativ është Gjykata kompetente për çështje administrative.

Neni 7 deri në nenin 16 të këtij ligji, parasheh mundësinë e fillimit të konfliktit administrativ kundër aktit administrativ, kundër të cilit nuk ka mjete të rregullta juridike në procedurën administrative, si dhe aktet administrative kundër të cilave nuk mund të zhvillohet konflikti administrativ.

Arsyet për të cilat akti administrativ mund të kontestohet janë: sqarimi i të drejtave dhe detyrave të palëve në konfliktin administrativ, mundësia e shtyrjes së ekzekutimit nga organi, akti i cili ekzekutohet, gjegjësisht organi që është kompetent deri në vendimin definitiv gjyqësor.

Nenet 17, 18 dhe 19 të këtij ligji përcaktojnë kompetencën për vendosje në konfliktin administrativ, përbërjen e kolegjit, rastet kur dhe nga kush paraqiten mjetet e rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike.

Prej nenit 20 deri në nenin 41 të këtij ligji është paraparë procedura në bazë të padisë, me të cilën rregullohet mënyra e fillimit, vazhdimit dhe përfundimit të konfliktit administrativ.

Ky projektligj parasheh që konflikti administrativ fillon me padi, e cila paraqitet në afat prej 30 ditësh që nga data e dorëzimit të aktit administrativ.

Pastaj, përcakton mënyrën e dorëzimit të padisë te gjykata apo organi tjetër. Mundësinë e fillimit të konfliktit administrativ për shkak të heshtjes së organit administrativ, vlerësimin formal dhe material të padisë dhe mënyrën e vendosjes nga ana e gjykatës lidhur me padinë e paraqitur.

Më tej përcakton detyrimet e organit kompetent që të veprojë ashtu si është caktuar në aktgjykim dhe të nxjerrë akt të ri administrativ, mundësinë që gjykata vetë të vërtetojë gjendjen faktike dhe në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar të nxjerrë aktgjykimin, respektivisht vendimin kur në bazë të provave është e qartë se gjendja faktike ndryshon nga ajo që është vërtetuar në procedurën administrative, ose nëse për të njëjtën çështje administrative është anuluar një herë akti administrativ, ndërsa organi administrativ nuk ka vepruar plotësisht sipas aktgjykimit.

Procedura sipas mjeteve juridike është paraparë nga neni 44 deri në nenin 55. Me këto dispozita është paraparë mënyra e paraqitjes së ankesës, kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm, kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe kërkesës për rishikim, si dhe është përcaktuar procedura lidhur me këto mjete juridike dhe afatet për paraqitjen e tyre.

Në pjesën - Dispozita të tjera të procedurës, është paraparë që nëse ky ligj nuk përmban rregulla për konfliktin administrativ, atëherë do të zbatohen përshtatshëm dispozitat e ligjit për procedurën kontestimore, si dhe bartja e shpenzimeve.

Nenet 58, 59, 60 dhe 61 përcaktojnë karakterin e detyrueshëm të aktgjykimit dhe rregullat se si të veprohet pas anulimit të aktit administrativ, ku parashihet afati për

nxjerrjen e vendimit të ri të organit administrativ, si dhe obligimi i organit që të veprojë sipas pikëpamjeve juridike dhe vërejtjeve të gjykatës, mënyra e veprimit kur organi administrativ nuk vepron sipas aktgjykimit, pastaj mënyra e vendosjes nga gjykata, kur pala paraqet padi të re.

Në dispozitat e fundit dhe kalimtare është paraparë që për paditë e paraqitura deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji të aplikohen dispozitat e ligjit të aplikueshëm, si dhe shfuqizimi i të gjitha dispozitave të ligjit të aplikueshëm pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Për zbatimin e këtij ligji nuk nevojitet të nxirren akte nënligjore, si dhe nuk do të ketë implikime buxhetore.

Të nderuar deputetë,

Duke pasur nevojën që Kosova si shtet i ri sa më shpejt të plotësojë të gjithë kuadrin ligjor për funksionimin sa më efikas, ju ftoj që pas një debati që do ta kemi së bashku, ta aprovoni në parim këtë projektligj të rëndësishëm për ardhmërinë e vendit tonë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministre!

Kryetarët e komisioneve, nëse e donë fjalën. A ka? Nëse jo, atëherë në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, kush e do fjalën? Deputeti Hajredin Hyseni e ka fjalën.

HAJREDIN HYSENI: Faleminderit, zoti kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Projektligji për konfliktet administrative, i cili rregullon konfliktet administrative, është një projektligj shumë i nevojshëm sepse bën ndarjen nga një legjislacion i sistemit të kaluar. Me këtë projektligj synohet edhe që të arrihet një përgjegjshmëri dhe efikasitet në marrëdhëniet mes palëve në procedurë dhe autoritete administrative.

Me këtë projektligj, i cili është mjaft mirë i punuar, mundësohet që të kemi një ligjshmëri dhe një procedurë të drejtë vendimmarrje në konfliktet administrative. Gjithashtu, në mënyrë precize shpjegon mënyrën e kontestimit të vendimeve, me çka pamundësohen abuzimet me pushtetin.

Projektligji nuk i cenon parimet e përgjithshme të legjislacionit të BE-së dhe gjithashtu bën mbrojtjen gjyqësore të të drejtave të personave fizikë dhe juridikë, me çka mund të themi se ky projektligj arrin standarde të mira në trajtimin dhe zgjidhjen e konflikteve administrative. Duke vlerësuar se ky projektligj është i mirë dhe i plotëson kriteret e një projektligji, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e përkrah në parim këtë projektligj.

KRYETARI: faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, fjalën e ka kryetari i Grupit, deputeti Ismet Beqiri.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Duke mos dëshiruar fare ta zgjas, me qenë se është në lexim të parë, vetëm mund të konfirmoj që Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e përkrah dhe do ta votojë miratimin e këtij projektligji në leximin e parë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, kryetari i grupit, deputeti Ardian Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Fillimisht, po ashtu dua të konfirmoj se në parim e mbështesim projektligjin, është projektligj format, i cili duhet të kalojë. Mirëpo, po provoj t'i ndihmoj pak Kuvendit me disa çështje të ndryshme, Kuvendit edhe Kosovës, në fund të fundit, për aq sa mundem.

Po vazhdon sistemi i njëjtë i paraqitjes së projektligjeve nga ekzekutivi në sistemin e prezantimit të numrit të neneve, se çka flitet prej nenit kaq deri në nenin kaq, çka flitet prej këtij neni në nenin tjetër, do të thotë është një përshkrim i ligjit thua se askush nuk e ka lexuar projektligjin këtu hiq, unë e di që shumica ndoshta nuk e lexojnë, po duhet nisur prej supozimit që deputetët lexojnë, kështu që në këtë rast nuk ka nevojë të na tregohet sa nene i ka ligji, as cili nen për çka flet për shkak se këto janë çështje të cilat ne i dimë.

Tani po kaloj në aspektin tjetër, i cili ka të bëjë me politikën. Kuvendi është institucion politik, 100% politik, nuk është as administrativ, as profesional, as kurrfarë tjetër, po është 100% politik dhe ne merremi vetëm me politikë, e di që ka pasur këtu deputetë që kanë thënë mos politizoni shpesh, po çuditshëm është ajo t'i thuhet Kuvendit mos politizo.

Çka do të thotë kjo. Ne na intereson që ministrat të vijnë të na tregojnë pse po bëhet ky ligj në aspektin politik, jo në aspektin administrativ. Çka po i vyen Kosovës ky ligj? Me çka kemi punua deri tash përderisa nuk ka ekzistua ky ligj dhe çka ndërron me këtë ligjin e ri, çka fiton Kosova, çka bëhet kur aprovohet ligji, çka ndodh me Kosovën kur ligji nënshkruhet nga presidenti dhe hynë në fuqi. Kuvendit duhet t'i interesojë kjo, e jo sa nene i ka ligji. Mendoj që është diçka që i ndihmon Kosovës, e kemi bërë një përvojë parlamentare, vetëm kjo legjislaturë i ka më shumë se dy vite dhe duhet filluar të sofistikohemi pak. Me këtë që e shohim me mënyrën e prezantimit, ne e kuptojmë që ligjin e bën administrata dhe ministrat bëhen vetëm mjet i prezantimit të asaj që shkruan administrata dhe kurrgjë tjetër. Ministri duhet të ketë ide politike pse ligji, pse po na vyen ky ligj neve, çka ndryshon me këtë ligj, çka bëhet Kosova më e mirë në momentin që aprovohet ligji.

Mendoj se e di që kam thënë një herë, këtë koment e kam thënë një herë, po e bëjë edhe një herë, mendoj që i ndihmon edhe Qeverisë, i ndihmon edhe Kuvendit, po bëhet e mërzitshme paraqitja e ligjeve duke na treguar sa nene i ka ligji edhe cili nen për çka flet, sado që ne i lexojmë. Edhe një herë po them, e mbështesim në parim projektligjin, është projektligj që duhet të kalojë. Unë ju falënderoj për vëmendjen!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, deputeti Riza Smaka e ka fjalën.

RIZA SMAKA: I nderuari zotëri kryetar,

Të nderuar ministra,

Deputetë të respektuar,

Pa konfliktin administrativ efikas dhe eficient, nuk ka shtet të së drejtës dhe nuk është zbulim i ditëve tona, daton nga borgjezitë, nga revolucionin borgjez e tjera e tjera. Këtë sistem e kemi pasur edhe deri më sot në këtë apo në atë mënyrë dhe nuk është e thënë që

me heqjen e atyre dispozitave, me miratimin e këtyre bëjmë revolucion. Tek e fundit, do të shohim te neni 17, që janë disa zgjidhje që janë, si të them këtu, antiproduktive. Gjithsesi e mbështesim në këtë dokument, apo jo, po disa vërejtje parimore.

Me këtë dokument juridik nuk është definuar sa dhe si duhet akti administrativ edhe akti material i administratës, e kjo është parakusht, se kundër aktit material të administratës nuk mund të procedohet konflikti administrativ.

Më pastaj, në nenin 2, paragrafi 2, nuk është definuar sa dhe si duhet nocioni i saktë, i drejtë e adapt i aktit administrativ. Akti administrativ është akti i administratës publike, i miratuar në procedurën administrative gjatë vendosjes së çështjeve juridike administrative në mënyrë autoritative, po jo edhe ai definim që është dhënë atje, që është shumë me rëndësi se duhet të definohet qartë në mënyrë që vetëm akti administrativ mund të jetë objekt i konfliktit administrativ.

Më pastaj, me nenin 9, paragrafi 2, është dhënë mundësia që me akte ligjore tjera që të bëhet restriksion për procedimin e konfliktit administrativ, e nuk është mirë asi soji, se synimi është që gjyqësori ta kontrollojë administratën nëpërmjet konfliktit administrativ, e mund të ndodhë që me akte të tjera, po e zëmë, që të bëhen përjashtime të rasteve, tek e fundit ky është ligji, ky është ligji special, që është mbi ligjin e përgjithshëm, lex specialis derogate lex generalis.

Më pastaj, te neni 17, ju lutem, në të gjitha praktikat e konflikteve administrative të shteteve moderne me peshë, sanksionohet dyshkallshmëria plus kontrolli gjyqësor, gjykata supreme, ose bie fjala, Gjermani, Franca, Austria kanë gjykata administrative supreme, që vetëm kundër aktit administrativ të shkallës përfundimtarë mund të procedohet konflikti administrativ, e ndryshe këtu me nenin 17, ju lutem, praktikisht pesë shkallë konstituohen, pesë instanca. Edhe me hipotezën se do të vendosshin organet, bie fjala administrativi i shkallës së parë, i shkallës së dytë, e gjykata, që këtu bile thotë gjykata përkatëse, duhet të precizohet cila gjykatë, gjykata themelore, bie fjala, apo e apelit, e kështu me radhë. Edhe këtu po e marrë, çështje e interpretimit, e hamendjes, po e marrim se dy organet e administratës, plus gjykata themelore, plus gjykata e apelit, edhe gjykata supreme, me supozimin se do të procedonin në mënyrë shumë efikase, së paku dy vjet do të zgjaste, ju lutem, përfundimisht vendosja e një çështje juridike administrative, e kur ta marrim realitetin tonë, mesatarisht 10 vjet do të zgjaste, sidomos gjykata që e kemi sot aktualisht, 250.000 lëndë të paprekura, të pahapura, se janë disa mija tjera që janë hapë edhe ato nuk dihet se kur gjykohen. Prandaj, çështje parimore, ju lutem, duhet dyshkallshmëria, që është parim juridik, valid edhe në administratë, edhe në gjyqësor, në çështjet juridike civile, edhe penale, edhe ekonomike, edhe administrative, e jo pesë shkallë.

Do të përpiqemi, duke e mbështetur në parim, ne do të jem në dispozicion që në vendet ku ndodhemi të japim një kontribut tonin aq sa mundemi për ta përmirësuar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të LDD-së, deputeti Lulzim Zeneli e ka fjalën.

LULZIM ZENELI: Faleminderit, zoti kryetar!

Grupi Parlamentar i LDD-së e mbështet, në parim, Projektligjin për konfliktet administrative. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, deputetja Shpresa Murati e ka fjalën.

SHPRESA MURATI: Hvala, predsedniče!

Pozdrav svima!

Nacrt zakona o upravnim sporovima je jedan od izuzetnog značaja, jer reguliše pravila upravnog spora, sudsku zaštitu, prava fizičkih i pravnih lica, kao i ocenjivanje zakonitosti upravnih akata u upravnom postupku.

Ovaj predlog zakona pruža sigurnost strankama u upravnom postupku i dopunu međunarodnih standarda, što je uslov za integrisanje u međunarodnim institucijama.

Predlog zakona je dobro izrađen, u glavnom najvećim delom na osnovu zakona o upravnim sporovima Republike Hrvatske. Međutim, ono što u pomenutom zakonu ima a u našem predlogu zakona nema, odnosno nedostaje jesu kaznene odredbe. Šta u slučaju ne izvršenja presude u određenom roku, koje su kazne? Naravno da u čitavom nacrtu ima mesta za izmene i dopune pojedinih članova, što će funkcionalna komisija uraditi u cilju izrade što funkcionalnijeg zakona koji će biti sprovedljiv u praksi. I na samom kraju, Parlamentarna Grupa „7+“ podržava ovaj Nacrt zakona u načelu i daće svoj doprinos u toku njegove dalje procedure. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, e do dikush fjalën? Petar Miletij e ka fjalën.

PETAR MILETIĆ: Poslanička grupa Samostalne liberalne stranke u načelu podržava ovaj zakon.

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar për Integritet, deputeti Numan Baliq, e ka fjalën.

NUMAN BALIĆ: Faleminderit, zotëri kryetar i Kuvendit!

Ovde bih želeo da kažem nekoliko zapažanja u ime grupe i moje osobno ime vezano za ovaj zakon. Smatram da je važno donošenje ovoga zakona i mi ćemo svakako podržati i istakao bi nekoliko stvari koje smatram važnim, tri ili četiri stvari, a prije toga bi se osvrnuo možda, malo bih meditirao na osnovu razmišljanja dvojice, trojice govornika koji su govorili prije ovoga o važnosti suđenja, o važnosti pravednog suđenja i tako dalje.

Čitava istorija ljudske zajednice u stvari počiva na dilemi o pravednim ili nepravednim vlastima i o pravednim i nepravednim sudovima. Jedna od najlošijih karika i najslabijih karika i kosovskog sistema jeste pravosudni sistem koji je nedjelotvoran, nefunkcionalan, nepravedan, nesamostavan, o tome sam govorio na jednoj sednici oko toga da ovo može biti prilika da ovaj zakon popravi onaj dio pravosudnog sistema koji se tiče povrede administrativnog postupka, i to je možda najbolji deo zakona koji se tiče toga pitanja.

Dakle, vrlo smo često u situacijama, u zemljama u kojima posebno pravosudni sistem slabo ili vrlo malo funkcioniše, da se krši zakonska procedura, da se krši administrativni postupak, da se povređuju osnovna zakonska procedura i da se nanosi šteta bilo kome subjektu, bilo da je to autoritet u okviru tog sistema ili strana koja je na sudu, koja se sudi.

Dakle, rešavanje pitanja povrede administrativnog postupka, kojim se bavi ovaj zakon, je od velike važnosti. Takođe je bitno da se regulišu bar neki djelovi, ako ne svi, jer zakon naravno ima i svoje nedostatke, ali u svakom slučaju ima dobru nameru da se efikasno odgovori na put ovom problemu koji sam istakao.

Pitanje žalbenog postupka, koje će se takođe mnogo cjelishodnije nastojati rešavati ovim zakonom i, naravno, neka pitanja takođe koja se tiču principa u odnosu na glavne postulate donete u ovom zakonu.

Kao treće što bih istakao, jeste da je dobro da ovaj zakon ne boluje, da tako kažem, od sindroma podzakonskih akata. Inače, to je velika boljka mnogih zakona koje smo doneli, a mnoge od tih zakona smo prosto prepisali, da oni boluju od tih podzakonskih akata, tako da zakašnjavaju, čine ne efikasnim zakone, ne upotrebljivim u mnogim smislovima i da je dobro da ovaj zakon nema podzakonskih akata i da je sam zakon regulisao mnoge sporne stvari kojima se bavio.

Na kraju bih poručio i to da se nadam da će ovaj zakon poboljšati, odnosno stvoriti uslove da se konačno počne bolje i pravednije suditi u ovoj zemlji, da će se poboljšati stanje sudova i konačno početi osamostaljivanje sudova, jer oni za sad to naravno nisu bili, jer ne mogu biti samostalni od onih koji utiču na njih bilo preko vlasti, preko ministarstava, preko moći novca, kriminalnog delovanja ili bilo kog drugog delovanja. Skoro sam bio u sudu, na kraju sasvim da vam kažem, i ako je poboljšano stanje sudija pa imaju bolje plate, rečeno mi je i to moram reći da sudski činovnici, pravnici koji pomažu u mnogim stvarima, imaju plate 250 evra. Moramo mnogo uložiti u sudove, moramo donositi zakone naravno kao što je ovaj i moramo ih primenjivati. Hvala vam lepo!

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Tani i kemi edhe katër deputetë të lajmëruar për diskutim.

Po fillojmë sipas radhës. Fjalën e ka deputeti Arsim Bajrami.

ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Ky ligj në fakt është ligj i fundit nga pakoja e ligjeve për reformën e administratës publike, sepse kjo legjislaturë tanimë ka miratuar ose është duke miratuar 8 ligje të tjera për reformën e administratës publike dhe pa dyshim që miratimi i këtij ligji po e rrumbullakon një proces të krijimit të kornizës ligjore për reformën e administratës publike. Ligji ka qenë i domosdoshëm, sepse e plotëson një vakum ligjor. Deri më tani Kosova nuk ka pas një ligj të tillë dhe në një mënyrë implementon edhe parimin kushtetues, sipas të cilit sigurohet kontrolli ligjor i veprimeve të organeve të administratës.

Konflikti administrativ është një konflikt i veçantë dhe special dhe ka të bëjë kryesisht me ligjshmërinë e akteve administrative dhe vetëm të akteve të formës së prerë, që është edhe një garancion kushtetues për mbrojtjen gjyqësore të lirive dhe të drejtave të njeriut, kështu që qëllimi politik i miratimit të ligjit është i qartë dhe ai ka të bëjë me sigurimin e garancioneve dhe të mundësive të qytetarëve që në rrugë gjyqësore t'i mbrojnë të drejtat që eventualisht do të mund të shkelen në procedura administrative.

Ligji ka tri qëllime. E para, ai definon në mënyrë të qartë nocionin e konfliktit administrativ, e jep atë deficionin pozitiv dhe negativ, pozitiv në kuptimin që konflikti administrativ mund të niset vetëm ndaj një akti të formës së prerë të organit administrativ dhe definimi negativ është që ky ligj mund të niset edhe në rast të heshtjes administrative,

që është jashtëzakonisht e rëndësishme për të bërë një presion në efikasitetin e administratës, sepse një mënyrë e neglizhencës administrative është edhe sëmundja e vjetër administrative, e ashtë quajtura heshtje e administratës.

Projektligji është dorëzuar në Qeveri pa u harmonizuar me Ligjin për gjykatat, i cili ka kalua ndërkohë dhe siç e kemi parë, të nderuar deputetë, Ligji për gjykatat aplikon një sistem tjetër të gjykatave dhe brenda gjykatave themelore, si gjykata e shkallës së parë, parasheh formimin e kolegjeve administrative, kurse ky projektligj është i ndërtuar në atë koncept që konfliktet administrative të delegohen vetëm te Gjykata Supreme e Kosovës. Për këtë arsye, e kisha lutur sponzoruesin, por edhe komisionin funksional që të kenë parasysh në leximin e dytë që ta evitojnë treshkallshmërinë e procesit të konfliktit administrativ në sistemin gjyqësor. E tha edhe profesor Smaka, do të mund të kemi dy shkallë në nivel administrativ, kur kësaj ia shtojmë edhe tri nivele në sistem gjyqësor, atëherë vërtet e humb kuptimin procesi i konfliktit administrativ, kështu që kisha kërkuar që me rastin e amendamentimit, në mënyrë të veçantë të kemi kujdes që konflikti administrativ të hapet vetëm në Gjykatë Supreme dhe aty të kemi vetëm një shkallë, diçka e ngjashme siç është tek Gjykata Kushtetuese dhe mos të kemi mundësi të apelimet ndaj një vendimi të formës së prerë të një gjykate.

Propozimi i dytë, siç e dimë, ne para ca kohe e kemi miratuar Ligjin për ndryshimin e procedurës administrative. Ai ligj tanimë është më në leximin e dytë dhe në atë ligj është janë paraparë dy mundësi shumë të mira për qytetarët e Republikës së Kosovës. E para, mundësia e fillimit elektronik të procesit administrativ, që përkon edhe me komplet pakon e strategjive për qeverisje elektronike. Dhe, e dyta, obligimi zyrtar apo atë që ne juristët e quajmë ex officio, jo organet që të mbledhin prova në favor të palës. Kjo është një praktikë evropiane që po e aplikojnë të gjitha shtetet që po aderojnë në hapësirën evropiane administrative, që administrata të servisojë pa pagesë shërbime për qytetarë. Mjafton që qytetari ta bëjë një kërkesë për ta filluar një proces të konfliktit administrativ, organi që zhvillon duhet të mbledh prova në emër të palës. Kjo e racionalizon administratën dhe i jep kuptim administratës, duke e shndërruar atë në servil, kështu që me rastin e amendamentimit ne duhet të kemi kujdes, duhet t'i japim mundësinë qytetarit që ta hapë në mënyrë elektronike një konflikt administrativ, ta bëjë një padi në mënyrë elektronike dhe ta obligojmë organin gjyqësor që zhvillon procedurë, që sipas detyrës zyrtare të mbledhë prova në favor të palës.

Procedurat administrative të parapara me këtë Projektligj për konfliktin administrativ janë tipike dhe ato janë standarde, janë të harmonizuara edhe me Projektligjin për procedurën administrative, kështu që unë jap një përkrahje parimore dhe mendoj se me këto dy rishikime në procesin e amendamentimit ne mund ta kemi një ligj jashtëzakonisht të mirë për konflikt administrativ dhe në këtë mënyrë ta plotësojmë plotësisht kuadrin ligjor për reformën e administratës publike. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjala tani është për deputeten Nekibe Kelmendi.

NEKIBE KELMENDI: Faleminderit, i nderuar zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Zëvendëskryeministra, ministra,

Unë, gjithashtu, në parim e mbështes këtë ligj dhe e përgëzoj ministren që e ka sjell këtë ligj prej Qeverisë në Parlament për ta miratuar.

Është menduar fillimisht që të themelohet një gjykatë e veçantë administrative, e cila do t'i gjykonte të gjitha çështjet administrative. Mirëpo, nuk është lejuar sigurisht për shkak të koston apo për arsye të tjera. Sido që të jetë, Ligji për gjykatat në lexim të parë ka kaluar, siç e cekën kolegët deputetë, të nderuar profesorët, dhe kishte për të qenë mirë që komisioni funksional të bëjë amendamentimin dhe shqyrtimin e këtij ligji dhe ta përgatis për lexim të dytë së bashku me Ligjin për gjykatat, në mënyrë që disa pjesë të këtij ligji të harmonizohen me Ligjin për gjykatat dhe të shkojnë këto dy ligje së bashku për miratim në të njëjtën kohë në procedurë parlamentare. Kjo do t'i evitonte të gjitha ato çështje që u përmendën këtu, sidomos do ta evidentonte pesëshkallshmërinë, që është në nonsens në procedurat administrative apo procedurat tjera. Kjo do të ishte ajo që pata ndërmend ta them. Pata ndërmend të them edhe diçka që i thanë kolegët deputetë, kështu që fjalimin po e shkurttoj vetëm me kaq dhe propozoj që ky ligj të miratohet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputete!
Fjalën e ka tani deputetja Nerxhivane Dauti.

NERXHIVANE DAUTI: faleminderit, zoti kryetar!
Të nderuar kolegë deputetë,
Zëvendëskryeministra dhe ministra të nderuar,
Në vazhden e përpjekjeve për të kompletuar bazën ligjore për rregullimin e çështjeve administrative, është edhe Ligji për konfliktin administrativ. Për këtë ligj unë kam shtruar dy herë pyetje parlamentare për ministrin e Administratës Publike dhe më vjen mirë që ky ligj sot po shqyrtohet në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Ligji për konfliktin administrativ dhe ai për procedurën administrative, që është shqyrtuar muajin e kaluar në Kuvend, paraqesin ligjet më të rëndësishme në sferën e administratës publike.

Procedurat administrative janë të themeluara për ta bërë efektiv dhe të realizueshëm parimin e ligjshmërisë në veprimet dhe vendimet e administratës, në mënyrë që të sigurojë një garanci formale për të drejtat e individëve përmes një aplikimi praktik të parimit të legalitetit, si dhe për të siguruar një garanci zyrtare përmes transparencës.

Ligji që jemi duke shqyrtuar përmban rregulla procedurale që synojnë të garantojnë ligjshmëri, përgjegjshmëri dhe transparencë në marrëdhëniet e autoriteteve administrative me palët në procedurë.

Me këtë projektligj synohet të adresohen çështje thelbësore të cilat kanë të bëjnë me parimet udhëheqëse administrative, si parimi i barazisë së palëve, parimi i dëgjimit të palëve, parimi i efikasitetit dhe parime të tjera.

Ky projektligj rregullon konfliktin administrativ, mbrojtjen gjyqësore të të drejtave të personave fizikë dhe juridikë, si dhe vlerësimin e ligjshmërisë së akteve administrative në procedurën administrative. Është me rëndësi të theksohet se ky ligj ju ofron palëve më shumë garanci procedurale dhe eliminon edhe ligje të aplikueshme që e kanë rregulluar këtë fushë të rëndësishme.

Projektligji i propozuar, marrë në përgjegjësi, përmban një teknikë, një gjuhë juridike të mirë.

Unë e përshëndes Ministrinë për punën e bërë, për intensitetin e shtuar në drejtim të miratimit të ligjeve funksionale, të ligjeve bashkëkohore për administratën publike.

Duke marrë parasysh rëndësinë e veçantë që ka Ligji për konfliktin administrativ, e mbështes Projektligjin e propozuar në shqyrtim të parë, ndërsa kontributin tim profesional do ta paraqes në komisionin funksional. Ju faleminderit për vëmendje!

KRYETARI: Faleminderit!

Dhe, diskutuesja e fundit është deputetja Sanije Aliaj.

SANIJE ALIAJ: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Të nderuar ministra,

Të respektuar deputetë,

Arsyeja për një legjislacion që rregullon funksionimin e një administrate shtetërore është e madhe, pasi edhe në BE e kërkojnë krijimin e një administrate të qëndrueshme funksionale, e cila është e nevojshme për respektimin e ligjit, zbatimin efektiv të politikave të demokratizimit dhe të zhvillimit ekonomik të vendit. Projektligji për konfliktet administrative plotëson pakon e ligjeve për një administratë funksionale, që rregullon marrëdhëniet e autoriteteve administrative me palët në procedurë, si dhe eliminon ligjet e aplikueshme që tani janë të zbatueshme në Kosovë.

Ministria e Shërbimeve Publike meriton mbështetjen për këtë projektligj, sepse ka një strukturë e teknikë të mirë juridike. Projektligji ka për qëllim rregullimin e konfliktit administrativ, mbrojtjen gjyqësore të të drejtave të personave fizikë, juridikë, si dhe vlerësimin e ligjshmërisë të akteve administrative në procedurën administrative. Pra, rregullon fushën që ka të bëjë me konfliktin administrativ, gjegjësisht të drejtat e palëve në procedurën administrative.

Projektligji e ka rëndësinë e vet, sepse shkelja e të drejtave të njeriut dhe e subjekteve në administratë është në rritje e sipër. Në shoqërinë demokratike të drejtat personale të individit janë legjitime. Projektligji iu mundëson subjekteve të ndryshme të drejtën e fillimit të konfliktit administrativ në gjykatën kompetente. Me këtë rast do të potencoj, është e përcaktuar në projektligj cilës gjykatë i drejtohet pala. Kur pala konsideron se me aktin administrativ është shkelur ndonjë e drejtë apo interes personal të bazuar me ligj, pra projektligji tenton të vendos masa ligjore për të rivendosur ekuilibrin mes palëve ose të paktën për t'i zvogëluar gjasat e padrejtësisë në institucionet administrative.

Nga neni 17 deri në nenin 41 projektligji rregullon procedurën në bazë të padisë, pra rregullon mënyrën e dorëzimit të padisë, mundësinë e fillimit të konfliktit administrativ, vlerësimin formal edhe material të padisë në gjykata, mënyrën e vendosjes së gjykatës lidhur me padinë dhe detyrimet e organeve kompetente administrative që të veprojnë ashtu siç është vendosur në gjykatat kompetente me aktgjykim.

Shkallëzohet niveli i gjykatave për shqyrtimin e aktit administrativ. Mendoj se realizimi i së drejtës me akt administrativ në tri nivele të gjykatave vetëm e ngadalëson realizimin e së drejtës që i është bërë palës në institucionet administrative.

Në nenin 48 rregullohen mundësitë që pala e interesuar mund t'i drejtohet gjykatës kompetente për rishikimin e vendimit, duke ofruar fakte dhe prova të reja. Me këtë rast do të potencoj se projektligjit i mungojnë masat ndëshkuese, nëse pala që bën kërkesën

për rishikim në aktgjykim e ka për qëllim zvarritjen e zbatimit të aktgjykimit për të shfrytëzuar në kohë, që në praktikë shpesh po ju ndodhë punëtorëve të administratës. Masat ndëshkuese në këtë projektligj do të zvogëlohen në fillimin e konfliktit administrativ.

Projektligjin e përkrah, në parim, se i plotëson standardet bashkëkohore për fillimin e konfliktit administrativ me rastin e shkeljes së të drejtave me akt administrativ dhe besoj se do të zvogëlohet rritja e nivelit të konflikteve në administratën shtetërore të Kosovës dhe se është në pajtim me *acquis communautaire* dhe nuk ka implikime të drejtpërdrejta buxhetore. Besoj se kontributi i deputetëve në komisionet funksionale do t'i plotësojë zbrazëtitrat në këtë projektligj që të bëhet më lehtë i zbatueshëm në praktikë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Nuk kemi më të lajmëruar për diskutim. Është radha për të hyrë në procedurën e votimit.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim.

Në sallë kemi 68 deputetë. Votojmë tash:

Konstatoj se me 60 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 1 abstenim, Kuvendi miratoi, në parim, Projektligjin për konfliktet administrative.

Në bazë të Rregullores së Punës, Kuvendi i ngarkon këto komisione:

1. Komisionin për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, si komision funksional,
2. Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi,
3. Komisionin për Buxhet dhe Financa,
4. Komisionin për Komunitete, dhe
5. Komisionin për Integrime Evropiane.

Komisionet duhet që brenda 2 muajve nga shqyrtimi i parë, Kuvendit t'i paraqesin raportin me rekomandime.

Vazhdojmë me pikën njëmbëdhjetë të rendit të ditës, pasi të dhjetën e kemi kaluar dje.

11. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit të Pavarur për Media, për vitin 2009

Komisioni funksional për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, në pajtim me dispozitën e Rregullores së Punës ka shqyrtuar Raportin e Komisionit të Pavarur për Media për vitin 2009 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Komisioni për Buxhet dhe financa ka shqyrtuar pjesën financiare të raportit të Komisionit të Pavarur për Media për vitin 2009 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Radha është e kryetarit të komisionit, nëse e do fjalën. Fjalën e ka kryetari i komisionit funksional, deputeti Esat Brajshori.

ESAT BRAJSHORI: Faleminderit, zoti kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni i Pavarur për Media, më 26 shkurt 2008, i ka adresuar Kuvendit të Kosovës Raportin vjetor të punës konform nenin 3.8 të Ligjit për Komisionin e Pavarur për Media dhe Transmetim.

Komisioni, më 9 mars 2010, ka vënë në rend të ditës Raportin e Komisionit të Pavarur të Mediave dhe e ka tërhequr me arsyetimin se disa anëtarë të Komisionit kanë nevojë akoma për ta shqyrtuar raportin. Menjëherë, më 26 mars 2010, komisioni ka shqyrtuar raportin vjetor të Komisionit të Pavarur të Mediave.

Komisioni ka shqyrtuar këtë raport duke iu referuar objektivave të Komisionit të Pavarur të Mediave për vitin 2009 dhe shkallën e realizimit të atyre objektivave. Nga shtatë çështjet kryesore, që ka vlerësuar Komisioni i Pavarur për Media si objektiva për vitin 2009, Komisioni i Pavarur për Media nuk ka gjetur ndonjë mangësi të theksuar në punën dhe realizimin e këtyre objektivave, përkundrazi ka shprehur një vlerësim unanim për punën e Komisionit të Pavarur të Mediave.

Megjithatë, nuk mund ta tejkalojmë këtë çështje pa e prekur pak krijimin dhe adoptimin e politikës për procesin e digjitalizimit. Në kuadrin e mundësive të veta, Komisioni i Pavarur për Media ka bërë një punë të madhe në këtë rrafsh, por ju e dini se kjo çështje do një harmonizim si nga ana e Qeverisë, e Kuvendit dhe nuk mund të jetë vetëm çështje e Komisionit të Pavarur për Media, ka edhe një kosto të lartë. Ju e dini se deri në vitin 2015 duhet të ndodhë digjitalizimi edhe në Kosovë dhe ka disa pengesa të natyrës objektive.

Megjithatë, Komisioni i Pavarur për Media edhe në këtë rrafsh ka bërë një punë të madhe, duke arritur që të organizojë një konferencë rajonale në Kosovë, më datën 4 dhe 5 dhjetor 2009, ku është bërë prezantimi i transmetimit digjital në Kosovë dhe regjion dhe strategjitë për të ardhmen.

Gjithashtu, te objektivat e Komisionit të Pavarur për Media duhet thënë përkushtimin e këtij komisioni lidhur me licencimin e operatorëve kabllorë në veriun e Kosovës. Komisioni i Pavarur për Media, në mbështetje të OSBE-së ka bërë një përpjekje të madhe që edhe mediat e atjeshme serbe, të cilat funksionojnë jashtë kompetencave, jashtë ligjit, t'i vejë dhe t'i licencojë sikurse të gjitha mediat tjera, por nuk ka arritur, janë dy televizione që funksionojnë pa licencë.

Përpjekjet e Komisionit të Pavarur të Mediave duhet theksuar se janë të mëdha edhe në përkushtimin e këtij Komisioni të Pavarur për Media sa i përket gjetjes dhe hartimit të mundësive për një kanal të dytë të minoriteteve ose të komunitetit serb, siç thotë pakoja e Ahtisarit, në Kosovë. Në fazën aktuale është duke punuar një grup punues dhe janë hartuar strategjitë se si do të funksionojë ky televizion. Do të jetë televizion nacional serb apo do të jetë kanal i dytë i Radiotelevizionit të Kosovës.

Më në fund, në mbledhjen e fundit të këtij grupi punues, që udhëhiqet nga një ambasador, është vendosur që të bëhet një kanal i dytë për komunitete në kuadër të Radiotelevizionit të Kosovës. Dua të theksoj se në këtë rrafsh Komisioni i Pavarur për Media ka bërë një punë të madhe.

Natyrisht që ka edhe disa gjëra që do të duhej të përmenden si punë e madhe e Komisionit të Pavarur për Media, siç është angazhimi i madh për nominimin e kandidatëve për anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës. Ju e dini se mbi dy vite

e gjysmë nuk ka funksionuar ky bord dhe në saje të këtij bordi, që më në fund është votuar edhe në Kuvend të Kosovës, është krijuar ose më saktë janë zgjedhur edhe kuadrot menaxhuese të Radiotelevizionit të Kosovës dhe në këtë rrafsh duket se punët janë vënë në binarë të mbarë.

Ajo që ndoshta na përket neve më shumë, si Kuvend, ka të bëjë me funksionimin e Këshillit të Pavarur të Mediave. Duhet thënë se ka rreth dy vite që anëtari i shtatë i Komisionit të Pavarur të Mediave mungon, ose më saktë të themi, është në kompetencat e këtij Kuvendi që ta emërojë dhe nuk e kemi bërë akoma. Pastaj, është fjala për dy anëtarë të tjerë, të cilëve iu ka skaduar mandati dhe Komisioni i Pavarur për Media nuk po mund të funksionojë në mungesë të anëtarëve të plotë. Them se në këtë drejtim është çështje e Kuvendit dhe unë e di që është krijuar një Komision ad-hoc, së shpejti duhet të bëhen emërimet e munguara.

Komisioni në tërësi e ka përkrahur raportin, gjithashtu ka pasur parasysh edhe strategjitë që i ka shtruar për vitin e ardhshëm Komisioni i Pavarur për Media dhe të gjithë së bashku, si të thuash, me konsensus të plotë e kanë përkrahur ky raport. Faleminderit shumë!

KRYETARI: Në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, kryetari i Komisionit, deputeti Gani Koci e ka fjalën.

GANI KOCI: Faleminderit, zoti kryetar!
Të nderuar deputetë,

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në mbledhjen e vet më 30 mars ka shqyrtuar Raportin e Komisionit të Pavarur për Media dhe Transmetim për sa i përket pjesës financiare dhe ka konstatuar se ky raport përmbush rregullat dhe standardet e raportimit financiar në Kuvend, të parashikuara sipas ligjit që rregullon Komisionin e Pavarur për Media dhe Ligjit të menaxhimit të financave publike, dhe si të tillë ia ka rekomanduar Kuvendit që ta përkrah për sa i përket pjesës financiare.

Nuk dua t'i përsëris çështjet që i shtroi kryetari i komisionit paraprakisht lidhur me strategjinë e zhvillimit ose projeksionet që i ka ky komision për të ardhmen dhe nevojën e digjitalizimit. Ajo kërkon një kosto të madhe financiare dhe ky Kuvend do të ketë parasysh që për vitin e ardhshëm kërkesat e tyre, që janë të projektuara në strategjinë e zhvillimit të këtij institucioni, duhet përmbushen në mënyrë që viti 2015 do të jetë një vit i fundit, vit përfundimtar kur nga transmetimi analog do të kalohet në transmetimin digjital dhe kjo ka një kosto të vet financiar dhe për këtë kosto duhet të mendojmë ne si Kuvend dhe institucionet tjera. Kjo ka qenë edhe kërkesa e komisionit gjatë shqyrtimit të raportit.

Shpenzimet e këtij komisioni në ato që kanë qenë të përcaktuara me Buxhetin e vitit 2009, janë në shkallën 97%. Nuk kemi hyrë në mënyrën e shpenzimit, sepse është raport, është çështje e auditorëve që mund të bëjnë mënyra se si janë shpenzuar këto, por ajo çka është karakteristike, sepse në vitin 2009 ka filluar për herë të parë ndoshta të realizojë të hyra nga licencimi i transmetuesve të ndryshëm dhe ajo gjobitje ose ndëshkimi i institucioneve që nuk përfillin standardet e transmetimit dhe këto të hyra janë diku rreth 300.000 euro, që është një plus dhe është një punë pozitive e këtij komisioni.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, duke pasur parasysh pikërisht gjendjen që është Radiotelevizioni i Kosovës lidhur me mënyrën e financimit, ka kërkuar prej Komisionit të Pavarur që të bëjë një monitorim lidhur me emetimin e reklamave dhe shkallën ose mundësinë e të hyrave që realizohen nga ky medium, do të thotë nga Radiotelevizioni i Kosovës, në mënyrë që të kemi një pasqyrë të qartë në përcaktimin e buxhetit të Radiotelevizionit të Kosovës, sepse në të gjitha raportet që i kemi shqyrtuar deri më tash, nuk kanë qenë të hyrat nga reklamat dhe nga marketingu, nuk kanë qenë të deklaruar në shkallën që ato janë të mundshme, por gjithmonë kanë qenë të minimizuara. Ne i kemi pasur dhe unë si kryetar i komisionit e kam pasur një raport të monitorimit njëmuajor të të gjitha medimeve lidhur me transmetimin e reklamave dhe shkallën e të hyrave të mundshme të realizuara dhe ato na dalin me një përqindje shumë më të madhe dhe tepër më të madhe nga ajo që, në këtë rast, mediumi publik – Radiotelevizioni i Kosovës i ka paraqitur gjatë raportimeve të tyre.

Prandaj, si rekomandim i dytë i këtij komisioni, përpos asaj që përkrahet në pjesën e vet financiare, është që ky institucion duhet sa më shpejt t'i dorëzojë Kuvendit një raport të monitorimit të mediave publike në Kosovë, veçanërisht të Radiotelevizionit të Kosovës dhe shkallën e mundshme të inkasimit ose të realizimit të mjeteve vetanake nga ajo që quhet – reklamë dhe marketing.

KRYETARI: Faleminderit!

Tani është radha e Grupeve Parlamentare. Në emër të grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, kush e do fjalën? Deputeti Hajredin Hyseni e ka fjalën.

HAJREDIN HYSENI: Faleminderit, zoti kryetar!

Mund të themi se ky raport dallon shumë nga raportet e mëparshme të Komisionit të Pavarur për Media dhe dallon për të mirë, sepse raporti përmbush kriteret e nevojshme të një raporti, duke pasqyruar gati në detaje punën që ka bërë komisioni në vitin 2009 në përmbushjen e obligimeve ligjore që ka ai.

Nga raporti shihet se Komisioni i Pavarur për Media në vitin 2009 ka pasur një fushë të gjerë të veprimeve dhe unë mendoj në disa fusha ka pasur sukses të mirë dhe ka përmbush disa detyra, duke rregulluar dhe saktësuar veprimin e mediave.

Një sukses i Komisionit të Pavarur për Media është licencimi afatgjatë i transmetuesve dhe mendoj se është bërë një punë e mirë në përmbushjen e këtij qëllimi. Gjithashtu, nxjerrja e rregulloreve, siç janë: Rregullorja për mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve nga programet e dëmshme, Rregullorja për pajtueshmërinë me obligimet e të drejtës së autorit, Rregullorja për komunikim komercial audiovizuel dhe fillimi i zbatimit të Rregullores për reklamim. Është një punë mjaft e mirë e këtij komisioni, me çka po përmbush objektivat dhe detyrat e saj ligjore.

Një çështje e cila është mjaft sfiduese për komisionin dhe që u përmend edhe nga parafolësit për Komisionin e Pavarur, është digjitalizimi i transmetuesve dhe në këtë drejtim ata kanë bërë hapat e parë, për çka mendoj se edhe Kuvendi me ndryshimin e Projektligjit të Komisionit të Pavarur për Media do të ndihmojë në përmbushjen e kësaj detyre shumë të rëndësishme që edhe Kosova të mos ngelet larg vendeve të tjera në këtë proces.

Marrë parasysh zhvillimin e madh të punës që ka pasur Komisioni i Pavarur për Media në vitin 2009, që ishte edhe viti i zgjedhjeve lokale, mund të themi se Komisioni i Pavarur

për Media ka arritur t'i realizojë shumicën e objektivave të saj për këtë vit. Në qoftë se ndalemi te monitorimi, ai dallon nga vitet e mëparshme, sepse në vitin 2009 Komisioni i Pavarur për Media ka arritur t'i monitorojë mediat elektronike sa dhe si ato zbatojnë parimet, rregullat e përcaktuara më parë, para dhe gjatë fushatës lokale.

Mendoj se ky raport është një raport i mirë, se Komisioni i Pavarur për Media ka tani kapacitete për t'i kryer obligimet ligjore, ndërsa Kuvendi mbetet t'i kryej obligimet që ka në raport me këtë Komisionit të Pavarur për Media. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, Armend Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar!

I nderuar zëvendëskryeministër,

Kolegë deputetë,

Edhe Grupi parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Raportin vjetor të punës dhe aktivitetet e Komisionit të Pavarur për Media. Njëherësh çmon punën dhe angazhimin e komisionit në përmirësimin e infrastrukturës mediale në Kosovë, që nga krijimi i kushteve për licencim, deri te monitorimi i tyre sipas legjislacionit në fuqi.

Ne mendojmë se bashkëpunimi me Këshillin e Pavarur për Media duhet të shtohet dhe të kemi koordinim më të mirë në angazhimet e përbashkëta duke marrë parasysh shumëllojshmërinë etnike të cilën e ka Këshilli në përmirësimin e defekteve dhe të pengesave që paraqiten në terren.

Duke përkrahur edhe dy rekomandime të komisionit funksional dhe Komisionit për Buxhet dhe Financa, Grupi Parlamentar i LDK-së e përkrah raportin për miratim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, deputeti Ardian Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Shumë shkurt, përkundër të gjitha mangësive që i kemi vërejtur, edhe Grupi ynë parlamentar i përkrah konstatimet dhe rekomandimet e dy komisioneve, edhe të këtij funksional, edhe të atij për Buxhet dhe Financa. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Esat Brajshori.

ESAT BRAJSHORI: Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës Kosova e Re e përkrah Raportin vjetor të Komisionit të Pavarur të Mediave.

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, deputetja Qamile Morina, e ka fjalën.

QAMILE MORINA: Faleminderit, zoti kryetar!

Ministër, deputetë të nderuar,

Lidhja Demokratike e Dardanisë konsideron se edhe pse Raporti vjetor i Komisionit të Pavarur të Mediave për vitin 2009, synon të paraqet realizimin e objektivave për vitin 2009, punën e rëndësishme si të veçantë dhe shumë vëllimore që kreu gjatë vitit 2009,

është e qartë që këtë institucion e përcjellin edhe mjaft dobësi, që kërkojnë qasje serioze dhe transparente, duke pasur parasysh rëndësinë e këtij institucioni në lëmin tejet të ndjeshme dhe të rëndësishme për vendin tonë.

Vërejtje që mund t'i adresojmë këtij raporti janë: licencimi është variabil, kërkohet plotësimi i kriterëve të dyfishta. Në faqen 10, 30 subjekte transmetuese kanë ulur përqindjen e programit të shërbimit publikë, 68 subjekte kanë ngritur përqindjen e programit argëtues. Andaj, derisa ato me interes publik kanë zbritje, kurse programet e argëtimit janë në rritje, andaj është e qartë se Komisioni i Pavarur për Media nuk ka arritur të kryej punën e vetë për zbatimin e ligjit. Nuk janë bërë analizat shtesë të transmetuesve dhe nuk janë gjetur zgjidhje adekuate përkitazi me kërkesat e subjekteve transmetuese për zgjerimin e sinjalit.

Angazhimi i Komisionit të Pavarur të Mediave dhe të Zyrës ekzekutive të tij nuk kanë qenë i mjaftuar në procesin e ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit ekzistues për KPM-në, në mënyrë që të jetë në përputhshmëri me Kushtetutën e Kosovës.

Sipas raportit, një delegacion i KPM-së ka realizuar takime të para të karakterit senzibilizues me Unionin Ndërkombëtar të Telekomunikimit në Gjenevë, që do të ndihmojë vendin tonë gjatë procesit të digjitalizimit. Shtrohet pyetja, përse Kosova nuk ka pasur përfaqësues në Konferencën rajonale në ndarjen e frekuencave digjitale televizive, që është mbajtur në Gjenevë në vitin 2006.

Dihet se deri në vitin 2015, sipas parametrave të BE-së të gjitha vendet jo anëtare të BE-së, që aty bëjnë pjesë edhe ne, duhet të kalojnë në transmetimin digjital. Sipas raportit, ne nuk kemi pasqyrë apo ofrim të rezultateve se çka kanë arritur grupet punuese gjer tani në këtë drejtim.

Në faqe 13, puna në vënien e rregullit dhe ligjit të operatorëve kabllor ilegal në veri të vendit, sipas raportit nuk është bërë as mjaft, as mirë. Kjo flet për jo seriozitetin e KPM-së në ushtrimin e funksionit kushtetues.

Hapja e Zyrës së veçantë në veri të vendit është qasje e gabuar, antiproduktive, e dëmshme, që krijon precedent. Krijimi i një transmetuesi të veçantë nacional në gjuhën serbe në raporte pasqyrohet si një detyrë parësore që po punohet për t'u përmbushur. Kjo nuk do të duhej të ndodhë, sepse krijohen precedente të dëmshme e të rrezikshme, duke krijuar institucione paralele shtetërore dhe kjo fare nuk është në dobi të qytetarëve të Kosovës.

Konsiderojmë se ekziston një transmetues publik në vendin tonë dhe zgjidhja duhet të gjendet brenda tij, si hapja e kanalit të dytë – programi për komunitete pakicë.

Formula e përbashkët KPM dhe RTK për dizajnimin e financimit afatgjatë të RTK-së nuk ka dhënë asnjë rezultat. Prandaj, meqë qershori po afrohet dhe po përfundon financimi i përkohshëm, ne do të duhej ta kishim Ligjin për RTK-në të kompletuar gjerë në qershor dhe formulën për financim të qëndrueshëm, në mënyrë që ky Kuvend mos të sfidohet përsëri me ndonjë skenar të shmangies së ligjit.

Mbikëqyrja ligjore e transmetuesve nga ana e KPM-së, divizioni ligjor nuk është bërë si duhet dhe aq sa duhet. Shkeljet që kanë ndodhur në ndërkohë, e që raport prezantohen si

të përmirësuar pas intervenimit të KPM-së, nuk qëndrojnë si rasti me marketingun e RTK-së.

Shkeljet tjera po thuaj se të përditshme bëhen nga shumë media, e sidomos të minoriteteve, mirëpo në raport nuk janë pasqyruar me korrektësi.

Në faqe 16 është paraqitur çështja e dy anëtarëve të Këshillit të KPM-së, mandati i të cilëve ka kaluar në mars të këtij viti. Obligimi ligjor nga Zyra e shefit ekzekutiv është përmbushur me dërgimin e listës së kandidatëve në Kuvend. Por, edhe një herë Kuvendi nuk po arrin të respektojë obligimet ligjore për zgjedhjen e këtyre dy anëtarëve.

Dhe, së fundi, Lidhja Demokratike e Dardanisë konsideron se KPM-ja duhet të avancojë përgjegjësinë, profesionalizmin, transparencën dhe të ngritë bashkëpunimin me të gjitha subjektet relevante me qëllim të zhvillimit të një sektori të mirëfilltë medial. Faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, deputete!

Në emër të Grupit parlamentar “7+”, deputetja Shpresa Murati e ka fjalën.

ŠPRESA MURATI: Zahvaljujem!

Izveštaj Nezavisne komisije za medije za 2009. godinu, je za razliku od Izveštaja za 2008. pa i ranije, mnogo bolje izrađen, sadržajan je i kompletan. Izveštaj sadrži ciljeve za 2009. godinu, i njihovu realizaciju, ciljeve za 2010. godinu, predstavljen je rad Saveta nezavisne komisije za medije, rad kancelarije izvršnog šefa i Medijskog odbora za žalbe. Među uspešno realizovanim ciljevima, treba istaći kompletiranje sekundarnog zakonodavstva, to jest izrada i usvajanje četiri osnovne uredbe, sprovođenje procesa dugoročnog licenciranja elektronskih medija, radio i TV stanica i izrada Nacrta projekta za prelazak na digitalno emitovanje. Ono što je za nas značajno, jeste monitoring RTK-a.

U izveštaju stoji da na osnovu urađenog monitoringa, procenat programa na jezicima zajednica emitovan na javnom servisu, bio je 11, 29%, a ne 15%, kao što je predviđeno Zakonom o RTK.

Od RTK su traženi podaci o procentu programa koji se emituje za zajednice i način njihovog računanja. Nakon objašnjenja od RTK, u obračunu programa koji se emituje ne beleže se programi koji se repriziraju nakon ponoći, tako da je procenat 14,58%. Prema RTK, procenat nije računat za emitovanja od 24. časa. O kakvoj podršci i podsticaju razvoju zajednica govorimo, ukoliko se njihovi jednočasovni i nedeljni magazini repriziraju nakon ponoći i da je tako, ali nije! I dalje je prisutan problem nepokrivenosti TV signalom regija gde žive pripadnici zajednica. Podržavajući izveštaj Nezavisne komisije za medije, želimo istaći da nam je neophodna podrška u otvaranju drugog kanala na jezicima ostalih zajednica, čime bi zajednice imale više prostora za promovisanje svoje kulture, sa zanimljivim naučno obrazovnim programima za sve građane Kosova. Hvala!

KRYETARI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, Petar Miletij e ka fjalën.

PETAR MILETIĆ: Hvala, predsedniče!

Poslanička grupa Samostalne liberalne stranke podržaće ovaj izveštaj. Ja bih želeo da istaknem nekoliko stvari vezano za formiranje novog kanala na srpskom jeziku. Kada

kažem novog kanala na srpskom jeziku, to nije kanal za srpsku zajednicu, kako danas neko ovde reče, već je to kanal za sve one koji govore ili razumeju srpski jezik, što je mnogo više nego što je broj srpska zajednica na Kosovu. Kao što vidim u ovoj sali, dok ja govorim, niko nema slušalice na ušima, tako da verujem da svi vi ćete gledati taj kanal.

Sveobuhvatni predlog za rešenje statusa Kosova, odnosno Ahtisarijev paket predviđa osnivanje nezavisnog kanala na srpskom jeziku, i to je vrlo precizna formulacija i to tako treba da bude. Sve drugo što bi se formiralo, ne bi bilo poštovanje Ahtisarijevog paketa. Takođe, ne mislim da je formiranje televizijskog kanala na srpskom jeziku bilo kakav presedan, jer ovakvi primeri postoje širom Evrope i sveta, dakle da postoji kanal koji će imati nacionalnu frekvenciju i koji će se videti na celoj teritoriji Kosova, a da nije kanal na većinskom jeziku.

Ja želim na kraju da izrazim zadovoljstvo što ovaj proces i ovaj projekat vodi ambasador Nemačke na Kosovu, i koji me u razgovoru sa njim uverio da će ovo biti jedan dobar projekat koji će uspešno završiti. Hvala!

KRYETARI: Edhe unë pajtohem me ju, deputet, që vërtet, do të thotë, t'i mësojmë gjuhët dhe t'i heqim të gjithë dëgjueset nga veshët. Në emër të Grupit Parlamentar për Integritet, fjalën e ka deputeti Danush Ademi.

DANUSH ADEMI: Ju faleminderit, kryetar!

I nderuar zëvendëskryeministër,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Shqyrtimi i Raportit të Komisionit të Pavarur për Media për vitin 2009, duke u bazuar në të metat e transmetuesit publik dhe në mospërbajtjen e praktikave të televizioneve tjera publike nëpër Evropë, ky raport tregon edhe një herë qartë se komunitet Hashkali, që unë e përfaqësoj, i mohohet e drejta e tij elementare për të pasur një program të vetin që kanë edhe komunitet tjera në Kosovë, komunitet serb, goran, boshnjak dhe të tjerë. Para se gjithash, ne nuk kemi programin tonë ku do të pasqyrojmë vështirësitë, papunësinë, problemet, gjendjen sociale që e kemi për çdo ditë dhe ballafaqohemi me të. Mirëpo, deri në tetor të vitit 2009, edhe komuniteti Ashkali ka paguar taksën në vlerë prej 3.5 euro për transmetuesin publik. Prandaj, duke u bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, në nenin 57, paragrafi 3, thuhet: “Pjesëtarët e komuniteteve do të kenë të drejtë të shprehin, të avancojnë dhe të zhvillojnë lirisht identitetin, atributet e tyre si komunitet”. Dhe neni 57, paragrafi 4: “Ushtrimi i këtyre të drejtave do bartë me vete detyrimet dhe përgjegjësitë për të vepruar në pajtim me Ligjin e Republikës së Kosovës”. Hashkalive kjo e drejtë iu është mohuar, nëse bazohemi edhe në Ligjin për të drejtat e komuniteteve, të miratuar në këtë Kuvend me datën 13.08.2008.

Neni 6.2, ku për komunitetin garantohet qasje dhe përfaqësim të barabartë në mediat publike, transmetuesit e programeve për komunitete, ku do të ndahet në kanale të transmetuesit publik. Në nenin 6.3, thuhet: “Komunitetet kanë të drejtën e programeve në mediat publike, transmetuese. Programet e tilla duhet të mbulojnë aktivitet e komuniteteve përkatëse dhe përmbajtjet e tjera që janë në interes të tij, duke përfshirë lajmet, kulturën, sportin, argëtime e tjera”. Kjo që 10 vite që ne kërkojmë, ende nuk ka ndodhur. Ne nuk po kërkojmë diçka jashtë Kushtetutës që garantohet, mirëpo matësi demokratik i një shoqërie dhe një shteti tregohet me avancimin e të drejtave të të gjithë

komuniteteve pa dallim. Kjo po i mohohet në vazhdimësi komuniteti Hashkali, që janë më shumë se 40.000 anëtarë në Kosovë, që nuk kanë programin e tyre në transmetuesin publik. Si përfaqësues i komunitetit Ashkali, më të diskriminuar për nga hapësira mediale në Kosovë, dua edhe njëherë ta ngreh zërin ndaj asaj që na takon ajo e drejtë që e kemi si komunitet dhe e kemi të garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Unë me plotë të drejtë kërkoj që të respektohet Kushtetuta dhe ligji për komunitete të Ashkalive t'u mundësohet të kenë qasje në transmetuesin publik, në RTK sikurse që kanë edhe komunitetet tjera në Kosovë. Edhe nëse më tutje na mohohet kjo e drejtë e jonë që të kemi qasje në mediat publike, atëherë do të shfrytëzojmë edhe mundësi të tjera konform ligjit, Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Po besoj që kësaj radhe, edhe pse do të jetë programi i dytë i RTK-së, besoj që kjo e drejtë nuk do të na merret dhe do të kemi edhe në minutazhin në gjuhën shqipe sikur e kanë edhe të tjera komunitete.

Edhe pse na është mohuar kjo e drejtë e jonë elementare, ne si Grup Parlamentar do ta votojmë këtë raport të vitit 2009, por nëse kjo e drejtë prapë na përsëritet, na merret në vitin 2010, sigurisht që nuk do ta votojmë. Faleminderit.

Drejtimin e seancës e merr zoti Sabri Hamiti, anëtar i Kryesisë

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!
Fjalën e ka deputeti Abdyl Ymeri.

ABDYL YMERI: Faleminderit, kryesues!
I nderuar zëvendëskryeministër,
Të nderuar kolegë deputetë,
Mediat e shkruara dhe elektronike janë pushteti IV në shtetet me një demokraci shumë të avancuar, sepse përmes tyre shoqëria në përgjithësi realizon kontrollin e saj mbi pushtetet e tjera.

Në bazë të raporteve të shumta, mediat në Kosovë në përgjithësi kanë vështirësi të mëdha financiare. Liria e shtypit dhe mediave është treguesi më i mirë që tregon lirinë e një shoqërie. Kosova, megjithatë, ka një progres të dukshëm sa i përket lirisë së shprehjes, e cila është e garantuar me Kushtetutë. Në kuadër të kësaj, Komisioni i Pavarur i Mediave ka një rol të veçantë në rregullimin dhe funksionimin e tërësishëm të sistemit të tregut të mediave në Kosovë.

Po që se bëhet një analizë e hollësishme e raporteve të viteve të kaluara dhe një krahasim me Raportin e vitit 2009, vërehet dukshëm se edhe për nga struktura dhe përmbajtja ky raport është më përmbajtësor dhe mirë i strukturuar. Në raport kemi shtatë objektiva, të cilat komisioni ia ka parashtruar vetes për t'i përmbushur gjatë vitit 2009 dhe, sipas raportit, këto objektiva në masën më të madhe janë përmbushur, duke përjashtuar objektivin e tretë dhe të katërt, të cilët pjesërisht janë përmbushur, që do të thotë se është në interes që objektivi i tretë të përmbushet në tërësi në vitet në vijim, do të thotë kalimi i transmetuesve analog në teknologji më të avancuar në transmetuesit digjital. Ndërsa, shihet se përkundër përpjekjeve, Komisioni i Pavarur për Media nuk ka arritur në përmbushjen e objektivit të pestë për legalizimin e operatorëve ilegalë të cilët veprojnë në Veriun e Kosovës. Përderisa në gjithë territorin e Kosovës, nëse kemi qoftë edhe një operator kabllor apo subjekt transmetues, i cili operon ilegalisht, kjo në masë të madhe e dëmton sistemin, por edhe konkurrencën në përgjithësi.

Divizioni i monitorimit është mirë që në radhët e veta të përforcohet me ekspertë dhe teknikë dhe në vazhdimësi të bëjë monitorimin e transmetuesve difuziv në përgjithësi, me qëllim të zhvillimit dhe të rritjes së performancës, si dhe ngritjen e cilësisë programore të çdo subjekti transmetues. Do të dëshiroja që objektivat e parashtruara për këtë vit, Komisioni i Pavarur për Media t'i realizojë në masën më të madhe. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputet! Fjalën e ka deputeti Numan Baliq

NUMAN BALIĆ: Ju faleminderit, zotëri kryesues i Kuvendit!

Nisam se nadao da ću ovako brzo doći na red, ali evo da kažem nekoliko riječi vezano za medije, odnosno Nezavisnu komisiju za medije. Na jednoj strani, Nezavisna komisija za medije se dobro bavila ovim pitanjima koje se tiču licenciranja, regulisanja rada medija, zakonskih osnova, potom i nekih drugih pitanja, uređivanje programa, sadržaja programa koji se tiču maloljetnika, dijece, zaštita od pojedinih djelova i tako dalje. Na drugoj strani, hoću da kažem da onaj deo koji se tiče Radio-televizije Kosova, o tome ću posebno govoriti i on je od posebnog interesa za Bošnjacku i druge malobrojne zajednice. Već je nekoliko riječi rečeno o tome i samo bih podvukao i podržao to da u vezi sa Radio-televizijom Kosova i programa na jezicima malobrojnih naroda, istini za volju, treba istaći dvije stvari:

Prvo, Radio-televizija Kosova, u cijelom regionu zapadnog Balkana ima jedina i najviše prostora za sve zajednice. Ona bukvalno ima program na 3-4 jezika i to je veoma dobra stvar. Dakle, forma je više nego zadovoljena, uprkos tome što prema zakonu se ne ispunjava onaj uzus od 15%, nego ga ima značajno manje, ne samo do 11, nego i manje. Ali, uprkos svemu tome je forma više nego zadovoljena i moramo biti jako zadovoljni. Međutim, na drugoj strani, ako govorimo o sadržaju programa, koji se tiče i malobrojnih zajednica ali i većine, moramo da ukažemo na neke stvari koje su vrlo bitne i to bi Komisija za medije trebala da obrati pažnju, ali i cijela javnosti, mi svi, posebno sa aspekta kvaliteta programa, zato što kvalitet na Radio-televiziji Kosova, programa ni iz daleka nije onakav kakav bi trebao da bude. Vrlo je često neprofesionalan, često se daju dijelovi programa koji su potpuno promašeni ili bajati, da tako kažem, potom vrlo malo se vodi računa o duhu naroda, o ukupnom duhu kosovskog naroda o nekim vrednostima koji su zapostavljene, neke su čak tabu teme vezano za tradiciju, kulturu, duh kosovskog naroda, svih zajednica u njemu. Pitanje vjerovanja i vjera je jedno od tih famoznih tabu tema na ovom javnom mediju. Ovo govorim sa tog aspekta što je pozicija Radio-televizije Kosova potpuno drugačija od dugih medija, jer to je javni medij, financirani medij pod kontrolom institucija Kosova, Parlamenta Kosova, koji su njegovi osnivači i, naravno, on mora voditi računa o narodu Kosova, i o albanskoj većini i o svim drugima koji tu žive, Bošnjacima, Srbima, Romima, Aškalijama i tako dalje.

Dalje, da se ponovo vratim na onaj dio koji se tiče programa. Informativni deo takođe je veoma vođen, moram to tako da kažem. Mi imamo programe informativne, centralni dnevnik, famozni „Ditari“ i ove druge, sada se vraćam na onaj deo koji se tiče većinskog govora, odnosno albanskom jeziku. Mi imamo tekućem ... koji zavisi od odnosa ovog javnog medija prema pojedinim moćnicima u zemlji. On je vrlo često podložen vlastima ili onima koji imaju moć, koji imaju snagu, koji imaju novac ili imaju bilo kakav uticaj, bilo da je on sa pozicija moći, familijarizma ili bilo čega drugoga koji su jako, jako izraženi u ovoj kući koja bi trebalo da bude javni medij. Pa tako je, recimo, kada imamo, uzmite samo primere, informišemo, dnevnik informiše o sjednici Skupštine i on govori o velikim partijama, onda se pomenu ili ne spominju neke partije iz

opozicije koje su važne, dok malobrojne partije, pojedinci, partije manjinskih zajednica, one se uopšte ne spominju, kao da ne postoje. To je taj deo koji se mora ispraviti. Javni medij mora pružiti ravnopravan tretman, nije dovoljno da mi na programu imamo 15 minuta vesti svakodnevno na jeziku kojim govorim, nego i onom delu koji se tiče centralnog informisanja, mora se pružiti ravnopravnost svim grupama, zajednicama i različitim pogledima. Upravo sam to hteo da podcrtam. Znači, različitost pogleda na svet mora biti zastupljena na Radio-televiziji Kosova.

Sada ću se na kraju samo još osvrnuti na deo programa na bosanskom jeziku. Pored toga što je potpuno neprofesionalan, pored toga što se vrlo često bavi temama koje su potpuno van koloseka ili nekim marginalnim događajima u Sarajevu, ili nekim događajima u Beogradu, Novom Pazaru, Skoplju, koji nemaju nikakve veze sa potrebama naroda, našeg naroda koji živi na Kosovu, oni se bave dvema vrlo ružnim stvarima, nanose štetu narodu. Najpre podvajanju regije, podvajanju prizrensku regiju, pečku regiju, Mitrovicu, Prištinu, potom izazivaju zavade i podjele. Potom urednica toga programa, moram to reći otvoreno, urednica Nadira Vlasi vrši otvorenu favorizaciju jednih političkih subjekata i satanizaciju drugih. Na tome se programu vodi kampanja punih deset godina. Ja sam to već govorio mnogo puta i to moram, Nezavisna komisija za medije, ovaj Parlament, to je neverovatno, to je Gebelsova kampanja koja nema granica. Svi vi koji gledate, pogledajte taj program pa ćete videti kako se vrši satanizacija i problem jednog dijela predstavnika ove zajednice i kosovske zajednice. Tako da, ako mogu to da završim sa ovim, jer ovo smatram važnim i nemam druge prilike da to kažem, za ovu zajednicu, urednica Vlasi je završila svoj posao, ona je verno služila prošli režim, vjerno služi sada i ovaj režim i mislim da je vreme da da ostavku. Ako je njen šef, nekadašnji drug Agim dao ostavku, neka i ona da ostavku. Mi tražimo njenu ostavku. Hvala vam lijepa!

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputet! Regjisë i them t'i bie ziles, t'i thërrasë deputetët për votim, derisa e merr fjalën diskutuesi i fundit, deputeti Naser Rugova.

NASER RUGOVA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Po diskutojmë sot për Raportin vjetor për vitin 2009 të Komisionit të Pavarur të Mediave, një institucion jashtëzakonisht i rëndësishëm që rregullon një fushë sidomos sensitive për vendet në tranzicion, siç është edhe vendi ynë.

Raporti i Komisionit të Pavarur për media për vitin 2009, është raport dukshëm më i mirë, më i strukturuar dhe jep informata dhe transparencë dukshëm më të mirë se sa Raporti i vitit 2008, dhe në këtë aspekt e përgëzoj Komisionin e Pavarur për Media për një strukturim të raportit që i plotëson kriteret dhe standardet që të debatohet në seancën plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Mirëpo, edhe kolegët tjerë, por edhe unë personalisht i kam disa vërejtje të caktuara në këtë raport në kuptimin e përmirësimit të punës së këtij institucioni të pavarur dhe shumë të rëndësishëm.

Së pari, krijimi dhe adaptimi i politikave për procesin e digjitalizimit, e 2015-ta është nesër, ku jemi në këtë proces të digjitalizimit, që është kërkesë imediate, do të thotë, e vendeve që aspirojnë të jenë pjesë e Bashkimit Evropian. Andaj, edhe Kuvendi i Republikës së Kosovës, edhe KPM-ja, por edhe mekanizmat e tjerë që kanë ndikim direkt në këtë sistem të organizimit të ri medial, vërtetë duhet të jemi të kujdesshëm që ta mbështesim KPM-në dhe mekanizmat e nevojshëm, por edhe KPM-ja t'i realizojë objektivat e veta, ashtu siç e ka paraparë në vitin 2010 dhe në vitet në vazhdim.

Pastaj, ky Kuvend ka obligim që ta plotësojë KPM-në me anëtarët e nevojshëm që iu ka skaduar afati dhe duhet një mbështetje financiare dhe ky Kuvend, besoj, në rishqyrtimin e buxhetit duhet të jetë shumë i vëmendshëm që KPM-ja ta ketë financimin adekuat dhe mos të dalin para situatave ad-hoc, siç na ka ndodhur me RTK-në. Kur jemi te RTK-ja, respektimi i Ligjit për RTK-në dhe këtu KPM-ja e ka detyrën e vet, sidomos tek marketingu dhe emetimi i reklamave dhe transparenca e të hyrave të këtyre mjeteve, sepse edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa edhe komisioni funksional, por edhe ne si Kuvend shpesh po biem në situata të palakmueshme dhe po sfidohemi se informata e kujt është e saktë. Andaj, si Kuvend, si themelues, po tani edhe Bordi i ri, në bashkëpunim me KPM-në kanë për obligim që Kuvendin ta informojnë në mënyrë transparente.

Është edhe një pikë interesante këtu te objektivat për vitin 2009 dhe realizimi i tyre, krijimin parakushteve për përmbushjen e obligimit kushtetues për krijimin e një programi, unë do ta quaja nacional në gjuhën serbe. Edhe kolegët nga komunitetet tjera e potencuan këtë çështje. Duhet ai program t'i mundësohet komunitetit serb, por në kuadër të radio-transmetuesit publik të RTK-së dhe kjo është shumë legjitime, sepse Kosova e ka vetëm një transmetues publik. Edhe komunitetet tjera me të drejtë i ngritën shqetësimet e veta. Njerëzve duhet t'ju krijohej hapësirë mediale, sepse ka mundësi dhe kemi obligime kushtetuese. Kur është çështja te promovimi i konkurrencës së drejtë transmetuese, këtu i kemi vërejtjet e caktuara dhe KPM-ja duhet të jetë dukshëm më aktive në këtë aspekt. Te licencimi i operatorëve kabllorë në Veriun e Kosovës, pse është krijuar një zyrë e KMP-së në veri të vendit? Mbase atëherë kërkon edhe Kaçaniku një ditë në jug, apo Gjakova në perëndim, apo Gjirokastrë në lindje. Ju lutem, Komisioni i Pavarur për Media është një institucion që është votuar nga Kuvendi dhe rregullon në aspektin nacional, do të thotë, të gjitha këto çështje që kanë të bëjnë me këtë sektor të ndjeshëm të institucioneve, por edhe të shoqërisë kosovare. Andaj, KPM-ja, duhet ta ketë si objektiv që të licencojë të gjithë operatorët kabllorë, por edhe mediat tjera në çdo cep të Republikës së Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Nuk ka të tjerë që donë të bisedojnë për këtë raport. Në sallë janë 69 deputetë. Edhe regjinë, edhe deputetët i lus të bëhen gati për ta votuar raportin, natyrisht me vërejtjet e veçanta që i bënë dy kryetarët e komisionit, kryetari i komisionit funksional dhe kryetari i Komisionit për Financa.

E hedh në votim, votojmë tash:

Me 60 vota “për”, 6 abstenime, dhe asnjë “kundër”, Kuvendi miratoi Raportin e Komisionit të Pavarur për Media për vitin 2009.

Kalojmë në pikën e tjetër të rendit të ditës:

12. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, për vitin 2009

Komisioni funksional për Buxhet dhe Financa, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Punës ka shqyrtuar Raportin e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, për vitin 2009, dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike e ka shqyrtuar Raportin e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Kryetari i komisionit funksional, zoti Gani Koci, nëse e do fjalën? Nuk shoh që e kërkon fjalën. Atëherë, nënkryetarja e komisionit, Safete Hadergjona. Urdhëro!

SAFETE HADERGJONAJ: Një plotësim, zoti kryesues, të faleminderit që ma dhe fjalën! Nuk jam nënkryetare e Komisionit, mirëpo Gani Koci, kryetar i Komisionit më ka autorizuar që ta njoftoj Kuvendin që ky raport është shqyrtuar, kurse unë do të flas në emër të Grupit parlamentar për të mos e marrë dy herë fjalën, ndoshta bën që me këtë ta kryej edhe në emër të Grupit Parlamentar.

KRYESUESI: Më vonë, të shohim zoti Haki Shatri a e do fjalën?

SAFETE HADERGJONAJ: Atëherë, në emër të komisionit.

KRYESUESI: Fol, pra, në emër të komisionit.

SAFETE HADERGJONAJ: Komisioni për Buxhet dhe Financa, si komision funksional, e ka shqyrtuar Raportin e Prokurimit, i cili përfshinë aktivitetet e Prokurimit Publik në Kosovë dhe Kuvendit të Kosovës i ka paraqitur rekomandimin që ky raport i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik të miratohet, sepse është i mendimit se ky i plotëson të gjitha standardet të cilat janë kërkuar me Ligjin e prokurimit publik, i plotëson standardet e kontabilitetit, prandaj si i tillë i rekomandohet Kuvendit të miratohet.

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja deputete!

Për Komisionin për Mbikëqyrje dhe Financave Publike, kryetari Haki Shatri.

HAKI SHATRI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Unë mendova që fjalën ta marr paralelisht, sepse do të flas edhe në emër të Grupit Parlamentar të Alenacës dhe mendova ta shfrytëzoj në të njëjtën kohë, por sido që të jetë, meqenëse e kam marrë fjalën...

KRYESUESI: Për komisionin tani...

HAKI SHATRI: ...për komisionin, para Kuvendit do të them këtë: Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike e ka shqyrtuar këtë raport, por ajo që dua të them është tepër shqetësuese. Te një grup i deputetëve, që vjen nga radhët e koalicionit qeverisës, nuk kam gjetur mbështetje brenda komisionit dhe nuk kam pasur as kuorum, sepse është bojkotuar me motivacion që ky komision, pra Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, gjëja nuk qenka kompetent, nuk paska mandat për ta shqyrtuar këtë raport. Për mua është, si kryetar i komisionit, tepër befasisëse, si është e mundur që një raport i cili flet për shpenzimin e parasë publike në procesin e prokurimit, nuk mund të jetë materie e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike. Njësoj është thënë edhe për raportin e organit shqyrtues, që do të jetë në pikën në vazhdim të kësaj seance, dhe po ashtu edhe të Raportit të Agjencionit antikorrupsion. Pra, nuk kam pasur mbështetje. Ne e kemi shqyrtuar me grupin e deputetëve që kanë mbetur aty, por nuk kemi marrë vendim, sepse nuk e kam pasur kuorumin, është bojkotuar thjeshtë me dalje nga mbledhja e komisionit.

Unë u bëj thirrje deputetëve që kanë pak vullnet për ta luftuar këtë dukuri negative, çështjen e korrupsionit, të keqpërdorimit të parasë publike, mos të sillen në këtë mënyrë, sepse nuk është qëllimi as i kryetarit të komisionit, as i këtij komisioni në tërësi që të

shpikë keqpërdorime, sepse kemi punë boll me ato çka po ndodhin në realitet. Ju faleminderit shumë!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Kalojmë te grupet parlamentare. Për Grupin Parlamentar të PDK-së, Safete Hadergjonaj.

SAFETE HADERGJONAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Desha vetëm një sqarim në lidhje me atë që tha kryetari i komisionit për llogari publike. Është e vërtetë që ne si anëtar të komisionit, shumica prej anëtarëve të Komisionit të Kontrollit nuk kemi qenë të pajtimit që ky raport të shqyrtohet në cilësinë e komisionit funksional nga ana e Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike, sepse komision funksional për shqyrtimin e këtij raporti është Komisioni për Buxhet dhe Financa, kurse çështja që secili komision mund të diskutojë për raporte, mund të diskutojë për të gjitha raportet, mirëpo duhet t'i ndajnë detyrat dhe secili komision funksional duhet të dijë se çka duhet të diskutojë.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Raportin e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik dhe është i mendimit se ky komision ka proceduar me kohë raportin, siç është paraparë me ligj. Çështjet që i parasheh Ligji i prokurimit publik, në përgjithësi janë përfshirë në këtë raport. Janë paraqitur aktivitetet e prokurimit publik sipas burimeve të financimit, vlerave të kontratave të prokurimit, llojeve të aktivitetit të prokurimit, si dhe procedurave të prokurimit.

Sipas Ligjit për prokurimin publik, Komisioni Rregullativ i Prokurimit publik është përgjegjës për zhvillimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e përgjithshme të sistemit të prokurimit publik në Kosovë. Kjo është detyrë e parë dhe më kryesore e këtij komisioni. Nëse analizojmë këtë raport, vijmë në përfundim se këtë detyrë ky komision nuk e ka kryer, kurse aktivitetet tjera që ka për obligim, bazuar në raport, janë kryer edhe pse jo të gjitha në masën e duhur. Nga raporti vërejmë se nga 152 autoritete kontraktuese, sa ekzistojnë në Kosovë, 149 prej tyre i kanë dorëzuar raportet, kurse tri komunat e pjesës veriore të Kosovës, ajo e Zubin Potokut, Zveçanit dhe e Leposaviqit, nuk i kanë dorëzuar raportet, kurse buxheti i paraparë për prokurim në këto komuna, gjatë vitit 2009 ka qenë 2.334.220 euro. Mbetet të bëhet më shumë që edhe këto komuna, meqë shfrytëzojnë buxhetin, të respektojnë procedurat e prokurimit dhe të raportimit.

Duke u bazuar në të dhënat e raportit, vërejmë se vlera e përgjithshme e prokurimeve publike, në raport me bruto produktin vendor në Kosovë, gjatë vitit 2009 ka qenë 19.86%, kurse 84.86% e buxhetit për prokurime publike në Kosovë, gjatë vitit 2009 është shpenzuar përmes procedurës së hapur që njihet si procedura më transparente e prokurimit publik. Në faqen 19 të raportit, janë paraqitur kontratat e nënshkruara sipas vlerës së përlllogaritur dhe vlerës së kontratës së nënshkruar gjatë vitit 2009, ku vërehet se kursimet e buxhetit në të gjitha aktivitetet e prokurimit publik kanë qenë 3.34% dhe kjo ka ardhur si rezultat ai procedurave të hapura gjatë kryerjes së aktivitetit të prokurimit.

Proceduarat e negociuara janë më të vogla për 46.84% se sa në vitin paraprak. Sipas raportit, procedurat e negociuara kanë ardhur duke u zvogëluar gjatë këtij viti, gjë që është sukses dhe në funksion të transparencës.

Nga raporti shohim se kryesisht kontratat e nënshkruara në formën e negociuar janë nga Korporata Energjetike e Kosovës, kurse Aeroporti dhe Ministria e Arsimit janë dy

institucione që kanë nga një kontratë të negociuar. Pse është përdorë kjo formë e kontraktimit, që është e lejuar me ligj në raste të veçanta, është vështirë të vlerësojmë pasi që nuk disponojmë me të dhënat e detajizuara. Ne nuk kemi përvojë aq të mirë për vite të tëra në formën e negociuar të kontratave nga ana e Korporatës Energjetike të Kosovës, edhe pse tani shohim se ka shkuar kjo formë duke rënë dukshëm.

Vlera e kontratave të nënshkruara sipas afatit kohor është 75.54% në vlerën e përgjithshme të kontratave të nënshkruara, kurse vlera e kontratave të nënshkruara në afat të shkurtuar është 24.46% në numrin e përgjithshëm të kontratave. Po ashtu, një çështje mjaft e diskutuar është edhe dhënia e kontratave me çmim më të ulët dhe me çmim ekonomikisht më të favorshëm. Se sa ka qenë i arsyeshëm shkurtimi i afatit kohor dhe kriteri i dhënies së kontratave, nuk mund të japim shpjegim nga ky raport. Kjo çështje i mbetet auditorit të konstatojë arsyshmerinë e këtyre veprimeve. Në raport thuhet se në mungesë të stafit të mjaftueshëm për mbikëqyrje, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik nuk ka arritur të bëjë një mbikëqyrje të të gjitha aktiviteteve kontraktuese të Kosovës. Konsideroj që mbikëqyrja dhe monitorimi janë shumë të rëndësishëm dhe është funksioni kryesor i Komisionit Rregullativ të Prokurimit dhe duhet të jetë këtu dhe duhet të bëhet gjithsesi. Funksioni i këtij Komisioni nuk duhet të jetë vetëm në mbledhjen e shënimeve teknike që janë paraqitur në raport. Janë gjithsej 152 autoritete kontraktuese, kurse komisioni ka monitoruar vetëm 43 autoritete. Sipas planit dhe sipas kërkesës së autoriteteve kontraktuese janë monitoruar 9 autoritete kontraktuese. Shtrohet pyetja se çka ka bërë Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik për të rritur efikasitetin në këtë drejtim. Është më se e domosdoshme që edhe përkundër vështirësive dhe numrit të kufizuar të stafit, të bëhet shumë e shumë në drejtimin e mbikëqyrjes së aktiviteteve të prokurimit.

Në Kosovë ka nevojë për një reformim të sistemit të prokurimit dhe për një angazhim shumë më të madh për zbatimin e Ligjit të prokurimit publik dhe për një konstatim real se ku janë vështirësitë më të mëdha në zbatimin e Ligjit të prokurimit publik. Nga Komisioni për Buxhet dhe nga shumica e deputetëve, në vitin e kaluar kur është diskutuar raporti i këtij komisioni për vitin 2008, është kërkuar që të bëhet ndryshimi i Ligjit të prokurimit publik dhe në kuadër të Ligjit të prokurimit publik të përgatitet rregullativa e veçantë që rregullon aktivitetin e prokurimit në sektorin e kompanive publike, duke u bazuar në Direktivën e prokurimit të Komisionit Evropian, nr. 2004/17. Ne si grup parlamentar rekomandojmë të punohet më shumë në këtë drejtim dhe të rregullohet kjo sferë mjaft e ndjeshme që ende është e pa rregulluar.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, me vërejtjet dhe sugjerimet e përkrah rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa që të miratohet Raporti i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik.

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputete! Naser Osmani flet në emër të Grupit parlamentar të LDK-së.

NASER OSMANI: Ju faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Ashtu siç e parasheh Ligji i prokurimit, me nenin 82.2, zyrtarët e prokurimit kanë paraqitur me kohë raportin dhe është shqyrtuar në komisionin funksional dhe ne ia kemi rekomanduar Kuvendit që ta aprovojë.

Raporti ndahet në dy pjesë, në atë pjesën që mund të quhet përmbledhje e shënimeve statistikore dhe një faqe apo, si ta quaj, si pjesë e dytë, që ka të bëjë me rekomandimet. Nga ky numër i madh i organizatave kontraktuese që i kanë kontaktuar diku 14.320 kontrata, kryesisht janë nga organet kontraktuese qeveritare mbi 10.900 dhe pjesa tjetër janë nga ndërmarrjet publike. Te ndërmarrjet publike vlen për të veçuar atë që kryesisht kontraktuesi më i madh është KEK-u dhe mos të them gati të gjitha kontratat e tyre apo vlerat më të mëdha të KEK-ut janë njëburimore. Kjo është çështje që duhet diskutuar, mundet dikush të merret me këtë punë më detajisht.

Krejt kjo pjesa e parë apo faza e parë, pjesa e parë e këtij raporti, do me thënë, që po e quaj ashtu, përmbledhje e të dhënave statistikore, do me thënë kanë përdorë metodën e komparacionit apo metodën e krahasimit dhe atë për 3 vite, për vitin 2007, 2008 dhe 2009, që thjeshtë jep një pasqyrë të mirë të gjithë atyre që janë të interesuar për ta shkoqitur ndonjë çështje që mund të jetë në interes për ta ndjekur më tutje. Numri i kontratave, vlera e kontratave, llojet e prokurimit, vlerat e prokurimit, procedurat, afatet kohore, kriteret, do me thënë krejt janë këto të paraqitura në metodën e krahasimit. Nga 700 e sa milion euro të kontraktuara, ne nuk mund ta dimë saktësisht se nuk ka analizë detale që ta dimë sa për qind e projekteve të aprovuara me buxhet janë realizuar, se kjo nuk na e jap këtë shënim, mirëpo diku rreth 32% të të gjitha kontratave janë kontrata të anuluar, por janë të anuluar kryesisht për shkak të mungesës së tri ofertave, ashtu siç e parasheh Ligji.

Një çështje që ishte dashur të përmendet, kush janë kontraktuesit më të mëdhenj? Kontraktuesi më i madh në Kosovë është KEK-u. Ky është numër një. Numër dy është Ministria e Transportit, numër 3 është Ministria e Arsimit, numër katër është PTK-ja. Kjo është një hierarki, domethënë, në bazë të buxheteve që kanë pasur dhe kanë bërë kontraktime më së shumti. Mirëpo, është një diçka që unë këtu kam një, unë mund ta kem personalisht edhe sqarimin, por nëse kjo çështje mbetet për komisionin që e udhëheq Hakiu, është çështje e komunës së Skenderajt, paraqitet kontraktuesi i dytë prej komunave, kur e dimë që grandet e tyre janë diku mbas, të renditura prej komunave e 15-ta, apo të hyrat vetanake janë diku, renditet në komunën e 20-të. Mirëpo, këtu neve nuk na paraqitet ndonjë analizë detale pse kështu ndodhë. Ndoshta dikush tjetër mund të merret me te, por në parim ka bazë të mirë për të bërë analiza sipas interesimeve. Raporti si i tillë duhet të aprovohet. Edhe Komisioni jep rekomandime që të aprovohet, ndërsa deputetët që kanë shqetësime të veçanta për ta ndjekur një çështje, kanë hapësirë shumë të madhe këtu.

Ne, si deputetë, mund ta nxisim si çështje, por nuk është e kësaj seance që të përmend detajisht këto çështje. Unë, në emër të grupit u rekomandoj deputetëve që ta aprovonjë raportin e KRPP-së. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet Osmani!

Kolegë të nderuar,

Para se t'ia jap fjalën Haki Shatrit, tash në emër të Grupit të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, më lejoni t'ua jap një sqarim. Në hyrje, ju thashë, që të dy komisionet e kanë përkrahur këtë raport, në mes tyre edhe Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, të cilin e kryeson zoti Shatri.

Në paraqitjen e vet në emër të komisionit, Shatri thotë që nuk ka mundur ta mbledhë shumicën e komisionit për arsye të problemeve të detyrave të komisioneve tjera. Ju lutem, shumë. Unë, siç e kam zakon, kur lexoj diçka, i kërkoj dokumentet. Unë kam në

dorë rekomandimin e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, i cili rekomandon që ky raport të votohet. Ka arsyetimin me tri pika. Thotë që mbledhjen e ka mbajtur më 9 mars 2010, thotë që edhe Komisioni Rregullativ i Prokurimit ka qenë i pranishëm. E rekomandon që të votohet, natyrisht, vërejtjet e komisionit janë në fund dhe këto, thotë: të meta në Ligjin mbi Prokurimin Publik, numri i madh i aneks kontratave, kontratat e negociuara, anulimi i prokurimeve, tre nga autoritetet si: komuna e Leposaviqit, Zveçanit, Zubin Potokut nuk i janë përgjigjur obligimit për të dërguar raportet. Kryetar, Haki Shatri, i evidentuar me 16 prill 2010.

Ju faleminderit, për kohën. Urdhëro, zoti Shatri, në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës.

HAKI SHATRI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Ajo që e lexuat ju, është e vërtetë, por unë desha të jem korrekt. Në fillim të mbledhjes kanë qenë të pranishëm, në ndërkohë e kanë lëshuar mbledhjen dhe kur është dashur të votohet, nuk e kam pasur kuorumin. Thjeshtë, ka qenë një lojë në pjesëmarrje në komision. Por, sido që të jetë, duhet ta them...

KRYESUESI: Atëherë, më fal Haki, të lutem shumë! Unë po flas me dokument. Unë flas me dokument të evidentuar në Kuvend. Kaq. Të lutem shumë, dokumentin e ke, merre, ti e ki nënshkruar. Kush ka votuar, problem i juaji. Unë dua të tregoj që e kam rezymenë e dokumentit në hyrje dhe dokumentin në dorë. Kaq.

HAKI SHATRI: Në rregull! Unë vetëm dua të them që këta njerëz edhe kanë marrë pjesë në diskutim, por në momentin e votimit, kanë dalë. Por, ju lutem, unë dua të them edhe diçka tjetër. As në Komisionin për Buxhet ky dokument nuk është shqyrtuar. Në atë kohë kam qenë anëtar i Komisionit për Buxhet, më vonë për arsye parimore jam tërhequr. As në Komisionin për Buxhet ky dokument nuk është diskutuar, është diskutuar vetëm pjesa financiare, pjesa përmbajtësore është lënë anash dhe nuk është diskutuar fare. Kjo dëshmon më së miri se edhe në Kuvendin e Kosovës ka ardhur deri te një vullnet, i mungesës të vullnetit për t'i diskutuar çështjet që kanë të bëjnë me keqpërdorimin e parasë publike.

Megjithatë, tash flas në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës.

Raporti mbi aktivitetet prokurimit publik në Kosovë për vitin 2009, i Komisionit Rregullativ, është një raport standard, i cili në aspektin formal i plotëson kushtet e raportimit në këtë fushë. Ne mendojmë që ky raport duhet të përkrahet, si grup parlamentar, por për sqarim të njerëzve prezentë këtu dhe të opinionit, përkrahja e raportit nuk do të thotë që ky raport ka përmbajtje të mirë për atë çka po ndodhë në terren. Pra, raporti i pasqyron krejt keqpërdorimet që po ndodhin në fushën e prokurimit publik në vitin 2009 dhe aktualisht.

Konsiderojmë që edhe institucioni i KRPP-së, në vitin raportues po ashtu i ka kryer obligimet e veta si institucion, obligimet të cilat i dalin nga Ligji për prokurimin publik. Edhe pse nuk e kemi të qartë pse Qeveria, koalicioni qeverisës nuk ia ka konfirmuar, nuk ia ka vazhduar mandatin Bordit të KRPP-së, të cilit Bord tash sa ditë, dikujt edhe disa muaj iu ka skaduar anëtarëve të Bordit mandati, nuk ka mandat. Po ashtu, në raport nuk thuhet përse që dy vite shefi i Agjencionit të Prokurimit Publik është ushtrues detyre. Unë e kuptoj 6 muaj të jetë ushtrues detyre, por dy vite nuk ma merr mendja çfarë ligji e parasheh. Po ashtu, e kemi edhe një mungesë, e cila nuk flet se sa njerëz që janë përgjegjës për shpenzimin e parasë publike, përgjegjës kryesor nëpër ministri janë

ushtrues detyre. Ne e dimë që prej 16-ve, 11 janë ushtrues detyre. Ka Agjencion shpenzues që përgjegjësin kryesor për shpenzimin e parave në Agjencion e kanë ndërruar edhe katër pesë herë brenda dy viteve. Po ashtu, edhe shefat e zyrave të prokurimit, në pjesën më të madhe ose ndërrohen shumë shpesh, ose janë ushtrues detyre dhe në rastet kur caktohen ushtrues detyre, kryesisht janë këshilltarët e ministrit përkatës. Do të thotë, ky raport pasqyron edhe gjëra të tjera, të cilat fatkeqësisht edhe po dëshmojnë edhe me realitetin e përditshëm, por ajo që desha t'ia tërheq vëmendjen Kuvendit dhe opinionit, është se ky raport tregon shumë qartë, sidomos në tabelën 2.6 në faqen 15, ku thuhet se nga shuma e përgjithshme e mjeteve të kontraktuara në vitin 2009, 87 milionë euro janë kontraktuar me procedura të negociuara, që do të thotë forma më e mirë e keqpërdorimit të parasë publike, më e lehta. E negociuar, nëse e përkthejmë në gjuhën më të thjeshtë të kuptueshme, është të bëjë pazar një njeri me një njeri, për sa po ma e kryen këtë punë. Po ashtu, është një pikë tjetër e formës së shpenzimit të parasë publike që pasqyrohet në raport, vlerat minimale. Vlerat minimale janë kur një ofertë, një furnizim pjesëtohet te shifra nën 1000 euro, me qëllim që ato para të paguhen me kesh në dorë, pa pasur nevojë për procedura tjera formale që i parashihet ligji.

E kemi, për shembull, një rast tepër të çuditshëm, sepse kontratat e negociuara i parashihet Ligji, këtë na e dimë, por këto duhet të bëhen me një procedurë që e lejon Agjencionin i Prokurimit, kur ka raste që parashihen me ligj. Por, për mua është shumë e paqartë si ka mundur të jetë një kontratë e negociuar në Ministrinë e Arsimit, në vlerë 9.000.000 euro për furnizim me libra, kur e dimë që në Kosovë janë disa botues të librave, në qoftë se nuk ka në Kosovë, ka edhe në Shqipëri, shqyr Zotit edhe në Maqedoni. Kjo është bërë në një vlerë prej 9.000.000 euro, e keni në pasqyrë.

Po ashtu, rastin të cilin e përmendi kolegu Naser Osmani, e kam identifikuar si një rast shumë të çuditshëm, në vlerën e kontratave të lidhura nga një agjencion shpenzues, që në këtë rast është Komuna e Skenderajt, e cila diku rreth 5 milion e ka buxhetin vjetor. Në vitin 2009, ka lidhur kontrata në vlerë mbi 17 milion euro. Unë nuk e di kah, qysh. Por, në raport figuron që ka ndodhë kjo dukuri. Nuk e dimë dhe nuk shkruan në raport, agjencionet shpenzuese a kanë shpallë tenderë për projektet, edhe buxheti që është paraparë në buxhet, apo janë tenderuar edhe projektet të cilat fare nuk janë në buxhetin e vitit 2009. Pra, shpallen tenderë për projektet që nuk janë askund në regjistr të shpenzimit për vitin përkatës. Me një fjalë, pjesa e prokurimit është bërë çerdhe e keqpërdorimit të parasë publike në institucionet shtetërore. Prandaj, si grup parlamentar, mendojmë që duhet patjetër të hyhet në ndryshimin e ligjit, ashtu siç propozon edhe vet KRPP-ja, dhe në përshtatjen ose ndryshimin komplet të sistemit të prokurimit, përndryshe kjo do të jetë një gangrenë e shtetit të Kosovës. Ju faleminderit shumë!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Edhe njëherë e shoh të arsyeshme të precizoj. Ju thatë përafërsisht që as ai komisioni tjetër nuk e ka shqyrtuar mirë ose në mënyrë të plotë, unë prapë e kam një letër këtu, të nënshkruar nga kryetari i komisionit, për një mbledhje që është mbajtur me 3 mars dhe një dokument që është regjistruar më 6 prill 2010. Kaq.

Shkojmë tutje. Fjalën e merr Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së.

MYZEJENE SELMANI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Përsëritet për ministrat që janë këtu dhe për të gjithë deputetët!

Grupi Parlamentar i AKR-së e ka shqyrtuar Raportin e Komisionit Rregullativ të Prokurimit dhe duke marrë parasysh se ky raport punohet dhe KRPP-ja funksionon në bazë të Ligjit të prokurimit publik të Kosovës, numër 02/499, shihet se në këtë raport janë paraqitur mjaft mirë të gjitha kontratat që janë nënshkruar nga paraja publike dhe pikësëpari unë jam në dakord me organin e KRPP-së, i cili kërkon ndryshimin e Ligjit, ku ne kemi marrë vërejtje edhe nga Raporti i progresit në lidhje me prokurimin njëburimor, i cili bëhet nga paraja publike dhe këtu nga Kuvendi i Kosovës, kërkoj nga ministri i linjës që të bëjë ndryshimin dhe plotësimin e këtij ligji, në mënyrën më të mirë të duhur për arsye që Kosova të mos marrë notë negative prapëseprapë. Mirëpo, në këtë raport, u fol mjaft mirë edhe nga parafolësit, se shihet mjaft mirë nga shkon paraja publike dhe si funksionon raporti me kontratat e nënshkruara publike gjatë vitit 2009. Janë të potencuara mjaft mirë ministritë nga të cilat janë bërë këto kontrata dhe ka vend mjaft për kritika, mirëpo siç shihet, raporti i KRPP-së dhe kisha për ta tërhequr një diagonale me pyetësin, i cili është plotësuar nga kjo Qeveri për politikën tregtare, ku shihet mjaft mirë se KEK-u dhe PTK-ja janë dy kompani publike, të cilat shkojnë në privatizim dhe KEK-u është një kompani publike, e cila merr të hollat nga buxheti i Kosovës dhe ka nënshkruar diku 22% të kontratave publike me vlerë 171 milionë euro dhe asnjëherë nuk ka dhënë përgjegjësi para këtij Kuvendi. Unë mund të them se raporti ka të drejtën ekskluzive të analizohet në mënyrë më të mirë të duhur dhe të ngrihen shumë çështje për paratë publike, por do të ngelet në një procedurë tjetër. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit të LDD-së, zoti Lulzim Zeneli.

LULZIM ZENELI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Kolegia parafolëse paraqiti vlerësimin e Komisionit Evropian në Raportin e fundit të progresit, ku prokurimin publik e paraqet si njollë të zezë të vendit dhe duke e vlerësuar si gangrenë të krejt atij vlerësimi apo raportimi, janë kontratat njëburimore, të cilat arrijnë vlerën 164 milionë euro për vitin 2009. Nëse kësaj i shtojmë edhe vlerësimet e fundit apo sinjalet të cilat vijnë, se gjendja në prokurimin publik është përkeqësuar, atëherë mund të vijmë në përfundim se gjendja në këtë fushë është shumë e rëndë. Cili është roli i Kuvendit të Republikës së Kosovës me rastin e vlerësimit të këtij raporti?

Të nderuar deputetë,

Këtu para jush kemi Raportin e vitit 2008 dhe 2009. Unë të vitit 2008 e kam marrë me veti që të bëj një krahasim, Shikoni rekomandimet të cilat kanë qenë të këtij komisioni në vitin 2008, janë po ato të njëjta, të cilat janë përcjellë në vitin 2009. Asnjë rekomandim tjetër nuk është. Unë kam arritur vetëm t'i nënvizoj rekomandimet të cilat përcillen prej viti në vit, çka do të thotë se viti 2009 është një vit i humbur në aspektin e përmirësimit të gjendjes dhe të angazhimeve për ta ndryshuar gjendjen në praktikë në këtë fushë. Dhe, tash jemi para një vlerësimi, si Kuvend i Kosovës, përgjegjës, që fundi fundit ka dhënë vizën, miratimin për këto organe, këto mekanizma të cilat udhëheqin me këtë fushë dhe nuk janë të pakta, janë 3-4 trupa njëkohësisht që merren. Është për çudi që kur flitet për tenderomaninë, korrupsionin në vend, vazhdon gogolizmi i vazhdueshëm pa asnjë veprim konkret, i cili do të përcillet në praktikë dhe do të ndryshojë, do ta pres këtë hallkë negative të këtij fenomeni.

Ajo çka mund të thuhet, është që i kam nxjerrë si diçka shqetësuese edhe sfidat që ky komision i ka shfaqur në këtë raport janë, duke filluar prej përgatitjes jo të duhur të tenderëve, përgatitja jo e duhur e dosjeve, mosinformimi i operatorëve ekonomikë

lidhur me shkaqet e eliminimit nga konkurrenca. Pastaj, kur autoritetet përkatëse marrin vendim në kundërshtim me kriteret të cilët i kanë aprovuar më herët, do të thotë në procedurën fillestare. Sfida kryesore në këtë raport që jepet, thotë se zyrtarët e prokurimit ndërrohen shumë lehtë dhe shpesh dhe në pozitë udhëheqëse vijnë njerëz pa përvojë, që po paraqitet një sfidë, një problematikë e vazhdueshme që po e pengon përmirësimin apo angazhimin konkret në përmirësimin e kësaj gjendjeje. Ajo, të nderuar deputetë, çka është një vlerësim që po na përcjellë edhe në raportin ndërkombëtar, se korrupsioni, tendoromania, në kuptimin negativ të fjalës, e ka kapluar sistemin. Dhe, kur kaplohet një sistem, merr shumë kohë që të vendoset në binarë të duhur.

Nëse vazhdon Kuvendi i Kosovës, unë e kam vlerësim pozitiv sa i përket raportit në kuptimin e përmbajtjes, në kuptimin e radhitjes, të profesionalizmit të cilin e ka paraqitur, mirëpo fenomeni si fenomen mbetet i paprekur dhe ende institucionet e vendit nuk tregojnë një përkushtim serioz që të merren me problemin real. Problemi real është se në Kosovë korrupsioni e ka kapluar sistemin, në Kosovë nuk ka vullnet politik për ta luftuar këtë dukuri dhe, përpos deklaratave publike dhe vazhdimit të këtij gogolizmi në opinion, nuk ekziston ndonjë trend që ne mund të vlerësohemi për momentin. Prapë po e themi, si raport duhet përshëndetur, mirëpo duhet ta ndiejmë veten të brengosur dhe të shqetësuar se kjo materie, kjo fushë po e kaplon një gangrenë, një parafolës e quajti, mirëpo ka metastazuar në atë masë sa që do të marrë shumë kohë dhe përkushtim që të ndryshohet gjendja në terren. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet!

Për Grupin “7+”, a është kush? Nuk është paraqitur. Për SLS, nuk paraqiten, e përkrahin sigurisht. Grupi për Integritet, deputetja Vezira Emrush.

VEZIRA EMRUŠ: Hvala na datu reč!

Pozdravljam sve kolege i Predsedništvo, kao i gospodu ministre koji su trenutno tu. Danas pred sobom imamo jako važan izveštaj, koji bi malo više trebalo da analiziramo zato što je ovo, da kažem, sektor koji se najviše kritikuje u zadnje vreme od strane Evropske komisije.

Sam izveštaj ima normalnu proceduralnu azbuku. Bavi se sa analizom svih ugovora na centralnom i lokalnom nivou, od ministarstva do opština. Međutim, ja hoću da kažem nešto kada je u pitanju izveštaj, da ovaj izveštaj, normalno, ova Komisija ima obavezu na ime Zakona o javnim nabavkama jednom godišnje da dostavi nama u Skupštini i ta obaveza ove komisije ispunjena je sa ovim izveštajem.

Međutim, u ovom izveštaju praktično nije definisan pravi segment samog izveštaja, namene izveštaja. Pošto je u pitanju trošenje javnog novca, trošenje budžeta, mi imamo listu svih ugovora koji su sklopljeni i dobro se iz ovog izveštaja vidi da se javni novac, da su najveći potrošači javnog novca javna preduzeća, a i sta ta preduzeća su prozvana od Evropske komisije da se da trenutno njihov status, da je takav kakav je. Izveštaj nema hronologiju, znači planiranog, ostvarenog i ostatka ili saldo rezervnih sredstava. Ne možemo da pratimo šta je na ugovoru, imamo potpisano ukupno, zbirno, šta je od toga ostvareno, šta je u budžetu još ostalo, kao da je to – uzmi koliko ti život pruža.

Prikazani su svi ugovori potpisani na centralnom i lokalnom nivou, a kada je u pitanje trošenje javnog novca, u tim ugovorima nemamo prave segmente, nemamo opis ugovora, nemamo članove, stavove, šta po ugovoru, šta po ugovoru ima investitor i šta po ugovoru ima izvršioc tog ugovora ili taj kome je javni novac dat na trošenje. Ja neću

da se zadržavam puno na opis samog ovog izveštaja, mogu ja da kažem u svoje ime da je izveštaj ispod nekog nivoa koji može da nas informiše na pravi način, ali hoću da se zadržim na jedan praktičan i tačan način, analizirala sam jedan od ugovora, jedan od ugovora iz izveštaja. Kada je u pitanju kapitalna investicija opštine Dragaš, sa Ministarstvom za povratak finansirala je po ugovoru put za selo Radeša 4,5 kilometara. Taj put je građen, nema nepunu godinu, u dužini od 4,5 kilometara, 630 metara. Put je trebalo da krene iz sela Radeše prema Dragašu, krenuo je suprotnim putem, putem iz Dragaša za Radešu i taj put nema 630 metara, nije izrađen od strane ovog izvođača 630 metara. Taj put sada ima jedan krater od 25 metara za nepunu godinu, znači kada je kvalitet, kada pravimo ugovore i kada trošimo javna sredstva, i sada selo Radeša praktično nema put, nego je izolovano, koristi njive i blato, a imalo je put makadam.

Ovde je Ministarstvo za povratak nadležno, ugovor je imalo sa opštinom Dragaš, i izvođač je bio GETOARI. Znači, šta radimo mi, naš javni novac trošimo, da kažem, bez neke analize. Ova komisija i sa ovim izveštajem nema znači povratnu informaciju. Mi ovde kao poslanici nemamo uvid, imamo uvid u ugovore finansijskih, ali nemamo uvid u ugovore kako su oni završili, koliko su se realizovali, gde su, kako su sa kvalitetom. Mi smo, kolege poslanici, prozvani zbog toga, zbog korupcije, jer svako golim okom može da vidi korupciju na putu, ne mora da zadire u sama dokumenta i izveštaje koje nam ovde serviraju. Ja sam malo pažnje htela od svojih kolega, i dala sam jedan konkretan način. Znači, mora tenderi i svi subjekti da se prepoznaju, da se svaki subjekat identifikuje kada je u pitanju posao, da se kulturno to radi sa penalima, gde se zna u članovima ugovora šta snosi izvođač, šta investitor. Eto, to su posledice naše korupcije. To je samo, samo se ljudi bave sa ugovorom, šta će sa tenderom nekome da daju i šta će da uzmu, a šta će da se završi, šta će od toga da bude, o tome niko ne brine. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja deputete! Tash vazhdojmë me diskutime të deputetëve në bazë të radhës së paraqitjes. Fjalën e ka deputeti Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Natyrisht që mbështes Grupin Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës për ta votuar në parim raportin, mirëpo megjithatë dua të diskutoj për tri çështje që duhet t'i kemi parasysh. Është shumë e vërtetë që duhet respektuar Komisionin e Prokurimit Publik që e ka prur raportin me kohë, ashtu siç e kërkon ligji. E kanë shkruar raportin mirë, kanë dhënë ndoshta edhe informacione të mjaftueshme në raport për të parë gjendjen reale, mirëpo për mua është një shqetësim rreth zbatimit të ligjit në Kosovë. Nëse e shikojmë me vëmendje raportin, ju e dini që modifikimi apo amendamentimi i Ligjit të prokurimit publik ka ndodhur në vitin 2007, dhe në amendamentim është kërkuar që pas amendamentimit, bordi të jetë nga 3 anëtarë. Sot e kësaj dite ky komision po vepron prapë me dispozitat e ligjit të vjetër dhe raporti këtu është sjellë nga 5 anëtarë.

Është edhe një çështje shumë shqetësuese, jo vetëm për këtë raport, por edhe për raportet tjera që do t'i kemi dhe që i kaluam, çka nëse raportet nuk kalojnë? Ne, si Kuvend, duhet sa më parë të nxjerrim një vendim dhe të vendosim çka nëse një agjencioni që vepron në kuadër të Kuvendit të Kosovës apo agjencioneve tjera që bordet e tyre i kemi votuar, çka nëse ne rekomandojmë apo nëse deputetët nuk e përkrahin raportin. Kjo çështje është shumë e diskutueshme dhe pavarësisht a i aprovojmë apo nuk e aprovojmë ne raportet, rezultati përfundimtar është me këtë situatë që e kemi, është pa Dhe, për mua ka pasur edhe disa aspekte tjera që kam dashur t'i diskutoj në raport, por ta them të vërtetën, si deputet, pak shqetësuese është çështja, ne nuk mund t'i kontrollojmë të tjerët,

përderisa nuk e bëjmë punën vetë. Ne posa dëgjuam që një kryetar i komisionit, që unë kam respekt, por i cili shumë diskutoi për çështjet përmbajtësore të raportit, e ndoshta edhe qëndrojnë dhe do ta kisha përkrahur shumë si deputet, por një kryetar komisioni ka prurë një rekomandim pa e votuar fare në komision. Prandaj, nuk kemi çka të diskutojmë më tepër. Vjen rekomandimi prej një komisioni, i cili nuk ka pasur kuorum as për të nxjerrë rekomandime, as për të sjellë rekomandime.

Prandaj, çka po kërkojmë më tepër ne, ku të mbështetemi. Në anën tjetër, nëse e dëgjojmë rekomandimin, është gjithsesi okej, duhet të përkrahet, komisioni e ka dhënë, në anën tjetër diskutimet janë krejt në të kundërtën e asaj që rekomandohet. Prandaj, konsideroj që Kuvendi i Kosovës shpejt duhet të nxjerrë një rregullore apo një vendim, me të cilin duhet të kërkohej qartë që, nëse raportet nuk e marrin votën e deputetëve të Kuvendit të Kosovës, të kërkohej përgjegjësi për anëtarët e Bordit apo për kryesuesin e Bordit dhe, natyrisht, ndoshta vetëm kjo situatë na nxjerrë që të kemi raporte të qarta dhe reale. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Hyseni! Fjalën e ka, deputeti Driton Tali.

DRITON TALI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Për idenë s'mund e vërejtja, po përndryshe edhe në këtë seancë, ashtu sikurse në seancën e 16 prillit të vitit 2009, nëse e keni harruar, t'ua rikujtoj, kur e kemi shqyrtuar këtë raport, kemi pasur vetëm 2 ministra prezent nga Qeveria. S'di çka është në pyetje, a po turpërohet shumë Qeveria nga raporti kur po na vijnë të KRPP-ës dhe OSHP-ës, apo është çështje tjetër, nuk e di?

Sidoqoftë, pasi u kapa në retrospektivë them se, nëse e krahasojmë këtë raport me raportin e vitit 2008, shihet njëfarë përmirësimi, por megjithatë edhe ky raport vuan shumë nga paqartësia, sikurse jepet përshtypja se ka tendencë që informatat të përsëriten në monotoni, me qëllim që të fshihet diçka aty dhe është njëfarë raporti klasik i numrave, statistikave që po them, po s'je njohës i mirë i çështjes, vështirë se e kupton.

Për shembull duhesh të jesh, po them, ta dish Ligjin e prokurimit publik shumë mirë për të kuptuar se pse në vitin 2009 janë trefishuar shpenzimet e tjera, në rubrikën të tjera, krahasuar me vitin 2007, merreni, shikoni, e keni, nëse nuk gaboju, është faqe 6 dhe faqe 7, do të shihni se shpenzimet në rubrikën të tjera janë trefishuar në vitin 2009, krahasuar me vitin 2007 dhe janë dyfishuar, krahasuar me vitin 2008. Dhe, shtrohet pyetja se ku janë shpenzuar këto para? Çka është financuar? Po them, është shumë vështirë ta zbulosh, duhesh goxha mirë të lexosh dhe ta dish mirë po them edhe në Ligjin për prokurimin publik për ta kuptuar se mbase ato para janë shpenzuar në OJQ të ndryshme, ndonëse këtë përshtypje edhe faqja 8 ta jep. Dhe, shtrohet pyetja se pse – pse janë shpenzuar këto para në OJQ, kujt, cilat projekte të OJQ-ëve janë dhënë, janë financuar. A janë ato OJQ të cilat për detyrë kanë pasur që Qeverisë t'ia përmirësojnë imazhin, mbase po them, s'po di, e tjera, e tjera. Të gjitha këto po i them se e kam parasysh që Ligji për deputetët ende nuk na ka ardhur dhe kur them Ligji për deputetët, kam parasysh jo paratë, se disa kolegë aty i hapën sytë mos po flas për rrogat e deputetëve, por po flas për atë hapësirë hulumtuese që ta jap, sepse Ligji për qasje në dokumente zyrtare na e cungon hapësirën, sidomos po them, nëse nuk gaboju, është neni 88 ku qartazi neni 88 i Ligjit për dokumentet zyrtare – qasjen në dokumentet zyrtare, na i kufizon këto hulumtime, andaj edhe nuk mund t'i bëjmë hulumtimet e thukëta, andaj edhe KRPP-ja, po edhe OSHP-ja na sjellin këso farë raporte të cilat për të dhënë ndonjë provim statistike janë të mira kështu për t'i kuptuar se çka është statistika alla-kosovarçe, gjithmonë po flas, sepse statistikat janë krejt tjetër.

Tashti, po them, duhesh të jesh ose njohës i mirë i ambientit për ta kuptuar se në vitin 2009 për ta ditur se në vitin 2009 si është shpenzuar paraja publike, sepse po them përsëri ky raport gjithmonë kur flas – ky raport dhe kam parasysh për kolegët aty që po rebelohen, nëni 83 pika 1 le të urdhërojnë e ta lexojnë të Ligjit për prokurimin publik qartazi ia jep detyrat KRPP-ës ku thotë se KRPP-ja ka autoritetin dhe përgjegjësinë të vëzhgojë dhe mbikëqyrë zbatimin e dispozitave të këtij ligji, e tjera, e tjera, dhe, nuk është bërë.

Shkojmë te këto që u cek te disa shpenzime që janë shumë të nxehta dhe po them, ata të paktën që i lexojnë mediat e përditshme, jo ato qeveritare, por këto që të paktën mundohen ta mbajnë njëfarë paanshmërie, shohin se ndërmarrjet publike, por edhe dikasteret e Qeverisë japin shumë tenderë njëburimore që ne i themi, këtu po i thuhet të negociueshme. Dhe, po nëse bën llogari, po them, përsëri duhesh goxha të mundohesh për ta kuptuar se bie fjala KEK-u, që ka shpenzuar paratë tona 170 milionë e 300.000 euro, mbi 300 mijë euro, u mor vesh, nga ato 32 milionë, mbi 32 milionë i ka shpenzuar në tenderin njëburimor dhe i shesin një 5-6 kompani janë aty, ESDS (Ei-Si-Di-Si) ajo tjetra, ai Kontrejdë e tjera e tjera, që janë shumë aktive, shumë janë aktive, po janë shumë me fat që i marrin këta farë tenderë dhe po them tashti duhet të jesh konspirativ si ndodhi kjo, si ndodhi ajo, se s’kemi informata sepse Ligji për qasje në dokumente zyrtare nuk na jep ato informata dhe ne s’kemi si t’i zbulojmë. Andaj duhesh ta përdorësh atë metodën krahasuese konform disa informatave që i ke dhe të vish në silogjizëm, sepse mënyrë tjetër nuk ka, po them edhe një herë dhe e mira po them apo “e mira” gjithmonë për këtë raport është se sipas ligjit, mesa unë di, nuk duhet të miratohet nga ne, por vetëm të japim vërejtjet. Me fjalë tjera folëm çka folëm, asgjë përsëri ky institucion po edhe institucionet tjera do të na sjellin raporte të ngjashme, sepse Kuvendi dhe ligji, në realitet Kuvendi kaq ka mundësi.

Ngjashëm është po them edhe një herë te paraja publike, po i hyjmë te Ministria e Transportit e Postë- Telekomunikacionit, Ministria e Arsimit, Ministria e Shëndetësisë ku janë shpenzues më të mëdha të parasë publike dhe informatat janë shumë të zbehta, shumë të vogla, gjithmonë thirren në nenin të cilin e përmenda 83, 83 pikë 1, sidomos të Ligjit për prokurimin publik. Andaj, çfarë mund të them, po e them edhe një herë atë që në seancën e 16 prillit të vitit 2009, do të thotë do kritika që ia dhamë, urdhëroni merreni transkriptin e asaj seance, faqe 80, 86, 87, mos ta përsëris, janë 80% edhe për këtë raport, sepse nuk ka ndryshime esenciale. Janë disa statistika të cilat thënë me këtë proverbin popullore” me iu qit hi syve njerëzve”, kishe kemi bërë diçka, por në realitet informata më shumë këtu kamuflohet se sa që qartësohet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, deputet! Fjalën e ka deputeti Naim Rrustemi!

NAIM RRUSTEMI: Faleminderit, kryesues!

Vërejtjet e mia do të jenë shumë substanciale, sepse mendoj që funksionimi i krejt KRPP-ës – Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik i projektuar në raportin e tillë nuk i arsyeton shpenzimet e parasë publike që i bën ky komision. Duke pasur parasysh se unë mendoj që një raport të tillë kanë pasur mundësi që ta bëjnë dy asistente që t’i punësojmë dhe ato jo gjatë tërë vitit, sepse janë vetëm përmbledhja e asaj çka ka ndodhur, duke mos i dhënë asnjë vlerësim si në të vërtetë është menaxhuar dhe është mbikëqyrur zbatimi i dispozitave të Ligjit të prokurimit publik.

Duke pasur parasysh Ligjin e prokurimit publik, saktësisht nenin 83, Komisionit Rregullativ i Prokurimit publik i jepet e drejta që të mbikëqyrë dhe të vëzhgojë a është duke u zbatuar Ligji për prokurimin publik nëpër të gjitha autoritetet kontraktuese, për çka edhe është i ndërtuar Ligji i prokurimit publik.

Në rast vetëm se afrohen tabela, tabela sa janë shpenzuar është një mbledhje e të dhënave, që nuk e arsyeton shumë, nuk i jep arsye pse të ekzistojë Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik.

Gjithashtu në nenin 83 të Ligjit të prokurimit publik është saktë e definuar pika 83 pikë 2, pika nën 4, ku kërkohet nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit publik të përgatisë raport vjetor dhe që të japë një vlerësim të përgjithshëm, por të saktë të gjendjes. Me fjalë të tjera, kemi kërkesë që të bëhet një vlerësim. Në rast se vetëm afrohet e ti gjyko vetë, atëherë ai nuk është vlerësim. Ose, është njëfarë tendence kështu në përgjithësi edhe prej politikanëve tjerë në këtë rast edhe Komisioni Rregullativ e luan rolin e diplomatëve – politikanëve, unë s’po mund ta them veç ti kupto vetë. Detyrë e Komisionit Rregullativ është të japë vlerësim – pse kemi shpenzime kaq të mëdha në kontratat e negociuara. Nuk është veç me paraqit dhe ti gjyko vetë dhe ne si deputet tash vetë të gjykojmë nga një tabelë. Vlerësim do të thotë edhe me dhënë një arsyeshmëri pse ka ndodhur deri te kjo? A janë tamam a s’janë, një analizë e tyre e saktë, që për ne kishte për të na dhënë një vlerë të shtuar kur t’i shqyrtojmë raportet e tilla.

Unë nuk do të futesha në analizën, ose për t’i lexuar këtu tabelat me fjalë, të tentoj të bëjë përmbledhje dhe për ta shpjeguar një tabelë, e në këtë tabelë shihet se ka qenë ajo, kanë qenë ato, ajo është diçka e dukshme dhe nuk e vë në dyshim se tabelat e dhëna dhe të dhënat e ofruara nëpër këto tabela janë të sakta, sepse sigurisht janë mbledhur nga terreni, nga atje ku është shpenzuar paraja publike, nga agjencitë të cilat e kanë shpenzuar paratë publike. Por vlerësim nuk ka. Ky vlerësim nuk është raport, nuk është vlerësues.

Disa gabime faktike do t’i sugjeroja Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik është se për shembull në faqen 30 i kemi aktivitetet e Komisionit Rregullativ kur thotë se publikohen publikimet të njoftimet e kontratës në ueb-faqe, nuk është gjithmonë kjo e saktë. Kemi shpesh raste ku janë kontrata të tilla dhe nuk kanë qenë në ueb-faqen e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik. Kjo është gjë që mund të dokumentohet, me fjalë tjera është gabim faktik që është paraqitur në raport, nëse mund t’i themi raport, sepse ky është një përmbledhje e të dhënave çka me të vërtetë ka ndodhë, duke mos i dhënë asnjë analizë.

Dhe, gjithashtu, me Ligjin e prokurimit publik kërkohet nga Komisioni Rregullativ që t’i japë edhe sugjerimet për tejkalimin e sfidave që paraqiten në fushën e prokurimit publik.

Unë do t’i jepja disa sugjerime të mia, edhe pse Komisioni i ka paraqitur këtu – për presionet që u bëhen zyrtarëve të prokurimit gjatë kryerjes së aktiviteteve të prokurimit e sidomos me rastin e dhënies së kontratës. Kjo është një fjali e vendosur në raport. Në shikim të parë, nuk po tregon shumë, por ne kemi qejf ta dimë – presion prej kujt. Nëse ka presin, e është prej dikujt, prej kujt ka presion. Me fjalë të tjera, me qenë pak më zbërthyes në këtë analizën e vet. Kjo është fjali e Komisionit, nuk është fjali e imja, nuk e kemi krijuar ne. Po, edhe ajo mund të jetë, se sigurisht që është kërkesë e atyre që nuk e njohin pavarësinë e Kosovës që ta rrënojnë sistemin dhe që t’i fusin njerëzit në korrupsion më thellë e më thellë dhe që të përdoren një ditë për zgjidhjen e problemeve të

veta politike, sigurisht. Se edhe ashtu e kam thënë një herë që mund të jenë ata që janë thellë të ngulfatur në korrupsion, mund të jenë dorë e zgjatur e Serbisë, edhe ashtu, shikuar, normalisht nga një aspekt tjetër.

Po, gjithashtu, unë kisha pasur dëshirë që Komisioni i Prokurimit Publik të bëjë përmbledhje edhe të paraqitjeve publike të zyrtarëve që janë përgjegjës për respektimin e dispozitave ligjore të prokurimit publik. Për shembull, ne shpesh kemi pasur rastin dhe kemi pas raste kur publikisht kanë dalë zyrtarët e lartë edhe kanë bërë thyerje të drejtpërdrejtë, fjalë publike kanë thënë për thyerje të Ligjit të prokurimit, asnjë fjalë nuk është e thënë në raport.

Për ta bërë një përmbledhje të përgjithshme, do të thosha që nuk është shumë i arsyeshëm funksionimi i Komisionit Rregullativ me një raport të tillë, sepse ky nuk është raport, ky është një përmbledhje e të dhënave që kanë mund t'i kryejnë edhe dy punëtorë dhe kishte me na kushtuar nja 5-600 euro në muajt, ose 5-6.000 në vit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e merr deputeti Arsim Bajrami.

ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, i nderuari kryesues!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Padyshim se përmirësimi i performancës së proceseve të prokurimit publik është një sfidë e të gjitha shteteve të transicionit, sepse siguron një efikasitet të menaxhimit të shpenzimeve publike dhe tanimë të gjitha shtetet e rajonit në raportet e progresit marrin vërejtje sa i përket performancës së prokurimeve publike. Dhe unë nuk do të flas shumë për raportin por do të flas për një proces që është në zhvillim e sipër në Qeverinë e Kosovës. Në fakt tanimë ekziston një projekt i fillimit të prokurimeve elektronike, është një proces që po praktikohet tani edhe në të gjitha shtetet e rajonit, Qeveria e Kosovës ka një projekt ideor, e gjithashtu e ka edhe një donacion të lejuar nga Banka Botërore dhe sa më shpejt që të fillojmë ta praktikojmë procesin e prokurimit elektronik, aq më shpejt në substancë do të vihet rend dhe rregull në këtë proces.

Prokurimi elektronik do të sigurojë katër çështje që janë esenciale, sepse ne këtu po mëremi me diskutimin e një raporti administrativ, ne do të merremi me substancën e përmirësimit të kualitetit të proceseve të prokurimeve publike që janë procese administrative shumë sensitive. E para, fillimi i aplikimit të këtij procesi, i cili ka qenë i menduar nga Ministria e Administratës Publike të pilotohet qysh në shtator, do të sigurojë standardizimin e prokurimeve publike. Do të kishim procese të prokurimeve publike standarde, me kushte standarde dhe kjo do të mundësonte shumë lehtë efikasitetin e këtij procesi. E dyta, do të siguronte një transparencë të plotë, sepse përmes prokurimit elektronik arrihen tri qëllime: e para aplikimi online në proceset e tenderimit publik, që është diçka shumë pozitive. E dyta, vlerësimi online i tenderëve publikë me kriterë unike dhe e treta, shpallja online e fituesve. Pikërisht ky proces do të siguronte një transparencë të plotë, do të arrite besimin e taksa-paguesve në proceset e menaxhimit të shpenzimeve publike. Efekti i tretë i aplikimit të prokurimit elektronik është efikasiteti. Një proces elektronik nuk do të zgjaste me muaj të tërë, por do të ishte jashtëzakonisht i shpejtë dhe kjo do të rriste edhe efikasitetin dhe do të krijonte politika të koordinuara të menaxhimit të buxhetit të Kosovës, jo politika ad-hoc, por të koordinuara. Dhe e katërta, do të racionalizonte buxhetin duke e shmangur një strukturë burokratike që e kemi në proceset e prokurimit publik, sepse kemi disa instanca në aplikimin e procesit të prokurimit elektronik, këto struktura do të racionalizoheshin dhe do të ishin jashtëzakonisht efikase.

Jam i sigurt se Qeveria e Republikës së Kosovës do ta shtyjë përpara këtë projekt për të cilin Ministria e Administratës Publike e ka përfunduar projektin ideor i cili është miratuar në Qeveri. Banka Botërore në kuadrin e projektit të modernizimit të sektorit publik i ka ndarë 2 milionë dollarë për implementimin e këtij projekti dhe fillimi i praktikimit të këtij procesi elektronik të prokurimit publik do të bëjë që vërtet ky proces të jetë jashtëzakonisht transparent dhe të jetë plotësisht efikas. Tanimë të gjitha shtetet e rajonit janë duke e praktikuar, Shqipëria ka një vit që është duke e praktikuar, gjithashtu edhe Maqedonia dhe shtetet tjera. Besoj se edhe ne do ta sigurojmë kuadrin e plotë normativ, jam i vetëdijshëm se duhen disa ndryshime në kuadrin ligjor sa i përket prokurimit publik dhe segmentet teknike janë të gatshme dhe unë po shpresoj se në vjeshtë të këtij viti ne veç do ta pilotojmë një proces të prokurimit elektronik në disa agjenci buxhetore, kurse nga viti 2011 unë mendoj se kjo duhet të instalohet si një metodë e rregullt e prokurimit elektronik. Kjo sigurisht se do të sigurojë menaxhim më të mirë të buxhetit dhe do të sigurojë një proces transparent të mbikëqyrjes dhe është një mjet edhe në parandalimin e keqpërdorimeve eventuale në procesin e prokurimit publik. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zotëri Bajrami! Fjalën e merr deputetja Myrvete Pantina.

MYRVETE PANTINA: Faleminderit, zotëri kryesues!

Raporti i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2009, të cilin po e shqyrtojmë sot është një raport mjaft i pasur me të dhëna, por përkundër këtij fakti nga ky raport nuk mund të fitojmë një pasqyrë të qartë për procesin e prokurimit publik në Kosovë.

Megjithatë, gjatë analizës detaje të të dhënave mund të nxirret konkludimi se gjendja në këtë fushë është jo e mirë dhe ka nevojë që të punohet shumë për të përmirësuar këtë fushë. Nga raporti konstatohet se rreth 84 apo rreth 85% të buxhetit për prokurime publike është shpenzuar përmes procedurës së hapur, vlera e të cilave kontrata ka shënuar rritje për 3.32% në krahasim me vitin 2008. Kjo formë e prokurimit që ndryshe konsiderohet si procedurë më transparente e prokurimit publik, e cila do të duhej të ishte shpresëdhënëse edhe për ekonominë e Kosovës dhe për të ardhmen e Kosovës drejt Bashkimit Evropian. Por, nëse nisemi nga fakti se prokurimi publik ka qenë ndër fushat më të kritikuara në raportin e progresit të vitit 2009 të Bashkimit Evropian për Kosovën në të cilin raport është konstatuar se gjendja e prokurimit publik në vitin 2009 madje është përkeqësuar. Se gjendja e prokurimit publik nuk ka qenë në rregull, mund të kuptohet edhe nga të dhënat e Departamentit për Mbikëqyrje dhe Monitorim të KRPP-ës, departament i cili gjatë vitit 2009 ka kryer 43 monitorime dhe mbikëqyrje të aktiviteteve të prokurimit. Nga këto monitorime është konstatuar se një pjesë e aktiviteteve të prokurimit nuk janë krye në tërësi në pajtim me kërkesat e Ligjit të prokurimit publik. Veçanërisht përmendet planifikimi i dobët gjatë përgatitjes së planit vjetor të prokurimit, përgatitja jo e mirë e dosjeve të tenderimit, mos informimi i operatorëve ekonomik për arsyet e eliminimit, vlerësimi jo i drejtë i operatorëve ekonomik. Po ashtu ka pasur raste kur autoriteti kontraktues ka bërë vlerësimin në kundërshtim me kriteret e përcaktuara. Edhe nga numri i madh i rekomandimeve të dhëna nga ana e KRPP-ës për përmirësimin dhe avancimin e sistemit të prokurimit publik në Kosovë mund të kuptohet se ekzistojnë lëshime dhe dobësi të mëdha në këtë fushë, mos definimi i qartë i kriterëve për vlerësim të ofertuesve, ka ndikuar në paraqitjen e vlerësimeve subjektive, jo reale dhe në kundërshtim me kërkesat e Ligjit të prokurimit publik.

Një shqetësim të madh për këtë fushë parqet numri i madh i njoftimeve për anulimet e publikuara. Në vitin 2009 kanë qenë 191 njoftime kontrate, ndërsa 67 prej tyre janë anuluar, që paraqet 32% të njoftimeve për kontrata. Po ashtu është shumë shqetësues fakti se ka ardhur deri te rritja e tenderimit njëburimor dhe atë prej 50 milionë sa ka qenë në vitin 2008, në 164 milionë në vitin 2009.

Dhe, në fund, e kam një propozim konkret. Në tabelat ku janë paraqitur kontratat e nënshkruara nga autoritetet kontraktuese, në faqen 28 dhe 29, do të ishte mirë që në të ardhmen, përveç të dhënave për procedurat e prokurimit dhe vlerës së kontraktuar të paraqiten të dhënat edhe për sasinë, varësisht prej llojit të punës së kontraktuar. Është fjala për kilometër, për kilovat orë, litër, copë apo çkado tjetër që është dhe çmimin në mënyrë që të fitohet një pasqyrë më e qartë për punën e kontraktuar. Dhe, gjithsesi, pajtohem me rekomandimet që jepen edhe nga vetë KRPP-ja që kanë të bëjnë me përmirësimin dhe avancimin e sistemit të prokurimit publik në Kosovë. Ndër të parat janë, reformimi i sistemit të prokurimit publik dhe forcimi i implementimit të Ligjit për prokurimin publik. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit deputetet! Fjalën e merr deputeti Naser Rugova.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti kryesues!

Së pari shpreh indinjatën dhe keqardhjen time pse një pjesë e ministrave kompetentë të Kabinetit qeveritar nuk marrin pjesë në këtë seancë kur po e shqyrtojmë një raport të një Komisioni Rregullativ, mbase që ka një rëndësi enorme edhe për zhvillimin ekonomik po edhe ka qenë një nga vërejtjet me të zeza nga Raporti i fundit i progresit të Komisionit Evropian.

Dhe në qoftë se vazhdojmë me këtë logjikë, kur organet që vërtet duhet t'i dhënë llogari Kuvendit dhe që ekzekutivi që është zgjedhur nga ky Kuvend, duhet t'i marrë këto rekomandime që të përmirësojë diçka në ato akuza të rënda që po na i bën Bashkimi Evropian dhe mekanizmat tjerë relevantë ndërkombëtarë, atëherë ku është serioziteti edhe i këtij institucioni më të lartë legjislativ të vendit?

Në qoftë se vetëm ministri i Mjedisit që ka më së paku mbase të bëjë me këtë çështje, që i ka 0.8% të buxhetit të Kosovës dhe ministri i Drejtësisë, i cili mbase është duke menduar që ta rregullojë një pavijon për VIP, në qoftë se prokuroria dhe organet e drejtësisë vetëm i lexojnë këto raporte edhe pse jo të hartuar në nivelin që do të duhej thjesht t'i drejtoheshin organit më të lartë legjislativ të vendit, jo me raportet deskriptive, por me raporte substanciale, me objektiva dhe me analiza të mirëfillta se si dilet nga ky izolim, nga ky karantinim i sistemit të prokurimit dhe menaxhimit të parasë publike në vend. Dhe, vërtet tani pyetje – kah është kah e çon ky ekzekutiv i këtij vendi dhe këta partnerë të koalicionit qeverisës Kosovën? Kjo është një pyetje që duhet për t'ia bërë Qeverisë e cila nuk është këtu dhe në qoftë se ministrat tjerë paskan ministri shumë të rëndësishme, paskan obligime, atëherë asnjë punë nuk e paska ministri i Mjedisit dhe ky i Drejtësisë që po i dëgjojnë këto të dhëna nga njerëz të zgjedhur të popullit.

Po kaloj tani në raportin konkret, se mbase disa kolegë edhe po flasin për gjëra që s'kanë të bëjnë me raportin, por po e citoj: ”rezultatet e gjetjeve të konstatuara gjatë mbikëqyrjes së aktiviteteve të prokurimit të autoriteteve kontraktuese tregojnë se një pjesë e aktiviteteve të prokurimit nuk kryhen në tërësi në pajtim me kërkesat e Ligjit të prokurimit publik”. Pastaj, vlerësimi subjektiv dhe jo i drejtë i operatorëve ekonomikë, mos definim i qartë i kriterëve për vlerësim ka shpie deri te vlerësimi subjektiv dhe

joreal. Kjo subjektiv dhe jo real tregon se një numër i madh i kontratave që gllabërojnë mbi 600 milionë të buxhetit të shtetit është vlerësuar sipas dëshirës dhe kënd ka dashur politika dhe ata zyrtarë jo profesionalë me nepotizëm e partizanë politikë që po e sjellin sistemin e prokurimit dhe të menaxhimit të parasë publike në Kosovë, në të gjitha agjendat ndërkombëtare, në të zezë, vërtet ku po i dërgojnë këto mjete? Këto janë para të popullit të varfër të Kosovës dhe njëherë e përgjithmonë duhet vënë limite institucionale dhe duhet të ndryshohet e plotësohet ky ligj dhe të merren masat konkrete dhe të dëgjohet zëri i njerëzve të zgjedhur të qytetarëve të Kosovës.

Ky raport nuk ka objektiva konkretë, se çka duhet të bëhet më tutje që të avancohet sistemi i prokurimit në Kosovë? Si do të duhej të jenë ato rekomandime për plotësim-ndryshimin e Ligjit për prokurimin publik? Nuk ka vlerësime adekuate dhe profesionale orientuese, qoftë për Kuvendin qoftë edhe për Qeverinë. Gjithnjë duke iu referuar këtij raporti, në faqen 37 shkruan: Sfidat me të cilat ballafaqohet sistemi i prokurimit publik në Kosovë janë mjaft të shumta, por më të shpeshtat janë... dhe ju lutem dëgjoni me vëmendje: presionet që iu bëhen zyrtarëve të prokurimit gjatë kryerjes së aktiviteteve të prokurimit e sidomos me rastin e dhënies së kontratës. E tani këtu është pyetja: ku punojnë këta zyrtarë të prokurimit? Në institucione, në pushtet lokal dhe në Qeveri. Kush iu bën presion? Vartësit e tyre. Kush janë shefat e tyre politikë? Dhe tani trendët e fundit po tregojnë që drejtësia në Kosovë duhet ta marrë një infuzion serioz, zotëri Ministër, ju nuk jeni ai që menaxhoni me sistemin gjyqësor në Kosovë, por duhet të krijoni klimë reformuese, hapësirë e cila vërtetë do të fillojë që këtë vend të shkretë dhe të sjell në këtë derexhe këto dy vjet e pak muaj të pavarësisë, thjesht të funksionojë shteti ligjor – drejtësia, rendi dhe ligji dhe të ketë transparencë.

Nën dy, ndërrimi mjafti i shpeshtë i zyrtarëve të prokurimit nëpër autoritete kontraktuese. Pse? Sepse, ka zyrtarë të prokurimit që janë të vetëdijshëm që nëse nënshkruajnë nën presin kontrata marramendëse mund të shkojnë në burg dhe thjeshtë thonë jo, është e paligjshme, bie ndesh me ligjin e prokurimit publik dhe nëse do ti zotëri epror apo shef politik të shkosh hapës, urdhëro se unë s'e nënshkruaj. Kemi emra dhe mbiemra të cilët edhe kanë deponuar materiale të tilla në prokurori. Dhe të gjeturat e Raportit të progresit të Komisionit Evropian për 2009 tregojnë edhe për cilësinë e investimeve kapitale dhe të nënshkrimit të këtyre kontratave që kalojnë shumë 660 milionë euro. Nuk po thotë opozita, as Naser Rugova, po ka thënë Raporti i fundit i progresit të Komisionit Evropian. Dhe në këtë kuptim, me procedurë të negociuar, me pazare janë shpenzuar nja 87 milionë e 263.000 euro. Unë e di që dikujt këtu s'po i vjen mirë, por është problem i tyre. Parlamenti nuk është poliklinikë për të shëruar komplekse, por është shprehje e vullnetit të qytetarëve dhe na këto gjëra duhet t'i themi shkurt, konkret, preciz dhe t'i themi ekzekutivit të vendit që të fillojë të marrë masa urgjente, sepse nuk ka as integritet, as proces të integriteteve, as zhvillim të ekonomisë, as investim të kapitalit të huaj – asnjë cent, asnjë vend i punës nuk është gjeneruar dhe nuk është investuar këto vite të pavarësisë. Dhe, kush e ka fajin? A ka zot shtëpie ky vend? A ka qeveri dhe a ka institucione? Dhe debati i tillë për çështje të rëndësishme në Parlament duhet ta ketë seriozitetin e organit më të lartë legjislativ të vendit dhe jo të biem joserioz edhe para miqve tanë ndërkombëtarë edhe para mekanizmave tjerë relevantë që e monitorojnë punën e Kuvendit dhe dërgojnë raporte te ata të cilët pastaj po ndikojnë a të ndihmohet Kosova a jo. Dhe sipas të gjitha trendëve, të zhvillimeve të fundit politike po edhe në relacion me mekanizmat e BE-së nuk ka vullnet që të ketë grande dhe donacione për hallet e shumta dhe për fushat e rëndësishme dhe dikasteret nacionale që të investohet në Kosovë.

Kur kësaj ia shtojmë edhe një statistikë të këtij raporti, procedurë për vlerë minimale, 3 milionë e 818.000 euro. Pse, me çfarë nevojë? A jeni në kushte lufte dhe rrethana emergjente apo çka po ndodh kështu. A vetëm të zhvatet buxheti i taksa-paguesve fukara të Kosovës. Le të jetë kjo një vërejtje serioze për Qeverinë, por edhe për këta mekanizma rregullativ që vërtet ta kryejnë punën e vet, sepse me këtë trend të qeverisjes së menaxhimit të parasë publike, sistemit të prokurimit, me këtë agoni politike që e ka kapluar Kosovën nuk po na këndohet këngë e mirë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Berim Ramosaj!

BERIM RAMOSAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Përshëndetje, zotëri ministra,

Kolegë deputetë,

Unë vërtet pata të flas shumë, por në atë çka e thanë të tjerët, disa shihet se kanë vullnet politik të bëjnë, të tregojnë në atë nivelin e deputetit, disa vërtet i kanë prekur çështjet. Ne sot duhet, mendoj, se jemi duke shqyrtuar raportin e Komisionit. Nuk jemi duke shikuar gjendjen në prokurimin publik në Kosovë. Në bazë të rekomandimeve që ka dhënë ky komision, del se jep hapësirë për të menduar që vetë Ligji i prokurimit publik ka të meta. Duke marrë parasysh të gjitha ato dobësi që dalin, qoftë nga periudha e 2008-shit, qoftë nga periudha e 2009-shit, del se Ligji i prokurimit publik në mjedisin kosovar nuk është duke u implementuar në atë mënyrën si ishte dashur. Vërtet është prokurimi publik sfidë sot për të gjitha vendet e regjionit, mos të flasim për nivel evropian, por në qoftë se vërtet dëshirojmë të japim provimin si legjislativ, duhet në njëfarë forme jo të merremi me çështje individuale, të izoluar, por të merremi me një çështje të madhe, globale: çështja e prokurimit publik në Kosovë.

Raporti, në bazë të asaj që ka paraqitur, vërtet dikujt i duket statistikor, por në fakt në qoftë se dëshirohet të elaborohet me të dhëna nga periudha në periudhë, ato duhet të bëhen përmes tabelave. Padyshim që deputetët disa janë ekspertë të asaj fushe, disa nuk janë, mirëpo unë mendoj se ne si pjesë politike duhet të ngritim çështjen e prokurimit publik – a është në pyetje ligji i prokurimit publik i cili lë hapësirë të keqmenaxhimit të kësaj fushe, respektivisht jo i hap hapësirë edhe keqpërdoruesve edhe atyre të cilët nuk janë keqpërdorues, por mund të jenë të përfolur, andaj unë mendoj se raporti na ka dhënë një hapësirë të mjaftueshme për të menduar për këto çështje. Vërtet raporti jep dy rekomandime, edhe shqyrtimin e moszbatimit të ligjit të prokurimit publik, që një gjë e tillë është evidente, por na jap mundësi edhe rishikimin e ligjit ekzistues. Unë në bazë të asaj që dëgjova edhe nga kolegët, vërtet ka shumë për t'u diskutuar në lëmin e prokurimit publik, por në qoftë se raporti i këtij komisioni na jep ne bazë formale, me letra, se ose duhet të ndërrohet ligji ose të ndërrohen njerëzit që duhet ta zbatojnë ligjin, atëherë baza është e mjaftueshme që vërtet këtë raport ta pranojmë. Mirëpo, nuk mund të luajmë në letrën e pasinqertësisë individuale. Në njërën anë t'i japim përkrahje raportit e në anën tjetër të tregojnë dhe të thirremi po në ato shënime të raportit për keq menaxhim, respektivisht keqpërdorim të kësaj fushe. Ne e dimë se është fusha. Unë e dëgjova edhe profesorin Arsim që foli për prokurimin elektronik. Ndoshta ajo ka me qenë zgjidhja në të ardhmen sepse një zgjidhje të tillë po e kërkojnë edhe vendet tjera. Vërtet situata është aq e palakueshme në këtë fushë që duhet të punohet, ose në ndryshimin e Ligjit ekzistues të prokurimit publik i cili nuk është në harmoni me mjedisin kosovar, i cili lë mundësi të keqpërdorimit bash të këtij ligji ose të kemi respektim strikt nga ana e personelit ekzistues. Andaj, sa i përket raportit unë mendoj se raporti na jep një bazë formale juridike që ne vërtet të merremi me këtë çështje dhe besoj se ky raport është i mjaftueshëm për ne ta votojmë në kuptimin e raportit të këtij komisioni. Ka mbet një

çështje e diskutueshme. Në qoftë se ky raport nuk aprovohet çfarë konsekuencash ka? A është konsekuenca në ndryshimin e Komisionit, a është konsekuenca në ndryshimin e bordit, a është konsekuenca në ndryshimin e ligjit? Në qoftë se ne nuk e aprovojmë këtë raport dhe mendojmë se do të ndryshojmë diçka pozitivisht në lidhje me këtë fushë, unë do të isha pro, por në qoftë se e diskutojmë sot vetëm këtë raport, unë mendoj se raporti si raport i plotëson kushtet të shqyrtohet ky fenomen i cili është vërtet shumë i preokupuar për mjedisin kosovar. Është i preokupuar edhe për pjesën ligjore, por është i preokupuar edhe për pjesën biznesore. Vërtet, disa nuk e ndien veten mirë me këtë prokurim, respektivisht me këtë ligj të prokurimit. Në qoftë se i krahasojmë prokurimet që i bëjnë agjensionet e huaja në Kosovë dhe prokurimet që i bëjnë ndërmarrjet tona publike, del se ne vuajmë prej kompleksit të çmimit që në fakt shumicën e projekteve i prish bash fenomeni i çmimit. Shkohet me çmimin më të ulët, në fakt dëmtohet kompania më serioze. Kjo ishte problemi kryesor në këtë aspekt që në fakt ligji e imponon një gjë të tillë.

Një fenomen që e ngriti edhe kolegja, zonja deputete, në fakt është çështja pas nënshkrimit të kontratës. Nuk janë saktë të identifikuar, edhe investitori në njërën anë, edhe kryerësi i punëve në anën tjetër, për ata kemi sot jo kualitet të projekteve të realizuara. Në qoftë se shkohet procesi i prokurimit deri në fund në aspektin e mbikëqyrjes, në aspektin e kualitetit, në aspektin e realizimit të kontratës, në aspektin e penaltive eventuale që mund të ndodhin nga punë kryerësi, atëherë sigurisht se nuk do të kishte edhe vërejtje të këtij niveli. Faleminderit! Ndoshta e zgjata pak.

KRYESUESI: Faleminderit! Edhe katër veta janë që do të flasin, pa i kryer këta dhe pa votuar, pushim nuk ka për drekë.
Branislav Gërbiq e ka fjalën.

BRANISLAV GRBIĆ: Zahvaljujem se predsedavajući!

Poštovane dame i gospodo poslanici,

Ja bih se nadovezao na ovaj izveštaj komisije i sigurno ne bih analizirao ovo što je napisano oko preporuke i u stvari više oko onoga što je bilo u toku ove godine i šta se dešavalo, ali ono što bih nagovestio i u ovoj temi u kojoj bih želeo da istaknem, to je da su ove preporuke za poboljšanje javne nabavke. Pazite, svi mi govorimo da je to javna nabavka jako bitna što se tiče trošenja novca, to je sigurno vrlo važno, međutim ovde jako je bitno i po meni je najbitnije da javnu nabavku bi se sveo na političku volju. U stvari to je više politički, nego tehnički stvar rešavanja javne nabavke. U kom smislu? Mi možemo da napravimo idealan zakon, mi možemo da dovedemo idealne ljude koji će obavljati tu javnu nabavku. Međutim, pitanje je političke volje koliko je u pitanju strategija javne nabavke dobra i koliko taj novac zaista želimo da utrošimo na ono što zaista želimo da postignemo. Ako dalje vidimo da ova javna nabavka ima tri segmenta koji rešavaju problem nabavke, to je politika, konkretno u nekom ministarstvu to je ministar, sekretar i šef javne nabavke. Pitanje je da li ministar i koliko ima odgovornosti u toj javnoj nabavci. To je nešto što utiče na sam razvoj tog ministarstva i na sam odnos tog ministarstva prema toj nabavci. Moguće je da bude loša nabavka koja će onemogućiti to ministarstvo da na adekvatan način sprovede politiku tog ministarstva i na adekvatan način troši sredstva tog ministarstva. Moguće je da ta nabavka bude loša i da ona bude oborena na konkursu i da taj vremenski rok koji je i onako veliki za samu nabavku bude udvostručen, da se duplira i da samim tim javna nabavka bude ostvarena možda i u trećem kvartalu godine, koji će onemogućiti da to ministarstvo ili javno preduzeće ili bilo ko na adekvatan tehnički i zadovoljavajući način ostvari svoju razvojnu strategiju. Sigurno da samim tim to sve povlači i druge mogućnosti, znači samim tim i kvalitet rada

i Vlade i svih segmenta koji su uključeni u toj javnoj nabavci. Prema tome, sigurno je da reformisanje javne nabavke jako bitno. Svest ugovornih autoriteta koji se bave javnim nabavkom takođe je bitno. Menažiranje nabavke i pogotovo kada se radi o traženju najjeftinijih ponuđača je jako štetno za nabavku. Samim tim, kada mi tražimo javnu nabavku da bude najjeftinija, to dovodi u sumnju samu nabavku jer tu se jave i razne ponude koje će na neki način onemogućiti kvalitetan rad i samim tim dovesti do situacije da se upitamo da li je taj posao zaista i bio vredan u raditi.

Možemo dalje govoriti o sistemu preporuke, da tu znači trebamo uvesti i standarde nabavke, elektronsku nabavku, koja takođe može doprineti i u svakom slučaju znači to vodi na jednu činjenicu da zaista u ovom slučaju što se tiče nabavke je jako bitno i jako treba voditi računa da postoji i politička volja koliko mi želimo da ova nabavka bude zaista autoritativna. Mi možemo čitati izveštaje svake godine, izveštaji mogu biti dobri i loši, možete ostvariti deficit i suficit, međutim ono što zaista želim da naglasim i da potenciram, to je znači da ta politička volja mora postojati, da se taj autoritet koji nabavlja zaista bude vrhunski i da odgovorne osobe, kao što su ministri i ostali budu na jednom visokom nivou koji će svojim zalaganjem i svojim preporukama zaista učiniti da ta javna nabavka bude od autoriteta. Hvala!

KRYESUESI: Ministrave duhet t' u besojmë se i dinë më së miri këto punë.
Zonja Besa Gaxherri e ka fjalën.

BESA GAXHERRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Do të mundohem të jem shumë e shkurtër për arsye se të gjithë kolegët, përkundër gjendjes reale shumë të keqe në prokurimin e Kosovës, të gjithë kolegët edhe nga opozita edhe nga mazhuranca, dhanë vlerësime natyrisht reale, çfarë e kemi prokurimin në Kosovë. Kjo është një aspekt “pozitiv”, sepse realisht procesi apo paraja publike e këtij vendi, edhe përmes këtij raporti që vërtet është i mangët, na paraqitet që vërtet keq menaxhohet dhe keqpërdoret buxheti i taksapaguesve të Kosovës.

Çka mendoj unë.....nga i gjithë ky debat pa u lëshuar në raport konkret, qoftë në shifra, qoftë në pasuse që përmenden, dhe presionet e tjera, e tjera. Çka duhet të nxjerrim ne nga ky raport, ose çka duhet të nxjerrim nga kjo gjendje që po na përsëritet vit pas viti? Në një formë, kolegu, ish- ministri, zoti Bajrami na tha që në një formë propozoi që me këtë prokurimin elektronik, do të evitohen keqpërdorimet, që pajtohemi. Por, faktikisht pajtohemi, prapë po e përsëris që të gjithë deputetët që vërtet prokurimi në Kosovë është nën çdo nivel dhe vërtet paraja e Kosovës, e buxhetit të Kosovës keqpërdoret dhe natyrisht se është instaluar korrupsioni në çdo institucion të Kosovës.

Më pëlqeu edhe propozimi i kolegut që tha çfarë vendimi ose duhet nxjerr Kuvendi ndonjë vendim? Unë realisht nuk mendoj se raporti është mjet i cili rregullon prokurimin. Nuk është. Raporti është një raport i cili paraqet gjendjen reale, varet nga këshilli se si e prezanton, e kamuflon apo nuk e kamuflon, por raporti nuk është mjet që e përmirëson gjendjen e prokurimit në Kosovë. Andaj, çka duhet të propozojmë ne, çka duhet të nxjerrim që vërtet kjo gjendje të ndryshojë? Unë për mendimin tim, duke parë edhe mos prezencën e Qeverisë sot që s'është këtu, s'është e interesuar fare as të dëgjojë deputetë as të dëgjojë raportin se çka thuhet për ta ose për ministrinë e caktuara, atëherë kisha bërë ndoshta thirrje nga këtu për prokurorinë që vërtet nuk i duhet më shumë se sa të marrë këtë raport dhe t'i dëgjojë të gjitha diskutimet e të gjithë deputetëve edhe nga pozita edhe nga opozita që të merret shumë seriozisht dhe shumë shpejt me ata të cilët vërtet shkelin ligjin, sepse nuk ka zgjidhje tjetër. Edhe në qoftë se fillojmë me prokurim elektronik,

edhe në qoftë se fillojmë me mekanizma tjerë, në qoftë se nuk fillojmë ta respektojmë ligjin dhe organet e drejtësisë dhe hetuesisë dhe nuk merren me persona të cilët bëjnë këto shkelje, kjo gjendje edhe vitin e ardhshëm, kolegë të nderuar, të njëjtin raport do ta lexojmë dhe të njëjtin raport ose do ta përkrahim ose do të themi se nuk vlen apo vlen. Andaj unë nuk do ta zgjas më shumë, përveç se vërtet ne si organi më i lartë i këtij vendi, mua ndonjëherë po më vjen shumë keq kur ne po diskutojmë, thotë populli po e shkruajmë në akull e po e kthejmë prej diellit. Ky është një raport... një fushë shumë e ndjeshme, shumë e rëndësishme për Kosovën dhe ne diskutojmë dy-tri orë dhe nuk mund të nxjerrim asnjë përfundim për t'i ndihmuar tek fundi i fundit edhe vetë organit po edhe vetë për buxhetin, domethënë, ne veç e kemi bërë praktikë të diskutojmë dhe t'i kalojmë çështjet kështu. Faleminderit, për vëmendjen!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja deputete Qamile Morina.

QAMILE MORINA: Faleminderit, zoti kryesues!

Ministra, deputetë të nderuar,

Sot mjaft u theksua se prokurimi publik ka qenë një nga fushat më të kritikuara të Raportit të progresit 2009. Ky raport kishte konkluduar se gjendja e prokurimit publik është përkeqësuar. Ligji ekzistues nuk përputhet me standardet evropiane të prokurimit publik. Evidente është mungesa e mbikëqyrjes së kontratave dhe monitorimi i implementimit të tyre. Çështja ende problematike që po mbetet është tenderimi njëburimor që për vitin 2009 kap vlerën prej 87 milionë eurove. Ne sot duhet t'kuptojmë qartë që përmes këtij raporti pasqyrohet gjendja në prokurimin publik në vendin tonë. Duhet theksuar se vlera e kontratave të nënshkruara nga autoriteti kontraktues nëpërmes prokurimeve publike gjatë vitit 2009 është 778 milionë euro dhe sipas raportit mbi 50% të kësaj vlere të kontraktuar i takon 3 ministrive kryesore dhe atë Korporata Energjetike e Kosovës, udhëheq me 22% të kontratave publike në vlerë të 171 milionë eurove, pastaj merr pjesë Ministria e Transportit dhe Postë- Telekomit me 20% të kontratave ose 150 milionë euro, Ministria e Arsimit, merr pjesë me 8.6% të kontratave në vlerë rreth 670 milionë eurove. Kontraktuesi tjetër më i lartë është Posta dhe Telekomit i Kosovës me rreth 4% të prokurimeve me vlerë prej 31 milionë eurove. Nëse vendit tonë i shkojnë kaq shumë milionë në prokurim publik e që janë paratë nga taksat e qytetarëve, atëherë shtrohet pyetja se a e ka përmirësuar ky prokurim publik në të vërtetë jetën e qytetarëve kur e dimë se ata ende ballafaqohen me vështirësi thuaja se në të gjitha fushat e jetës? Gjithashtu vlen të përmendet që sipas këtij raporti vlera e kontratave të nënshkruara për vitin 2009 për Qendrën Klinike Universitare të Prishtinës është afër 6.5 milionë euro, që krahasuar me vitin 2008 është 357% më e lartë dhe se në çfarë gjendje është kjo qendër më së miri e dinë pacientët, qytetarët tanë dhe personeli mjekësor. Hiq më larg, deputetë të nderuar, mbrëmë në media kemi pasur mundësinë të shihni si projekti i Institutit të Onkologjisë, me aparaturë shumë të sofistikuar diagnostik, për të cilën janë investuar me miliona euro të qytetarëve tanë, janë në rrezik të dëmtimit nga uji. Ky është një shembull tipik si ka munguar mbikëqyrja e kontratave dhe monitorimit të implementimit të tyre që me vite është në sektorin e shëndetësisë. Situata në këtë institut kërkon nga autoritetet përgjegjëse veprime tejet urgjente për ta mbrojtur këtë aparaturë, si dhe futjen e saj në funksionin e qytetarëve tanë që të mos të bredhin dhe të shpenzojnë jashtë vendit. Fatkeqësisht, tenderët janë shndërruar në burimin më fitimprurës në Kosovë, bile edhe Agjencia Kosovare Kundër Korrupsionit ka bërë të ditur se në fushën e prokurimit po bëhen abuzime të ndryshme financiare. Përqindjet për dhënien e tenderëve tashmë janë shndërruar në sekret publik. Për të fituar tender nga institucionet paraprakisht duhet dhënë përqindjen e caktuar me ç'rast abuzohen miliona euro të taksapaguesve të Kosovës. Në Kosovë po krijohet një kategori e veçantë e tregtarëve, ata që shesin

tenderët. Ndoshta tingëllon si prejudikim, por është fakt i pamohueshëm dhe ndonëse ka shumëçka të dyshimtë, mirëpo është më e qartë se në këtë terren ende nuk ka pasur guxim të qaset hetuesia dhe ajo që është më brengosëse është se korrupsioni dita-ditës më shumë po konsiderohet si dukuri normale në vendin tonë. Mungesa e vullnetit të vërtetë nga kompetentët për ta luftuar këtë dukuri e ka vështirësuar tej mase jetën e qytetarit të rëndomtë.

Së fundi, duke pasur parasysh se Kosova është në procesin e integritimeve evropiane, reformimi i kësaj sfere duhet të jetë prioritet dhe i domosdoshëm, si dhe ndryshimet në Ligjin për prokurimin publik duhet të krijojë një sistem efikas dhe transparent të prokurimit publik në vendin tonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Diskutuesi i fundit është deputeti Gani Koci.

GANI KOCI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Fillimisht dua të them që ne kemi një raport të një autoriteti, një institucioni që është i themeluar mbi bazë të Ligjit të prokurimit publik dhe për të mbikëqyrë dhe për të implementuar prokurimin publik dhe Ligjin e prokurimit publik janë 3 mekanizma: është autoriteti i prokurimit publik, organi rregullativ i prokurimit publik dhe është organi shqyrtues i prokurimit publik.

Ne sot po shqyrtojmë raportin e njërit nga këta mekanizma ose këta instrumente që janë përgjegjës dhe bartës për implementimin dhe mbikëqyrjen e prokurimit ose ambientit të prokurimit publik në Kosovë. Nuk po shqyrtojmë raportin e performancës së prokurimit publik në Kosovë. Po shqyrtojmë vetëm si të them atë anën statistikore, siç e tha edhe profesori atje dhe kemi vetëm se sa kontrata janë të nënshkruara në Kosovë në vitin 2009 nga paraja publike dhe natyra e atyre kontratave, bile i kemi edhe disa shpjegime në këtë raport se ky raport është përbërë mbi bazë të raporteve që i çojnë autoritetet kontraktuese dhe jep një shpjegim se janë nja 3 ose 4 autoritete kontraktuese që nuk e kanë përmbushur obligimin e tyre ligjor që të përfshihen në këtë raport dhe s'kanë pasur çka të thonë.

Nëse e mbani mend, vitin e kaluar kur e kemi shqyrtuar po të njëjtin raport, por për një vit tjetër, ka qenë rekomandim edhe i Komisionit, rekomandim edhe i vetë këtij autoriteti, të Organit rregullativ të prokurimit publik, se Ligji i prokurimit publik ka nevojë të ndryshohet dhe ligji i prokurimit, procedurat për ndryshimin e ligjit për ndryshimin e prokurimit publik kanë filluar dhe janë duke u bërë natyrisht me institucionet tjera të Qeveria me ndihmën e të tjerëve që kanë përvojë dhe kanë ekspertizë në këtë çështje. Unë dola këtu për të treguar një element që nuk di ndoshta para diskutuesit është folur. Ne kemi defekte në Ligjin e prokurimit publik, në këtë foltore dhe në këtë vend është kërkuar edhe nga Komisioni për Buxhet dhe Financa që duhet në kuadër të ligjit të prokurimit publik të jetë një pjesë e veçantë, kapitull i veçantë për prokurimin publik në ndërmarrjet publike, sepse ky ligj ekzistues dhe këto rregulla të ligjit të prokurimit publik të tanishme vë në pozitë të pabarabartë sektorin publik me sektorin privat për sa i përket konkurrencës dhe aktiviteteve të tyre ekonomike. Kjo është çështja e parë dhe çështja e dytë, e dini kohëve të fundit kemi pasur probleme me prokurimin për përfaqësitë tona diplomatike dhe është dashur për shpejt të fusim disa amendamente që t'i japim një hapësirë më të madhe për shkak të aktivizimit të përfaqësive tona atje dhe me të nuk kemi bërë zgjedhje, prandaj, nuk di, ndoshta është kërkuar, por po e përsëris dhe nuk është e tepërt. Nëse duhet të insistojmë në atë, duhet të insistojmë të ndryshohet Ligji i

prokurimit publik dhe të na vijë këtu me këto dy elemente: elementin e prokurimit publik të ndërmarrjeve publike dhe prokurimit publik për sa i përket përfaqësive tona diplomatike. Nga ky raport dhe nga ky organ, nëse e lexoni mirë rregullën 81 të Ligjit të prokurimit publik, këtu nuk mund të vijë në përfundim se a ka qenë prokurim i rregullt, a ka qenë i parregullt, a ka pasur abuzime a s'ka pasur abuzime? Vetëm kur të shqyrtojmë raportet e audituara financiare të Zyrës së revizorit gjeneral për agjencionet buxhetore vetëm atëherë mund të vijmë në përfundim se vërtet në një aktivitet të prokurimit ka pasur shkelje ose nuk ka pasur shkelje. Ky raport nuk na jep dhe s'duhet të na jap se a ka pasur shkelje a s'ka pasur shkelje. Pas kësaj çështje do të shqyrtojmë tash raportin e organit shqyrtues të prokurimit publik, që merret po ashtu me aktivitetet e prokurimit publik mbi bazë të rregullave dhe dispozitave dhe të përgjegjësisë që i jep ligji. As aty nuk mund të shohim se a ka pasur aktivitet të rregullt, jo të rregullt të prokurimit publik, absolutisht, ne të kërkojmë nëse dyshojmë në çfarëdo aktiviteti të prokurimit publik, edhe unë dyshoj siç dyshoni edhe ju atëherë të kërkojmë një çast, të kërkojmë që të aktivizohen mekanizmat tjerë, siç është Zyra e revizorit gjeneral dhe për çështjen e caktuar si e përmendi kolegja atje te klinika le të fillojë procesi, le të fillojë procesi i hetimit dhe të shohim vërtet a ka qenë në rregull a s'ka qenë në rregull? Komisioni për Buxhet dhe Financa nuk ka dashur ta ripërtërijë rekomandimin e vet të viti të kaluar. E keni në raport, në fund të organit rregullativ të prokurimit publik se ligji duhet të ndryshohet. Kuvendi nuk ka kapacitete që të fillojë vetë ta ndryshojë atë ligj, prandaj vendim ose sugjerim imi është që ky Kuvend të kërkojë që urgjentisht Ligji i prokurimit publik të ndryshohet.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Koci! Tashi kanë përfunduar të gjitha diskutimet, nga ajo që dëgjuam gjatë gjithë kësaj kohe dolën rekomandimi themelor që duhet të ndryshohet Ligji i prokurimit publik me dy nënvizime në dy fusha rreth ndërmarrjeve publike dhe prokurimeve përtej Kosovës, pra në përfaqësitë diplomatike. Unë kolegë deputetë do ta hedh në votim këtë raport dhe me të gjitha rekomandimet... bëhuni gati, regjia të votojmë dhe votojmë tash.

Kemi 67 deputetë të pranishëm. Për raportin votojnë 52, 9 abstenojnë dhe 2 votojnë "kundër". Kuvendi aprovoi Raportin e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2009.

Vazhdojmë punën në orën 15:00.

Vazhdimi seancës pas pauze

KRYESUESI SABRI HAMITI: Ju lutem, i zini vendet tuaja!
Pika e trembëdhjetë e rendit të ditës është:

13. Shqyrtimi i Raportit të Organit Shqyrtues të Prokurimit, për vitin 2009

Komisioni funksional për Buxhet dhe Financa, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Punës, ka shqyrtuar Raportin e Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2009 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Fjalën e ka kryetari i Komisionit funksional Gani Koci, apo raportuesi i Komisionit, përkatësisht i rekomandimit.

GANI KOCI: Faleminderit, zoti kryesues i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Buxhet e Financa ka shqyrtuar Raportin e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik dhe rekomandimet i keni para veti siç i keni para veti edhe vetë raportin e këtij institucioni. Është nga ato institucionet që folëm edhe në pikën tjetër që monitoron dhe ka për detyrë implementimin e Ligjit të prokurimit publik për sa i përket çështjeve të ankimimit të operatorëve ekonomik dhe autoriteteve kontraktuese lidhur me proceset ose me rastet e prokurimit. Ju raportin e keni përpara, nuk do të ndalem shumë në të. Është një organ që merret me shqyrtimin e ankesave mbi bazë të ankesave që shtrohen para këtij organi dhe natyrisht vendimet përfundimtare të këtij organi janë të plotfuqishme dhe të detyrueshme për zbatuesit, por ka edhe një mundësi që në rast se vendimet e këtij organi janë të kontestueshme atëherë palët kanë të drejtë për ankimim deri në gjykatë dhe ky raport na paraqet vetëm rastet, të gjitha rastet e ankesave pa dashur të hyjë në atë, ka pasur diku 542 ankesa nga operatorët ekonomik dhe autoritetet kontraktuese. Pretendimet e palëve ankimore kanë qenë kryesisht me shkelje të Ligjit mbi prokurimin publik prej 542 ankesave, 457 janë ankesa të parashtruara nga operatorët ekonomik dhe 85 ankesa janë nga autoritetet kontraktuese kundër vendimeve të Agjencionit të Prokurimit Publik. Prej ankesave të pranura OSHP-ja i ka aprovuar 219 ankesa mbi bazë të vendimeve të autoriteteve kontraktuese, 73 raste i ka kthyer në rivlerësim, 55 raste e ka anuluar aktivitetin e prokurimit, 96 ankesa janë hedhur poshtë për shkak të moskompletimit të ankesave, dokumenteve për ankesa dhe 14 ankesa janë tërhequr nga operatorët ekonomik, pas ushtrimit.

Ky është po ashtu një raport të them statistikor lidhur me vendimet për këto ankesa dhe buxheti i këtij agjencioni, tash pjesa buxhetore e këtij agjencioni është realizuar diku vetëm 65% dhe OSHP-ja ka sugjeruar që për vitin 2010, Komisioni në të vërtetë i ka sugjeruar OSHP-ës që për vitin 2010 në ekzekutimin e buxhetit të vet të jetë në nivelin e asaj që ka projektuar ose të projektojë më pak buxhet.

Në komision është diskutuar gjatë rreth këtij raporti. Sigurisht edhe anëtarët e Kuvendit po edhe anëtarët e Komisionit i kanë procesverbalet në të gjitha pyetjet që janë shtruar raportuesve para këtij komisioni dhe a ka vendosur drejt dhe në mënyrën e duhur dhe në përputhje me ligjin ky organ lidhur me ankesat, janë organet tjera që mund të vendosin eventualisht nëse ka pretendime ankimore, është gjykata kompetente dhe është auditori i përgjithshëm dhe vetëm në rastin e një auditimi të këtij agjencioni ose këtij subjekti nga auditori i përgjithshëm ne mund të vijmë te konkluzionet lidhur me vendimet e drejta ose të padrejta të kësaj njësie ose këtij agjencioni buxhetor.

KRYESUESI: Faleminderit! Kalojmë te deklaratimet e përfaqësuesve të grupeve parlamentare.

Për PDK-në Safete Hadërgjonaj, besoj!

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar raportin e organit shqyrtues të Prokurimit publik dhe është i mendimit se raporti është sjell me kohë dhe i përfshin të gjitha çështjet të cilat janë të parapara që të paraqiten para Kuvendit me Ligjin e prokurimit publik.

Organi shqyrtues i prokurimit publik ka luajtur rolin e vet që është paraparë me Ligjin e prokurimit publik për rritjen e transparencës dhe përgjegjshmërisë për administrimin e

fondeve publike dhe njëkohësisht ka krijuar kushte për një konkurim të drejtë dhe të paanshëm të gjithë operatorëve ekonomik.

Në raport vërejmë se një punë të mirë që ka bërë organi shqyrtues i prokurimit është krijimi i marrëdhënieve të mira me publikun, në informimin dhe ndërgjegjësimin e publikut dhe operatorëve ekonomik, për funksionimin dhe për shërbimet që ofron ky organ shqyrtues. Shqyrtimi i ankesave ka rritur interesin e operatorëve ekonomik për të paraqitur ankesa kur ata dyshojnë në shkeljen e të drejtave të tyre të cilat janë të parapara me Ligjin e prokurimit publik. Njëkohësisht është rritur edhe besueshmëria ndaj organit shqyrtues të prokurimit në mbrojtjen e interesave të operatorëve ekonomik, për çka janë bërë edhe 542 ankesa ku organi shqyrtues i prokurimit publik i ka shqyrtuar 347 ankesa, të cilat kanë ardhur nga operatorët ekonomik, por njëkohësisht ka shqyrtuar edhe 85 ankesa të cilat kanë ardhur nga autoritetet kontraktuese, ankesa këto të cilat janë bërë kundër vendimeve të Agjencionit të Prokurimit Publik.

Nga të gjitha ankesat e shqyrtuara për 8 vendime të marrura nga organi shqyrtues i prokurimit publik janë bërë padi në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës, nga ana e operatorëve ekonomik meqenëse vendimet e organit shqyrtues janë të plotfuqishme dhe ankesat mund të bëhen vetëm në Gjykatën Supreme.

Në faqen 15 vërehet se gjatë procedurave të shqyrtimit organi shqyrtues i prokurimit publik ka bërë verifikimin e të gjitha dokumenteve të tenderimit, nuk kanë marrë parasysh vetëm pretendimet e ankuesit, por kanë shqyrtuar tërë aktivitetin e prokurimit si autorizimin e autoritetit të prokurimit, njoftimin për kontratë, vendimin mbi themelimin e Komisionit të vlerësimit të ofertave, procesverbalit mbi hapjen e ofertave, raportin e vlerësimit të ofertave dhe në fund njoftimin mbi dhënien e kontratës si dhe çështjet tjera të cilat kanë të bëjnë me procedurat e marrjes së tenderit.

Në raport është theksuar se ka pasur autoritete kontraktuese që nuk kanë respektuar vendimet të Organit shqyrtues të prokurimit. Këto vendime janë vendime përfundimtare dhe ministritë dhe të gjitha komunat duhet që t'i respektojnë këto vendime të cilat janë marrë nga organi shqyrtues i prokurimit publik dhe mbetet shumë për t'u bërë në këtë drejtim që në të ardhmen mos të kemi raste kur autoritetet kontraktuese nuk i respektojnë vendimet të organit shqyrtues të prokurimit publik.

Është dashur që në raport po ashtu të theksohet se ku ka pasur shkelje të ligjit të prokurimit publik dhe në cilat nene apo cilat nene të ligjit nuk janë respektuar dhe të theksohet se çfarë masash janë ndërmarrë ndaj atyre të cilët nuk kanë respektuar ligjin.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e përkrah raportin e organit shqyrtues të prokurimit publik dhe rekomandimet e Komisionit për Buxhet e Financa.

KRYESUESI: Faleminderit! Për LDK-n flet deputeti Naser Osmani.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryesues!

Kemi të bëjmë me një raport, i cili është i ndërlidhur me raportin paraprak. Për dallim nga raporti i mëhershëm kjo nuk krijon mundësi, nuk jep shumë mundësi për ta diskutuar, por jep mundësi më të mëdha për t'i hulumtuar rastet të cilat janë paraqitur si ankesa. Ky organ si kriter apo si kompetencë ka të bëjë kryesisht në rend të parë shqyrtimin e procedurave administrative në prokurimin publik dhe dhënien me koncesion, mirëpo nuk kem asnjë rast të specifikuar për të cilat raste të koncesioneve apo

raporteve, marrëdhënieve publiko-private bëhet fjalë, nëse është diku e shkruar bile nuk duket në tekstin e raportit për arsye se është e pamundur që të lexohet. Edhe kompetenca tjetër që ka të bëjë, domethënë, me hetimin e veprimeve nga mosveprimet e kundërligjshme ose të parregullta të autoriteteve kontraktuese.

Nga gjithsej 14.320 kontrata të cilat janë trajtuar, 542 kanë qenë ankesa të cilat normalisht janë ankuar në lidhje me vendimet e operatorëve ekonomik ose të organeve kontraktuese. Nga këto 457 janë paraqitur si të rregullta faktikisht, ndërsa 219 janë aprovuar plus.

Ajo çka është që mund të shkoçitet është se të gjitha ankesat të cilat i janë bërë këtij organi që kur e kemi aprovuar Ligjin e prokurimit, kur e kemi shkoçitur këtë institucion nga organi KRPP-ja kemi menduar që një përbërje prej 5 anëtarëve në nivelin e gjykatësve do të jetë shumë më efikas dhe do të trajtojë çështje të ankesave në mënyrë shumë më profesionale, ne kemi një raport të BE-së i cili kritikon pikërisht udhëheqjen apo menaxhimin e personave të caktuar. Atë që po dua ta potencoj që prej krejt këtyre rasteve vetëm 8 raste kanë vazhduar procedurën në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës, të cilat nuk kanë qenë të kënaqura me vendimin e organit rregullativ, organit shqyrtues, prokurimit. Mirëpo, nuk e kemi në raport se cilat janë ato raste dhe çfarë vlere të shumave kemi të bëjë me këto 8 raste të cilat kanë kaluar në instancën e fundit të trajtimit. Nuk ka analizë detaje, nuk ka analizë detaje me të cilën ne kishim mund për ta trajtua në mënyrë më të thuktë dhe më të mirë këtë raport, mirëpo në përfundim të krejt kësaj unë pajtohem me kryetarin e Komisionit funksional për Buxhet e Financa që raporti edhe si i tillë duhet të shkojë, duhet të aprovohet dhe në emër të Grupit të LDK-së propozoj që raporti në fund të aprovohet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Osmani! Për Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës, unë besoj, e ka fjalën deputeti Haki Shatri.

HAKI SHATRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Më lejoni në fillim të them që edhe lidhur me këtë raport në Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike është përsëritur e njëjta skenë sikurse për raportin e Komisionit Rregullativ. Megjithatë, raporti i organit shqyrtues të prokurimit për vitin 2009 pasqyron aspekte përshkruese të punës së këtij organi, por fillimisht duhet të theksoj se këtij raporti i mungon aspekti i analizës përmbajtësore të shqyrtimit të ankesave të operatorëve ekonomik apo autoriteteve kontraktuese. Duke marrë parasysh klimën e krijuar në lëmin e prokurimit e konsiderojmë që parashtruesit e 457 ankesave kanë treguar guxim qytetar kur mirret parasysh se çfarë rreziku i ekspozohen këta ankues për të mos marrë më punë në të ardhmen në rast se marrin guxim dhe ankohen në ndonjë vendim. Dhe krejt tjetër çështje është se cilës rrugë duhet të kalojnë këta të shkretë të ankuar për t'iu realizuar ankesa e tyre në bazë të ligjit. Nuk kemi po ashtu përgjigje në këtë raport, cilat vendime të organit shqyrtues të prokurimit janë përfillur nga autoritetet kontraktuese dhe çka është ndërmarrë ndaj atyre të cilët kanë vepruar në kundërshtim me ligjin e sidomos atyre që nuk i kanë respektuar urdhëresat e organit shqyrtues? Pse organi shqyrtues i prokurimit në raport nuk prezanton edhe pengesat në sistemin e prokurimit, pengesat objektive, siç është fjala për shembull urdhëresa administrative 2008/1 e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave dhe nevojën e ndryshimit të ligjit për prokurimin publik”, por në vend të kësaj ata parashtrojnë kërkesa për rritjen e mjeteve buxhetore. Do të ishte e dëshirueshme të kemi një pasqyrë të operatorëve ekonomik të cilët arrijnë të lidhin kontratë me autoritetin kontraktues të cilët operatorë kurrë nuk i përmbushin obligimet kontraktuese dhe prapë në tenderat e ri arrijnë që të lidhin kontratë për punë të reja. Na duket që me qëllim në

këtë raport disa pjesë përmbajtjesore janë shmangur, por megjithatë raporti mendoj se duhet të mbështetet, sepse raporti nuk ka faj për atë çka ndodh në realitet në sferën e prokurimit publik. Faleminderit!

KRYESUESI: Raporti, s'ka faj, fantastike. E ka fjalën Suzan Novobrdaliu për Aleancën Kosova e Re.

SUZAN NOVOBRDALIU: Faleminderit, zoti kryesues!

Përshëndetje për të gjithë!

Grupi Parlamentar i AKR-së e ka shqyrtuar raportin e organit shqyrtues të prokurimit. Në këtë raport përshkruhet puna e këtij organi, do të thotë, tregon se në këtë organ janë pranuar 542 ankesa, 457 ankesa janë të parashtruara nga operatorët ekonomik kundër vendimeve të autoriteteve kontraktuese për dhënien e kontratës, ndërsa 85 ankesa janë të autoriteteve kontraktuese për shqyrtimin e vendimit të APP-ës. Prej gjithsej 457 ankesave të pranura në shqyrtim nga organi shqyrtues i prokurimit janë trajtuar 347 ankesa të parashtruara nga operatorët ekonomik të cilat i kanë plotësuar kushtet ligjore për shqyrtim.

Në panelin shqyrtues, nga 219 ankesa të shqyrtuara ka aprovuar vendimin e autoriteteve kontraktuese si të bazuara duke konstatuar se pretendimet e palëve nuk përmbajnë bazë ligjore. Në 73 raste paneli shqyrtues ka marrë fëdëm për rivlerësimin e ofertave duke hasur në shkelje të caktuara të LPP-ës gjatë procedurës së vlerësimit të ofertave ndërsa në 55 raste paneli shqyrtues ka marrë vendim për anulimin e aktiviteteve të prokurimit ritender. 96 ankesa janë hedhur poshtë për shkak të moskompletimit të ankesës brenda afatit ligjor në pajtim me nenet e caktuara të LPP-ës. Gjithashtu e kemi një tabelë me të dhënat e autoriteteve kontraktuese, pastaj në faqen 21 shprehet, do të thotë thuhet në përqindje se 61% ka më shumë numër të ankesave të parashtruara në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008 çka kuptohet se është rritur besueshmëria në këtë organ shqyrtues. Mendoj se ky ishte një si mangësi e këtij raporti janë disa pjesë siç theksuan edhe parafolësit e mi, mungesa e pjesëve përmbajtjesore të disa pjesëve kyçe përmbajtjesore të këtij raporti, gjithashtu mendoj se shkeljet të cilat janë cekur të ligjit të prokurimit publik duhet të tregojmë se në cilat shkelje konkrete si dhe masat të cilat i kanë ndërmarrë për këto shkelje dhe ishte dashur të jetë pak më i detajizuar, sepse nuk ka një analizë detale, mirëpo ne do ta përkrahim si grup parlamentar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Për Lidhjen Demokratike të Dardanisë Naser Rugova.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Po e shqyrtojmë raportin vjetor të organit shqyrtues të prokurimit për vitin 2009 si organ i pavarur i zgjedhur nga ky Kuvend ai na jep epërsinë për t'i kushtuar vëmendje çështjeve të ankesave të prokurimit publik, do të thotë të operatorëve të natyrave të caktuara ekonomike dhe dhënies me koncesion sepse ky organ i pavarur bazë ligjore ka edhe Ligjin për prokurimin publik, por edhe Ligjin mbi partneritetin publiko-privat dhe koncesionet dhe është një mekanizëm jashtëzakonisht i rëndësishëm për mbikëqyrjen e këtyre proceseve të rëndësishme, si dhe ka për obligim paanshmërinë transparencën dhe dhënien e vendimeve me procedura të shqyrtimit të ankesave të mundshme. Edhe ky raport, si edhe raporti që e shqyrtoam më herët nuk i ka objektivat e qarta, nuk përmban në vete substancë konkrete dhe nuk jep rekomandime dhe orientime Kuvendit se si duhet përmirësuar këto shkelje flagrante që i evidenton vetë ky raport me statistikat e veta.

Gjatë vitit 2009 ky organ ka shqyrtuar gjithsej 542 ankesa nga operatorët ekonomik dhe autoritetet kontraktuese, që nënkupton që 542 ankesa, pjesa dërrmuese e të cilave janë diku të parashtruara nga operatorët ekonomik apo mbi 80% gjithsej 457 ankesa që nënkupton për dyshime serioze për shkelje të legjislacionit që e ka si bazë ligjore ky organ dhe lë dilema të mëdha pse ky organ thjesht nuk jep referencat e veta se cilat hapa i ka ndërmarrë në veçanti ndaj autoriteteve kontraktuese që kanë bërë shkelje dhe kanë shkelur dispozitat e Ligjit për prokurimin publik dhe dispozitat e legjislacionit tjetër që i ka si bazë ligjore.

Prej gjithsej 457 ankesave të pranuar, ky organ shqyrtues i pavarur ka trajtuar 347 ankesa të parashtruara nga operatorët ekonomik. Dhe statistikat flasin për dekurajim të operatorëve ekonomik dhe të komunitetit të biznesit që thjesht të konkurrojnë në procedura të hapura të tenderimit që shpallen nga institucionet e Republikës së Kosovës dhe nga ndërmarrjet publike. Në 73 raste paneli shqyrtues ka marrë vendim për rivlerësimin e ofertave duke hasur në shkelje të caktuara të Ligjit për prokurimin publik gjatë procedurës së vlerësimit të ofertave, ashtu siç thamë dhe në raportin për KRPP-n edhe këtu hasen shkelje flagrante të legjislacionit që kanë për obligim, në këtë rast autoritetet kontraktuese apo thënë më shqip organizatat buxhetore që financohen nga buxheti i taksapaguesve të Kosovës.

Paneli shqyrtues ka marrë vendim për anulimin e aktivitetit të prokurimit, po e citoj raportin, apo ritenderimin, atëherë kur autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të procedurave të prokurimit gjatë zhvillimit të aktivitetit të prokurimit. Por, çka ka ndodhur në ato raste kur janë bërë shkelje dhe operatorët ekonomik të lodhur nga presionet dhe neglizhenca e institucioneve gjegjëse, nuk janë ankuar fare dhe këtu do të duhej të ishte paanësia dhe transparencja dhe angazhimi i këtij mekanizmi të rëndësishëm që është zgjedhur nga ky Kuvend dhe i jep llogari këtij Kuvendi. Shkeljet ligjore, po e citoj raportin dhe parregullsitë e përsëritura nga autoritetet kontraktuese janë gjetur veçanërisht në disa aspekte të rëndësishme të zhvillimit të procedurave të prokurimit publik. Paneli shqyrtues në shumicën e rasteve ka hasur në parregullsi gjatë procesit të vlerësimit të ofertave dhe në marrjen e vendimeve të gabuara për shpalljen e fituesit. Vetëm ky tog fjalësh nënkupton që janë dhënë kontrata ofertuesve të caktuar apo operatorëve të caktuar ekonomik me presione, me lidhje politike, me nepotizma dhe këto gjëra ky organ është dashur t'i fusë në raport që vërtet të kemi paanësi, transparencë dhe që Kuvendi ta thotë fjalën e vet sepse te e fundit e ka zgjedhur këtë organ që t'i monitorojë, zbatojë dhe në njëfarë forme ta mbikëqyrë zbatimin e këtyre tri-katër ligjeve bazike që janë jashtëzakonisht të rëndësishme.

Në grafikun numër 2, përqindja e vendimeve të paneleve shqyrtuese ku kemi të bëjë me aprovimin e rreth 48% të kontratave nga autoritetet kontraktuese dhe po ta shikojmë trafikunin tjetër në anën e majtë del se 52%, do të thotë, autoritetet kontraktuese nuk e kanë respektuar ligjin për prokurimin publik dhe procedurat ligjore të prokurimit dhe në njëfarë forme në këtë balans shihet një shkelje flagrante, mosrespektim i ligjit dhe të gjitha ato. Ky grafikon tregon se do të thotë vetëm në 48% të rasteve dhe kjo është thjesht teori e probabilitetit, sepse ne ende nuk i dimë rrethanat se a janë vlerësuar drejt kontratat e këtyre autoritete kontraktuese, do të thotë, vetëm në 48% të rasteve autoritetet kontraktuese kanë respektuar Ligjin e prokurimit publik. Kjo do të thotë se këto janë shkelje shumë serioze. 68 kërkesa kanë të bëjnë me lejimin e përdorimit të procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë. Dhe kjo është ajo thembra e Akilit që po e dëmton më thjesht po e zhvatë buxhetin e Kosovës, po i pengon ardhjen e ofertuesve ekonomik ndërkombëtarë që t'i kryejnë punët si duhet, sepse një nga vërejtjet e zeza të

Raportit të fundit të progresit të Komisionit evropian është edhe cilësia e mbi 660 milionë mjeteve të buxhetit të Kosovës që janë investuar në procedura tenderuese dhe në investime kapitale. Kjo statistikë tani dhe statistikën e tjera tregojnë se logjika e jo transparencës, kontratave njëburimore dhe shkeljes së Ligjit të prokurimit publik po vazhdon. Dhe, ky raport është dashur të dalë me rekomandimet e veta, me orientimet e caktuara, me adresime të caktuara konform bazës ligjore mbi të cilën vepron se si do duhej të sillej Kuvendi dhe çfarë masash ka marrë ndaj autoritete kontraktuese, gjegjësisht organizatave buxhetore që e kanë shkelur ligjin dhe herën tjetër, të gjitha këto organe që janë zgjedhur nga Kuvendi, mos të mendojnë se janë duke dërguar raporte në organizata joqeveritare apo në klasë të maturantëve, por janë duke sjell raporte vjetore që e monitorojnë buxhetin e taksapaguesve të varfër të Kosovës dhe janë duke i dërguar raporte Parlamentit të Republikës së Kosovës, vullnetit të qytetarëve të Kosovës. Dhe, vërtet ky do të duhej të ishte një alarm për këta mekanizma të pavarur që të respektojnë vetveten, ligjin dhe organin kompetent që i ka zgjedhur dhe iu ndanë buxhet te e fundit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Për Grupin 7+ nuk ka paraqitje. SLS-ja, nuk ka. Nga Grupi për Integrim, deputetja Vezira Emrush e merr fjalën.

VEZIRA EMRUŠ: Hvala lepa na datu reč!

Ponovo imamo pred sobom razmatranje izveštaja tela za razmatranje nabavki i isto kao i prethodno telo koje smo razmatrali za javnu nabavku, ima isti cilj, ista sredstva, međutim ovo telo postoji zbog, da kažem, one prve komisije. Ovde smo u izveštaju čuli i da ne bi ponavljala sve što su prethodne kolege rekle, ali ja hoću da obratim pažnju zajedno sa svojim kolegama na jednu stvar, to je na strani 25, gde se kaže koje su, kada su izrečene naredbe prema agencijama ugovorenih autoriteta, gde smo dosta diskutovali da se krši Zakon o javnoj nabavci kada su u pitanju tenderi i tenderisanje, davanje u koncesiju kod ekonomskih operatora, međutim ovo što je jako žalosno za sve nas ovde, jedno telo danas pred nama daje do znanja da kada je u stanju da je povreda ekonomskog operatora ili povreda ugovora kod javne nabavke ili koncensije, šta može ovo telo da preduzme. Kaže ovako: „Telo za razmatranje nabavki, nakon razmatranja žalbi, izrečena naredba tela je konačna“. Međutim, neki ugovoreni autoriteti odugovlačili su proceduru javnih nabavki ili nisu ispoštovali odluku za ponovnu procenu ponuda, a u nekim slučajevima dolazi i do poništenja aktivnosti nabavke. I....

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete!
Abdyl Ymeri e ka fjalën!

ABDYL YMERI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Organi shqyrtues i prokurimit publik, si organ i pavarur, ka një mision të veçantë në shqyrtimin e të gjitha ankesave të parashtruara nga operatorët ekonomik të cilët i paraqesin me rastin e shkeljeve nga autoritetet kontraktuese.

Përpos kësaj ky organ duhet që në vazhdimësi t'i përmbushë obligimet, detyrat dhe parimet që dalin nga ligjet në fuqi, me qëllim të rritjes së transparencës, konkurrimit të drejtë, paanshmërisë dhe të ngritjes së nivelit më të lartë të përgjegjshmërisë për administrimin më të mirë të fondeve publike.

Nëse lexohet me shumë kujdes ky raport shihet se janë pranuar 542 ankesa, ndërsa 457 ankesa të parashtruara nga operatorët ekonomikë të cilët kanë pretenduar se autoritetet

kontraktuese kanë marrë vendime jo të drejta. 73 vendime për rivlerësim dhe 55 vendime për ritenderim apo 28% nga vendimet e tërësishme, konsideroj se nga 128 vendime të marra në favor të operatorëve ekonomik, tregon se në një masë jo të vogël ka pasur shkelje të Ligjit të prokurimit publik dhe në raport nuk shihet se cilat masa janë marrë.

Po qe se shihet tabela me të dhënat e autoriteteve kontraktuese, shihet se OSHP ka pranuar një numër jo të vogël të ankesave nga operatorët ekonomik, prandaj disa prej autoriteteve kontraktuese duhet ta përmirësojnë performancën e tyre. Këto shifra i përmenda qëllimisht, sepse operatorët ekonomikë që nga themelimi i këtij organi kanë ku të drejtohen, në rast se pretendojnë se iu janë shkelur të drejtat e tyre. Këto shifra tregojnë edhe për një rritje të besueshmërisë së operatorëve ekonomik ndaj këtij institucioni. Faleminderit!

KRYESUESI: Edhe ty faleminderit! Fjalën e merr deputetja Kaqusha Jashari!

KAQUSHA JASHARI: Faleminderit!

I nderuar kryesues,

I nderuar ministër Demolli, të nderura kolegë,

Në seancën para dite kemi pas raportin e Komisionit Rregullativ të Prokurimit, tash kemi të organit shqyrtues të prokurimit dhe pas kësaj pike e kemi edhe raportin e Agjencisë Kundër Korrupsionit. Raportojnë tri organe të pavarura me përgjegjësi të ndara, veprojnë në bazë të ligjeve të ndara dhe të tri organet janë të obliguara t'i japin raportin këtij Kuvendi se jemi themelues të tyre. Me siguri nuk është edhe rastësisht që janë këto tri raporte bashkë se kanë diçka të përbashkët.

Unë s'mund të them se kanë të përbashkët korrupsionin, por dikush e ka obligim me luftua korrupsionin, një organ tjetër duhet me zbatua rregullat e tenderimit, qoftë se bëhet lëshimi në këto rregulla është organi shqyrtues i prokurimit i cili duhet t'i identifikojë ato gabime dhe padrejtësi dhe shumica e ankesave janë prej operatorëve ekonomik, por në qoftë se bëhen lëshime edhe në këto dy shkallë atëherë vjen rendi Agjencionit Kundër Korrupsionit, i cili duhet ta zhvillojë aktivitetin, ta identifikojë dhe ta paraqes, prandaj, ka një zinxhir i cili sillet te këto tri organe të pavarura.

Prandaj, unë mendoj se duhet të diskutojmë seriozisht si më tutje të tri organet të punojnë të pavarura, po të punojnë aq mirë që të bëjmë shtetin e drejtësisë ligjore, por kjo sëmundja e korrupsionit nuk është e lehtë të luftohet se diku janë do infektive, prandaj nuk është lehtë. Unë kam vetëm disa fjalë lidhur me organin shqyrtues të prokurimit. Fillon, sikur çdo raport me funksionimin e organit, vazhdon me....

KRYESUESI: Aleanca, konsultimet mundeni jashtë, por jo në këtë formë!

KAQUSHA JASHARI:... parimet e organit, gjithkund e kemi sikur edhe këtu strukturën dhe organogramin e këtij organi, cilat janë trajnimet që janë bërë, a e kanë apo s'e kanë faqen e internetit, shpjegimi i buxhetit dhe shfrytëzimit e parave të ndara për veprimin e tyre dhe më tutje statistika.

Në qoftë se e mbajmë mend edhe këtë pikën para kësaj që e kemi pasur gjithashtu është një raport statistikor. Asnjë analizë, asnjë sugjerim, asnjë problem serioz nuk është në raport i theksuar. Merrni vetëm një vlerësim në këtë raport të organit shqyrtues. Ankesat janë 500 e disa, diçka më shumë se në 2008 dhe ky organ kështu po vlerëson. Pasi janë më shumë ankesa më 2009 se 2008, ky organ po thotë kështu, ky është një indikator i

qartë që tregon se besueshmëria e operatorëve ekonomik në mbrojtjen e të drejtave të tyre ligjore nga ana e organit shqyrtues të prokurimit është rritur nga fakti se numri i ankesave të parashtruara në vitin 2009 është për 61% më shumë. A mund të ndodh edhe një vlerësim tjetër? Unë e vlerësoj edhe ndryshe, më shumë ankesa, më shumë padrejtësi e pse rritja e besueshmërisë? Domethënë në qoftë se kemi tash edhe më shumë ankesa, atëherë më shumë besohet në këtë organ që t'i sqaron, a këndej korrupsioni nuk ndalet.

Prandaj unë po e përfundoj me një propozim konkret. Kuvendi duhet ta unifikojë formën e raportimit. Pos pjesës statistikore e cila është obligative, me siguri në çdo raport, duhet të kërkohej edhe vlerësimet analitike, prandaj në qoftë se nuk e bëjmë kështu në këtë mënyrë kërkesën, këto raporte kanë për të vazhduar sikur deri më tani, vetëm statistikën dhe puna të vlerësohet në bazë të asaj sa kanë punuar dhe si i kanë harxhuar këto parat e ndara nga buxheti. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Jashari! Fjalën e merr deputeti Naim Rrustemi.

NAIM RRUSTEMI: Faleminderit për fjalën e dhënë!

Unë njëjtë edhe sikur të raportimi i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, po dua ta ngrit një çështje që me të vërtetë këto nuk janë as raporte dhe s'di as pse i diskutojmë. Për të gjithë ata që mendojnë që raportimi është i kësaj forme veç duke dhënë tabela pa ardhur deri te asnjë përfundim, atëherë këtij raport nuk i thuhet. Nuk e di çka mund të nxjerrim. Ky raport nuk e ka asnjë përfundim. Janë disa tabela dhe disa tabela janë edhe të zeza që vështirë e kam pasur t' i shoh. Por si do që të jetë, këta e kanë zgjedhur këtë formë të raportimit. Unë po ndalem vetëm në një. Nuk po e di arsyen se pse e kanë vendosur në raport buxhetin – një tabelë të buxhetit që e ka kopjuar prej Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave, që e kanë marrë me kode të veta shpenzuese. Po ka harruar një gjë ta bëjë, se me nenin 113 të Ligjit të prokurimit publik ku flitet për sigurinë, gjobat dhe dëmet, raportimi nuk i përfshin të ardhurat që grumbullohen nga sigurimi i ankuesit me rastin e dorëzimit të ankesës.

Me fjalë tjera, prej të gjitha këtyre ankesave që janë parashtruar 457, nga ky raport le të kuptohet se asnjë euro nuk është i grumbulluar, kurse me Ligj të prokurimit publik, me rastin e vendosjes së ankesës je i obliguar që ta sigurosh ankesën në shumën prej 1.000 deri 5.000 euro. Edhe nëse do me qit buxhetin, atëherë qite krejt. Ofrimi gjysmak i informacionit është tentim për manipulim.

Nuk e besoj se prej të gjithë këtyre 457 ankesave të pranuar nga operatorët ekonomik, nuk ka rezultuar asnjë me konfiskimin e sigurimit të ankesës. Kjo është njëra prej çështjeve. Me fjalë tjera kërkoj që të shihet se a është konfiskuar ndonjë prej sigurimit të ankesave.

Dhe pika e dytë për mua që kishte me qenë, është gjithashtu se janë shqyrtuar 85 ankesa të Agjencionit të Prokurimit Publik lidhur me vendimet e APP-ës. Nëse veç ankesat e tilla janë shqyrtuar e njëri prej autoriteteve ASHP-ja dhe APP-ja kanë dalë gabim, me fjalë të tjera, dikush e ka një faj këtu.

Dhe, si në fund, mirë do të ishte të ketë ndonjë përfundim, por unë mbeta borxh kur e kemi shqyrtuar raportin e KRPP-ës, i mbeta borxh se ato sugjerimet për ta përmirësuar, për ta amendamentua Ligjin e prokurimit publik KRPP-ja e pat vendosur se zyrtarët e prokurimit punojnë nën presion. Unë e zgjodha pyetjen: prej kujt, kush? Por tash pas një përsiatje, të një mendimi pak më të thellë e pashë se s'kanë nevojë me qenë në presion

sepse kushdo që vjen shef i një institucioni e ndërron njërën e parë që e ndërron është shefi i prokurimit. E kur ta ndërrojë shefin e prokurimit s'ka nevojë ai me kanë në presion se është shoq... Kolegu im po më sugjeron, e ndërron kuletën, ajo trashet kuleta po mendoj se nuk e ndërron atë, po e ndërron bashkëpunëtorin e vet. Faleminderit!

KRYESUESI: Qysh e ndërron bashkëpunëtorin? Driton Tali, pranë tij e ka fjalën!

NAIM RRUSTEMI: Kam replikë me kryesuesin!

KRYESUESI: S'ka replikë! S'ke pse. Nuk ke replikë!

NAIM RRUSTEMI: Po, s'ke ti të drejtë të ndërhysh.

KRYESUESI: Ndaj kujt?

NAIM RRUSTEMI: Urdhëro! Ndaj teje!

KRYESUESI: E pse ndaj meje? Jo, jo, s'thashë kurrgjë unë. Driton, merre fjalën!

NAIM RRUSTEMI: Ti mos komento, se s'është e jotja të komentosh.

DRITON TALI: OK. Duhet ta hapim një pikë të veçantë për këto komentet, zoti kryesues, që po jepen nga kushdo që po e kryeson seancën, se mendoj me të vërtetë nuk është në rregull për shkak se kemi problem me regjinë. Fjala juaj atje po dëgjohet, e jona nuk po dëgjohet, pastaj dhe po keqinterpretohet.

KRYESUESI: E jotja, momentalisht po dëgjohet dhe po flet jashtë teme. Rri në temë!

DRITON TALI: Po pikërisht ta dhashë shansin, ti e ke atë mundësi.

KRYESUESI: Po unë e kryesoj more zotëri këtë mbledhje. Merre fjalën!

DRITON TALI: Po s'ke të drejtë të flasësh, o burrë! S'ke të drejtë të më japësh...

KRYESUESI: Kam të drejtë për të sugjeruar të flasësh për temën. E drejta ime e parë është, fol në temë.

DRITON TALI: Po, ajo është dhe atë punë e ke, kurrgjë tjetër s'ke. Nuk ke kurrgjë më shumë tjetër. S'ke të drejtë as ti as të tjerët për t' i komentuar ato çka....

KRYESUESI: Vërejtja ime e dytë është, fol në temë.

DRITON TALI: Shumë bukur! Mirë që u mor kjo, u qartësua njëherë e përgjithmonë, që tash në temë po kthehem. Dhe shumë në temë kam për të folur tash. Nuk është mirë të keqpërdoret mikrofoni, sidoqoftë.

Unë tash veç të kthehem, se këtu u çelën nga parafolësit a diskutojmë siç u tha për gjendjen e prokurimit publik, apo diskutojmë për këto raporte? Dhe, vetvetiu lind një pyetje, po çka raportojnë këto raporte të këtyre dy institucioneve të respektuara. Apo më mirë me thënë çka është dashur të raportojnë këto raporte, sigurisht se shfrytëzimin e parasë publike apo gjendjen... Të thuash se këto janë të ndara nga gjendja në prokurimin

publik apo nga mënyrat e të shpenzuarit të parasë publike është një non-sens i llojit të vet, sepse janë të ngjitura.

Sido qoftë unë po them krahasuar, se e kam këtu transkriptin e 16 prillit të vitit 2008 kur e diskutuam atë raportin e këtij institucioni për vitin 2007... më falni 2008, pra të 16 prillit 2009, po flas të vitit të kaluar, shihet se është njëfarë përmirësimi në këtë raport. Për ata që kanë harruar, po ua rikujtoj se vitin e kaluar ky institucion e pat sjell një raport dyfaqësh. Tash pak e kanë përmirësuar, s'është më dy faqesh, është po them një raport nja 12 faqe, sepse disa faqe veç i kanë shti kot këtu për të mbushur faqe dhe nga këto 12 faqe 6 faqe i ka tabela, 1 faqe e ka me dy grafikone të mëdha, plus saj edhe nja 4 grafikone të mëdha që i zënë nja një faqe e gjysmë dhe ke parasysh këtu është përdor fonde 12 me hapësira. Dhe nëse e llogarisim këtu del se ky raport, po flas në aspektin e raportit është përmirësuar për gjysmë faqe – dy faqe e gjysmë sivjet na i kanë sjell dhe paramendo ti tash së pari sa duhet të jesh i aftë që 542 ankesa të pranuar t'i shpjegosh apo t'i raportosh në dy faqe e gjysmë dhe po ashtu çfarë lexuesi inteligjent duhesh të jesh për t'i kuptuar se çka kanë dashur të na raportojnë neve?

Dhe po ashtu krejt në fund, se shumë sende u thanë, zoti kryesues, t'ua rikujtoj edhe juve po edhe të tjerëve – këtu e kam nga po e njëjta seancë, që, nëse doni, edhe emrin ia përmendi kush ka thënë, po them kur është shqyrtuar raporti i këtyre dy agjencive thuhet kështu, kështu kemi bërë. Thuhet se Kuvendi nuk i shqyrton raportet, në vërtetë i shqyrton raportet, por nuk i miraton raportet e këtyre dy agjencive, domethënë të KRPP-ës dhe të OSHP-ës, vetëm i shqyrton nëse ka rekomandime. Rekomandimet i nxjerr Kuvendi, ato i shqyrton apo i voton dhe jo këtë raport. Në diskutimin e raportit të kaluar për aq sa më punon memoria, nuk dhamë asnjë rekomandim dhe e votuam raportin për të cilin s'kemi pasur të drejtë ta votojmë, sepse të paktën po them se kështu na e ka interpretuar ligjin shumë me rëndësi në koalicionin qeveritar, kështu ka mbetur në seancën e kaluar, andaj as këtë raport ne nuk duhet ta votojmë, vetëm se nëse kemi propozime tona të cilat pastaj i nxjerrim në votim. Kështu është të paktën, ta mbajmë një konsistencë e jo kujt si të ketë dëshirë të bëjë. Faleminderit!

KRYESUESI: Jo, jo! Ai po më adresohet mua dhe s'e kam ndërmend të bëj replikë! Hydajet Hyseni-Kaloshi e ka fjalën. Nuk është këtu. Kaloshi abstenon, nuk është këtu. Atëherë, zonja Myrvete Pantina e ka fjalën.

MYRVETE PANTINA: Faleminderit, zoti kryesues!

Lidhur me raportin e organit shqyrtues të prokurimit për vitin 2009, së pari do të ndalem në një konstatim të këtij organi ku thuhet se besueshmëria e operatorëve ekonomik në mbrojtjen e të drejtave të tyre ligjore nga ana e organit shqyrtues të prokurimit është rritur nga fakti se numri i ankesave të parashtruara për vitin 2009 është rritur për 61% në krahasim me vitin 2008 dhe atë nga 290 në 457. Ky konstatim i OSHP-ës duhet të shikohet edhe nga një aspekt tjetër se numri i rritur i ankesave të operatorëve ekonomik do të thotë edhe rritje e parregullsive dhe shkelje të Ligjit në fushën e prokurimit publik nga ana e autoriteteve kontraktuese në shfrytëzimin e fondeve publike. Dhe ky është një element që duhet të na brengosë.

Po ashtu është shqetësues edhe fakti se paneli shqyrtues në shumicën e rasteve ka hasur në parregullsi gjatë procesit të vlerësimit të ofertave dhe në marrjen e vendimeve të gabuara për shpalljen e fituesit.

Gjithashtu nga raporti kuptohet se janë konstatuar shkelje të Ligjit mbi prokurimin publik, gjë që kanë ndikuar që njoftimet për dhënie të kontratës të autoriteteve kontraktuese të anulohen apo që lënda të kthehet për rivlerësim e që numri i rasteve të ankesave për rishqyrtim të vendimeve të Agjencionit të Prokurimit Publik ka arritur në 85, prej të cilave 68 kanë qenë kërkesa që kanë të bëjnë me lejimin e përdorimit të procedurës së negociuar, pa publikim të njoftimit për kontratë dhe prej tyre 59 kërkesa kanë qenë të aprovuara.

Numri më i madh i kërkesave për rishqyrtim të vendimeve të Agjencionit të Prokurimit Publik kanë qenë të drejtuara Ministrisë së Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit, që janë 21, Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë 10 dhe Policisë së Kosovës, 6.

Sa i përket buxhetit të organit shqyrtues të prokurimit për vitin 2009 duhet cekur se përkundër vlerësimit nga ana e OSHP-ës se buxheti është realizuar në mënyrë efikase, të dhënat flasin ndryshe. Në fakt nuk mund të qëndrojë një konstatim i tillë derisa buxheti është shpenzuar vetëm 65%. Kjo flet për planifikim jo të mirë të buxhetit, sepse një pjesë e madhe e mjeteve kanë mbetur pa u shpenzuar, sidomos në kategorinë e shpenzimeve për shërbime komunale që janë vetëm 24% të mjeteve të planifikuara dhe në kategorinë për mallra dhe shërbime, ku janë shpenzuar 58% të mjeteve të planifikuara. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit zonja Pantina! Nuk ka më diskutues! Ju lutem, në sallë janë 65 deputetë. Kërkoj që të bëhet gati për votim të këtij raporti, votojmë tash:

Votimi është: 49 vota “për”, 9 abstenime dhe 3 “kundër” dhe Kuvendi e ka miratuar Raportin e organit shqyrtues të prokurimit për vitin 2009.

Pika në vijim e katërmbëdhjetë e rendit të ditës, është:

14. Shqyrtimi i Raportit të Agjencisë Kundër Korrupsionit për vitin 2009

Komisioni funksional për Legjislacion dhe Gjyqësi, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Punës ka shqyrtuar Raportin e Agjencisë Kundër Korrupsionit për vitin 2009 dhe Kuvendit i ka rekomanduar këtë raport për miratim.

Komisioni funksional për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar pjesën financiare të Raportit të Agjencisë Kundër Korrupsionit për vitin 2009 dhe ka rekomanduar për shqyrtim në seancë plenare.

I pari, fjalën mund ta marrë, nëse dëshiron kryetari i Komisionit funksional ose raportuesi i komisionit funksional, Bahri Hyseni.
Urdhëroni, Bahri!

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuari, zoti ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi ka në fushëveprimin e vet edhe shqyrtimin e Raportit të Agjencisë Kundër Korrupsionit të cilën çështje e ka bërë më datën 12 prill 2010 dhe gjatë shqyrtimit të Raportit të Agjencisë Kundër Korrupsionit Komisioni ka

konstatuar se Agjencia ka hartuar një raport i cili i përmban të gjitha kriteret që të aprovet në parim.

Megjithatë, Komisioni ka konstatuar dhe ka pasur edhe dilema të cilat i kemi diskutuar rreth çështjes së lëndëve të cilat janë shqyrtuar në Agjencinë Antikorrupsion, duke pasur parasysh që dukuria e korrupsionit së paku në opinion publik po diskutohet për çdo ditë, së paku në Komisionin Evropian është diskutuar që është prezent dhe natyrisht edhe nga vetë zyrtarët e Agjencisë Antikorrupsion janë hartuar shumë kallëzime apo kërkesa që iu kanë drejtuar organeve të drejtësisë që të merren me lëndët përkatëse.

Komisioni ka konstatuar se me rastin e trajtimit të lëndëve të hetuara si të dyshuara për veprime anti... apo për veprime korruptive dhe veprime tjera, të cilat ndërlidhen me korrupsionin për vitin 2009 kanë qenë diku 168 raste prej të cilave pothuaj një pjesë e tyre tanimë ka dhe janë konfirmuar si informata që janë në procedurën hetimore mirëpo megjithatë prej këtyre rasteve ka edhe shumë informata, diku 40 informata të cilat janë hedhur si të pa bazë.

Gjatë raportit kemi pasur prezentë edhe zyrtarët e Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe një prej çështjeve ka qenë kjo dukuria që edhe në këtë vit, në vitin 2009 por edhe në vitet paraprake, shumica e lëndëve të cilat janë hartuar apo janë trajtuar në Agjencinë Kundër Korrupsionit në organet e ndjekjes apo në prokurorinë e shtetit janë hedhur si të pa baza. Natyrisht, do të thotë deri tash kemi konfirmimin për 40 informata apo 36 informata po ka informata edhe në Prokurorinë Speciale të Kosovës dhe kemi konstatuar se është bukur shumë një pjesë e madhe, do të thotë diku 35% e informatave të cilat po hedhen si të pa bazuara në fakte, prandaj kjo ka qenë shqetësuese për komisionin dhe kemi kërkuar që Agjencia në të ardhmen të ngrit apo të forcojë kapacitetet me qëllim që informatat të jenë të bazuara dhe me rastin e hartimit të raporteve ato të kenë bazën që mos të ketë mundësi prokuroria e shtetit me i hedhë poshtë.

Unë po përmendi vetëm një fakt se nga informatat për këtë vit që janë dorëzuar në Prokurorinë e EULEX-it, diku janë dorëzuar 34 informata, 20 deri tash janë hetuar, kurse 11 prej tyre janë hedhur si lëndë të pabazuara. Do të thotë se në përqindje i bie pothuaj përafërsisht ashtu siç i ka hedhur edhe prokuroria e shtetit të Kosovës, një përqindje përafërsisht e njëjtë.

Prandaj, duke pasur parasysh që një pjesë e informatave po hidhen poshtë të pa bazuara, ne konsiderojmë se Agjencioni e ka kryer një punë të mirë, ka ndikuar dhe ka pasur efektivitet ndoshta edhe në ndaljen e aferave korruptive, mirëpo megjithatë si Komision kemi konstatuar se duhet që Agjencioni t'i ngrit kapacitetet profesionale, gjithsesi duhet që Kuvendi i Kosovës të mendojë që në të ardhmen, si rekomandim edhe i Komisionit për Legjislacion është që Agjencisë t'i jepet mundësia që të ketë edhe kapacitete shtesë financiare dhe natyrisht në fund si Komision kemi rekomanduar që të shtrohet edhe aktiviteti, por edhe efektiviteti në ndaljen e aferave korruptive apo të rasteve korruptive. Dhe, këto do të ishin të mirëseardhura dhe do të ndikonin pozitivisht që së paku opinionin publik, mandej të mos e ketë, në aspektin negativ, një bindje se në Kosovë, po bëhet shumëçka dhe po shkatërrohet pothuaj e tërë Kosova. Sepse, në fakt, nëse e shihni, në krahasim me vitet paraprake janë vetëm 7-8 kërkesa më tepër, nuk ka, janë 10 kërkesa apo 10 njoftime të cilat janë bërë nga qytetarët më tepër, por nuk është ajo që po flitet në opinion së paku nga raporti që e kemi para veti.

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi konsiderohen se duhet të aprovohet raporti i Agjencisë Antikorrupsion apo kundër korrupsionit me ligje të reja, duke marrë parasysh që tani e kemi edhe një bazë të mirë ligjore. Domethënë, tani për tani e kemi mbyllur atë, e kemi përmbyllur atë paketën ligjore të ligjeve kundër korrupsionit dhe agjencia është në një situatë më të mirë, të bëjë punën më të mirë që t'i ndjekë apo hetojë rastet korruptive. Dhe është mirë që Kuvendi edhe rekomandimet e rekomanduara nga komisioni t'i aprovojë dhe të japin mundësi që Agjencia të jetë më efikase. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Gani Koci, në emër të Komisionit të Buxhetit. Gani Koci ia jepni fjalën!

GANI KOCI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Vërtet, për sa iu përket zgjidhjeve ligjore ose dispozitave ligjore që përcaktojnë mënyrën e shqyrtimit të raporteve të agjencioneve të ndryshme, kemi zgjidhje të ndryshme, varësisht nga agjencionin dhe raportimet që bëhen, kemi zgjidhje të ndryshme. Unë po e lexoj nenin 12 të Ligjit për luftën kundër korrupsionit, lidhur me raportin dhe çka duhet të bëjë Kuvendi me raportin, në mënyrë që kolegët e mi deputetë t'i kenë parasysh se çka të miratojnë pastaj, se nuk po dinë.

Neni 12 thotë: “Agjencia paraqet raport vjetor të punës për vitin paraprak në Kuvendin e Republikës së Kosovës, më së voni deri me 31 mars”. Ligji i menaxhimit të financave publike, po ashtu thotë se i paraqitet Kuvendit për këto agjencione të pavarura raport i veçantë i shpenzimeve buxhetore dhe ky agjencion i ka plotësuar të dy këto dispozita në raportimin e vet dhe, natyrisht, kur i paraqiten Kuvendit raporte të ndryshme për shqyrtime, nuk është thjeshtë vetëm një shqyrtim dhe Kuvendi duhet të miratojë, varësisht nga ajo që del nga diskutimet, rekomandimet e ndryshme, vendimet e ndryshme, por kur nuk ka rekomandime dhe nuk ka vendime të ndryshme, atëherë nuk ka çka të miratohet pos të përkrahet raporti që na u ka sjellë këtu në Kuvend.

Prandaj, kjo është ajo mënyra dhe procedura e diskutimit, e raportimit dhe e shqyrtimit të raporteve. Për sa i përket pjesës buxhetore, buxhetit që e ka pasur ky agjencion, e ka realizuar në përputhje me Ligjin mbi menaxhimin e financave publike në tërësi dhe këtu Komisioni për Buxhet dhe Financa nuk ka pasur asnjë vërejtje. E vetmja vërejtje që nuk është thënë në rekomandime, është sepse ky institucion do mbështetje financiare dhe ka nevojë për mbështetje financiare, në mënyrë që vërtet të zhvillojë kapacitetet e veta dhe të realizojë atë për çka edhe është krijuar mbi bazë të Ligjit. Prandaj, Komisioni për Buxhet dhe Financa ka përkrah në pjesën e vet, shpenzimet financiare, Agjencionin antikorrupsion dhe kërkon nga Kuvendi, po ashtu, që gjatë përcaktimit të buxheteve për vitin 2011, për këtë Agjencion të kihet parasysh mbështetje më e madhe financiare.

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Tash kalojmë te paraqitjet e përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Selviqe Halimi, në emër të PDK-së.

SELVIQE HALIMI: Ju faleminderit, i nderuari kryesues!

Agjencionin Kosovar kundër Korrupsionit, në raportin e vet për vitin 2009, ka paraqitur në mënyrë të detajuar punën dhe aktivitetet e tij.

Grupi Parlamentar i PDK-së e ka shqyrtuar këtë raport të punës dhe ka konstatuar se Agjencia Kosovare kundër korrupsionit, si institucion i pavarur dhe i specializuar për

parandalimin e korrupsionit, ka intensifikuar angazhimet dhe veprimet e veta në ballafaqimin me këtë dukuri. Intensifikimin e punës, padyshim se e ka ndihmuar kompletimi i infrastrukturës ligjore, si dhe aprovimi i strategjisë kundër korrupsionit dhe plani i veprimit. Nga raporti shihet se Agjencia ka shtrirë aktivitetin e vet në të gjitha fushat dhe në procesin e raportimit të zbatimit të strategjisë kundër korrupsionit dhe planit të veprimit, ka përfshirë gjithsej 41 subjekte, e ndër të cilat edhe Këshillin Gjyqësor i Kosovës, që sipas raportit, nuk ka korresponduar me Agjencinë, me raporte për zbatimin e strategjisë kundër korrupsionit. Kjo çështje për Grupin Parlamentar të PDK-së është shumë shqetësuese.

Po sipas raportit, Agjencia nuk ka pranuar informata kthyesë nga institucionet, se a janë shqiptuar masa sipas kërkesës së Agjencisë, gjithë herë konform Ligjit, ndaj personave zyrtar të lartë, të cilët janë të obliguar që të bëjnë deklarinë e pasurisë së tyre, e të cilët më pas, sipas raportit gjithnjë, pas vërejtjes së parë, të dytë apo të tretë, kanë bërë deklarinë, mirëpo Agjencioni në këtë raport nuk ka paraqitur informata se a janë shqiptuar masat konform ligjit.

Në këtë raport, për t'u admiruar është një fakt i rritjes së gatishmërisë së qytetarëve për të raportuar për rastet e dyshuara për korrupsion, gjë që dëshmon atë që u cek në fillim se Agjencia ka shtuar aktivitetet e saj dhe ka arritur që të ngritë nivelin e besueshmërisë së qytetarëve për t'iu drejtuar Agjencisë për rastet e tilla apo edhe konfliktet e interesit gjatë ushtrimit të funksionit publik të zyrtarëve të lartë.

Andaj, Grupi Parlamentar i PDK-së e përkrah raportin e Agjencisë Kosovare kundër Korrupsionit, njëherësh i përkrah edhe rekomandimet e komisionit funksional, që ishin: shtimi i aktiviteteve të Agjencisë në parandalimin e korrupsionit; ngritja dhe zhvillim i kapaciteteve profesionale të Agjencisë, si dhe përkrahja e shtuar financiare nga ana e Qeverisë për Agjencinë. Me këtë rast, Grupi Parlamentar gjithashtu kërkon rritjen e nivelit të bashkëpunimit të mëtejshëm të institucioneve me Agjencinë, e në veçanti të shtyllës së tretë të pushtetit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Deputeti Zemaj, për LDK-në.

ARMEND ZEMAJ: Ju faleminderit shumë, profesor!

I nderuar ministër,

Kolegë të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Raportin e punës të Agjencisë kundër Korrupsionit për vitin 2009. Edhe pse raportet që paraqiten nga agjencitë e pavarura më shumë japin pasqyrë përshkruese të punës dhe të aktiviteteve të tyre, ne mendojmë që pasi e kishin miratuar strategjinë dhe planin e veprimit kundër korrupsionit, si dhe pakon e ligjeve kundër korrupsionit, duhet që raportet e tilla më shumë të ofrojnë fakte dhe argumente konkrete në luftimin e korrupsionit dhe mbrojtjes së parasë publike.

Si grup parlamentar jemi të brengosur me funksionimin e raporteve në mes të Agjencisë kundër Korrupsionit dhe organeve tjera hetuese, në këtë rast: Prokurorisë, Policisë dhe deri te gjykatat, si dhe me kthimin e informatave nga institucionet tjera publike. Prandaj, mendojmë se duhet mbështetur edhe rekomandimet e Komisionit për Legjislacion e Gjyqësi, siç janë: rritja e efikasitetit të agjencisë në parandalimin e korrupsionit; të ngriten kapacitete personale të agjencisë për ta luftuar korrupsionin dhe të shtohet përkrahja financiare për Agjencinë kundër Korrupsionit, kështu që Agjencia kundër

Korrupsionit të mos mbetet vetëm si organ parandalues apo preventiv për luftimin, por të ketë luftim të pakompromis të kësaj dukurie negative.

Grupi Parlamentar i LDK-së e përkrah raportin me plotësime, si dhe mbështet punën dhe angazhimin e Agjencisë kundër Korrupsionit. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, zoti Zemaj! Për Aleancën, kush flet? Zonja Donika Kadaj.

DONIKA KADAJ – BUJUPI: Ju faleminderit, i nderuari kryesues!

Të nderuar kolegë deputet,

Konsideroj që tema për të cilën sot flasim, ka kërkuar dhe është domosdoshmëri që Qeveria e Kosovës të ishte prezentë dhe mendoj që, nëse nuk janë të privuar që të jenë këtu për ndonjë arsye, është domosdoshmëri që sot të jenë këtu, sepse është një problem që, nëse asgjë tjetër, në dy-tri ditët e fundit ka lëkundur themelet e këtij shteti.

Kisha dashur shumë sot të flas për progres të vendit dhe për të arriturat e Qeverisë, kisha dashur që të shoh në këtë raport që kemi pasur të arritura dhe kemi pasur progres, sidomos kur Kosova është shtet sovran dhe e pavarur dhe kur institucionet e këtij vendi kanë të gjitha kompetencat që të veprojnë konform obligimeve që kanë marrë para qytetarëve të Kosovës. Fatkeqësisht, përkundër vullnetit, realiteti i krijuar nga po kjo Qeveri, nuk ma mundëson këtë. Pse nuk ma mundëson? Fakti që në dy-tri ditët e fundit EULEX-i hyn në Qeveri në mes të ditës dhe bastisë zyrat e shtetit, fakti që prej pardje, çdo herë kur ndihen sirenat e policisë, qytetarët e Kosovës pyesin, pyesin se cili është institucioni i radhës i cili do të bastiset, flet që Zyra Antikorrupsion në fakt ka dështuar në mandatin e saj dhe që është e tepërt të flasim për ato që janë paraqitur në këtë raport. Është e tepërt, sepse në raport nuk kemi asnjë informatë rreth rasteve korruptive të ngritura nga Prokuroria Speciale, do të thotë nuk është as e cekur në këtë raport dhe ky është një problem kyç, është një temë me të cilën po merret shteti i Kosovës, po shqetësohen qytetarët e Kosovës, po merret e gjithë bota, përveç atyre që duhen të merren, do të thotë që po mungojnë edhe sot, e që në teori në vazhdimësi po flasin për zero tolerancë kundër korrupsionit, e sot kur flitet për raportin kundër korrupsionit, mungojnë. E them me të drejtë që, nëse nuk janë të privuar, është fatkeqësi shumë e madhe që nuk janë këtu.

E dyta, ajo që po ndodhë sot në Kosovë, atakon të ardhmen, po e dëmton imazhin e Kosovës, do të na sjellë, i nderuar kryesues dhe deputetë, raporte edhe më të këqija të progresit se ato që i kemi pasur deri më sot dhe, mbi të gjitha, po i përzë investitorët e këtij vendi. Nëse kthehemi në aspektin teknik dhe e shikojmë raportin, e shohim se raporti nuk ka një hulumtim kualitativ të rasteve të korrupsionit. Do me thënë, janë dhënë disa shifra dhe sqarime të cilat nuk japin përgjigje ligjore ndaj rasteve të shqyrtuara të korrupsionit. Kështu si është, kemi vetëm statistika dhe jo një hulumtim kualitativ.

E treta, për sa i përket infrastrukturës ligjore, Zyra Antikorrupsion nuk ka përfillë ose zbatuar të njëjtën, e cila ndër të tjera parasheh edhe përpjekjet antikorrupsion, të cilat përmbushin objektivat e synuara, atë të parandalimit dhe të luftimit të korrupsionit. Duke marrë parasysh që ky raport ka tentuar që të shminkohet shumë dhe për kundër të gjithë atij makijazhi të tepruar që i është vënë, nuk mund të mëshefet një realitet shumë i hidhur, një problem tmerrësisht i madh që po ndodhë sot në Kosovë, në këto momente, e ai është një korrupsion në të gjitha institucionet, në të gjitha nivelet në

shkallë vendi dhe që është shumë shqetësues për qytetarët e Kosovës, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës nuk do ta votojë si të tillë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja Kadaj! Kush flet për Aleancën e Re? Shefi i Grupit, Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Grupi Parlamentar i Aleancës Kosova e Re e përkrah raportin e Agjencionit Kundërkorrupsion dhe e përgëzohet këtë institucion për punën që e ka bërë në këtë vit, përkundër vështirësive që ka dhe inkurajojmë që edhe në të ardhmen Agjencioni të arrijë të realizojë funksionin e vet, ashtu siç e ka me ligj.

Sikur u tha edhe nga të tjerët, por edhe nga raporti vërehet një nevojë e përgjithshme që ky institucion të ketë mbështetje edhe nga ana e Kuvendit të Kosovës, por edhe nga ana e institucioneve tjera, sepse kemi një mosbashkëpunim të institucioneve kryesore që do të duhej të ishin hallka mbështetëse të Agjencionit në luftën kundër korrupsionit. Unë do të ndërlidhem edhe me rastin e pardjeshëm, ku në emër të luftës kundër korrupsionit është dhunuar institucioni i shtetit, sikurse edhe është kryer atentat politik. Prandaj, askush nuk duhet që t'i shfrytëzojë përpjekjet në luftën kundër korrupsionit që të dhunojë institucionet shtetërore. Sikur e thashë në fillim, Grupi Parlamentar i AKR-së, do ta mbështesë këtë raport, natyrisht edhe rekomandimet e të dala nga ana e Agjencionit, sikurse edhe rekomandimit e Komisionit për Legjislacion. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Makolli! Në emër të LDD-së, flet shefi i Grupit, Lulzim Zeneli.

LULZIM ZENELI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Raporti vjetor i Agjencionit Kundërkorrupsion për vitin 2009, ngërthen në vete të gjitha ato elemente të cilat pothuaj se kanë qenë prezent edhe në raportin paraprak, një vit më herët. Ajo çka mund të identifikohet me një fjalë si sintezë apo emërues i përbashkët në këtë raport, kemi të bëjmë me korrupsion, konflikt interesi, klientelizëm, çka nuk është risi qoftë për opinionin, qoftë edhe për Kuvendin e Kosovës.

Është për fatkeqësi tek ne se një Agjencion i tillë që është krijuar me një entuziazëm aq të madh në fillim, dalëngadalë është devaluuar në kuptimin e përgjegjësive dhe në kuptimin e rolit që ka. Në fakt, Agjencioni Antikorrupsion është shndërruar në një mbledhës të informatave për rastet e dyshimta korruptive dhe asgjë më shumë. Nga numri, vetëm një rast çka mund të pretendohet se shumë raste të cilat janë denoncuar në kuptimin e përgjithshëm, shumë raste të cilat janë procedur në gjykatë dhe në procedurë të mëtejshme, një numër i vogël i tyre ka hyrë në procedurë dhe asnjë prej rasteve nuk është finalizuar. Kjo jep për të kuptuar se Agjencioni Antikorrupsion jo vetëm që është devaluuar në kuptimin e përgjegjësive dhe në kuptimin e rolit që ka, por dalëngadalë është bërë pjesë e politikave ditore që nuk është në kuadër të funksionit dhe në kuadër të përgjegjësive që pret ky Kuvend dhe presin qytetarët e vendit.

Që është devaluuar dhe ekziston një mungesë enorme e autoritetit të këtij agjencioni në publik dhe tek institucionet relevante, tregon më së miri fakti se nga numri i përgjithshëm i zyrtarëve të lartë, të cilët e kanë obligim të deklarojnë pasurinë, në fazën e parë – 173 prej tyre e kanë injoruar autoritetin e Agjencionit Antikorrupsion. Dhe, në qoftë se kësaj i shtojmë edhe numrin e rasteve të cilët kanë deklaruar apo kanë dhënë të dhëna të

rrejtshme, duke fshehur kështu edhe pasurinë milionëshe që e kanë krijuar brenda natës, atëherë vihet në pikëpyetje autoriteti i këtij agjencioni dhe i mekanizmave përcjellës.

Ky agjencion është veprim i kotë të mbledhësh fakte për të korruptuarit, derisa ndëshkimi më i madh për zyrtarët të cilët nuk e deklarojnë pasurinë sipas Ligjit për deklarimin dhe prejardhjen e pasurisë, është maksimumi 1500 euro. Mund ta merrni me mend se çfarë konsekuencash mund të përjetojë a mund të bartë një zyrtar i korruptuar. Ajo çka neve duhet të na brengosë, është legjislacioni i cili e përcjell këtë agjencion, është tejet i disfavorshëm në kuptimin e dhënies të përgjegjësisë dhe ngritjes së autoritetit të këtij agjencioni. Prandaj, është imediate që Kuvendi i Kosovës ta rishqyrtojë Ligjin për këtë agjencion, t'i rishqyrtojë ligjet përcjellëse dhe sidomos Ligjin për deklarimin dhe prejardhjen e pasurisë, për vet faktin se me këtë legjislacion në fuqi, çfarë e kemi, ne do të vazhdojmë, e ceka edhe më herët, gogolizmin vetëm nëpër opinion, me pretendime që të luftohet korrupsioni mirëpo, në realitet, mekanizmat përcjellës dhe mekanizmat kompetent nuk kanë fuqi reale për të ndërmarrë veprime.

Pra, teoretizimet publike duhet të marrin fund në këtë kuptim. Në qoftë se e përjashtojmë për një moment ekzistencën e këtij agjencioni, atëherë do të shtrohet pyetja - cila do të jetë gjendja reale, a do të ndryshonte diçka nga kjo aktualja. Unë do të thosha që një Agjencion i tillë duhet t'i rishikojë përgjegjësitë e veta, duhet t'i rishikojë obligimet që ka, në mënyrë që ky autoritet i paktë që ekziston, nëse mund të thuhet se po devalvohet vazhdimisht, të mos shndërrohet në pjesë të një mekanizmi që do të jetë në shërbim të politikave ditore. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Në emër të Grupit “7+”, nuk ka. Në emër të LSL-së, nuk ka. Në emër të Grupit për Integritet, Vezira Emrush.

VEZIRA EMRUŠ: Hvala na datu reč!

Ponovo se javljam sa namerom da doprinesem malo ovoj oblasti.

Imamo pred sobom Izveštaj agencije za korupciju. Ja ne bih mnogo dala vremena sebi da analiziram izveštaj. Verujem da smo ga svi pročitali. On zadovoljava elemente, da kažem, osnovnog školskog obrazovanja i možda bi bio dobar kada bi ga dali na analizu kod nekih osnovnih škola.

Sam Izveštaj bavi se mnogo sa brojem prijavljenih, sa brojem istraživanih slučajeva, međutim zaboravlja osnovni cilj da ova agencija postoji zbog toga da bi imala dobru strategiju i plan delovanja protiv korupcije. Mi nigde ne vidimo strategiju i plan delovanja protiv korupcije, iako nas ovde više vremena, da kažem negde oko dva-tri meseca bombarduju, praktično bombarduju iz Evrope i bude nas da je visoki stepen korupcije na Kosovu. Mi se i dalje odnosimo kao da se opet ne radi o nama i ovo isto je u Dublinu, u martu mesecu dao do znanja i specijalni izaslanik za Evropsku Uniju, gospodin Piter Feith. Međutim, mi čekamo da kod nas korupciju reši neko drugi. Mi je sami pravimo, a da je drugi rešavaju. Zašto ovo kažem? Kažem da prvo kada je magistratura u pitanju, meni je žao što Agencija nije dala do znanja da mora zakonski infrastruktura da se popuni u ovoj oblasti. Ovde ima praznina, zakonska praznina, znamo da imamo Zakon o javnoj nabavci, Zakon o sukobu interesa i Zakon o davanju u konsignaciju, zakon, sve zakone, ali nemamo najvažniji zakon. Ja hoću da podignem političku i moralnu svest ovde svih nas poslanika, da tražimo da se pod hitno u Skupštinu donese Zakon o oduzimanju imovine stečene na nezakonit način. Šta ćemo s time da uradimo? Da popunimo prazninu, da popunimo prazninu i da damo Evropi signal da hoćemo da radimo kada je polje korupcije u pitanju. Bez ovog zakona ne

možemo u ovoj sferi da uradimo ništa. Ovaj zakon su usaglasile i usvojile sve zemlje u regiji, sve zemlje imaju, ne kažem da nemaju korupciju, ovaj zakon mora da dođe ovde pred nama u Skupštinu. To je pod jedan.

Ja ne znam zašto se direktor Agencije nije izborio za to, zato što on je namenski zbog toga da popuni zakonsku strukturu. Više ne treba pod tepih da stavljamo ovaj zakon. Zašto, zašto to kažem? Zato što će iz tog zakona, kada je u pitanju sam zakon, zakon ima svoj cilj i svoja sredstva, opravdanje. Tim zakonom bi bilo oduzimanja imovina, gde bi mogli da napravimo fond, gde bi mogli da pospešimo siromaštvo i da popravimo socijalnu kartu Kosova.

Ja ću sada na kraju da završim samo sa jednom rečenicom, koju ću da citiram i da zamolim sve kolege da slušaju, citiraću Vinstona Čerčila, koji je rekao: „Da je dobro društvo koje ima sigurnosnu socijalnu mrežu, kroz koju se ne propada u vrtlog beznada i siromaštva, ali ima i stepenice kojima se sposobni, bez partijskih tutora slobodno penju ka vrhu socijalne piramide“. Za Kosovo u ovom trenutku to bi bilo više nego dovoljno, da se sami penjemo prema piramidi. Ovaj izveštaj danas bi trebao da ima ovu poruku ali, nažalost, on analizira samo neke brojke tamo, nema suštinu, i meni je žao što ja kao poslanica, u svoje ime kažem da neću da ga podržim. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Fjalën e merr zoti Bajram Kosumi.

BAJRAM KOSUMI: Ju faleminderit, i nderuar kryesues!

I nderuari ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Raporti i Agjencisë Antikorrupsion, po të shikohet si standard, realisht është i hartuar më mirë se ai i vitit të kaluar. Paraqet një standard më të lartë edhe teknikisht, por edhe përmbajtësisht. Po të bëhet ky krahasim, vërehet një dallim pozitiv prej atij të vitit të kaluar.

Po ashtu, mund të ketë edhe disa segmente që mund të merren si pozitive, si zhvillime pozitive. Është për shembull, rritja e numrit të rasteve të lajmëruara si të dyshuara, do të thotë ka edhe disa tregues tjerë që janë pozitiv dhe mund të merren pozitiv, siç është numri i rritur i rasteve të lajmëruara si dyshime për korrupsion, pastaj rritja e numrit të dosjeve që Agjencia i ka dorëzuar në Prokurori e tjera. Mirëpo, pavarësisht prej këtyre treguesve, që në dukje të parë janë pozitiv, rezultati vazhdon të jetë i njëjtë. Rezultati i punës që bën Agjencia, përsëri vazhdon i njëjti në këtë vit, sikurse në vitin paraprak, nuk ka do të thotë një avancim në këtë drejtim.

Ky rezultat matet me rastet që ka filluar Prokuroria në bazë të punës që ka bërë Agjencia dhe me rastet që kanë filluar gjykatat. U përmend disa herë edhe sot gjatë debatit dhe nuk po përmend tash përsëri shifra, por numri i rasteve që ka filluar Prokuroria për hetime dhe numri i rasteve që kanë filluar gjykatat, në vitin 2009 është pothuaj se i njëjtë me atë të vitit 2008, nuk ka një avancim në këtë drejtim. Mua më kujtohet shumë mirë edhe në vitin e kaluar kur e kemi diskutuar këtë temë në seancën plenare, po ashtu edhe në këtë vit në Komisionin për Legjislacion, ne e kemi shtruar një pyetje që do ta shtroj edhe sot – kush është fajtori në këtë mes? Do të thotë, Agjencia bën një numër të madh të dosjeve që i dorëzon në Prokurori, Prokuroria nuk kthen përgjigje në shumicën prej tyre dhe shumë pak bën kërkesë për hetime dhe gjykatat edhe më pak fillojnë hetime në këtë drejtim. A është fajtor Agjencia, sepse nuk ka bërë dosje të duhura, nuk ka argumentuar sa duhet vepra të dyshuara, a është fajtor Prokuroria, që nuk kërkon që të

fillojë procesi i hetimeve, apo është fajtorë gjykata që diku e fillojnë procesin dhe e lënë gjysmë, diku nuk e fillojnë fare procesin.

Unë nuk do të isha pajtuar plotësisht që të akuzohet Agjencia, qysh pati disa herë edhe sot në debat, sepse Agjencia nuk është institucion që mund të luftojë me korrupsionin, ashtu siç po mendohet edhe qysh u duk edhe sot gjatë disa debateve. Agjencia është një mjet ndihmës, një institucion ndihmës, që bile më tepër është i paramenduar si një preventivë për korrupsionin. Korrupsionin mund ta luftojnë me sukses vetëm prokuroritë dhe gjykatat. Agjencia është vetëm një institucion ndihmës që mund t'i ndihmojë institucionet e Kosovës, po edhe gjykatat për t'u ballafaquar me korrupsionin.

Unë kam biseduar edhe me disa a prokurorë, kam biseduar edhe me gjykatës nga gjykatat për këtë çështje. Kjo çështje është diskutuar edhe në Komisionin për Legjislacion, ku është me të vërtetë problemi, që kaq i madh numri i dosjeve të dorëzuara në Prokurori dhe kaq pak raste të procedura prej Prokurorisë. Kjo është pikëpyetje e madhe dhe unë e kisha ftuar ministrin e Drejtësisë që të kërkojë prej Prokurorisë dhe gjykatave që të jenë më azhur, të jenë më të shpejtë dhe më të vendosur në shqyrtimin e të gjitha rasteve që kanë të bëjnë me korrupsionin. Nëse pajtohemi që korrupsioni është prioritet, lufta kundër korrupsionit është prioritet për Qeverinë, për Kuvendin e Kosovës, për Agjencinë, atëherë këtë prioritet duhet t'ua imponojmë edhe Prokurorisë edhe gjykatave që ata t'i shqyrtojnë rastet e dyshuara për korrupsion, t'i shqyrtojnë në kohën e duhur, që të mos ketë humbje të kohës.

Unë, vetëm po e përmendi se ka raste që janë lajmëruar në Prokurori dhe në gjykatë nga ana e Agjencisë, e raste për të cilat Agjencia beson që ka mbledhë prova të mjaftueshme, të cilat nuk janë proceduar me dy vjet, me tri vjet, flejnë ose në Prokurori, ose në gjykata. Ky është problemi dhe mendoj ministri i Drejtësisë dhe Qeveria duhet me të vërtetë të kërkojnë në mënyrë të vendosur nga Prokuroria dhe nga gjykatat që t'i procedojnë në kohën e duhur të gjitha lëndët e dyshuara për korrupsion. Dhe, më lejoni në fund të them, po ashtu, te rekomandimet që i ka bërë Komisioni, janë dy rekomandime të cilat Kuvendi duhet t'i ketë parasysh edhe gjatë rishikimit buxhetor të këtij viti.

Komisioni për Legjislacion ka rekomanduar që të shtohet përkrahja financiare për Agjencinë, është rekomandimi katërt. Nuk mundet Agjencia të funksionojë suksesshëm nëse nuk ka mjete financiare për t'i paguar ekspertët, por edhe punëtorët e vet për t'i mbajtur aty, sepse është një punë më senzibile, më e ndjeshme. Dhe, dy, të ngritën kapacitetet profesionale të Agjencisë. Duhet ta ndihmojmë Agjencinë, po kërkojmë prej tyre angazhim më të madh, punë më të madhe, por duhet ta ndihmojmë që të kenë kapacitete profesionale dhe të kenë përkrahje financiare më të madhe edhe me rishikimin buxhetor të këtij vitin, në qershor apo kur do të bëhet për fitin 2010. Ju faleminderit, zoti kryesues!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Kosumi! Fjalën e ka deputeti Gani Geci.

GANI GECI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

I nderuar ministër,

Ne sot para veti kemi Raportin vjetor të Agjencionit Antikorrupsion, por çka na duhet raporti kur i gjithë populli i Kosovës po e sheh me sy korrupsionin në Kosovë. Çka na duhen letrat, që nëse ne i lexojmë, të gjitha këto letra dhe parametrat e tyre ka ngritje

prej 40, 37 deri në 45% të rritjes së korrupsionit. Rasti më i fundit, rasti i para disa ditëve, jep për të kuptuar se ministrinë e Qeverisë së Republikës së Kosovës, konkretisht ato ministri që kanë buxhet më së tepërmi, janë skajshmërisht të korruptuara. Ne kemi të korruptuar në njëfarë forme edhe Policinë, për shkak se në mes të Policisë, në shtëpinë e tyre vidhen, askush lëre që nuk ndien përgjegjësi morale, po as përgjegjësi politike.

Sikur të kishte pak moral në politikë dhe sikur të kishte vetëm pak burrëri në politikë dhe sikur politikanët të ishin pak të ndërgjegjshëm, rasti që ka ndodhur dje, në shtetet perëndimore, në shtetet me një demokraci pak më të fortë, më të mirëfilltë, dikush do të jepte dorëheqje. Vetëm te ne ndodhë që gjithë kompjuterët, gjithë dokumentacioni i një shteti, i një ministrie merret nga policia e të nesërmen të gjithë punëtorët shkojnë në punë. Shkojnë në punë dhe nuk kanë ku të shkruajnë dokumente për shkak se kompjuterët e tyre i kanë marrë policia. Atëherë, unë sinjerisht këtë që po e them, po e bazoj në atë që po e shohim, nuk po flas këtu për vitin 2009, sepse në vitin 2009 i kemi të shkruara në letër vetëm ato çka i ka shkruar Agjencioni dhe po ju them sinjerisht, punëtorët e Agjencisë Antikorrupsion nuk guxojnë t'i bien kah disa ministri, rrugës kah është ministria nuk guxojnë t'i bien, e lëre më të hyjnë në ministri dhe të marrin ndonjë dokument aty. Dhe, duke pasur parasysh këtë çka na shkruajnë ata këtu, na shkruajnë se kemi në përqindje të rritur, kemi lajmërimë, ç'lajmërimë, nuk kemi pasur fakte, kemi fakte, por fakti kryesor qëndron aty kur Qeveria e Republikës së Kosovës çdo mbrëmje detyrohet të mbaj mbledhje deri në orët e vona me gjithë stafin ndërkombëtar mu për këtë shkak, mu për korrupsionin dhe nëse nuk ka fakte, këtu dikush duhet të shkojë. Çka na vyen EULEX-i, nëse nuk ka fakte dhe ka bastisur Ministrinë, e ka bastisur shtetin. Çka na duhet ai EULEX, ose çka na duhet ai ministër, nëse ka fakte dhe është prapë ministër, çka i duhet këtij populli një ministër që është i korruptuar? Atëherë këtu dikush duhet të shkojë, ose duhet të shkojë EULEX-i prej shpije ose duhet të shkojë ministri që e kanë bastisë, sepse nuk ka mundësi për korrupsion, të dytë të kenë të drejtë, edhe EULEX-i që e ka bastisur, edhe ministri që, ta zëmë, nuk është fajtor.

Qytetarë të nderuar, por edhe deputetë të nderuar, ne ka kohë që e rrejmë popullin, e rrejmë e plaçkitim deri në atë masë sa edhe, po them sinjerisht, ta zëmë, një ubot që hynë (dhe për këtë le të ndien pak EULEX-i, ndoshta marrin masa), që hyn në kufirin në Han të Elezit, ndalet në një trafikë dhe i lë dy litra naftë dhe ata 20 mijë ubote që hyjnë, i lënë 40 mijë litra naftë për shkak të laboratorit që ka për t'i bërë analizat e naftës. Hajde ta zbërthejmë se sa po bëjnë 20 mijë litra naftë, mesatarisht nëse ia zbresim çmimin për gjysmë, janë 20.000 euro dhe 12 muaj janë 200.000 euro. Kush po i merr ato? Këtu ka korrupsion të kulluar, me nga një litër naftë. Është shumë e vërtetë që nëse do populli, një njeri e bë pasanik. Nga 1 euro ia jap dhe ai bëhet milioner dhe 2 milion euro i bën dhe nuk duket, askujt nuk ia lë shenjë. Edhe atyre që marrin naftë dhe ia dhënë nga 1 litër, kurrë nuk ka problem në këtë drejtim, nga një litër naftë e kanë dhënë dhe i kanë bërë 200.000 euro.

Ne kemi probleme edhe në raportin e shkruar, që kemi probleme në pjesën Veriore të Kosovës, ku disa komuna nuk kanë raportuar as si raport dhe ne i kemi tërhequr doganat tona, i kemi prurë në Zveçan dhe te varret ortodokse në Mitrovicë, ndërsa te Dudi-Kërshi, një 200 metra më tej, ubotet ndalen aty, ka kontrabandë, korrupsion, aty shkarkohet kafe, aty shkarkohet alkool, aty shkarkohet gjithçka, çka nuk shkarkohet aty te Dudi-Kërshi dhe askush prej institucioneve të Qeverisë së Republikës së Kosovës nuk merret me këtë çështje, sepse nuk ka raport për Zveçan, për Leposaviq e Zubin Potok, nuk ka raport. Ata nuk e njohin shtetin e Kosovës. Dhe, një njëfarë forme bashkësia ndërkombëtare po tenton që atë pjesë ta quaj Kosova Veriore. Askush prej

institucioneve tona nuk reagon që ajo nuk është Kosovë Veriore, por është pjesë e Kosovës, sepse Kosova serbe, Kosova Veriore dhe Kosova Jugore, e dini çka janë Koreja Jugore dhe Koreja Veriore.

Prandaj, nëse ne e lexojmë me vëmendje raportin dhe shohim në bazë të raportit, del se institucionet e Republikës së Kosovës, në krahasim me vitin 2008, janë 40.7% më të korruptuara se në vitin 2008. Por, nëse e marrim një krahasim të vitit 2009, ose tremujorin e parë të vitit 2009, me tremujorin e parë të vitit 2010, mendojmë që çka na del këtu, mendojmë për shkak se në këtë rast, në vitin 2010, janë infiltruar edhe bashkësia ndërkombëtare që të mund ta ndalë korrupsionin. Po ju them sinjerisht, nëse në një tender, sepse hajnitë nuk po bëhen tjetër kund, vetëm nëpër tenderë, nuk ka hajni askund tjetër, se nuk ka mundësi edhe të bëhet, se nuk ka ku të vjedhë tjetërkund, por nëse në një tender milionësh ose 5 milionësh ose 10 milionësh, ka çmim prej 4 milionëve dhe i jepet puna një tenderuesi me 8 milionë, këtu nuk do koment, çka kemi për të komentuar ne, vetëm e marrim raportin dhe e shohim se aty ka korrupsion, sepse parametrat e secilës punë shënohen në tender dhe ai që e merr letrën për tenderim, i ka parametrat e njëjtë sikur ai tjetri që e qet çmimin. Këso raste kemi, x raste kur tenderët jepen me miliona euro me çmim më të lartë dhe prapë ne themi se nuk ka korrupsion në Qeverinë e Republikës së Kosovës, veç po na e ka dynjaja inati, se na jemi më të mirët.

Kosovës nuk ia ka bota inati, aq më pak miqtë ndërkombëtarë që na kanë ndihmuar që të çlirohemi, por ne pak ia kemi vetit inati, po ia mbyllim dyert vetit, që as mos të mund të shkojmë në Bashkimin Evropian dhe si vend i vetëm të mbetemi të izoluar për viza për shkak të korrupsionit dhe krimit të organizuar. Tash edhe institucionet më të larta duhet të merren çdo ditë, edhe kryetari i Kuvendit, e thërrasin për çdo ditë, hajde ndihmona se mbaruam. Po them sinjerisht, Qeveria e Republikës së Kosovës është në hall, është në hall, sepse nuk po di a ta dëgjojë EULEX-in, a t'i dëgjojë ministrat e vet. Prandaj, të nderuar qytetarë, i nderuar kryetar, unë kisha kërkuar edhe nga ju, që ta përdorni autoritetin e juaj, që ne si Kuvend i Republikës së Kosovës t'i adresojmë të gjitha problemet që i ka Kosova, edhe korrupsionin, sepse taksat që i paguajnë qytetarët e Republikës së Kosovës janë edhe tonat, edhe të fëmijëve tanë dhe ne duhet t'ua hapim rrugën fëmijëve tanë që të shkojnë në Evropë dhe për me shkua në Evropë, në këtë formë i kemi rrugët e mbyllura. Ju faleminderit!

Drejtimin e seancës e merr zoti Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti, Ibrahim Gashi.

IBRAHIM GASHI: Ju faleminderit, kryetar!

Sigurisht që edhe koha kaq e vonë, që po e debatojmë një pikë kaq të rëndësishme pa transmetim të drejtpërdrejtë, edhe prezenca e vogël e kolegëve deputetë, e mbi të gjitha mungesa totale me një përjashtim, për të cilin kam respekt, e Kabinetit qeveritar, nuk flet shumë për seriozitetin e punës tonë, aq më tepër përballë temës që e kemi sot për ta debatuar.

Sidoqoftë, unë do t'i them fjalët ndoshta më të mira për punën që ka bërë një Agjencion, konform kompetencave tepër të mëdha që i ka me Ligjin kundër korrupsionit. Ne e kemi aprovuar një ligj për të cilin subjekti ynë ka pasur vërejtje se krejt lufta e korrupsionit, kundër korrupsionit në Kosovë, i ngarkohet ose i jepet si kompetencë këtij agjencioni, i cili ka fuqinë që të përballë me këtë sfidë, me të cilën përballen sot shoqëritë postkomuniste me të madhe, është sfidë tepër e madhe përballë një fuqie që ka ky

agjencion shumë të vogël dhe, thashë, do ta përshëndes raportin, sepse përkundër kësaj fuqie të vogël, përkundër kapaciteteve të kufizuara, përkundër mbështetjes po ashtu jo shumë të madhe dhe përkundër kapaciteteve logjistike dhe të ekspertëve që i ka, por mbi të gjitha të fushës dhe hapësirës që i lejohet për të punuar, e ka bërë një raport mbi punën e tij, që flet se ka pasur punë dhe në njëfarë mënyre është munduar që ta implementojë rolin e vet konform ligjit të cilin ky Kuvend e ka miratuar. Por, shqetësuese mbetet sigurisht rritja e rasteve që ky agjencion i ka evidentuar, krahasuar vitin 2008 me vitin 2009, dhe ky shqetësim rritet, sepse përkrah të këtij agjencioni, si mekanizëm i brendshëm që përcjell shkallën e korrupsionit dhe përpiqet ta luftojë, janë edhe mekanizmat tjerë ndërkombëtarë që mbledhin të dhëna dhe i përgatisin për raportet e radhës edhe të progresit të Komisionit Evropian, por edhe raportet tjera. Dhe kjo është, thjeshtë, një frikë se do t'i kemi të rritura edhe në këto raporte për masat e rritjes së korrupsionit në këtë në ndërkohë.

Nga ana tjetër, fakti tjetër shumë shqetësues mbetet që implementimi i këtyre rasteve që i ka identifikuar, përkatësisht është munduar t'i provojë ky Agjencion para organeve të drejtësisë, injorimi nga ana e këtyre të fundit për t'i trajtuar si raste oste trajtimi minor, në numër shumë të vogël i tyre deri më tash, jep për të kuptuar se ky agjencion që në start është i dekurajuar për të kryer punën e vet. Mbi të gjitha, këtu u përmend edhe nevoja e rishikimit të ligjit. Ne diçka duhet të bëjmë, se edhe atëherë kemi thënë që një agjencion si ky, që nuk ka mekanizma ekzekutiv dhe nuk ka si të ketë, nëse nuk ka edhe mekanizma tjerë qeveritarë që e suportojnë, përkatësisht e komplementojnë punën e tij, e ka të vështirë ta bartë këtë barrë që ia kemi dhënë. Unë po e shikoj këtë, pjesën e fundit të raportit, ku ata mëtojnë t'i realizojnë disa përgjegjësi ligjore të tyre në luftimin e korrupsionit përmes Departamentit të parandalimit. Me të vërtetë janë veprime të rënda që ky agjencion nuk mundet t'i çojë, shihet mirëfilli që nuk mundet t'i çojë. Unë nuk po dua të them bash ashtu, në mënyrë të ekzagjeruar se nuk guxon t'i thuash, po edhe po t'i thotë, nuk zgjidhet, përkatësisht neglizhohen nga mekanizmat tjerë. Prandaj, në përmbyllje, ne si grup parlamentar, e tha edhe shefi i grupit, e mbështesim punën e këtij agjencioni, e inkurajojmë që të vazhdojë edhe në të ardhmen, ofrojmë në njëfarë mënyre bashkëpunimin për aq sa na lejohet, por e konsiderojmë si mekanizëm që ka një barrë të madhe përballë të cilës duhet të mendojë krejt shoqëria se si të dilet dhe jo vetëm një agjencion. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputetja Sanije Alijaj.

SANIJE ALIJAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar ministër,

Të respektuar deputetë,

Edhe përkundër përkushtimit të Agjencionit Kundërkorrupsion në zbulimin dhe hetimin e rasteve korruptive, Raporti i prezantuar sot, por edhe raportet tjera të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare, të ndërlidhura me shpenzimet e parasë publike, janë shqetësuese për përmasat që ka marrë korrupsioni në Kosovë.

Raporti prezanton aktivitetin gjithëpërfshirës të agjencisë për realizimin e mandatit ligjor për luftimin dhe parandalimin e korrupsionit. Sipas Ligjit kundër korrupsionit, mekanizmi themelor që heton dhe parandalon korrupsionin është Agjencioni Kundërrorrupsion, i cili punën e vet e mbështet në tri shtylla: luftimi i korrupsionit, parandalimi i korrupsionit, si dhe edukimi i opinionit për evitimin e kësaj dukurie.

Departamenti i hetimeve të Agjencionit Kundërkorrupsion gjatë vitit 2009 ka pranuar 175 raste apo informata të raportuara nga qytetarët, të cilët kanë qenë viktime të veprimeve korruptive nga zyrtarët e lartë publikë.

Sipas Agjencionit Kundërkorrupsion, ky është indikacioni i rritjes së besimit të qytetarëve për raportimin e rasteve korruptive. Por, unë do të shtoja sa është indikacioni i rritjes së korrupsionit, se në përqindje i bie se janë pranuar 34.1% më shumë informata se në vitin paraprak.

Agjencioni Kundërkorrupsion pas zhvillimit të procedurës hetimore dhe sigurimit të provave ka dorëzuar në Prokurinë Publike kompetente denoncime në lidhje me dyshimet korruptive për 159 raste të zyrtarëve të lartë, që krahasuar me vitin paraprak ka rritje për 45 raste apo 40.7%.

Raportet e ndryshme të institucioneve vendore lidhur me indeksin e korrupsionit në Kosovë japin një pasqyrë që veprat penale kundër korrupsionit përbëjnë numrin më të vogël të veprave të hetuara nga organet e ndjekjes, por përbëjnë edhe vepra penale për të cilat më së paku janë shqiptuar dënime, me arsyetim për shkak të kompleksitetit të veprave penale. Kjo ilustron me faktin se nga 175 raste të paraqitura në vitin 2009, 103 raste janë të mbyllura, 68 janë përcjellë në Prokurori, 26 raste janë në procedurë.

Që nga funksionimi i Agjencionit Kundërkorrupsion deri me rastin e raportimit në Prokurorinë kompetente dhe në Prokurorinë e EULEX-it janë përcjellë 168 informata, prej të cilave prokuroritë kanë dhënë informata kthyesë, si vijon: 60 raste janë në procedurë hetimore, në 5 raste është ngritur aktakuza, 5 arrestime janë kryer ndaj personave të dyshuar, 36 informata janë hedhur poshtë dhe për 62 informata nuk ka kurrfarë informate kthyesë nga prokuroria. Kjo lë përshtypjen se ose Agjencioni Kundërkorrupsion nuk e bën punën e vet, ose prokuroria nuk është duke i hetuar rastet, por është duke i prolonguar ose duke i mbyllur me vetë faktin se vetëm për 5 raste është ngritur aktakuza dhe 5 raste janë të dyshuar, kur dukuria e korrupsionit është bërë lajm i përditshëm në media. Pra, nëse nuk funksionon zinxhiri agjencion – prokurori – gjykatë, nuk mund të hetohet, të ndiqet dhe të ndëshkohet korrupsioni, e atëherë nuk mund të flasim se funksionojnë institucionet demokratike me standarde bashkëkohore.

Sa i përket tabelës, deklarimi i pasurisë në afatin e parë, nga 800 raste, pra që kanë pasur për obligim për të dhënë informata, 173 nuk e kanë deklaruar pasurinë. Thjeshtë, me këtë rast më intereson, cilat janë masat dhe veprimet konkrete që do t'i marrë Qeveria dhe institucionet tjera kundër individëve që nuk e nderojnë veten, në radhë të parë, se lëre më institucionet me veprimet e tyre, kur ata veprojnë. Individëve të tillë duhet t'u shembim dheun nën këmbë dhe duhet dënuar sepse me veprimet e tyre pengojnë Kosovën për t'u plotësuar standardet bashkëkohore që Kosova ka si synim për t'u inkuadruar në institucionet ndërkombëtare.

Sa i përket shtyllës së dytë – Parandalimi i korrupsionit, në faqen që ka të bëjë me deklarimin e pasurisë së zyrtarëve të lartë, lë një përshtypje jo të mirë, sepse 375 përfaqësues të institucioneve kanë mungesa në mënyrën e plotësimit të formularëve, duke iu shmangur deklarimit të të dhënave për pasurinë e tyre të krijuar.

Edhe në këtë raport paraqitet kompleksiteti i korrupsionit për nga natyra dhe laramania e faktorëve që ndikojnë në të. Për shkak të këtij kompleksiteti, lufta është e vështirë, e gjatë dhe duhet zhvilluar në disa fronte. Ky raport rezulton me opinionin se faktor kryesor për

hetimin dhe luftimin e korrupsionit janë gjykatat në Republikën e Kosovës. Por, si të jenë gjykatat në nivelin e detyrës, kur numrin më të madh të rasteve të dyshuara në këtë raport e zënë vetë gjykatat, që konsideroj se për të qenë efikase, kërkohet një reformë rrënjësore e gjykatave për funksionalizimin e mirëfilltë të tyre.

Konsideroj se Ligji kundër korrupsionit duhet të rishqyrtohet dhe të begatohet me dispozita që obligojnë gjykatat që ato në afatin e duhur t'i shqyrtojnë denoncimet që i bën Agjencioni Kundërkorrupsion.

Në fund, konsideroj se deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës duhet me përkushtim të monitorojnë zbatimin e ligjeve, që është parakusht për evitimin dhe parandalimin e dukurive të pamira në Kosovë.

Në fund, e vlerësoj këtë raport, edhe pse jam e vetëdijshme se raporti prezanton një pjesë të vogël të asaj çka po ndodh në Kosovë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputetja Rita Hajzeraj.

RITA HAJZERAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

I nderuari i vetmi ministër sot në seancë plenare,

Më erdhi mirë nga parafolësja që dëgjova që po e pranon se ka korrupsion në Kosovë. Edhe ne jemi dakord që ka korrupsion në Kosovë. Disa parafolës të tjerë të cilët janë nga Qeveria e Kosovës, që janë pjesë e koalicionit qeveritarë, e pranuan këtë raport dhe më e keqja është se ky raport flet shumë më keq se vitin e kaluar, që do të thotë se korrupsioni është në rritje e sipër.

Që në fillim dua të jap vlerësimet e mia pozitive për formën në të cilën është hartuar ky raport, por fatkeqësisht jo edhe për përmbajtjen sepse përmbajtja, siç thashë, është jashtëzakonisht e rëndë edhe e keqe për situatën tonë.

Të nderuar kolegë, ky raport e bën publike një fakt shumë negativ për të ardhmen tonë. Këtu është shkruar, sipas të gjitha statistikave të cilat i tregon raporti, sepse ka pranuar një numër dukshëm më të madh të rasteve të dyshuara për veprime korruptive. U përmend edhe më herët se ka jashtëzakonisht shumë raste, çka do të thotë 175 raste, e nëse i kthejmë në përqindje, kjo i bien që janë 34.61% më shumë raste se në vitin paraprak.

Fatkeqësia më e madhe është se në realitet numri i rasteve të korrupsionit është shumë më i madh, por këto raste të cilat i ka raportuar AKK-ja, dyshoj se janë vetëm disa nga ato që kanë arritur të zbardhen si rezultat i kontributit të madh të qytetarëve të Kosovës.

Në luftimin e këtij fenomeni qytetarët e Kosovës janë munduar, mirëpo nuk kanë arritur atë lirinë sa do të duhej që rastet të identifikohen në masën qysh ne kërkojmë dhe si agjencioni kërkon.

Unë besoj që falënderimin e madh duhet ta marrë edhe udhëheqësi i Agjencionit Antikorrupsion, së bashku me punëtorët e tij, duke pasur parasysh që nuk ka një përkrahje adekuate nga shtyllat tjera të shtetit - ekzekutivi edhe gjyqësori që do të duhej të merrnin masa. Ne para dy muajsh, më pak se dy muaj, e kemi miratuar Ligjin për

Agjencionin Antikorrupsion dhe besoj që aty qartas shihet dhe ne jemi ata deputetë që e kemi hartuar atë ligj, kur këtu u dhanë edhe disa vërejtje për atë ligj dhe unë mendoj që në bazë të kompetencave në të cilat bazohet, ky Agjencion Antikorrupsion e ka kryer punën e tij jashtëzakonisht mirë, sepse detyrë e tij nuk është ekzekutimi i vendimeve, detyrë e tij është identifikimi i veprimeve, ndërsa ekzekutimi i vendimeve është nga një organ tjetër, ku besoj që 90% e deputetëve të Parlamentit të Kosovës u pajtuan që mungon.

Shqetësim i madh është se korrupsioni i cili tashmë padyshim ka marrë përmasa të një fenomeni, ka kapur institucionet më të larta shtetërore dhe, më e keqja, pikërisht institucionet të cilat duhet ta luftojnë këtë fenomen, prijnë nga rastet në këtë raport. Pra, gjykatat e Republikës së Kosovës, institucionet të cilat duhet ta ndajnë drejtësinë edhe të cilat e kanë për obligim ligjor ta luftojnë korrupsionin, janë renditur të parat me 53 raste.

Po ashtu, të korruptuara i gjejmë edhe institucionet tjera të drejtësisë, të cilat duhet t'i hulumtojnë rastet e dyshuara për korrupsion, e që janë prokuroritë e Republikës së Kosovës, tek të cilat është identifikuar gati trefishimi i shpërndarjes së këtij fenomeni krahasuar me vitin paraprak të raportimit.

Nëse gjykatat qenkan të korruptuara, sigurisht me disa përjashtime, sikur edhe prokuroritë, atëherë luftimin e këtij fenomeni përmes formave të ndryshme duhet ta bëjnë institucionet tjera shtetërore, për shembull ekzekutivi i vendit. Ende nuk kemi pa vendim konkret apo veprim konkret të ekzekutivit për ta luftuar këtë dukuri negative, sepse pikërisht nga ky segment shtetëror janë evidentuar 34 raste që lidhen me veprime korruptive, do të thotë nga ekzekutivi.

Të nderuar kolegë, luftimi i këtij fenomeni me qëllim të zvogëlimit të tij, sepse zhdukja e tërësishme e tij është po thuaj se e pamundur, duhet të jetë prioritet i të gjitha institucioneve të vendit. Them prioritet, sepse zhvillimi i mëtejshëm i këtij fenomeni ndikon në të ardhmen e këtij vendi dhe jo vetëm në ngecjen e zhvillimit ekonomik të vendit, por edhe në integrimin e tij në strukturat euroatlantike. Ndërsa në këtë raport nuk na del se ne po ndërmarrim hapa të mjaftueshëm në këtë drejtim dhe kjo situatë jashtëzakonisht është shqetësuese.

Para më shumë se dy muajsh, konkretisht në muajin shkurt, Qeveria e Republikës së Kosovës me shumë pompozitet medial tha se në bashkëpunim me strukturat e EULEX-it do të themelojë Task Forcën kundër korrupsionit. Përveç faktit se edhe pas dy muajve kjo Task Forcë ende nuk është funksionalizuar, kam frikë se edhe pas funksionalizimit të saj ajo të mos arrijë ta kryej rolin e saj, sepse për ta luftuar këtë fenomen, duhet të jesh i pastër karshi tij.

Ndërsa ditëve të fundit u zbulua se edhe ata që për mandat kanë sundimin e ligjit në Kosovë, na qenkan të korruptuar. As këtu nuk dua të përgjithësoj dhe të them se të gjithë pjesëtarët e EULEX-it janë të korruptuar, por fatkeqësisht dhe fatkeqësi e madhe që pikërisht ata nga të cilët pritnim me të drejtë se do të na ndihmonin në luftimin e korrupsionit, qenkan të korruptuar apo u korruptuan. Nga ky rast besoj se duhet të marrim mësim të madh se prijës në luftimin e korrupsionit duhet të jemi vetë ne dhe jo organizatat ndërkombëtare. Pra, të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës, sepse përndryshe mund të zhgënjehemi në vazhdimësi sikur edhe këtë herë.

Duke përfituar nga ky rast, më lejoni që për fund të kërkoj nga të gjitha institucionet e Kosovës dhe kryesisht nga ekzekutivi i Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës që të mbështesë çdo kërkesë të saj që është bërë nga Agjencioni Kundërkorrupsion, duke ia bërë më të lehtë luftën kundër kësaj dukurie, sipas mandatit që e ka përcaktuar me ligj ky Kuvend. Po ashtu, dua të ju uroj për guximin për të gjithë punëtorët e AKK-së, për punën e madhe që po bëjnë, sikur edhe të gjithë qytetarët për bashkëpunimin që i kanë afruar këtij agjencioni, duke ia lehtësuar identifikimin e rasteve që janë përfshirë në afëra korruptive, sepse korrupsioni mund të luftohet vetëm me angazhimin e gjithë neve. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Driton Tali, le të përgatitet Ramadan Avdiu.

DRITON TALI: Faleminderit!

Po, tash është pak si problem të flitet pas gjithë atyre fjalimeve sharmante, fjalimeve intelektuale që na i dhanë parafolësit. Po, megjithatë, do t'i them disa fjalë.

Kështu, më lejoni fillimisht ta përkrah këtë raport, s'di se a kemi të drejtë ta votojmë, nuk dhamë ndonjë rekomandim, por megjithatë. Po, ajo që desha ta them është një kritikë për Agjencionin Antikorrupsion, se unë e lexova raportin, por askund nuk janë 16.200.000 euro të çekut të Agjencionit Rregullativ të Telekomunikacionit dhe asnjë kritikë nuk i është dhënë Kuvendit, pse Kuvendi nuk e hulumton ku është ai çek. Kur them Kuvendi, u mor vesh, mendoj për Kryesinë e Kuvendit, sepse kjo është neglizhencë, bile, bile është edhe pjesëmarrje apo kontribut në korrupsion. Ministri i Ekonomisë dhe Financave, i nderuari zoti Ahmet Shala tha se, para dy muajve tha se çeku ekziston në ART, është, vlen deri në vitin 2011 dhe pse nuk deponohet në Thesar, aty ku e ka vendin. Nga ana tjetër, tha se ajo është kompetencë e Kuvendit, nuk di se Agjencioni Antikorrupsion a e di këtë, për ta kritikua, po them, Kuvendin – pse nuk i ushtron kompetencat e veta dhe flasim për 16.200.000 euro, që është një shumë goxha e madhe. Po them, Kuvendi, sepse për t'ua rikujtuar kolegëve të nderuar, sidomos të koalicionit ... qeveritar, se e ka votuar apo e ka zgjedhur këtë udhëheqësi të ART-së, udhëheqësi shumë e dyshuar. Andaj, edhe po them, edhe nga mëkatet e të votuarit për ta, por edhe nga kompetencat ligjore që i kanë, mendoj se duhet pa tjetër të përdoret autoriteti ynë dhe të kërkohet për çekun ku është, pse nuk deponohet në Thesar dhe çka duhet ne të bëjmë që ai çek më në fund të dorëzohet në Thesar, nëse veç ekzistua.

Unë kam parasysh se disa deputetë të nderuar të koalicionit qeveritar nuk e kanë votuar me shpirt, po them, atë udhëheqësi, por për t'ua bërë hatrin shefave të vet, tash jemi në përfundim të këtij legjislacionit, shpejt na vinë zgjedhjet, siç thuhet ajo "Qengji i mirë i thithë dy nëna, e thithë edhe dashin", duhet të mendohet për zgjedhjet e radhës, e kështu... Faleminderit!

(Ndërprerje e incizimit)

KRYETARI: Do të thotë, Dritoni e ka fjalorin e vet parlamentar. Fjalën e ka deputeti Ramadan Avdiu.

RAMADAN AVDIU: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar ministër,

Të respektuar kolegë deputetë,

Vërtet, tash thuajse në fund të debatit pak ka mbetur edhe për t'u thënë lidhur me raportin. Mirëpo, ajo çka më shtyri unë ta marrë fjalën, është që t'ua përkujtoj juve si

deputetë se ne po diskutojmë sot për një agjencion i formuar mbi bazën e ligjit dhe i formuar nga ky Kuvend, jo nga Qeveria, për një agjencion i cili raporton Kuvendit dhe nuk i raporton Qeverisë. Prandaj, nuk është domosdoshmërisht apo nuk është e domosdoshme që kur debatohet për agjencionet që i ka formuar Kuvendi, të jetë e pranishme e gjithë Qeveria në Kuvend dhe atë gjithë ditën për të dëgjuar jo përralla dhe mualife, si thonë gjakovarët, sepse vërtet janë edhe disa kolegë deputetë të cilët vinë në seanca me paragjykime, të përgatitur me batare dhe presin vetëm momentin për t'i zbrazur ato batare qoftë kundër Qeverisë, qoftë kundër ndonjë kolegu apo kundër ndonjë institucioni, gjithmonë duke dalë jashtë rendit të ditës.

Rast konkret ishte edhe tash. Ne nuk mund të paragjykojmë, nuk mund të hyjmë me paragjykime, nuk mund të akuzojmë njeriun vetëm pse ia kam zili që është në një pozicion ose vetëm pse ia kam zili që është në pushtet apo pjesëtar i partisë në pushtet, gjë që po ndodh nga disa kolegë të cilët vërtet meritojnë që ta humbin respektin që mund ta kemi ne si partinë në pushtet për ta.

Dua të ndalem konkretisht tek ngjarja para tre ditësh, e pardjeshme, në Ministrinë e Transportit, që u apostrofua nga disa kolegë deputetë, nga disa debutues, të cilët në një mënyrë përpiqen të prejdukojnë ose të paragjykojnë se si do të jetë epilogu i krejt kësaj. Aty EULEX-i mund të dyshojë, organet e drejtësisë mund të dyshojnë, por dyshimet do të vërtetohet dhe krahas vërtetimit atëherë edhe mund të hapet debati dhe të debatohet, pse jo edhe në parlament.

Raportin e vitit të kaluar të Agjencionit Kundërkorrupsion, ka qenë qëndrim unanim edhe i të gjitha grupeve parlamentare, edhe i institucioneve tjera që çdo kërkesë që e bën Agjencioni Kundërkorrupsion të mbështetet, gjë që edhe ka ndodhur edhe me Buxhetin e vitit 2009, sidomos në Buxhetin e vitit 2010. Aq sa ka kërkuar, mbase është e vetmja organizatë buxhetore, aq sa ka kërkuar Gjyqësori Antikorrupsion, edhe i është alokuar buxheti. Prandaj, në Raportin e vitit 2009, shihet që Agjencioni brenda kompetencave të veta ligjore e ka kryer punën e vetë mirë, gjë që është për t'u përshëndetur.

Mua nuk më vjen keq dhe nuk jam i shqetësuar pse numri i rasteve të paraqitura është më i madh në vitin 2009 se në vitin 2008 dhe mbase këtu do ta inkurajoja edhe Agjencionin Antikorrupsion, edhe Qeverinë, edhe institucionet tjera që të sforcojnë dhe ta intensifikojnë një fushatë të vetëdijësimit që qytetarët të bashkëpunojnë jo vetëm me Agjencionin Antikorrupsion, por edhe me institucione të tjera të cilat e luftojnë këtë dukuri kaq të dëmshme jo vetëm në shoqërinë tonë, sepse korrupsioni është një dukuri e përhapur në gjithë regjionin.

Unë e mbështes raportin dhe njëkohësisht e inkurajoj Agjencionin Antikorrupsion që të vazhdojë me aktivitetet e tija në luftën kundër korrupsionit, por njëkohësisht i ftoj edhe institucionet tjera të jenë më bashkëpunuese, e sidomos në këtë rast, organet investiguese dhe prokurorinë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Naim Rustemi, le të përgatitet Naim Maloku.

NAIM RRUSTEMI: Naim mbas Naimi.

Po, unë një herë dua ta nisë me kolegun këtu në anë të majtë timen, Driton Talin, t'i them se qengji i butë s'i thithë veç dy nëna, tash me të renë e thithë kopenë.

Po vazhdoj, po i kthehem raportit. Raporti, është e vërtetë që është i shkruar shumë mirë, po sigurisht që ka edhe disa mangësi të veta, mangësi të veta dhe normalisht që ka hapësirë që të përmirësohet edhe më tutje për të ardhmen. Për shembull, nëse do t'iu referohemi informatave të procedura sipas strukturës së veprave penale, unë lirisht publikisht mund t'i them Agjencionit Antikorrupsion se nën pikën - Lidhja e kontratave të dëmshme, nuk ka pasur nevojë as të harxhohen para, ka pasur nevojë të qëndrojnë në Kuvend edhe t'i identifikojë lidhjet e kontratave të dëmshme që bëhen nga institucionet përgjegjëse në Kosovë. Edhe raportimi i vetëm një kontrate të dëmshme që është proceduar në Prokurori, për mendimin tim dhe për faktet që janë prezantuar në këtë sallë të Kuvendit gjatë mundësive të ndryshme, nga ma të ndryshmet, duke filluar prej pyetjeve parlamentare, e tejkalon shumë, shumë herë numrin një. Po, gjithashtu, ne jemi të vetëdijshëm se obligimi i Agjencisë Antikorrupsion është që të përcjellë te Prokuroria e Kosovës çdo informatë lidhur me aferat korruptive, me fjalë të tjera nuk i takon atij sistemit të drejtësisë, gjyqësorit, prokurorisë apo edhe avokatisë, por hapësira për punën e mëtutjeshme ekziston në Kosovë dhe nuk është shumë e rëndë që të shihet se në Kosovë lidhen kontrata nga më të llojllojshmet.

Gjithashtu, do t'i referohem edhe një letre që unë ia kam dërguar personalisht, ia kam dërguar Kryesisë së Kuvendit lidhur me parandalimin e konfliktit të interesit. Dhe Agjencioni Antikorrupsion e ka raportuar se nuk është konflikt interesi gjatë ushtrimit të funksionit publik. Kam dash që të ngreh në njëfarë forme ndërgjegjësimin edhe të deputetëve, se nuk janë të lejuar të kryejnë punë të tjera. Kjo për mendimin tim i adresohet agjencionit që të kryejë punën e vet në formë ligjore dhe ashtu siç duhet. Edhe pse është përgjigj pozitivisht se kanë të drejtë të kryejnë edhe detyra të tjera, unë nuk mund ta di si është e mundshme që një njeri të jetë në dy vende njëkohësisht. A ka mundësi që njeriu të jetë edhe në sallën e Kuvendit, edhe në vendin e punës. Me lidhjen e kontratës së punës, ai obligohet që të punojnë 40 orë dhe jo me orë fleksibile, por me orar të caktuar. Si është e mundshme që të jetë edhe në udhëtim zyrtar një javë dhe ta marrë rrogën prej organizatës punuese? S'është e mundshme. Me fjalë të tjera, këto veprime do të duhej të ishin të reflektuara në Raportin e Agjencisë Antikorrupsion, sepse duke mos tentuar që të hapet debat lidhur me Ligjin për parandalimin e konfliktit të interesit gjatë ushtrimit të funksionit publik, sepse është barë e zi, është pastër. Po, pyetja ime është, si dhe pse a thua e komentuan në atë formë, se s'kanë pasur të drejtë ta komentojmë, sepse zyrtari nuk ka të drejtë të kryejë funksione të tjera dhe punë të tjera përpos atyre që përcaktohen me ligj, as logjikisht dhe as nga aspekti legal nuk lejohet një formë e tillë. Kjo ishte sa për parandalimin e konfliktit të interesit.

Çuditërisht, në tabelën 18, ku janë paraqitur në formë tabelare rastet e konfliktit të interesit të vitit 2009, dominojnë Kuvendi i Kosovës dhe Qeveria e Kosovës. Institucionet tjera, edhe në rastet që janë në procedurë, nuk marrin pjesë me asnjë, përpos këtyre dy institucioneve. Ndoshta edhe ky diskutimi im do të shërbej nga Kryesia e Kuvendit që të marrë hapa më radikal lidhur me parandalimin e konfliktit të interesit nga ana e zyrtarit.

Raportin në përgjithësi mund ta trajtojmë se është shumë pozitiv, është pozitivë duke pasur parasysh se ka filluar të eksploatohet në një formë që njerëzit të mos hezitojnë të procedojnë me rastin në prokurori. Po, në krahasim me nivelin e korrupsionit në shoqëri, ne jetojmë në Kosovë me 10 mijë kilometra katrorë, 2 milionë banorë, nuk mundemi ta fshehim njëri – tjetrin. Numri i rasteve të paraqitura, të hulumtuara nga Agjencioni është parimisht i vogël kundrejt rasteve që paraqiten në jetën reale. Me kaq kisha për ta përfunduar këtë diskutim timin. Faleminderit për ndëgjim!

KRYETARI: Faleminderit edhe për racionalizëm!

Fjalën e ka deputeti Naim Maloku, le të përgatitet deputetja Nekibe Kelmendi.

NAIM MALOKU: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Pas këtij debati, në të cilin morën pjesë shumë deputetë, parafolës të mi, më mbetet vetëm t'i them disa fjalë shkurtimisht. Është inkurajuese dhe për t'u përshëndetur fakti se për tri vite, prej që ka filluar të funksionojë ky agjencion, është ndërtuar një agjencion funksional dhe i suksesshëm që i kryen detyrat në bazë të ligjit dhe të përgjegjësive që i ka. Pra, për t'u ndërtua një agjencion në aspektin strukturor dhe profesional në këtë nivel që të mund t'i kryej detyrat për tri vite, është kohë shumë e shkurtër dhe unë i përgëzoj të gjithë punonjësit e agjencionit që kanë arritur ta ngrisin një agjencion që mund të përballlet me detyrat dhe obligimet që i ka me ligj.

Unë e përshëndes dhe e pranoj këtë raport si të shkruar mirë, përveç me faktin se asnjë prej nesh, besoj, nuk mund të jetë i kënaqur me përmbajtjen e këtij raporti, me faktet se përqindja e rasteve të paraqitura për korrupsion në vitin e kaluar është rritur dukshëm në krahasim me vitin paraprak. Pra, kemi diku rreth 63.63% të rasteve që vinë për gjykata, 54% të rasteve për persona zyrtarë të nivelit lokal, diku 6.25% më shumë raste të Qeverisë, të institucioneve tjera, pra çdo kund kemi rritje.

Më lejoni, i nderuari zoti kryetar, të nderuar deputetë, ta inkurajoj Agjencionin Kosovar Kundërkorrupsion që të punojë më tepër në sigurimin e informacioneve sipas detyrës zyrtare. Pra, janë dy mënyra të sigurimit të informacioneve, kur qytetarët paraqesin rastet, por edhe agjencioni në bazë të ligjeve në fuqi ka kompetenca që të sigurojë informacione edhe sipas detyrës zyrtare. Pra, të rriten kapacitetet e Agjencionit që ata vetë të sigurojnë, të hulumtojnë dhe të sigurojnë informacione për korrupsionin.

E mora fjalën për këtë debat edhe në shenjë të respektit për të gjithë ata qytetarë që kanë pasur guximin dhe i kanë paraqitur rastet në agjencion dhe për t'i inkurajuar qytetarët e Kosovës që të bashkëpunojnë më mirë dhe më tepër me këtë agjencion.

Rekomandoj, pra, një rekomandim i imi është për Kuvend, një propozim, që Kuvendi t'i rekomandojë Prokurorisë dhe Gjyqësisë që rastet që vinë nga Agjencioni Kosovar Kundërkorrupsion t'ju japin përparësi në zgjedhjen e rasteve. Në bazë të tabelave që ne na u kanë paraqitur në këtë raport, pra shumë raste që janë të paraqitura në Prokurori nuk kanë informacione kthyes, pra nuk i kanë ofruar Agjencionit – a janë në hetim, apo nuk kanë bazë. Pra, ne mund të kërkojmë nga Ministria e Drejtësisë, Gjyqësia dhe Prokuroria që rastet që vinë nga Agjencioni Kundërkorrupsion të merren me prioritet dhe të kthehet përgjigja, janë apo nuk janë fakte mbi të cilat mund të ndërtohen akuza dhe mund të kryhen hetime. Faleminderit, për vëmendjen!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputetja Nekibe Kelmendi.

NEKIBE KELMENDI: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar zoti ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Nuk do ta zgjas shumë, por më nxitën dy diskutime të dy deputetëve, që thanë se i rekomandojnë ministrit të Drejtësisë dhe Kuvendit të Kosovës që të ndikojnë te gjykatat dhe te prokuroritë që t'i përshpejtojnë apo t'i marrin në shqyrtim rastet që i ka paraqitur Agjencioni Antikorrupsion. Kjo nuk është e mundur, nuk është e lejueshme, sepse

pushtetet janë të ndara, dihet cili është roli i Kuvendit, cili është roli i Qeverisë, cili është roli i gjykatave dhe ato janë institucione të pavarura.

Nga ana tjetër, unë mendoj që Agjencioni ka kryer një punë jashtëzakonisht të mirë, punën e ka kryer brenda afatit që ka. Mandati i Agjencionit Antikorrupsion buron nga tri ligjet, të cilat tani janë shtuar së fundi. Mandati i Agjencionit është grumbullimi i informatave dhe ai nuk ka rol operativ që të shkojë vetë t'i zhvillojë hetimet. Ai i grumbullon informatat që i vinë nga qytetarët apo që ia dërgojnë institucionet, organizatat, personat fizikë, juridikë e të tjerë dhe më pastaj këto informata i grumbullon. Na vjen keq që përmbajtja është e këtillë e këtij raporti, por kjo përmbajtje pasqyron realitetin e sotëm që mbretëron në Kosovë.

Përndryshe, qëllimet e Agjencionit dhe puna e tij është jashtëzakonisht e mirë sepse, fundi i fundit, Agjencioni si institucion i pavarur synimin kryesor e ka që të ndikojë në parandalimin e korrupsionit përmes grumbullimit të informatave, pastaj në përcjelljen e deklarimit të pasurisë të zyrtarëve të lartë publikë dhe në eliminimin apo përcjelljen e ekzekutimit të konfliktit të interesit.

Agjencioni punën e vet e ka kryer, por thashë realiteti është i tillë edhe na pëlqeu, s'na pëlqeu, ky raport reflekton realitetin dhe nuk kemi arsye që të mos e votojmë këtë raport të Agjencionit. Faleminderit!

Drejtimin e seancës e merr anëtar i Kryesisë, zoti Sabri Hamiti

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Kelmendi! Suzan Novobrdaliu.

(Reagim nga salla)

KRYESUESI: Jo, jo, s'ka përmendur emra, Bajram s'ka përmend. Një minutë, Bajram! Bajram Kosumi, replikë të shkurtër, një minutë Bajram!

BAJRAM KOSUMI: Me qenë se zonja Nekibe e përmendi kërkesën time që unë ia drejtova ministrit të Drejtësisë që të kërkojë nga gjykatat e prokuroria të përshpejtojnë punën në të gjitha rastet e dyshuara për korrupsion, zonja Kelmendi e kundërshtoi këtë duke thënë se pushtetet janë të ndara. Është një çështje jo që pushtetet janë të ndara dhe kjo është një çështje e konceptit filozofik të diskutimit të pushteteve të ndara. Por, pushtetet e ndara nuk do të thotë se janë të shkëputura. Ekziston edhe balanca e pushteteve të ndara në secilin vend demokratik, vetëm në vendet ku nuk ka demokraci të stabilizuar, mund të sillen krye në veti institucionet pa pasur asnjë gjale për balancën e pushteteve. Prandaj, unë edhe sot e thashë dhe e theksoj, Qeveria mund të kërkojë dhe duhet të kërkojë nga gjykatat dhe prokuroria që të përshpejtojnë, të bëjnë punën e tyre në përputhje me Kushtetutën e vendit.

KRYESUESI: Një minutë, Nekibe, dhe mbaron kjo.

NEKIBE KELMENDI: Kompetencat për ta menaxhua punën e gjykatave dhe të prokurorive i kanë Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli Prokurorial dhe ata i kanë edhe mekanizmat tjerë, njësitë për hetimet ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve, nëse nuk i shqyrtojnë këto lëndë. Faleminderit!

KRYESUESI: Novobërdali, a hoqe dorë ti? A s'hoqe dorë? Suzan Novobërdali!

SUZAN NOVOBËRDALI: Faleminderit, zoti kryesues!

Përshendetje edhe një herë për të gjithë!

Unë e kam analizuar Raportin e Agjencionit Kundërrorrupsion, jam ndalë në faqe 8, 9, 10 dhe 11. Po shpreh keqardhje, sepse këtu në krahasim me vitet e kaluara kemi rritje në përqindje të korrupsionit. Mirëpo, prapë se prapë më vonë jam orientuar në faqet 14, 15, ku i kemi rastet e proceduara sipas vitit të kryerjes së veprimit të dyshuar korruptiv për periudhën raportuese, rastet për të cilat gjatë hetimeve AKK-ja ka gjetur prova, do të thotë ka gjetur prova për vërtetimin e dyshimeve për veprime korruptive, e të cilat janë dorëzuar për procedim penal të mëtutjeshëm në prokuroritë publike kompetente dhe të cilat u takojnë viteve të ndryshme.

Në këtë raport, në faqen 14 dhe 15 i kemi, do të thotë, rastet të cilat janë proceduar, prej vitit 2004 deri në vitin 2007 kemi 31 rast. Prej vitit 2008 dhe 2009, do të thotë në dy vite janë proceduar 26 raste, çka do të thotë se korrupsioni si fenomen daton qysh nga vitet e kaluara.

Në këtë raport, në faqe 14 e 15 përcaktohet edhe lloji i veprave penale, siç është marrja e ryshfetit, shpërdorimi i detyrës zyrtare ose autorizimit, nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore, falsifikimi i dokumenteve zyrtare, përvetësim i paligjshëm, shpërdorim i detyrës, ushtrim i ndikimit, lidhja e kontratës së dëmshme, keqpërdorim i autorizimeve në ekonomi.

Agjencioni Kundërrorrupsionit është formuar në vitin 2006, mirëpo në vitin 2007 filloi funksionalizimi i këtij agjencioni. Konsideroj që formimi dhe funksionimi i Agjencionit është një gjë shumë pozitive, sepse duke marrë parasysh rastet e paraqitura, ndihet nevoja për funksionim, do të thotë për përkrahje më të madhe të këtij agjencioni, sepse besueshmëria në këtë agjencion e qytetarëve është shumë e madhe.

Prandaj, edhe më herët qenka përmendur që rastet të cilat i kemi në gjykata, e dimë, e kemi edhe këtu tabelën prej vitit 2004, mirëpo rezultate nuk kemi. Kishte qenë mirë ndoshta të bëjmë një listë apo një kërkesë, sepse e vërtetë është që Gjyqësori është i pavarur, mirëpo t'u jepet prioritet këtyre lëndëve, ndoshta për shkak të natyrës së rëndësishme që i kanë këto lëndë edhe për vendin, do të thotë për Kosovën dhe për rrugën të cilën ne po mendojmë ta rrugëtojmë për Bashkësinë Evropiane, në familjen e Bashkimit Evropian. Faleminderit, kryesues!

KRYESUESI: Kolegë të nderuar, më të paraqitur nuk ka. Më lejoni veç tri fjali t'i them prej kësaj tribune, meqë nuk kam mundësi të zbres poshtë aty, për momentin.

Ne dëgjuam bisedat për një raport. Kuvendi e ka të drejtën të bisedojë edhe për Agjencinë. Unë po e shoh që krejt diskutimi ka derivuar një tekst të shkruar. Megjithatë, na takon të themi që kjo agjenci, si të gjitha të tjerat agjenci të pavarura, duhet të punojnë dhe të zbatojnë pikë për pikë ligjet organike, të vetat, dhe ligjet të cilat mbulojnë veprimtaritë që lidhen me veprimtaritë e tyre. Është Ligji për deklarimin e pasurisë; Ligji për konfliktin e interesit dhe ligjet që edhe u përmendën këtu.

Nuk është mirë që kjo Agjenci punën institucionale nganjëherë ta derivojë në një propagandë politike, siç ka ndodhur jo një herë. Nuk është mirë kjo agjenci kërkimet e veta, që janë në nismë, në mënyrë selektive t'i bëjë gjysmë publike ose publike, madje në mjete publike. Kjo ka ndodhur. Unë mendoj që kjo nuk duhet të ndodhë, sepse në

këtë formë ajo e humbë vetë kredibilitetin dhe tregon që ka mundësi të bëhet instrument dhe në momentin që bëhet instrument i kujtdo qoftë, Agjencia e tretë fuqinë e vet të kërimit.

Në Kuvend janë të pranishëm 62 deputetë. Na kërkohet që ta votojmë këtë raport me rekomandime, tri rekomandimet e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, tash veç u bënë 65. Janë tri rekomandime, i tretë për përkrahje financiare, është përforcuar edhe nga Komisioni për Buxhet. Ju thërras t'i votojmë edhe këto tri rekomandime dhe raportin.

Votojmë tash:

Me 58 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 4 abstenime, konsideroj që Kuvendi e ka miratuar këtë raport, bashkë me tri rekomandimet.

Ju njoftoj që mbledhja vazhdon ditën e martë, në orën 10:00.

E martë, 4 maj 2010, ora 10:00

Seancën drejton: kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI I KUVENDIT: Të nderuar deputetë,

Në sallë kemi deputetë sa për t'ia filluar debatit.

Vazhdojmë me punimin e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të filluar më 29 prill 2010, për pikat e mbetura.

Vazhdojmë me pikën e pesëmbëdhjetë të rendit të ditës:

15. Shqyrtimi i Raportit të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, për vitin 2009,

Komisioni funksional për Buxhet dhe Financa, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Punës ka shqyrtuar raportin e Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2009 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Ftoj kryetarin ose raportuesin e komisionit për arsyetimin e Raportit me rekomandime.

Fjalën e ka deputetja Safete Hadergjona.

SAFETE HADERGJONAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar zëvendëskryeministër,

Me qenë se kryetari i komisionit nuk është këtu, më ka autorizuar mua që t'i paraqes rekomandimet e Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Komisioni për Buxhet dhe financa ka shqyrtuar Raportin e Trustit të Kursimeve Pensionale në mbledhjen e mbajtur më datën 14 prill 2010 dhe ka vlerësuar se i njëjti është në pajtim me Ligjin dhe i rekomandon Kuvendit miratimin e tij.

Po ashtu, komisioni i ka dhënë edhe disa rekomandime tjera. Si rekomandim tjetër që i është drejtuar Kuvendit është obligimi i Trustit që në raportet e ardhshme drejtuar

Kuvendit të pasqyrojë nivelin e pagave të anëtarëve të Bordit dhe të punëtorëve të tjerë të Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës.

Komisioni, gjithashtu, i ka sugjeruar Trustit që të shikojë eksperiencat e vendeve në rajon dhe të bëjë një analizë krahasuese dhe Kuvendi t'i dërgojë propozime për ndryshim – plotësimin e Ligjit për fondin pensional të Kosovës me qëllim të eliminimit të pengesave ligjore në kufizimin e përqindjeve të interesit të mjeteve, sidomos në tregun e brendshëm financiar. Këto janë rekomandimet e Komisionit për Buxhet dhe Financa, domethënë komisioni i propozon Kuvendit që ta miratojë këtë raport.

Drejtimin e seancës e merr anëtari i Kryesisë, zoti Naim Maloku

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja deputete!

Kalojmë te kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare të deklarohen në lidhje me raportin.

Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, deputetja Safete Hadergjonaj e ka fjalën.

SAFETE HADERGJONAJ: Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Raportin e Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës dhe është i mendimit që ky raport më tepër është një raport teknik, jo i plotësuar dhe jo me të gjitha të dhënat e kërkuara, po pret që së shpejti Trusti t'i sjell Kuvendit raportin financiar më të kompletuar, më përmbajtjesor dhe njëkohësisht pasqyrat e audituara financiare për vitin 2009.

Nga raporti mund të konstatohet se pas krizës financiare në tregjet globale që goditën edhe aksionet e Trustit në vitin 2008, në fillim të vitit 2009 kanë filluar kthimet pozitive të investimeve të Trustit. Këto kthime kanë rezultuar me një rritje 14.1%, megjithatë humbjet e porealizueshme në Trust ende vazhdojnë. Ka një gjendje të përmirësuar të vlerës së aseteve, ku totali i aseteve pensionale nga raporti vërehet se është 376 milionë euro. Nga këto mjete, 36.81% apo 138 milionë euro mjete të Trustit mbahen në Bankën Qendrore të Kosovës, kurse 63.19% të mjeteve të Trustit mbahen jashtë Kosove, apo 237 milionë euro.

Trusti i Kursimeve Pensionale ka pasur në shfrytëzim për shpenzimet e veta, për nevojat e veta buxhetin prej 2.521.000 euro, kurse ka shpenzuar 1.904.000 euro, pra diku 75.54% të buxhetit që ka pasur në dispozicion.

Nuk do të hyjë në arsyeshmërinë e shfrytëzimit të këtyre mjeteve me qenë se presim që së shpejti në Kuvend do të vijë raporti i auditorit për mënyrën e shpenzimit të këtyre mjeteve, por dua të theksoj se nga këto të dhëna me të cilat disponojmë, vërehet se pas zgjedhjes së bordit është bërë njëfarë racionalizimi i shpenzimeve të brendshme të Trustit të Kursimeve Pensionale.

Shpeshherë ne në Kuvend ngrisim shqetësime që kanë të bëjnë me Trustin e Kursimeve, kurse asnjëherë nuk kemi marrë iniciativa serioze që shqetësimet tona t'i shndërrojmë në angazhim konkret për të ndryshuar ligjin. Ligji ka nevojë të plotësohet në mënyrë që të eliminohen pengesat të cilat veç i ka paraqitur edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa.

Ne i përkrahim rekomandimet e Komisionit për Buxhet dhe Financa që Trusti i Kursimeve Pensionale të bëjë publike tërë mënyrën e shpenzimit të mjeteve dhe për pagat e bordit dhe të anëtarëve të tjerë të Trustit dhe njëkohësisht përkrahim edhe

Rekomandimin për t'u bërë ndryshimi i Ligjit për Trustin e Kursimeve Pensionale dhe në parim e përkrahim këtë raport.

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete!

Aktualisht në sallë janë 63 deputetë.

Vazhdojmë me përfaqësues të grupeve parlamentare. Ftoj që në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, ta marrë fjalën deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar zëvendëskryeministër,

Kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës i ka shqyrtuar raportet e Trustit të Kursimeve Pensionale për vitin 2009 dhe njëherësh duke u mbështetur edhe në rekomandimet e Komisionit për Buxhet dhe Financa, raportet si të tilla i përkrahim, në parim, por mbetet për t'u vlerësuar arsyeja e parë, e cila është përsëritur edhe gjatë viteve të kaluara – plotësimi ndryshimi i ligjit, që është një ndër mungesat kryesore të cilat paraqiten vazhdimisht edhe në rritjen e efikasitetit të punës së Trustit Pensional, por edhe besueshmërisë së qytetarëve që t'i besojnë fondet e tyre në këtë trust.

Për vitin 2009, sipas këtyre raporteve shihet se ka pasur një rritje të vlerës së aksioneve krahasuar me vitin në të cilin kishim humbje, por prapë se prapë ne mbesim pranë asaj se duhet të presim raportet financiare të audituara për vitin 2009, të cilat e kanë afatin të dorëzohen deri në fund, domethënë ishte afati 30 prill 2010. Si raport i plotëson kushtet që të aprovohet, por prapë se prapë pasqyrat e audituara dhe të performancës, edhe të investimeve, atëherë si Grup Parlamentar mund të japim konkluzionet kryesore, vërejtjet dhe të gjitha ato që do të plotësohen edhe nga deputetët tjerë. Njëherësh e përkrahim si raport të tillë. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, deputeti Haki Shatri e ka fjalën.

HAKI SHATRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Për Grupin Parlamentar të Aleancës mendojmë që ky material që e kemi nuk plotëson asnjë prej kriterëve që quhet raport. Unë për kolegialitet kisha pyetur këtu të pranishmit, në qoftë se dikush e ka parë këtë material, e ka lexuar, çka ka kuptuar prej këtij materiali. A e ka kuptuar dikush thjeshtë çka shkruan në të. Është thjeshtë një material me 5 faqe tabela, pa asnjë lloj shpjegimi.

Çështja tjetër qëndron në atë se nuk e di, ky material a është i aprovuar nga strukturat menaxhuese a jo. Është i dërguar me një nënshkrim prej zëvendës drejtorit, që kam respekt, por nuk e di a ka kaluar procedurat e miratimit të bordit. Në vitin e kaluar ne nuk kemi pranuar të marrim këso materiale, sepse atëherë s'ka qenë i konstituuar bordi, s'ka qenë i emëruar dhe gati dy vite s'kemi pasur raport, bile edhe faji për humbjen e mjeteve të Trustit i ka mbetë mungesës së bordit, mos emërimit të bordit nga ana e institucioneve tona. Fundi i fundit, në vetë shkresën shkruan se një raport më përmbajtësor dhe i audituar për vitin 2009 shpresojmë ta dërgojmë deri më 30 prill 2010, sot jemi më 4 maj. Ne po shqyrtojmë një material që për vetë institucionin që e ka dërguar është material jo i plotë dhe i tejkaluar në kohë. Prandaj, për grupin tonë parlamentar ky material mund të diskutohet, por kërkojmë të pritët materiali i plotë i Trustit, siç kanë thënë vetë, po ashtu i audituar dhe të diskutohet dhe të miratohet në Kuvend. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, ftoj deputetin Riza Smaka, ta marr fjalën.

RIZA SMAKA: I nderuar zotëri kryesues,

I nderuar zotëri zëvendëskryeministër, Manaj,

Deputetë të respektuar,

Raporti nuk është i qartë sa duhet edhe si duhet, ka mjaftë të dhëna konfuze dhe kontradiktore, madje edhe problematike.

Nga të dhënat e prezantuara në këtë raport shihet ndër të tjera se pagat edhe kompensimet, qoftë të shërbimit civil, qoftë të udhëheqësisë së Trustit janë jashtëzakonisht të larta, në kundërshtim me kriteret elementare të solidaritetit, të reciprocitetit, të ndërlíkueshmërisë së punëve, të përgjegjësisë. Shihet, nëse marrim numrin dhe bëjmë pjesëtimin, se qëllimisht nuk është dhënë ajo e dhënë konkrete, që janë 3 apo 4 herë më të larta se sa në sektorët tjerë, ani pse punët mund të jenë shumë më të thjeshta e shumë më të lehta.

Ky raport ka, ndër tjera, edhe nocione të panjohura, madje edhe problematike. Unë kam pyetur edhe jam mjaftë mirë i familjarizuar me terminologjinë, po kam pyetur megjithatë profesorë universitarë të shkencave të ekonomisë, nuk kanë ditur të më thonë çka janë këto të hyrat e shtyra, nuk i njeh, si të them, as ligji, as doktrina. Ndër tjera, shihet se honorarët janë 70 mijë euro, ose për konsulentë 23 mijë e tjera. A pretendimet, po e zëmë, të menaxhmentit janë se ata janë ekspertë të shquar, të dalluar, atëherë del se ata nuk qenkan, po qenkan këta të tjerët, të cilët marrin honorare të majme ose janë ata, ka abuzime, ose këta që thirren, apelohe se janë ekspertë. Nuk janë, po janë kuazi ekspertë.

Ndër të tjera, shihet se këtu paguhen, po e zëmë, kur marrin pjesë anëtarët në bord apo jo, bordistët, po e zëmë, përpos të tjerave beneficione, edhe qëndrimet e akomoditetit nëpër hotele, që është absurde, apo jo.

Më pastaj, ju lutem, ne e dimë fare mirë se asnjë institucion në Kosovë nuk ka sigurim shëndetësor, që është synimi ynë i që ta bëjmë këtë, mirëpo këtu po, edhe nga cilat para, nga paratë e kursimtarëve. Bile këta nuk janë, na nuk jemi kursimtarë jus dispositivum, po jus inperativum, me zor domethënë, apo jo, që kjo nuk ndodh, është absurd.

Sa u përket mjeteve të Trustit, që janë mjaftë abuzive, kështu, unë kam shtruar personalisht mocion shkrimor. Ndër të tjera, ministri i Ekonomisë dhe Financave me shkrim më është përgjigj se ka kërkuar të dhënat për pagat, po e zëmë, të tyre edhe s'ju kanë përgjigjur, se na nuk ua japim juve të dhënat. Ju lutem, këto janë para publike, për paranë publike do të duhej çdo tre muaj të informohen kontributdhënësit, se ato nuk mund të jenë top sekret apo jo, kjo vetëm te ne ndodhë.

Nuk ka, ky Trust është anti - trust, trust është fjalë që e ka kuptimin e besimit, nuk ka kurrfarë besimi, apo jo, sepse është fjala për tekno – burokrati arbitrarë, se paratë e kursimtarëve janë të mbyllura, disponohen arbitrarisht, nuk dihet se ku janë, supozohet se kamatat apo normat e interesit janë më të ulëtat në Evropë, që prapë është pikë e dyshimit, pse më të ulëtat, a thua dikush mos merr nga diferenca e asaj që do të ishte ordinere me këtë më të ultën, mos merr para në xhep, se dyshimet janë të bazuara.

Zotëri kryesues,

Deputetë të respektuar,

Medoemos duhet urgjentisht të modifikohet legjislacioni për këtë trustë dhe ndër të tjera duhet të bëhen norma të tilla të cilat e normalizojnë gjendjen. Nuk mund të tolerohet, po e zëmë, që një udhëheqës i Trustit marrë pagën 12.000 euro, kam lexuar dje disa herë në gazetë. Absurd i absurdeve, sa 4 pagat e kryetarit të Kosovës apo të kryetarit të Kuvendit apo të kryeministrit dhe aq zëshëm protestojnë shumë njerëz të painformuar se paga, po e zëmë, e kryetarit qenka aq e lartë, ndërsa e Trustit të Pensioneve 4 herë më e lartë dhe ajo është një punë më e thjeshta ndër punët më të thjeshta, sepse mjetet grumbullohen sipas automatizimit. Edhe po të mos ekzistonte ai trust, po mendoj bordi apo eventualisht, në radhë të parë menaxheri, do të grumbulloheshin ato para, a sa i përket disponimit me ato, ka shumë baza të dyshuara.

Edhe ndër të tjera, po e zëmë, në qoftë se është Trust i sigurimit, atëherë i siguruari/e siguruara do të duhej të dispononte me mjetet e veta ose së pakut të informohej dhe të konsultohet, sepse nga momenti që futen në konton e trustit, ato nuk janë në dispozicion të pronarëve të tyre.

Përfundimisht, duke ju përshëndet zoti kryesues dhe kolegë të nderuar, Grupi Parlamentar i AKR-së insiston që nga këtu Qeveria le ta marrë përsipër menjëherë modifikimin e bazës juridike të Trustit, të rregullohet në harmoni me solidaritetin, me reciprocitetin edhe me drejtësinë sociale dhe të eliminohen shumë paqartësi sa i përket statusit juridik të tanishëm. Ju falënderohem!

KRYESUESI: Faleminderit, profesor!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, deputeti Naser Rugova e ka fjalën.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Zonja dhe zotërinj,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë e ka shqyrtuar dhe analizuar me vëmendje raportin e Trustit dhe në konsultim edhe me ekspertët tanë, kemi ardhur në këto konkludime:

Ky raport, në një, është teknik, nën dy, i paplotësuar, nën tre, josupstancial, në katër, konfuz dhe, nën pesë, kontradiktor. Për jotransparencë po e vërejmë të gjithë që as që bëhet fjalë për një raport transparent. Dhe, raporte të tilla t'i dërgohen organit më të lartë legjislativ të vendit, vërtet është joserioze dhe autoriteti i Kuvendit me raporte të tilla dhe me këtë joseriozitet vërtet po vihet në sfidë dhe në sprovë të madhe.

Vetëm një raport detal financiar dhe me performancë të auditimit do të na jepte një pasqyrë reale për gjendjen e Trustit, tek e fundit, edhe ne si deputetë jemi kontribuues, kemi asetet tona personale në këtë trust. Andaj, një raport i tillë 5 faqesh, i paraqitur në mënyrë tabelare, po thuaj se po e dërgojnë në ndonjë simpozium shkencor e jo para deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, vërtet do të ishte alarmi i fundit për Bordin e Trustit që pas shumë peripecive u zgjodh dhe, fatkeqësisht, tani ky bord nuk ka kryetar, sepse kryetari i Trustit tani është ministër i Qeverisë dhe këtu shihet paanshmëria, profesionalizmi dhe serioziteti i kësaj Qeverie kur po i propozon anëtarët e Bordit. Kjo është një vërejtje shumë serioze edhe për partnerët e koalicionit, që vërtet me emërime të tilla, pastaj me emërime në pozicione tjera shihet që çdo pore e jetës, edhe mbikëqyrja dhe menaxhimi i aseteve të kontribuuesve të Trusti Pensional të Kosovës monitorohet dhe thjeshtë shikohet me llupë nga Qeveria. Por tash dalin disa pyetje të tjera

– pse 63.19% e mjeteve të kontribuuesve të këtij Trusti janë jashtë Kosovë? Bëhet fjalë për 237 milionë euro të kontribuuesve të shërbyesve civilë dhe të punëtorëve të tjerë të Kosovës, të cilët e kanë mbushur këtë trust dhe nuk dinë ku janë paratë e tyre, ku janë kontributet e tyre, çka ndodh me fatin e këtyre mjeteve? Ku ndodhen këto mjete, kush i menaxhon, sa është kamata dhe cili është, tek e fundit, interesi im si kontribuues në këtë Trust. Fjala Trust do të thotë besim dhe, fatkeqësisht, besimi i kontribuuesve, të njerëzve të Kosovës me këtë qasje monopolizuese, jotransparente, vërtet është që organet e drejtësisë të fillojnë të hetojnë dhe të analizojnë se çka po ndodh me kontributin e këtyre kontribuuesve, pjesa dërmuese të varfër dhe të lodhur me këto paga që i marrin në fillim të muajit në Kosovë.

Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për Trustin është një nevojë imediate. Vërtet, ky Kuvend duhet ta plotësojë dhe ndryshojë dhe të precizojë në mënyrë konkrete përgjegjësitë, organizimin, formën e menaxhimit, transparencën dhe llogaridhënien për këtë institucion jashtëzakonisht të rëndësishëm për të punësuarit, për shtetin, por edhe për qytetarët e Kosovës.

Kur është fjala te pagat dhe kompensimet, mëditjet e të tjera të këtij mekanizmi, vërtet unë bëjë pyetje – a është Trusti i Kosovës, a është nën legjislacionin dhe juridiksionin e Kosovës dhe kujt duhet t'i japë llogari ty Trust? Duke parë një raport të tillë konfuz, josupstancial, kontradiktor, jotransparent dhe të zbrazët, vërtet është momenti i fundit që mekanizmat, kategoritë kushtetuese që zgjedhen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës duhet njëherë e përgjithmonë t'i japin llogari ashtu si duhet organit më të lartë legjislativ të vendit.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë nuk e mbështet këtë raport. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, ftoj deputetin Sadik Idriz ta marrë fjalën.

SADIK IDRIZ: Hvala predsedavajući!

Poštovane kolege poslanici, i oni iz pozicije i opozicije, i oni koji su dali glas da se podrži ovaj izveštaj, i oni koji su protiv toga, slažu sa u jednom da ovaj izveštaj zaista ne ispunjava osnovne kriterijume, jer je pre svega jedan tehnički izveštaj koji ima nekoliko stranica, od prilike kao kad dobijamo iz banke izveštaj kada apliciramo za vize, šta imamo i šta nam je na tom kontu.

Veoma je neozbiljno da se sa ovakvim izveštajem prezentira Trust koji na Kosovu raspolaže možda u ovom trenutku sa najvećom količinom novca na jednom mestu i Komisija, mislim da je i Komisija olako prešla preko ovoga izveštaja i dala je vizu samo sa jednom napomenom da dobije informacije o nivou plata zaposlenih u bordu i ostalim u ovom trustu. Mislim da to nije dovoljno da se traži samo nivo plata, nego su u pitanju i druge aktivnosti. Prošle godine se više diskutovalo zato što su akcije prošle godine pale preko 20 procenata i zbog toga je to bilo aktuelno, ove godine su akcije nešto porasle i zbog toga je manje interesovanje za izveštaj ovoga trusta.

Parlamentarna grupa „7+“ će podržati ovaj izveštaj i pored toga što smatra da ne zadovoljava osnovne kriterijume iz razloga što su ostale partije koje su u koaliciji podržale ovaj izveštaj sa napomenom da zaista ovakvi izveštaji ne služe na čast ni Trusu,

a ni ovom Parlamentu koji mora da bude, da bi podigao svoj nivo, mora da traži ozbiljnije izveštaje od onih koji ih pripremaju. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit, deputet!

Në emër të Grupit Parlamentar SLS, nuk kam të paraqitur për fjalë. Tash u lajmërua, Petar Miletqi e ka fjalën.

PETAR MILETIĆ: Hvala, gospodine predsjedavajući!

Bez namere da ponavljam ono što su prethodnici rekli, potrebno nam je više objašnjenja i potrebno nam je više objašnjenja ovih tabela koje su nam dostavljene u izveštaju obzirom da u poslaničkim klupama nisu svi ekonomisti i ako neko ko nije ekonomista, mnoge stvari iz ovog izveštaja nisam razumeo. Dakle uz tu napomenu da nam je potrebo više objašnjenja, Poslanička grupa Samostalne liberalne stranke glasaće za ovaj izveštaj.

KRYESUESI: Faleminderit!

Më emër të Grupit Parlamentar për Integrim, deputetja Vezira Emrush e ka fjalën.

VEZIRA EMRUŠ: Hvala na datu reč!

Pozdravljam sve kolege poslanike i Predsedništvo!

Danas imamo jako važan izveštaj Trusta pred sobom i meni je žao što moram da kažem da sa današnjim izveštajem ne možemo da budemo zadovoljni niko od nas. Jako mi je ovo žao što funkcionalna komisija kada je dobila ovaj izveštaj, nije vratila Trustu ili nije dala, od svog izveštaja samo nam je napomenu dala da treba da razmatramo i da treba da ga prihvatimo kao takvog. Međutim, ovo funkcionalne komisije treba više da se pozabave kada su u pitanju ovakvi izveštaji i kada su u pitanju fondovi ili kada su u pitanju, ka kažem, sredstva građana. Mi znamo da je Trust počeo 2003. godine, da je izdvajanje 5% od poslodavca, 5 od individue koja radi, od svojih sredstava, da niko nas nije pitao kad smo osigurani kod ovog trusta, da smo misli da je to početak penzionog fonda. Znači, prvo javno mišljenje i pristup kod građana bio je nezakonit, formiran je trust. Trust je, na ime danas kada mi vidimo od ovog izveštaja, ništa drugo, jedan da kažem privatni penzioni fond. Privatni penzioni fondovi su sporedni fondovi, fondovi kada imamo penzijsko i invalidsko osiguranje je osnovni fond PIO, ovaj fond je sporedni fond. Ovaj sporedni fond drastično od 2006, 2007, ja neću da se vraćam, samo sam ponela izveštaje od 2006 i 2007, kao brojka, da se zna koliko je ovaj fond 2007. godine imao 494. miliona, 2008. 528 miliona, kada su akcije rasle, a 360 i nešto miliona, 130 miliona je fond izgubio 2009. godine, i niko nije odgovarao. Sredstva na rizik ostvaruju se ako je privatnik, privatni fond, taj fond je trebao sam da snosi posledice rizika, a ne mi građani Kosova. Tu posledicu rizika od 30 i nešto posto trebao je da snosi sam, 130 milion sam, kada dobija i kada gubi. Naša sredstva su zagarantovana, data su na čuvanje. Fond za trust nije privatni fond, to je fond penzijskih sredstava, to su fondovi gde se sredstva daju na čuvanje, na čuvanje gde od 3 do 10% ima pravo oplođenja, znači ja danas kada vidim, da se vratim na 2010. godinu, vidimo da sredstva u opšte nisu oplođena, da je ovaj fond davao sredstva privatnim bankama, kao što su Prokredit i ostale koje uzimaju debele kamate a ovom fondu koji su kamatu platili, mi nemamo izveštaj. Gde je sredstva obrtao, gde je oplođivao, nemamo izveštaj. Gde su, gde su pitam, zašto nisu oplođena sredstva, ako su izgubljena prošle godine, zašto ove godine nisu oplođena. Ko snosi rizik, rizik, Vlada je iza ovog, Vlada kaže da su sva ova tela nezavisna, Vlada je danas odgovorna sa menadžiranjem, sa imenovanjem, sa postojanjem ovog fonda. Vlada treba da odgovori građanima gde su sredstva građana. Mi moramo više da budemo jasni, moramo dobro da gledamo sva sredstva koje imamo, sve fondove da počnemo da pravimo jednu građansku državu. Građansku državu gde će biti socijalnog dijaloga između svih građana, Vlade,

institucija. Ovo je samo privatni fond, moraju građani da znaju. Mi svi zaposleni treba da damo peticiju da ne dajemo svoja sredstva iz svojih sredstava u fond. Ja ću da vam kažem, od 255 hiljada zaposlenih, ima preduzeća koja plaćaju samo radnici, odbija se, slušajte me, odbija se od sredstava koja treba da plati zaposleni, a ne odbija se od sredstava poslodavca. Ima i takvih kršenja ovaj fond i Vlada i svi mi zreli smo za jednu dobru reviziju, da se izvrši od strane Skupštine jedan dobar pritisak, gde ćemo izvršiti reviziju, nadgledanje ovog fonda, da li će da postoji u ovoj formi ili ćemo na ime zakona, koji nedostaje o platama i penzijama, da formiramo PIO – Fond za penzijsko i invalidsko osiguranje. Meni je žao što još jednom moram da kažem, pored visokih plata ova gospoda u Trustu ima i socijalno i zdravstveno osiguranje, to što nemaju njihovi klijenti. To je žalosno u ovoj državi, žalosno. Ako smo mi od 2008. godine država, mi moramo, više ne može po Uredbi UNMIK-a, nego mora po Zakonu o penzijskog i invalidskom osiguranju i privatni fondovi dobijaju licence od agencije koja će biti formirana i gde će biti na tržištu sa svojim sredstvima. Ovaj fond nema svoja sredstva, koristi sredstva građana i čak nema pristup. Mora fond da ima politiku ulaganja i davanja sredstava, nema pristup sa koliko godina, sa 65. godina mora naš građanin da čeka da bi pristupio ovim fondovima. Molim lepo, ovde je velika zloupotreba, veliko kršenje, ja apelujem danas na moje kolege da ovaj fond je nešto najmanje što moramo da pritisnemo i tražimo reviziju.

U ime naše grupe, mi nećemo da podržimo ovakav izveštaj, toliko od nas. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Kalojmë te deputetët, sipas radhës së paraqitjes. Fjalën e ka deputeti Abdyl Ymeri, le të përgatitet deputetja Mimoza Ahmetaj.

ABDYL YMERY: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Trusti i Kursimeve Pensionale është një institucion i pavarur me një rëndësi të veçantë dhe i dizajnuar në atë mënyrë që me efikasitet të plotë t'i administrojë dhe të menaxhojë kontributet apo kursimet në llogari të të gjithë të punësuarve në Kosovë, të cilët me rastin e pensionimit në llogari të tyre të kenë mjete për një jetë të rehatshme.

Po ashtu, Trusti në vazhdimësi duhet të punojë në ofrimin e shërbimeve më të mira dhe rritjen e transparencës në nivelin më të lartë, me qëllim që çdo kontribuues të ketë njohuri dhe informata të mjaftueshme për gjendjen e llogarisë së tij.

Në raport shihet se krahasuar me vitin 2008, kemi një performancë më të suksesshme të Fondit të Kursimeve Pensionale gjatë vitit 2009, 14.10% kthim pozitiv në investime, po ashtu kemi edhe ngritje të numrit të kontribuuesve. Sipas të dhënave të Trustit, 46.3 milionë euro është kthimi i investimeve prej fillimit të vitit 2009.

Trusti, sipas këtij raporti menaxhon mbi 385 milionë euro, me afro 300.000 kontribuues. Edhe pse Trusti ka po thuaj se të gjitha informatat në Web faqen e tij, është mirë që pasqyrat financiare të gjendjes së llogarisë t'ia dërgojë çdo kontribuuesi në afatin e paraparë, sepse një numër i tyre nuk i merr këto pasqyra dhe në anën tjetër informatat në Web faqe nuk mund t'i shfrytëzojnë një numër i madh i kontribuuesve duke pasur parasysh nivelin e përdorimit dhe të shfrytëzimit të internetit.

Sa i përket pasqyrës së shpenzimeve të Buxhetit për vitin 2009, shihet se është në kufi të lejuar, krahasuar me buxhetin e planifikuar. Në raport shihet se të ardhurat e punëtorëve

në Trust janë të mira dhe, përveç kësaj, kanë një privilegj, që ende nuk e kanë punëtorët në institucionet tjera – sigurimin shëndetësor.

Edhe ekspertët më të mirë të ekonomisë sonë sugjerojnë që mjetet në Fondin e Trustit Pensional të kthehen dhe të investohen në Kosovë, prandaj është mirë të punohet në drejtim të ndryshimit të Ligjit të kësaj fushe, me qëllim që të eliminohen të gjitha pengesat ligjore për kthimin e fondeve në Kosovë, sepse sipas ligjit vetëm 5% të Fondit të Trustit është i obliguar ta investojë në Kosovë, kurse pjesën tjetër jashtë vendit.

Po ashtu, është shumë i nevojshëm edhe miratimi i Ligjit mbi letrat me vlerë, i cili deri më tani ka pamundësuar investimin e një pjese të mjeteve të Trustit në tregun kosovar. Investimi i këtyre mjeteve në Kosovë do të ndikonte pa dyshim në rritjen e depozitave bankare, bankat do të kishin mundësi më të mëdha për dhënien e kredive, e kjo sigurisht do të ulëte edhe kamatat dhe në përgjithësi do të përfitonte ekonomia e Kosovës.

Mjetet e plasuara në institucionet financiare ndërkombëtare, përveç se kanë ndikuar negativisht në zhvillimin ekonomik, kanë krijuar një imazh jo të mirë për sistemin bankar në Kosovë. Trusti duhet të jetë i kujdesshëm në investimet e tij, sepse informatat që rrjedhin nga tregjet financiare botërore nuk janë shumë inkurajuese për këtë vit, duke pas parasysh krizat që kanë disa vende në Bashkimin Evropian. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputet!

Fjalën e ka deputetja Mimoza Ahmetaj, le të përgatitet deputeti Driton Tali.

MIMOZA AHMETAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Përshëndetje për të gjithë deputetët!

Së pari, nga hera e fundit që ne kemi debatuar për Trustin, ka qenë domethënë nga data 26 shkurt, kur e kemi debatuar një raport për Trustin. Mund të them se vetëm janë dy gjëra pozitive të cilat e përcjellin këtë raport të tanishëm. E para, është rritja e cila është në vlerat e aksioneve të Trustit, domethënë një vlerë prej 14.1% që është rritur për vitin e kaluar si dhe kjo pozitive, e dyta, e cila vlen të përmendet, është zbritja e taksës administrative nga 0.9% në 0.8% që është bërë këtë vit. Unë do të apeloja te Trusti që taksën administrative nga 0.8 ta vazhdojë ta zbrësë në 0.7% me qenë se kushtet e tilla e lejojnë dhe tanimë janë plotësuar.

Pjesa tjetër, të cilën edhe shumë nga parafolësit e përmendën, si ndryshimet në Ligjin e Trustit, në Ligjin e Bankës Qendrore meritojnë dhe kërkojnë një vëmendje të veçantë, që mundësisht sa më shpejtë që është e mundur të bëjmë ndryshimet brenda këtij ligji, në mënyrë që 5% sa investohen nga këto mjete në Kosovë, të krijohet një mundësi të rritet vlera e tij, domethënë nga 5% të bëhet një investim më i madh në Kosovë.

Pjesa tjetër, të rishikohet përsëri krijimi i ligjeve, që kolegu më herët i përmendi, të Ligjit për letrat me vlerë dhe të Ligjit për huamarrje publike, në mënyrë që të krijohen mundësi më të mëdha të investimeve në Kosovë. Nuk do të dëshiroj të përmend më tutje dhe t'i citoj ato që u përmendën, si çështja e sigurimeve shëndetësore, si çështja e sigurimeve sociale, që punëtorët brenda Trustit Pensional i kanë, ndërkohë që ne duke nisur nga presidenti e poshtë deri te qytetarët e rëndomtë, nuk e kanë këtë mundësi të kenë sigurime shëndetësore dhe sociale. Mbetem me shpresën që raportin më të plotësuar do ta kemi shumë më shpejtë nga Trusti, në mënyrë që të kemi mundësi të debatojmë më në detale për situatën brenda Trustit. Parimisht, e votojë këtë raport dhe po e presim momentin kur

vjen raporti më i zgjeruar që deri tani është dashur ne ta kemi në tavolina që ta debatojmë. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Driton Tali, le të përgatitet deputetja Teuta Hadri.

DRITON TALI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë, të them të drejtën, këtë raport e kam lexuar disa herë dhe ende nuk e kam të qartë se për çka jemi ne këtu, them Kuvendi, duke marrë parasysh atë se çka do që flasim ne, asgjë nuk merret para sysh. Këtu e kam edhe Transkriptin e seancës së 20 korrikut të vitit 2009, kur u debatua Raporti i vitit 2008, dhe shoh gjithë ato i lexova, gjithë ato sugjerime të cilat i patëm bërë, ato kritika, ka qenë një mal kritikash, asgjë nuk janë marrë parasysh në këtë raport, bile, bile është përkeqësuar, sivjet është më keq, sepse jo që gabimet janë përsëritur, por ato janë edhe përkeqësuar, po them. Tash të investosh në Fortis, për ata të cilët i përcjellin këto gjëra, mendoj se është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me atë filozofinë që na shesin Trusti, do të thotë të investimeve pa rreziqe dhe kjo është arsyeja pse nuk investon Trusti në Kosovë sepse, sipas tyre, nuk ka siguri në Kosovë, por ja që Fortis-i qenka i sigurt! Për ata që nuk e dinë, Fortis-i ka qenë duke bankrotuar dhe sikurse të mos intervenonin bankat e Beneluksit me 11 miliardë e 500 mijë euro në shtator të vitit 2008, më nuk do të kishte Fortis. Dhe, ja Fortis-i është vend i sigurt, ama Kosova nuk është e sigurt. Dhe, tash shtrohet pyetja – çka është qëllimi i këtyre njerëzve? Është një farë gare që të punojnë sa më keq, ta bëjnë sa më llugë apo është e kundërta, unë nuk e kam të qartë. Sigurisht, se kjo është si rezultat i asaj që Qeveria çon njerëz pa kualifikime adekuate në bord atje, kur them Qeveria, po them Qeveria i sugjeron Kuvendit, ne e dimë se çka të thotë Qeveria, këtu miratohet patjetër. Dhe, kur them Qeveria, nuk është vetëm kjo Qeveri, por Qeveria si koncept dhe posa t'i kalojnë ata nja 2 – 3 vjet, t'i mësojnë disa gjëra, vjen një Qeveri tjetër, i ndërron ata, i çon edhe disa ma bilmeza atje dhe atyre ju shkojnë nja 2 – 3 vjet derisa të mësojnë diçka dhe kështu në vazhdimësi është puna. Harrojnë se këto institucione të rëndësishme nuk janë për t'u mësuar njerëzit aty, po janë për të punuar, mësohen tjetër kund gjerat, është industria, janë shkollat ku mësohen këto gjëra.

Pastaj, unë po e marr edhe AURIEL-in, vjet tentova ta ngreh këtë çështje, që është në kundërshtim po ashtu me filozofinë e Trustit, ndonëse nuk e kanë qartësua këtu me cilën AURIEL, por e kam parasysh se kemi të bëjnë me këtë Capital Management. Unë përsëri pyes, ku po i gjejnë more këto kompani? Përsëri shtrohet ajo pyetja – a janë këta njerëz konform asaj që deklarojnë, njerëz të sigurisë, AURIELI, ata që i dinë këto gjëra, e dinë që është krijua në vitin 2004, nga disa ish punëtorë të punonjës të Deutsche Asset Management Company dhe kjo kompani e re, e cila vjet e mbylli atë farë selinë e tyre në Amerikë, t e ka vetëm një seli ne Londër. Pra, kemi të bëjmë me një ndërmarrje të vogël e cila është në kundërshtim me filozofinë e të investuarit pa rreziqe, filozofi e cila ata i ndalon për të investuar në Kosovë, që është po them në kundërshtim me gjithë filozofinë e tyre, bile, bile aje farë indeksi i tyre Global Macro Fond-in, unë jam i bindur se ata të cilët janë në bord, këta ndërkombëtarët e dinë se vjet pati humbje apo ulje për 5.71%.

Pastaj, kthehem tash te këto që nuk na kanë dhënë shpjegime, shpjegime adekuate të them, po i kanë qitur ato dhe tash duhesh, po them, të jesh ekspert për t'i ditur disa gjëra. Pra, e kanë qitur ECM-në, që është European-Credit Market, shikoni Fitch-i, që është Fitch-i Ratings apo gradimi Fitch, që është kompania e tretë apo agjencia e tretë më e njohur së bashku me SP-në, pra Standard & Poor's dhe Moody's, këto janë tri agjenci që i gradojnë bonet. Fitch-i e ka graduar ECM-në në përgjithësi ne BBB, po ashtu edhe

ECL-në, domethënë European Credit të Luxemburgut e ka kraduar në gradën BBB. Grada BBB, për t'ia shpjeguar opinionit, ka elemente të jo sigurisë, që nënkuptohet se elementet mbrojtëse, mund të dështojnë gjatë ndryshimeve ekonomike, sepse ballafaqohen me probleme financiare. Dhe këtu vjen përsëri ajo që është në kundërshtim me atë që Trusti thotë se në Kosovë s'po mund të investojmë se s'ka siguri, e shkojnë e investojnë në disa gjëra, në disa instrumente financiare që janë edhe më të pasigurta se ekonomia e Kosovës, ku ka sa të duash hapësirë për të investuar me kthim shumë më të madh. Kthimin të cilin, kuponin të cilin ata e investojnë, nuk e kalon as 1%.

Pastaj edhe në seancën e kaluar, por edhe më përpara, pyetja e vazhdueshme është sa paguhet menaxhmenti, kur përgjigje s'kemi marrë. Nëse e merrni dhe e shihni këtë raport, duhet vetë t'i bëjmë llogaritjet, do të shihni se pagat thotë këtu janë 351.031,30 centë, nëse këtë shumë e pjesëtojmë me 23 punëtorë dhe 12 muaj, na del se rroga mesatare është 1271 euro atje, domethënë duke marrë parasysh edhe pastruesen deri te menaxhmenti dhe shtrohet pyetja menaxhmenti sa paguhet dhe për çka paguhet?

Pastaj bordin, e marrim bordin dhe e analizojmë se edhe aty na ka dhënë një informatë që kemi të bëjmë vetëm me dy tremujorëshat e fundit për shkak se bordi nuk ka qenë i kompletuar, tremujorëshin e fundit, domethënë e kemi një shumë 43.750 euro, pjesëtuar me 7 vetë, pjesëtua me 3 muaj, na del se Bordi merr 2083 euro në muaj honorare. Tash vjen përsëri pyetja logjike, njerëzit të cilët janë çua atje për të dhënë konsulencë profesionale, çka ju ka dashur Clive Lloyd'i dhe shtrohet pyetja, dhe përsëri shtrohet pyetja se kush është ky Clive Lloyd. Unë jam futur në atë farë listën e brokerëve të Londrës, dhe pash se është një njeri prej qindra tjerëve, nuk po them profesionalisht që është i ulët, po shihet ashiqare që ka lidhje, miqësore me dikë atje në bord, që e kanë thirr këtu për të marrë një mëditje e tjera e tjera.

Dhe atë që u tha këtu, këtij Trusti duhet t'i ndërrohet emrin, nuk e ka emrin Trust, nuk është transparent, nuk punon konform kërkesave dhe interesave të qytetarëve të Kosovës, andaj nuk e meriton ta ketë emrin Trust. Unë po them që le të zgjohen nga gjumi, se është koha e fundit, mos të shesin përralla, broçkulla këtu, po le të bëhen më profesionist, po edhe Qeverisë, jo veç kësaj, po edhe atyre të ardhme, ju lutem, të keni parasysh se kë po e dërgoni atje në bord, mos dërgoni amatorë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputet!

Fjalën e ka deputetja Teuta Hadri, le të përgatitet deputeti Fatmir Rexhepi.

TEUTA HADRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Këtu para nesh kemi dy rekomandime, rekomandimi një dhe dy. Të dy këto rekomandime, si njëshi dhe dyshi duhet të kalojnë dhe të miratohen sa më shpejtë nga ky Parlament. Por, vërejtjet e mia, si deputete, do të jenë te rekomandimi, jo te rekomandimi i dytë, por ndaj Bordit të Trustit të Pensioneve.

Mendoj se ky bord në propozimet e veta, në rekomandimin e dytë, nuk e ka parapa nivelizimin e pagave të punëtorëve të vet, të anëtarëve të Bordit, kur dihet se ky Parlament, të nderuar deputetë, i ka kërkuar disa herë këtij bordi që t'i bëjë transparente pagat e tyre dhe ne si deputetë disa herë kemi pasur presion nga qytetarët tanë – pse ne nuk e ngrehim këtë çështje në Parlament për nivelizimin e pagave të tyre, kur ato paga kanë qenë enorme, duke i krahasuar pagat e institucioneve tjera dhe kjo pagesë e tyre besoj se e ka irrituar edhe qytetarin e Kosovës.

Dhe, vërejtja e dytë, nëse ka transparencë këtu te këto paga, kthehem prapë, atëherë për institucionet tjera duhet të ketë transparencë edhe për bordin dhe anëtarët e tij.

Dhe, vërejtja e dytë e imja është se ky Bord para pak kohe e ka marrë një vendim dhe e ka nënshkruar një marrëveshje, që e thanë edhe parafolësit tanë, që paratë e fondit për 59 milionë euro i ka investuar jashtë. Lind pyetja – pse i kanë investuar jashtë dhe deponuar, domethënë ata kanë eksportuar para në bankat e jashtme, jo në bankat vendore, ku edhe ekspertët vendorë, ekonomistët, të gjithë kanë parapa se ky eksportim i parave, thonë me plotë fjalën, është eksportim derisa nuk janë në bankat vendore, pse bëhet ky, çfarë qëllimi bëhet kur edhe interesi i pagesave në bankat e jashtme ka qenë më i ulët për 0.5 se interesi në bankat vendore me 0.1%. Pastaj, është edhe interesi i vetë Trustit, se me këto deponime të parave vetë Trusti fiton 5.5% të këtyre interesave. Dhe, lind pyetja – a jemi të marrë apo çka jemi, pse këto para shkojnë në bankat e jashtme, kur ka mundësi të investohet këtu. Me këtë veprim që ka marrë ky Trust, e ka dëmtuar imazhin e bankave vendore, e ka humbur sigurinë e qytetarëve tanë që deponojnë para në këto bankat tona vendore. Prandaj, propozojmë që sa më shpejtë dhe plotësisht t'i miratojmë këto rekomandime që komisioni dhe deputetët e këtij Parlamenti sa më shpejt të merren me Ligjin për Fondin e sigurimeve pensionale. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit!

Deputeti Fatmir Rexhepi e ka fjalën, le të përgatitet deputetja Myzejene Selamani.

FATMIR REXHEPI: faleminderit, zoti kryesues!

Përsëritet kolegjë deputetë!

I nderuar ministër,

Ditën e premte, kryetari i Parlamentit bëri mirë që e shtyri mbledhjen për sot dhe unë gjithnjë mendoja se debati lidhur me këtë temë kaq të rëndësishme me këtë raport për të nxjerrë rekomandime më adekuate dhe për të parë, do të thotë, se çka ka ndodhur me Fondin e Trustit të Pensioneve, me ato qindra miliona, mendoj që vëmendja jonë do të ishte pak më ndryshe me debatin që duhet t'i kushtohet këtij fondi dhe kësaj çështje për të cilën sot unë nuk po e shoh që është në atë nivel çfarë e kam pritur. Si do që të jetë, shqyrtimi i këtij raporti nuk mund të kalojë pa vërejtjet adekuate për shkak të mangësive të mëdha që i ka një raport, i cili besoj që nuk i përmbush as konditat elementare që të marrë notën pozitive të institucionit të parlamentit, pavarësisht rekomandimeve që i ka bërë Komisioni për Buxhet, të cilat nuk thonë shumë, nuk thonë diçka të veçantë.

Duke u nis nga fakti se treguesit brenda këtij bilanci nuk shpjegohen sa u përket politikave të investimeve të këtyre mjeteve për objektivat, për synimet, për strategjinë, për krejt atë çka realisht duhet të jetë pjesë e shpjegimeve brenda një raporti vjetor për një fond kaq të rëndësishëm me qindra, qindra miliona kur bëhet fjalë, çka është një mangësi e madhe, mendoj që është dashur të jetë i plotësuar. Nuk mungon kuadri që është brenda këtij bordi që e menaxhon këtë, por mendoj që mungon serioziteti i këtij parlamenti, sepse ne jemi themelues të këtyre institucioneve, të cilat me ligj i kemi krijuar dhe ndërtuar si institucione të pavarura. Unë mendoj që nuk duhet ta marrin atë formë, të jenë të pavarura plotësisht, por ato duhet të jenë të kontrolluara, të mbikëqyren nga ana e Parlamentit, atij që e themelon, por pjesërisht edhe nga ana e Qeverisë, ashtu si është me ligj. Kjo nuk po ndodhë, prandaj kemi këto raporte dhe e kemi këtë gjendje çfarë e kemi edhe me menaxhimin dhe shfrytëzimin apo investimin e këtyre mjeteve.

Na kujtohet, ne për politikat të cilat kemi folur këtu, në të cilat bien edhe politika e menaxhimit të këtij fondi, për deklarimet lidhur me investimet, qoftë të huajat, qoftë tonat në Kosovë, për ambientin ekonomik, sigurinë dhe të tjera, secili prej nesh, edhe Qeveria, kemi deklaruar se kemi ambient, pra ambient të sigurt ekonomik të investimeve në vendin tonë. Prandaj, çka ndodhë? Ta bëjmë vetëm një krahasim në mes të këtij raporti dhe raporteve ose bilancit vjetor të sistemit bankar ose të bankave që punojnë në Kosovë. Përderisa politikat e këtyre bordeve kanë plasuar mjetet jashtë, ashtu siç u tha në raport 1:2, që nuk është në favor të atyre politikave që i kemi proklamuar as në këtë Parlament, sepse nuk janë në interes të zhvillimit ekonomik të vendit, të gjithë e dimë zinxhirin e ndikimit të impaktit që kanë, dërgimi i mjeteve jashtë vendit, sikur ato të ishin investuar në vend dhe sigurisht që, në mënyrë shumë dimensionale do të afektonin jetën ekonomike dhe zhvillimin më të mirë të vendit tonë. Por, kjo nuk po ndodhë, nuk po bëhet, nga ne nuk po kërkohet në Parlament, nuk po kemi kohë, sikur sot që nuk po kemi kohë, po ashtu, që realisht, me seriozitetin më të madh të shqyrtojmë, pra, kah po lëvizin me qindra miliona.

Në anën tjetër, është e vërtetë ajo që u tha nga një deputete këtu se kemi humbje me qindra e qindra miliona nga ky fond dhe askush nuk jep llogari, askush nuk kërkon llogari nga ata atë cilët janë përgjegjës për plasimin dhe investimin e këtyre mjeteve.

Po ta lexojmë bilancin financiar të bankës, Revizion Bankës ose Pro-kredit Bankës në Kosovë, merrni me sa vite që punojnë ata në Kosovë, kanë fituar me qindra e qindra milionë. Por, edhe ky është një lloj fondi. Por, derisa ne kemi proklamuar siguri, që thashë pak më herët, atëherë bëhet pyetje për politikat të cilat ne po i ndërtojmë dhe përmes mekanizmave dhe institucioneve tona të pavarura, në këtë rast, e kemi fjalën për Trustin e Pensioneve. Kjo na thërret, pra, që realisht ne, si Parlament, të vendosim në rend dite dhe shqyrtojmë atë çka u kërkua nga deputetët, çka duhet të plotësohet, çka duhet të ndryshohet, realisht me këto borde të pavarura, me këto institucione apo agjenci të pavarura, të kësaj natyre për të cilat ne jemi themelues, për të cilat mbajmë përgjegjësi.

U tha këtu nga kolegët deputetë, po t'i shikojmë edhe tabelat në atë faqen tjetër, e cila flet shumë, që është kërkuar nga Komisioni i Buxhetit, për nivelin e pagave. Realisht, 30 punëtorë, staf dhe bord, një mesatare e bruto të ardhurave personale vjetore i kanë diku rreth 25.000 deri 30.000 euro. Analizoni tash me gjithë punonjësit e tjerë në Kosovë, në cilindo sektor që është, merrni të ardhurat mesatare, nuk besoj që kalon 5000 deri në 6000 bruto të ardhura personale vjetore. Atëherë, ku po jetojmë? Kush i ka bërë këto? Kush i ka ndërtuar këto? A kemi ne të drejtë të korrigjojmë, a kemi të drejtë të kontrollojmë, a duhet ndërmarrë këtë? Unë besoj që po. Është e pandershme politikisht dhe mos të flas ekonomikisht, në raport me krejt punonjësit e tjerë. Ne t@I japim paratë tona, të na i menaxhojë dikush, të na krijojë humbje dhe të krijojë këso të ardhurash marramendëse personale, pra të jetojë në kurrizin e asaj çka nuk do të ishte mirë të lejohet, por ne e kemi lejuar, pra Parlamenti nuk mund t'i ikë përgjegjësisë së vet. Kur e them këtë, e kam parasysh se i takon Kryesisë së Parlamentit të merret më shumë me çështjet, institucionet e pavarura të cilat ne i kemi themeluar.

Ne humbim kohë shpeshherë këtu për temat që aspak nuk kanë rëndësi, ndërsa Kryesia e Parlamentit me komisionet funksionale, me komisionet përgjegjëse, i takon pra që të marrë në mbikëqyrje të plotë dhe të kontrollojë punën e këtyre agjencive, në këtë rast edhe të Trustit. Nëse duhet të bëhen ndryshimi, ne jemi ata që duhet t'i iniciojmë ndryshimet, duhet Kryesia e Parlamentit, përmes komisioneve, përmes ekspertëve, ta

ndryshojmë, ta plotësojmë ligjin dhe të ndërhyjmë në momentin e duhur, që realisht të harmonizojmë atë çka është në interes të funksionimit më të mirë dhe të menaxhimit më të mirë, por edhe të vetë harmonizimit, pra, të të gjitha akteve me nevojat që u duhen të gjitha institucioneve. Kjo nuk po ndodhë, nuk është mirë. Prandaj, thirrja ime i bashkohet asaj që kisha plotë kolegë deputetë. Duhet të ndryshojmë aktet ligjore me kohë, të mos vonohemi, se kështu nuk bën t'i lejojmë këto institucione të pavarura, vërtet të bëjnë kësi lloj menaxhimi dhe kështu keqpërdorime të mëdha të fondeve të cilat kanë një rëndësi jetike në qoftë se ato do të investoheshin në Kosovë.

Ne nuk kemi të drejtë, edhe në herë po përfundoj, në njërin anë këtë foltore të Parlamentit, në këtë Parlament, qoftë qeveritar, qoftë deputet të proklamojë, se jemi vend, domethënë jemi një shtet i ri, me një ambient të sigurt ekonomik për investime, me një sistem të qëndrueshëm bankar, në anën tjetër të gjitha fondet t'i dërgojmë jashtë vendit. Nuk shkojnë këto dy politika, nuk shkojnë. Pra, nuk duhet të mashtrojmë as opinionin, as këtë Parlament, as vetveten. Pra, të ndërmarrim hapat tonë institucional në korrigjimin, plotësimin, ndryshimin me kohë të asaj çka duhet nesër të plotësohet, në mënyrë që edhe këto agjencione, realisht të japin llogari, të japin përgjegjësi dhe realisht të punojnë më mirë se sa që kanë punuar deri më tash. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputet! Fjalën e ka deputetja Myzejene Selmani, përgatitet deputetja Kaqusha Jashari.

MYZEJENE SELMANI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Përsëritet për të gjithë!

Para nesh është një raport i Trustit Pensional, më mirë të them një raport 5 faqesh, i cili nuk di a mund të quhet raport për gjendjen çfarë është momentale brenda këtij Trusti. Mirëpo, me të gjitha rekomandimet e Komisionit për Buxhet dhe Financa, që njëkohësisht mund të them se rekomandimet janë të mira, por esenca qëndron te vetë Qeveria, e cila është ekzekutiv dhe e cila duhet të bëjë draftimin e ligjeve dhe në këtë aspekt, i gjithë raporti paraqet një raport teknik, them edhe një herë, se në vet raportin thuhet diku se raportin financiar më përmbajtësor dhe të audituar për vitin 2009, shpresojmë ta dorëzojmë nga vetë Trusti deri më 30 prill 2010, ndërsa i gjithë raporti, mund ta quaj raport teknik, jo raport shumë i detajuar dhe jo shumë transparent, ndërsa çështja e kthimit të parave të Trustit, apo më mirë të themi çfarë kthimi pozitiv kemi pasur, është një gjendje shumë e vogël e kthimit, jo aq e mirë dhe të jep për të treguar më së miri se cilat janë politikat qeveritare të këtij Kabineti, kur dihet mjaft mirë se Ligji është dashur shumë më herët, Ligji nr. 03-084 mbi pensionet në Kosovë të ndryshojë, kur dihet mjaft mirë se tash ky Kuvend e ka emëruar edhe Bordin vitin e kaluar, siç potencoi parafolësi, ndërsa çdo herë bëhet publike dhe thuhet se politikat qeveritare janë për ambient të sigurt të investimeve, potencoi edhe zotëri Fatmir Rexhepi. Mirëpo, nuk thuhet se jemi për investime të sigurt, kur me ligj ia kemi lënë mundësinë Trustit Pensional që vetëm 5% të ngelin në Kosovë, ndërsa të hollat e taksapaguesve apo të qytetarëve tanë të cilët vet në këtë trust, dalin jashtë Kosovës dhe kur dihet se Kosova përballlet me një buxhet mjaft të varfër dhe nuk mund të investojë prej buxhetit të vet.

Esenca e gjithë këtij raporti dhe esenca e këtij Kuvendi është që të mos merret me një raport pesë faqesh, vetëm kur e kanë raportimin edhe në bazë të Kushtetutës, mirëpo Kuvendi si formues i tyre thërret çdo herë këto agjencione apo këtë Trust të Kursimeve Pensionale dhe e di më së miri ku janë pengesat, ku shihet mjaft mirë se akoma janë funksionale rregulloret e UNMIK-ut, në Fondin Pensional, ndërsa jemi duke shkuar kah viti i tretë i pavarësisë së Kosovës dhe akoma nuk kemi mundur të plotësojmë

infrastrukturën ligjore dhe unë nuk e di cilat janë interesat tona në këtë aspekt në Trustin Pensional të Kosovës. Edhe njëherë, apel total imi kishte për të qenë që Qeveria të amandamentojë Ligjin, në mënyrën më të shpejtë të mundur dhe të bien nga funksioni rregulloret e UNMIK-ut, kur dihet se vendi po shkon nga viti i tretë i pavarësisë dhe të gjithë jemi bartës të këtyre pasojave të humbjeve të Trustit Pensional të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Deputetja Kaqusha Jashari e ka fjalën, le të përgatitet deputeti Berim Ramosaj.

KAQUSHA JASHARI: Ju faleminderit, i nderuari kryesues!

Të nderuar kolegë dhe ministër, i cili është prezent,

Kemi filluar pak t'i përsërisim, prandaj unë shkurtimisht do të diskutoj, se mendoj njësoj sikur edhe parafolësit.

Të diskutojmë Raportin për vitin 2009 të Trustit, e jo raportin periodik, që mund t'i kërkojmë më vonë disa shpjegime, disa plotësime. Prandaj, mendoj se raporti vjetor është i rëndësishëm, si është punuar dhe ai ka të gjitha të dhënat që na tregojnë edhe ecuritë e mëtutjeshme në këtë fond. Raporti për mua nuk është raport, vetëm një dy tri faqe të raportit bankar, pa asnjë fjalë, pa asnjë shpjegim dhe kështu unë nuk mendoj se është mirë ta kalojë Kuvendi. Në vitin e kaluar kur kemi diskutuar për Raportin të vitit 2008, kemi thënë që nuk ekziston bordi dhe nuk ka kush që guxon edhe nuk është mirë që të japë vlerësime se nuk ka kush edhe ta nënshkruaj raportin vjetor. Bordin e kemi kompletuar me shumë vështirësi, me shumë vonesa, por ekziston, nuk hyjmë tash në vlerësimin e mundësisë të jepen edhe analizat, por e kanë obligim. Prandaj, unë mendoj se ky raport është çudi që është dhënë kështu në dy-tre faqe dhe për mua, për shembull, është një nënçmim i bordit ndaj institucionit të Kuvendit, i cili e ka formuar dhe unë mendoj se na duhet të kemi iniciativën për bazën juridike dhe të rishikohet pozita e Trustit, sepse ai vepron në bazë të ligjit ose të rregullores e cila është bërë në kohën e UNMIK-ut, sikur me ligjet tjera, atëherë duhet marrë seriozisht jo vetëm pozitën e Trustit, por në tërësi Ligjin për sigurimin pensional. Sipas agjendës tonë, edhe Qeveria që na ka dërguar, është fundi i vitit, unë mendoj se duhet të jetë shumë më herët, se është i gatshëm.

Pse jam pak e ashpër në krahasim me, jo në krahasim me kolegët, por edhe të gjithë po kërkojmë njësoj, shumë jam irrituar edhe me këtë letërën përcjellëse për këtë raport. Shikoni çka po thotë: "Ju njoftojmë se raportet financiare më përmbajtësore dhe të audituara për vitin 2009, shpresojmë t'i dorëzojmë deri me 30 prill 2010". Shpresojmë, domethënë në qoftë se munden, e dorëzojnë, e në qoftë se nuk munden, nuk e dorëzojnë. Prandaj, ata duhet pasur kujdes edhe Kuvendi duhet t'i kërkojë afatet, e jo në qoftë se mund të mbërrijnë. Gjithashtu, "Nëse keni ndonjë pyetje rreth raporteve, ju lutemi mos nguroni të na kontaktoni". Kush kujt i kërkon llogari? Prandaj, unë këtë raport nuk do ta votoj. Nëse kalon sot, kam për të vazhduar edhe më 2010 në këtë mënyrë. Unë mendoj që duhet seriozisht të merret, se ata nuk janë të pavarur në atë kuptim, të disponojnë me paratë e të punësuarave. Edhe sivjet ka qenë një konferencë për shtyp, ku kanë deklaruar se kanë investuar ende jashtë, e sa në bankat vendore.

Ky raport është qesharak, pa asnjë fjalë. Edhe një herë po them, nuk do ta votoj, le të kthehet. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Deputeti Berim Ramosaj e ka fjalën, le të përgatitet deputeti Gani Buçinca.

BERIM RAMOSAJ: Edhe pse po mungon një audiencë e madhe, por unë thashë të dal këtu dhe ta ngrisim pak interesimin për këtë çështje shumë të rëndësishme. Ju faleminderit, zoti kryesues!

Përsëritës, nuk paska Qeveri këtu!

Ju përsëritës, kolegë të nderuar!

Vërtet, ashtu si e përmendën shumë deputetë këtu, se është një çështje mjaft e rëndësishme të bisedohet për Trustin Pensional të Kosovës. Vërtet, dëgjuam ne këtu prej shumë kolegëve të mi, që patën shumë të drejtë në aspektin e asaj se vërtet ne duhet të mbajmë përgjegjësi si Kuvend për këtë institucion. Por, Institucioni i Trustit Pensional të Kosovës është një institucion specifik, nuk është as institucion financiar, që punon për fitime, ekskluzivisht për fitim, por të njëjtën kohë nuk është as institucion që merret me çështje humanitare, çështje sociale. Andaj, vendimet që merren në Trust, duhet të merren duke u mbështetur në ekuilibrin midis përgjegjësisë sociale, në njërën anë, dhe efikasitetit ekonomik, në anën tjetër. Shtrohet pyetja: A mund të bëjë ky bord, a mund të bëjë ky institucion, a mund të nxjerrë vendime ky institucion në harmoni me këto dy qasje – përgjegjësinë sociale dhe efikasitetin ekonomik. Nga përvoja e deritanishme e këtij Trusti, nuk e ka dhënë provimin.

Vërtet, përgjegjësia është e këtij Kuvendi, sepse ne duke u mbështetur në ligj, kemi zgjedhur anëtarë të bordit, ku decidivish shkrunte: “Anëtarët e bordit duhet të jenë ekspertë në fushën e menaxhmentit financiar, respektivisht të financave ndërkombëtare”, që unë dyshoj që niveli i tillë i bordit e ka atë ekspertizë. Këtë nuk e marr këtë guxim të them për Bordin menaxheus apo për menaxhmentin, sepse në menaxhmentin e Trustit ka mundësi që të jetë ndonjë edhe ekspert i kësaj fushe. Ligji ekzistues ka paraparë që vërtet niveli edhe i përgjegjësisë publike ndaj mjeteve të cilat janë obligativisht të mbledhura, që nuk është sikur çdo fond tjetër apo çdo organizatë tjetër sigurose, e cila është vullnetare, domethënë në bazë të mjeteve në aspektin vullnetar përcaktohesh për këtu, ky është një fond obligativ, e me qenë se është obligativ, që ndalet pjesa e të ardhurave edhe nga punëdhënësi, edhe nga punëmarrësi, atëherë përgjegjësia rritet edhe më shumë. Andaj, këtë nuk po mundet, vërtet nuk po mundet Trusti në mënyrën e tillë të organizimit që e ka sot, nuk po mundet të realizojë. Ky nivel i ekspertizës së bordit nuk na ka dhënë ende neve një përgjigje të tillë që vërtet t’i besojmë në kuptimin e krijimit të portfolios. Nuk është në pyetje këtu vendi ku plasohen mjetet, këtë ta heqim këtë dilemë. Nuk është e rëndësishme sepse vendimet për plasimin e kapitalit të Trustit, respektivisht të mjeteve merren duke u mbështetur edhe në shkallën e riskut, në njërën anë, por edhe në efikasitetin e shfrytëzimit të atyre mjeteve. Andaj, ku gjenden burimet, ku gjenden kompanitë, ku gjenden ato fondacione të cilat garantojnë shkallë të lartë të efikasitetit, domethënë mund të fitojmë me këto para, në të njëjtën kohë mund të na garantojnë shkallë të ulët të riskut, padyshim që edhe plasimi i këtyre mjeteve bëhet në atë. Andaj, këtu kërkoj pak ndjesë ndaj deputetëve të cilët vërtet janë ekskluziv në këtë kuptimin të plasohen vetëm këtu ose vetëm atje. Jo, duhet të plasohen aty ku na garantohej efikasiteti i lartë dhe shkallë e lartë e riskut. Ky është vendimi.

Duhet bërë krahasimi i Trustit Pensional të Kosovës me fondet tjera pensionale simotra, qoftë në nivel të vendit, qoftë në nivel regjioni, qoftë të nivelit të Evropës, në qoftë se duam t’ia masim performancën Trustit. Nuk mundemi ne ad-hoc të masim performancë, po na pëlqen, s’po na pëlqen, kemi mbledhur pak mjete, s’kemi mbledhur. Unë e di fare mirë dhe jemi, ndoshta edhe jemi anëtarë që kemi sigurancë edhe private, që e kanë

natyrën e tillë të fondeve private të sigurimit pensional, që performanca e tyre nuk është kaq e dobët në krahasim me Trustin, për shembull VFF-ja apo austriakët apo gjermanët apo, ka shumë kompani të sigurimeve në Amerikë që nuk e kanë këtë shkallë kaq të ulët të performancës në kuptimin e efikasitetit, duke ruajtur apo duke mbajtur shkallën mjaft të ulët të riskut.

Mënyra e organizimit të Trustit në dy nivele, prej një bordi i cili është i rregulluar me ligj, që e kemi dhënë në anëtarët, dhe pjesës së menaxhmentit, nuk po mund të garantojë as përgjegjësinë ndaj këtij Kuvendi, ndaj qytetarëve të Kosovës, e në të njëjtën kohë nuk po mund të garantojë as efikasitet dhe ekspertizë. Unë këtë bile po e mendoj se kjo është esenca e problemit. Dhe, një problem tjetër, i cili u tha edhe nga shumë deputetë të tjerë, është infrastruktura ligjore. Ju lutem, kjo infrastrukturë ligjore, pa marrë parasysh a është rregullore a është ligj, është recidiv i periudhës së kaluar, që kur Kosova nuk ka qenë shtet, andaj na u kanë imponuar format e tilla të organizimit juridik, që në njëfarë forme nuk i përgjigjen sot nivelit tonë të zhvillimit, nuk i përgjigjet një shteti të pavarur, që sot ekziston, Kosova si Republikë e pavarur duhet të nxjerrë ligje të cilat edhe janë në harmoni me vendet tjera të Evropës, janë në harmoni me Ligjin antimonopol, por në të njëjtën kohë sigurojnë edhe shkallë të lartë të efikasitetit në mjedisin kosovar, që nuk do të thotë të jetë sikur çdo mjedis tjetër.

Mbas krejt kësaj që i thashë, që janë në fakt vërejtje jo vetëm të miat, unë mendoj që në qoftë se shkojmë në votim për këtë raport, unë mendoj që edhe në qoftë se aprovohet ky raport, të shkojnë këto rekomandime. Të nxirret një ligj që organizon ndryshimin organizativ të Trustit, një ligj i veçantë që ka kuptimin e një ligji të Fondit Pensional të Kosovës, që i përgjigjet mjedisit kosovar dhe në harmoni me komponentet e ekonomisë së tregut, që nuk biem në kundërshtim as me nivelin regjional, as evropian. Nëse kjo gjë kërkon kohë, kërkon angazhim, kërkon potenciale plotësuese që ne nuk i kemi, atëherë të shkojmë me ndryshime eventuale të infrastrukturës ekzistuese ligjore, që na mundësojnë neve një bord me ekspertizë të lartë dhe marrje të vendimeve në këtë institucion, duke u mbështetur në përgjegjësinë sociale, në njërën anë, shkallën e ulët të riskut, në anën tjetër, por edhe efikasitetin ekonomik, po ashtu duhet mbajtur në përgjithësi. Mendoj që nuk duhet të na ndajë përkatësia politike kur është çështja te Fondi Pensional apo te Trusti Pensional, andaj kisha kërkuar që të jemi shumë unik që një herë e përgjithmonë të fusim edhe këtë institucion që po thirrëmi, shumë i pavarur, që po duket që është shumë i varur, që në fakt të nxjerrim diçka juridikisht për çka jemi të thirrur, një infrastrukturë ligjore e cila do të na mundësojë një fond pensional të Kosovës që garanton edhe mjetet, meqenëse është fond obligativ, por në të njëjtën kohë na garanton edhe sukses apo efikasitet ekonomik. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Deputeti Gani Buçinca e ka fjalën, le të përgatitet deputetja Drita Kadriu.

GANI BUÇINCA: Ju faleminderit, zoti kryesues për fjalën e dhënë!

Ju përshëndes të nderuar kolegë deputetë!

Është viti i tretë që ne e diskutojmë këtu, për mua është viti i tretë që diskutojmë për raportet e Trustit Pensional dhe, t'ju them të drejtën, gjithmonë diskutimet dhe raportet janë të njëjta për kah përmbajtja. Në fakt, nuk janë fare raporte për arsye se edhe nuk mund të jenë raporte sepse vet statusi juridik i Trustit është i tillë, është ambivalent, është i komplikuar, kështu që nuk mund të shkruhen raporte të mirëfillta, por edhe diskutimet tona janë përafërsisht të njëjta dhe nuk japin ndonjë zgjidhje afatgjate për fatin e Trustit Pensional.

Këtë raport, ma merr mendja, është mirë mos ta votojmë, përkatësisht të rekomandojmë diçka, t'i rekomandojmë diçka Trustit dhe të fitojmë kohë në si deputetë, si Kuvend që ta ndryshojmë ligjin. Këtu nuk po diskutohet a e ka shkelur Trusti ligjin, gjë që unë mendoj se nuk e ka shkel dhe është duke punuar konform ligjit, nuk janë fajtorë punëtorët që punojnë aty, por është legjislativi që ua mundëson mënyrën e tillë të punës në Trust, kurse në tre vite, së paku ky legjislacion, dy vite e gjysmë nuk kemi manifestuar vullnet politik që të ndryshojmë qoftë statusin e Trustit, qoftë gjendjen në Trust. Këtu edhe dikush e anatemoi Qeverinë, nuk dua t'ia bëj apologjinë Qeverisë, as ta marr në mbrojtje, mirëpo nuk është çështja e ekzekutivit çështja e Trustit, por është çështje e legjislativit, është çështje ekskluzive politike e jo ekzekutive. Edhe ne duhet këtu, në këtë sallë, të nderuar kolegë, sot të marrim një vendim, të manifestojmë një vullnet politik, të gjejmë një konsensus politik dhe të ndryshojmë statusin e këtij institucioni, i cili, atyre që paguajnë aty, nuk ju siguron pleqëri të sigurt.

Ato para në mënyrë qysh menaxhohen me legjislativin aktual që është, nuk i garantojnë asnjërit, asnjë kontribuuesi aty që kur t'i bëjë 65 vjet do të ketë një pleqëri të rehatshme. Për këtë arsye, unë kisha kërkuar që në kuadrin e rekomandimeve, ashtu siç e tha edhe profesori i nderuar Ramosaj, t'i rekomandojmë Trustit që mos të bëjë asnjë transaksion financiar për një periudhë gjashtëmujore, shtatëmujore, tetëmujore përderisa të gjitha grupet parlamentare këtu bien në ujdë dhe fillojnë procedurat për amendamentimin e ligjit dhe ia imponojmë kësaj Qeverie dhe atyre qeverive që do të vinë pas kësaj, që të japin garanci për paratë e atyre që paguajnë në këtë fond. Të kemi një fond shtetëror të sigurimit pensional dhe pastaj qytetarët e Kosovës, sipas dëshirës të bëjnë sigurime pensionale, qoftë në vend, në kompani të ndryshme të sigurimeve, qoftë jashtë vendit. Është çështje e tyre personale.

Mirëpo, në këtë mënyrë ne mund të diskutojmë me vite të tëra dhe gjendja në Trust ka për të vazhduar njësoj. Unë nuk po vërej se punëtorët e Trustit kanë shkelur ligjin në fuqi. Ata janë duke punuar konform ligjit dhe të jeni të bindur, kurrë.... iniciativa për ndryshimin e ligjit prej tyre për arsye se me ligjin ekzistues ata kanë privilegje dhe benificione që nuk besoj se mund t'i ketë dikush në një shtet diku në rruzullin tokësor.

Ky Kuvend ka fuqi politike, ka mandat të bëjë ndryshimin e statusit të Trustit. Ky Kuvend ka mandat dhe ka fuqi politike edhe juridike për ta bërë këtë ndryshim. Problemi është se a dëshiron çdo deputet që është këtu, pavarësisht cilës partie politike i takon, të marrë përgjegjësinë ndaj këtyre 300.000 qytetarëve të cilët paguajnë dhe nuk kanë asnjë garanci se pas 30-40 viteve do t'i gëzojnë pensionet e veta. Unë, si deputet e Partisë Demokratike, nuk do ta votoj këtë raport, sepse nuk është raport, edhe pse qëndrimi i partisë është të votohet dhe unë si deputet i Partisë Demokratike mund të bashkëpunoj me çdo deputet, të cilës do forcë politike, për të ndryshuar ligjin dhe për t'i realizuar në interesat e qytetarëve të Kosovës të gjithë bashkë si politikanë. Ma merr mendja se është koha që në këtë fazë, së paku të nxirret Ligji për pensionet ose për Trustin, që të na bashkojë të gjithëve si politikanë dhe ta bëjmë këtë ndryshim. Kemi edhe aftësi profesionale, kemi edhe ekspertë mjaft brenda Kuvendit dhe kjo është përgjegjësi e Kuvendit të Kosovës. Kaq. Ju falënderoj për vëmendjen, më falni se e zgjata!

KRYESUESI: Fjalën e ka deputetja Drita Kadriu, përgatitet deputeti dhe anëtar i Kryesisë, Ibrahim Gashi.

DRITA KADRIU: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Meqenëse kanë filluar të përsëriten shumë çështje rreth Raportit të Trustit Pensional, me respekt do të ndaj disa mendime rreth këtij raporti.

Sipas Ligjit nr. 3, 03/04, i cili është miratuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës, më 13 qershor të vitit 2008, i cili gjithashtu ka zëvendësuar Rregulloren e UNMIK-ut 2001/35 për Fondin Pensional të Kosovës, Fondi Pensional është i obliguar të paraqesë raport vjetor për vlerën e mjeteve pensionale dhe raportet vjetore për të gjitha pagesat, të cilin raport sot po e shqyrtojmë. Derisa për Fondin e Privatizimit nuk kemi të dhëna dhe nuk ka transparencë, raporti dhe pasqyrat financiare të cilat sot i kemi në debat, nuk janë të shoqëruara me një raport narrativ, i cili do ta bënte më të lehtë debatin dhe diskutimin për këtë çështje kaq të ndjeshme.

Tanimë është e ditur se gjatë vitit 2008-2009, për shkak atë rënies së aksioneve në tregjet botërore, Fondi Pensional i Kosovës ka humbur mbi 120 milionë euro të të gjithë qytetarëve të Kosovës, ndërsa aktualisht shihet një tendencë dhe ka një stabilizim të këtij fondi. Trusti sot menaxhon me 380 milionë euro, ku sipas ligjit në fuqi, në Kosovë investohen vetëm 5% nga ky fond. Në kohën kur më së shumti kemi nevojë për investime, gjithashtu ndodhë një paradoks ku mjetet e Fondit të Privatizimit nuk janë transparente dhe nuk dihet, ndërsa Fondi Pensional ndodhet në tregun e jashtëm. Mendoj dhe besoj se tanimë janë krijuar kushtet dhe kapacitetet humane që ky Fond Pensional të kthehet në Kosovë, duke pasur parasysh se sot në Kosovë, janë promovuar projekte shtetërore shumë të mëdha kapitale, siç është Strategjia e energjisë, autostrada dhe projektet tjera, prandaj rekomandojmë që ky Fond Pensional sa më shpejt të kthehet në Kosovë me kusht që t'i paraprijë përmirësimit dhe amendamentimit të infrastrukturës ligjore që e rregullon veprimtarinë e Fondit.

Gjithashtu, në Strategjinë e Kuvendit është paraparë Ligji për letrat me vlerë dhe besoj se të gjitha grupet politike brenda Kuvendit dhe ekspertët tjerë do të kontribuojnë që ky ligj të jetë përmbajtësor dhe të jetë ligj, njëri ndër ligjet shtyllë që do t'i kontribuojë stabilitetit ekonomik të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Deputeti Ibrahim Gashi e ka fjalën, përgatitet deputeti Ramadan Avdiu. Lus regjinë që ti ftojë deputetët të kthehen në sallë për shkak se po ofrohet koha e votimit. Është edhe një deputet pas këtyre të dyve që i përmenda, por u tërhoq deputetja Gjylnaze Syla, e tërhoqi fjalën, kështu që i fundit është Ramadan Avdiu.

IBRAHIM GASHI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Debatet që e kanë ngjallë këtë Parlament, raportet e Trustit tashmë më shumë se dy vite, sigurisht që me këto që u thanë sot, me një kompetencë edhe profesionale edhe politike nga shumica e parafolësve, flasin se ka një pakënaqësi të vazhdueshme me punën e Trustit, përkatësisht me mënyrën e menaxhimit të kursimeve të të punësuarve në Kosovë me këtë fond, i cili është i ngritur me qëllimin që pas arritjes të moshës, të krijojë një mirëqenie, pra një pleqësi, siç u tha, të rehatshme. Derisa është kështu, do të thotë sot ndoshta ajo pjesa që është pak inkurajuese se do të ketë ndryshme, është se edhe nga deputetët e pozitës, edhe të opozitës, edhe pse Komisioni ka dhënë propozimin që të miratohet ky raport, u dëgjuan edhe zëra kundërshtues në adresë të këtij raporti, me të cilët pajtohem plotësisht. U ngrit nevoja e rishikimit të bazës juridike mbi të cilën funksionon ky Trust. Kjo ndoshta është inkurajuese se në të ardhmen do të korrigjohet

diçka, pikërisht përmes amendamentimit të ligjit dhe do të bëjë të mundur që ky Kuvend, në njëfarë mënyre me vërejtje të vazhdueshme që i ka dhënë në adresë të punës së këtij Trusti dhe të ligjit mbi të cilin punon ky Trust, të ndryshohen në të ardhmen.

Unë, sigurisht që nuk kam si të mos e them se ne po bisedojmë për një çështje shumë senzitive, çështjen e kursimeve, në një kohë kur edhe si shtet kemi problemi të theksuara sociale, kemi papunësi enorme dhe kemi bazë, po mendoj nivel të zhvillimit tepër të ulët ekonomik. Në këto rrethana, shtetet si ne nuk e kanë luksin që ato para që nxirren, që janë domethënë para që kursehen për t'u përdorë më vonë, të menaxhohen jo në mënyrë më racionale të mundshme, aq më tepër që ata të cilët janë të thirrur t'i menaxhojnë këto, i lejojnë vetit të krijojnë privilegje që në një shtet, në një fazë tranzicioni çfarë është Kosova, të gëzojnë kaq shumë privilegje. Unë veç rastësisht e pashë, domethënë, koston e sigurimeve shëndetësore për të punësuarit në këtë Trust. Ne sot nuk kemi sigurime shëndetësore, as deputetët e Parlamentit të Kosovës, as udhëheqësit e institucioneve më të larta të vendit dhe këtë luks e kanë, domethënë, të punësuarit në Trustin e Kursimeve Pensionale, përderisa i kemi qindra mijëra pensionistë të mëhershëm, që sot e marrin një pension i cili është më pak se ndihma sociale.

U fol këtu edhe për pagat. Me të vërtetë është e patolerueshme lartësia e atyre pagave, pavarësisht që ligji ndoshta nuk ua ndalon dhe sipas asaj maksimës që asgjë që nuk është e ndaluar, është e lejuar. Sidoqoftë, ne duhet të reflektojmë që diçka të ndryshohet edhe në këtë. Unë nuk i njoh ata njerëz kush janë atje, mund të jenë edhe ekspertë më të mirë që i ka Kosova në fushën menaxhimit financiar, por edhe kjo u vërtetua këtu, u provua këtu që nuk janë të tillët, sepse investimet e kursimeve ku janë bërë, nuk flasin se ka shkallën më të madhe të sigurisë për ato investime dhe efikasitetin më të madh financiar.

Ne sot në Kosovë kemi disa banka që operojnë në Kosovë, që ofrojnë kredi qoftë për biznese, qoftë familjare, me tarifa tepër të larta të kamatave, që askund nuk korrespondon me investimet që ne i paskemi bërë të kursimeve tona jashtë vendit. Do të thotë, ka një jo proporcionalitet aq të madh në favoret që na i bëjmë dikujt me paratë tona dhe në disfavoret me të cilat shërbehemi ne nga ata që na e ofrojnë paranë, shfrytëzimin e parasë së tyre këtu.

Krejt këto, do të thotë, kur i merr dhe i analizon edhe Parlamenti, që është themelues i këtij Trusti, por edhe Qeveria që ka dërguar një pjesë të anëtarëve të bordit atje, i ka propozuar, që ne i kemi votuar, duhet të reflektojmë më përgjegjshëm që kjo të ndryshohet në një afat sa më të shpejtë. Dhe, propozimet që dolën këtu, që të mos votohet ky raport, plotësisht pajtohem me to dhe ju bashkohem, sidomos rekomandimit i cili duhet të futet dhe duhet të dalë prej kësaj seance që të rishikohet, që të amendamentohet, pra t'i bëhet thirrje Qeverisë që të fillojë procedurë të re të amendamentimit të ligjeve. Lidhur me këtë Trust, përmes këtij ligji të bëjmë diçka që ato para, meqë edhe ashtu s'e paskan një siguri të madhe ku investohen dhe, aq më pak një profit të madh nga ato investime, t'i kthehen vendit, natyrisht, me një transparencë shumë të madhe, me një përgjegjësi shumë të madhe të investohen aty ku ka më së shumti nevojë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! I lus deputetët që të përqendrohet në debat dhe pas një ore e sa, kemi të lajmëruar prapë për fjalë. Ramadan Avdiu e ka fjalën, ka qenë i fundit, i ka ra ndërmend diçka deputetes Synavere Rysha, le të përgatitet për fjalë.

RAMADAN AVDIU: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Kjo çështja e Trustit që nga themelimi i Trustit Pensional, po vazhdon në një formë, është shndërruar në rutinë të njëtrajtshme mënyra e menaxhimit dhe mënyra e raportimit. Mbase, këtë material të cilin e shqyrtuam sot, unë nuk do të mund ta quaja raport, këtu janë vetëm pasqyra financiare dhe sipas letrës të nënshkruar nga zëvendësudrejtori, ky raport nuk do të duhej edhe të vijë fare në rend dite sot, sepse ai ka shprehur se deri me 30 prill, do të na e dërgojë një raport më përmbajtësor dhe më të detajuar. Pra, nëse i referohemi kësaj fjalie, del se ky raport nuk ka qenë përmbajtësor dhe presim raportin më përmbajtësor që të na vjen.

Gjendja në Kosovë ka evoluar shumë, mirëpo Trusti Pensional ka stagnuar dhe ka ngelur sikur në vitin 2001. Është e domosdoshme që ne ta kemi një raport të plotë lidhur me menaxhimin e Trustit, por njëkohësisht edhe me objektivat se çka planifikojnë dhe si mendojnë që ata në të ardhmen t'i menaxhojnë mjetet e kursimeve, domethënë të 300.000 punëtorëve në Kosovë. Unë nuk do të ndalem më shumë për arsye se vetëm do të und t'i përsëris ato çka i thanë diskutuesit paraprak, por e presim këtë raport e detajuar dhe të audituar dhe atëherë do të vëmë sigurisht edhe njëherë gjatë këtij viti në rend dite çështjen e Trustit dhe ne raportet duhet t'i marrim nga Bordi dhe jo nga zëvendësudrejtori. Në fakt, këtij Kuvendi do të duhej t'i raportojë Bordi të cilin ne e kemi zgjedhur dhe të na njoftoj përafërsisht me objektivat dhe me politikat investive që do t'i ketë në të ardhmen.

Kjo çka ka ndodhur, do të thotë është si pasojë edhe e krizës financiare, ne e kemi tejkaluar në vitin e kaluar. Shihet se ka filluar të krijohet një stabilitet më i madh, por duhet të mendohet sinqerisht dhe shumë racionalisht për mënyrën e menaxhimit të mjeteve dhe shfrytëzimit të atyre mjeteve për zhvillimin ekonomik të vendit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Dhe deputetja e fundit për këtë pikë të rendit të ditës, Synavere Rysha e ka fjalën. Lus regjinë që t'i ftoj në deputetët të kthehen në sallë. Ju faleminderit!

SYNAVERE RYSHA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

U fol mjaft për Raportin e Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovë. Megjithatë arritëm në një pikë të përbashkët, ndoshta nga ana e të gjithë deputetëve se ky Trust bën menaxhimin e mjeteve në mënyrë jo të mirë dhe politika e tyre menaxhuese edhe më tej vazhdon të jetë sfiduese dhe të jetë jo e përfillur dhe jo e mbështetur për qytetarët e Kosovës.

Kur e them këtë, bazohem në dy fakte dhe aty është tarifa e lartë menaxhuese dhe mënyra se si po ruhen mjetet e kursimeve të të punësuarve në Kosovë dhe, ndoshta e pash se këto dy fakte u përmendën edhe nga diskutuesit, mirëpo nëse ju kujtohet, të nderuar deputetë, pikërisht kur e kemi bërë shqyrtimin e raportit të vitit të kaluar, jemi paguar që Trusti duhet të ketë tarifën menaxhere, t'i zvogëlohet dhe të ulet ajo tarifë, domethënë kanë qenë propozime të ndryshme, megjithatë është kërkuar të ulet.

Megjithatë, në një raport plotësues që ka kërkuar Komisioni për Buxhet dhe Financa, nga shënimet që janë dhënë, thuhet që të gjitha taksat paguhen nga 0.90%, që ndalet nga Trusti për administrimin mjeteve. Prandaj kjo duhet të verifikohet, nëse është një lëshim

teknik, që unë nuk do të besoj fare, do të ishte krejt në rregull. Megjithatë, nëse Trusti ka vazhduar edhe për vitin 2009, me menaxhim të mjeteve me 0.9% tarifë menaxhuesi, kjo do të ishte kundërligjore dhe do të ishte kundër vendimit të Parlamentit. Prandaj, edhe kjo çështje duhet të shqyrtohet, sepse u tha edhe nga deputetët tjerë, pagat e larta me 1200 euro, duke filluar nga niveli më i ulët, nga pastruesit e deri te niveli i lartë dhe politika nga, deri në 5000 euro nga Bordi që marrin, 5000 mëditje, janë jashtëzakonisht të larta, prandaj kjo çështje, jo se duhet të shqyrtohet, por duhet edhe të merren masa nëse nuk është respektuar vendimi i këtij Kuvendi që ka qenë vitin e kaluar.

Prandaj nga ky fakt, unë mendoj që të vërtetohet, nëse është kështu, Trusti ka punuar kundër vendimit të Parlamentit. Gjithashtu, u dhanë vërejtje se ligji ia mundëson. Është e vërtetë se ligji ua mundëson, mirëpo është një bord që e ka vendosur ky Parlament nga 5 anëtarë, të cilët edhe më tej vazhdojnë të mos e kryejnë punën e tyre në mënyrën më të mirë të mundshme, sepse të paktën ai bord është dashur t'ia sugjerojë këtij Parlamenti, politikën më të mirë dhe ku duhet të intervenohet në ligj, mirëpo kjo nuk ka ndodhur dhe kërkohet raporti mos të votohet. Do të kalojë te çështja e fundit.

Të nderuar deputetë,

Nëse nuk do ta kalojmë raportin, atëherë duhet të kërkohen masa nga bordi. Dhe cila është masa, shkarkimi i bordit dhe të themi se a jemi të gatshëm ne si deputetë që të vendosim dhe ta shkarkojmë atë ekip, sepse nëse nuk miratohet raporti i punës, atëherë ka dështuar bordi, prandaj është ky efekti tjetër që njëkohësisht të mendohet për mosmiratimin e raportit dhe shkarkimin e bordit. Këto janë dy çështje. Ju faleminderit!

Diskutim i dorëzuar me shkrim

MYRVETE PANTINA

Raporti i Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2009, të cilin po e diskutojmë, në realitet nuk është raport i kompletuar, por kemi të bëjmë me raportin financiar të bilancit të gjendjes dhe shpenzimeve të buxhetit të TKPK për vitin 2009. Sipas të dhënave të paraqitura në këto dokumente, shihet se totali i aseteve të këtij institucioni ka shënuar rritje në krahasim me vitin 2008, dhe atë rreth 260 milionë euro, sa kanë qenë në vitin 2008, në 385 milionë euro, në vitin 2009, gjë që paraqet një lëvizje pozitive dhe është rezultat i përmirësimit të situatës në tregjet financiare botërore. Nga këto mjete, 63% gjenden jashtë Kosovës, kurse pjesa tjetër prej 37% gjenden në Kosovë. Ajo çka vërehet nga të dhënat është se është rritur pjesa e mjeteve që gjenden në Kosovë, prej 34 milionë euro në 122 milion euro. Kjo shumë paraqet mjetet e kursimeve pensionale që janë grumbulluar pas krizës financiare globale e që prej atëherë nuk janë plasuar jashtë Kosovës dhe gjenden në llogaritë e BQK-së. Por, këto mjete nuk janë futur në përdorim, d.m.th. prej këtyre mjeteve nuk përfiton ekonomia e Kosovës. Prandaj, duhet të krijohet mundësia ligjore që këto mjete të futen në qarkullim në tregun financiar të Kosovës. Ndërsa, sa i përket shpenzimeve buxhetore të TKPK, shihet se nga të hyrat që i ka pasur në disponim ky institucion janë shpenzuar vetëm 75% të mjeteve. Meqë, të hyrat e këtij institucioni grumbullohen nga taksa menaxhuese, të cilën e paguajnë kontribuuesit e TKPK, atëherë lë të kuptohet se në të ardhmen kjo taksë ka mundësi të ulet edhe më tutje, në ç'mënyrë do të ulet edhe ngarkesa për kontribuuesit e TKPK.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në sallë janë 76 deputetë, 77 u bënë tani. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, pra votohet për Raportin e Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2009.

Votojmë tash:

A ka deputetë që nuk i kanë kartelat dhe votojnë pa kartela. Nuk ka.
Konstatoj se me 49 vota “kundër”, 15 “për”, dhe 12 abstenime, Kuvendi nuk e miratoi Raportin e Trustit të kursimeve pensionale të Kosovës për vitin 2009.

Obligohet me këtë mos votim, pra Kryesia e Kuvendit dhe Kuvendi në bazë të Ligjit të veprorë pastaj çka do të veprohet pas këtij refuzimi kaq unanim pra të Kuvendit të raportit të Trustit.

Kalojmë në pikën e radhës:

16. Shqyrtimi i Propozim – vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Pavarur për Rishqyrtimin e Ankesave

Konstatime hyrëse:

Komisioni funksional për Buxhet dhe Financa, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Punës, ka shqyrtuar Propozim vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, për emërimin e anëtarëve të Bordit të Pavarur për Rishqyrtimin e Ankesave dhe nuk e ka përkrahur listën e kandidatëve të propozuar nga Qeveria.

Propozim vendimi i Qeverisë dhe Raporti me rekomandime e Komisionit funksional, u është shpërndarë deputetëve. Radha e diskutuesve. Përfaqësues të Qeverisë, nuk ka të paraqitur. Në emër të Komisionit funksional, pra a ka të paraqitur?
Safete Hadergjonaj e ka fjalën.

SAFETE HADERGJONAJ: Zoti kryesues,

Ju veç e thatë rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa. Komisioni, në mbledhjen e mbajtur me datën 31 mars të vitit 2010, pasi që ka shqyrtuar listën e kandidatëve të cilët janë propozuar me vendimin e Qeverisë për emërimin e Bordit të pavarur për shqyrtimin, rishqyrtimin e ankesave, ka refuzuar një listë të tillë dhe i ka rekomanduar Kuvendit të mos ta miratojë këtë propozim vendim për emërimin e këtij bordi, sepse në këtë listë është dashur të propozohen së paku 7 anëtarë, 7 kandidatë të propozuar në këtë listë, është dashur të vijnë nga komuniteti biznesit, siç e ka rregulluar neni 57, pika 3 e Ligjit e Ligjit për Administratën Tatimore dhe procedurat. Meqenëse kjo çështje, kjo pikë, ky nen i Ligjit për Administratën Tatimore nuk është plotësuar, Komisioni ka vendosur t'i kthejë prapa listën me kandidatët e propozuar. Kurse, nëse më lejon, në emër të Grupit që të mos marr fjalën dy herë, ne në grupin parlamentar e kemi shqyrtuar një propozim vendim të tillë dhe grupi parlamentar në këtë rast nuk do t'ua imponojë deputetëve të votojnë apo të mos votojnë. Të gjithë deputetët e kanë rishqyrtuar, kanë shqyrtuar Ligjin për Administratën Tatimore, por njëkohësisht i kanë shqyrtuar edhe biografitë e kandidatëve të propozuar, prandaj mbetet në dëshirën e deputetit të votojë apo të mos votojë.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Pasi kaluam në deklaratimet e përfaqësuesve të grupeve parlamentare, ftoj që në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, shefin e Grupit Parlamentar, deputetin Ismet Beqiri, ta marrë fjalën.

ISMET BEQIRI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Së pari konsideroj që është joserioze më së lehti për ta thënë, që për propozimet ose vendimet që vijnë nga Qeveria nuk është askush këtu për t' i arsyetuar, për t' i arsyetuar së paku para këtyre deputetëve, para neve, është jo serioze, aq më tepër kur Komisioni përkatës del që nuk e përkrah. Ne nuk mund ta anashkalojmë dhe të themi që në këtë propozim nuk ka njerëz meritore, që ndoshta edhe e meritojnë të zgjidhen në këtë bord, por nëse Komisioni e thotë jo dhe askush nga Qeveria nuk del për ta arsyetuar, sepse është i nënshkruar nga kryeministri i Kosovës dhe, ne si Grup Parlamentar e kemi shqyrtuar, e kemi parë, të gjitha ato kandidatura ose ata të propozuar dhe, meqenëse s' kemi as deklarament të Qeverisë, nëse edhe Komisioni edhe flitet që nuk qenka plotësuar kushti ligjor, së paku është dashur të jetë dhe të themi po e tërheqim, po e rishqyrtojmë apo çfarë po bëjmë.

Dhe, sinjorisht po e them, ne si Grup Parlamentar edhe një herë po e përsëris kemi parë njerëz gjatë debatit, analizat që i kemi bërë që e meritojnë të jenë, por bie ndesh edhe me ato qëndrime të Komisionit. Po ajo që po e përsëris për të satën herë, më befason, është mosgatishmëria e shpjegimit të vetë këtij vendimi nga ata që e kanë dërguar në Kuvendin e Kosovës. Prandaj, këto dy mundësi janë ose të tërhiqet edhe një herë dhe njerëzit mos t' i fusim në zjarr, në kuptimin e votimit, s' po them që i mohohet e drejta përsëri ndonjëri ndonjë prej tyre të jetë kandidat, ose duhet të shkojmë në votim dhe ne, si Grup Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, me këto mangësi që i ka në këtë rast ky propozim- vendim, atëherë e lëmë në disponimin e deputetëve të përcaktohen a do ta përkrahin apo jo?

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar AAK-së, Haki Shatri e ka fjalën.

HAKI SHATRI: Ju faleminderit, kryesues!

Për Grupin Parlamentar të Aleancës, ky propozim konsiderohet se është propozim me emra të personave më tepër politik, edhe pse po ta shikojmë regjistrin me emra, shohim që ka njerëz të cilët vërtet i plotësojnë kushtet sipas ligjit që të jenë në Komisionin për Shqyrtimin e Ankesave. Mirëpo, ajo që është politike, si duket këtu sheshazi, është se vetë propozuesi me qëllime të caktuara nuk ka ardhur për t' i arsyetuar këta emra, do të thotë është duke bërë një politikë brenda koalicionit qeverisës, sepse në këtë regjistër nuk i pëlqen dikush. Prandaj, ne do të mbajmë një qëndrim individual, nëse votohet veç e veç, mund ta zgjedhim atë që i plotëson kushtet ta votojmë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, deputeti Ibrahim Makolli dhe shef i grupit parlamentar.

IBRAHIM MAKOLLI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë,

Nuk është hera e parë që Qeveria ofron lista me individë të cilët nuk i plotësojnë kriteret ligjore ashtu siç janë të parapara dhe unë po e shtroj pyetjen- A ka në Qeveri njerëz të cilët i shikojnë ligjet apo nuk vlejnë ligjet për këta, sepse nuk është hera e parë po them që Qeveria ofron njerëz të cilët nuk i plotësojnë kriteret e parapara me ligj? Unë po e përgëzoj Komisionin, i cili në këtë radhë është vënë në mbrojtje të ligjit, që nuk ka ndodhur edhe herët e kaluara, sepse në këtë vend dhe në këtë Kuvend, janë miratuar edhe lista në kundërshtim me ligjin, por konsideroj momenti i mirë që të kërkohet nga Qeveria, që të mos ofrojë më lista me individë të cilët nuk i plotësojnë kriteret ligjore. Unë nuk e besoj kolegë se do të duhej të mbetej tash në vullnetin e deputetëve që të

votojnë “për” ose “kundër”, por gjithsesi duhet të thuhet edhe një herë këtu që Kuvendi nuk do të pranojë t’i shkelë ligjet të cilat i ka miratuar vetë.

Si grup parlamentar, pavarësisht se në këtë listë mund të ketë edhe individë të cilët i plotësojnë kushtet e parapara me ligj, megjithatë si tërësi kjo nuk i plotëson këto kushte dhe Grupi Parlamentar i AKR-së, deklarohet kundër kësaj liste të Qeverisë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, ftoj deputeten Besa Gaxherri ta marrë fjalën.

BESA GAXHERRI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Tashmë, më vjen shumë mirë që të gjitha grupet parlamentare janë të arsyeshëm dhe përkrahin vendimin e Komisionit të Buxhetit, që goxha me vështirësi e kemi marrë këtë vendim, është dashur mirë ta shqyrtojmë, sepse vërtetë ne jemi mësuar shumë shpesh edhe si komisione edhe si Kuvend të kalojmë çështjet, të cilat vërtet janë të përcaktuara ose të përgatitura për grupet e caktuara të interesit. Është shumë e vërtetë që kjo listë, me këta persona nuk i ka plotësuar kushtet ligjore dhe, andaj ftojmë të gjithë deputetët, e në veçanti në emër të Lidhjes Demokratike të Dardanisë, të mos votohen.

Njëkohësisht, kërkojmë që sot ky Kuvend të marrë vendim që e njëjta listë asnjëherë më nuk mund të silltet në Kuvend për t’u votuar. E dimë që sot është dashur të jetë këtu prezent Qeveria, dikasteri përkatës, pra Ministria përkatëse, por na po e shohim se nuk po funksionon asgjë më në Kosovë, dhe nuk kanë më kohë institucionet tona të merren me problemet, të cilat edhe sot, në këtë radhë po i diskutojmë. Andaj, natyrisht që Lidhja Demokratike e Dardanisë, voton kundër. Edhe një herë po e theksoj, kërkojmë që Qeveria nuk ka të drejtë ta sjellë më të njëjtën listë para Kuvendit. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “7+”, ftoj deputetin Xhezair Murati, ta marrë fjalën.

DŽEZAIR MURATI: Hvala vam, predsedavajući!

Ja ne znam kakva je situacija sa odzivom predstavnika Vlade, dali zato što ste vi predstavnik opozicije, kao da ste ih uplašili, nikog nema, ja ne znam šta se ovo dešava. Predsedavajući, ja ne znam kakav je ovaj strah, ali jedan predstavnik manjina i jedan novi ministar. Mislim dosta neodgovorno kada je u pitanju razmatranje veoma bitnih predloga Vlade, makar oni bili u ovoj tački negativni, ali i ja delim mišljenje moje kolegice koja je pred mene rekla da je ova neodgovornost i da mi moramo da pronađemo modus veće zainteresovanosti predstavnika izvršne vlasti kada rešavamo neka od ovako bitnih pitanja.

Naravno da se ja pridružujem ostalim kolegama, šefovima parlamentarnih grupa i mi ne podržavamo ovu listu ako je komisija koja je zato nadležna donela takvo mišljenje i stav, iako znamo da neki od članova, neki dakle u manjem broju ispunjavaju neki od kriterijuma, ali u većini ne ispunjavaju i zato smo da se promeni personalna lista za narednu olluku, uz normalno veće prisustvo predstavnika izvršne vlasti. Hvala vam!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar SLS-së, nuk kam të lajmëruar. Në emër të Grupit Parlamentar për Integritet, ftoj deputetin Numan Baliq ta marrë fjalën.

NUMAN BALIĆ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Ja ću se takode pridruđiti većini prethodnika koji su izrekli svoje mišljenje. Nastojaću da budem vrlo sađet. Oćigledno je da će danas biti na redu jedno disipliniranje Vlade od stane Parlamenta i jasno naglašavanje njene neodgovornosti, takode ministra financija. Podrđavamo obrazlođenje Komisije za budđet i financije, koja je jasno dala neke razloge koji se tiću neprihvatanja na današnju sednicu Skupštine. Podrđavamo takode parlamentarne grupe koje su se izjasnile na ovaj naćin i takode ovu preporuku koja govori oko toga, da su se trebali ukljućiti odrećeni broj poslovnih ljudi, ali ja bih dodao da je osim ovih razloga, trebalo biti mnogo većeg i angađovanja i ukljućivanja i konsultovanja drugih zajednica koje i ove ... izostalo. Mi ćemo glasati protiv. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit, tē nderuar deputetē!

Dēgjuat arsyetimin e Komisionit, nē emēr tē Komisionit, tē shumicēs sē grupeve parlamentare. Pēr fjalē dhe pēr debat janē lajmēruar tre deputetē. Unē e ftoj deputetin Riza Smaka ta marrē fjalēn, pērgatitet deputeti Eqrem Kryeziu.

RIZA SMAKA: I nderuari, zotēri kryesues!

Tē nderuar ministra,

Deputetē tē respektuar,

E shfrytēztoj kētē oportunitet vetēm pēr t’u pērqendruar nē dy pika parimore, emērtimi i Bordit, Bordi i pavarur pēr rishqyrtim tē ankesave. Do tē thotē abinicio, nga fillimi nuk ēshtē nē rregull, se mē tē parēn, na po e dimē se as Kuvendi i Republikēs sē Kosovēs, nuk ēshtē i pavarur, kjo ēshtē njē. Absurdi, absurdi, Bord i pavarur, pleonazēm, kjo quhet pleonazēm, ndērsa pēr, nuk ēshtē pēr rishqyrtim, por pēr vendosje se po e zēmē ēshtē fjala pēr ankesē mjet juridik tē rregullt qē vendoset e nuk rishqyrtohet, se ēshtē vendosur njēherē, nuk ēshtē shqyrtuar nga asnjē organ tjetēr. Kjo ēshtē çēshtja, domethēnē. Edhe e dyta, çēshtje parimore qē, po e zēmē ky bord nuk garanton profesionalizēm aspak, a analogjikisht shtetet e pērparuara kanë gjykata administrative tē profesionalizuara, se ankesa duhet tē trajtohet tepēr seriozisht, e varet nga aty se sa trajtohet e si shqyrtohet dhe si vendoset edhe ligjshmēria edhe pakēnaqēsia apo kēnaqēsia e ankuesve. Se ankuesi i denjē edhe kur i refuzohet ankesa, ēshtē i kēnaqur apo e kēnaqur kur e lexon njē arsyetim qē ka bazament logjik edhe juridik, a kur e lexon njē aktvendim i cili nuk ka kurrfarē arsyetimi, me tē vërtetē atēherē shprehet i zhgēnjyer, i dēshpēruar, e tjera e tjera. Kjo ēshtē kēsisoj edhe do tē duhej, medoemos Qeveria ta merrte pērsipēr kētē punē. Nē dy variante tē shkojē, njērēn ose gjykatē tē themelojmē gjykatē administrative, sić e ka njē Austri, njē Gjermani ose njē Francē, ose te ministria, po e zēmē respektive, tē ishte organi administrativ i instancēs sē dytē.

Po e zēmē, po e marrim njē ministri, ta quaj kushtimisht nē Pejē, po e zēmē qē vendos pēr çēshtje tē pylltarisē, me, pa fije tē dyshimit qē ministria respektive e shkallēs sē dytē, do tē kishte kapacitete profesionale pēr ta rishikuar, domethēnē, pēr ta vendosur çēshtjen profesionalisht, mē mirē se sa cilido bord, jo kurrsesi nē kētē strukturē. Unē e shoh kētu, fal disa rasteve, shumica janē qē kanë punuar do kohē nē kooperativa bujqēsore edhe si do tē mund tē ishin ata kompetent apo ato, qē pēr tē vendosur pēr ankesa edhe atē ankesa hitoregjene tē tē gjitha sferave, qē ēshtē e pamundur pēr tē qenē profesionalist pēr tē gjitha çēshtjet, se mund tē jetē pēr dićka, pēr njē sferē, pēr njē skop, ama nuk mund tē jetē askush, as nuk ka pasur as qē do tē ketē profesionalist pēr tē gjitha temat. Edhe pērfundimisht, ju lutem, meqenēse edhe Komisioni kompetent i Buxhetit e ka dhēnē pikēpamjen e vet, gjykoj tē pranuar, nuk do tē duhej tē diskutohej, sē pakut jo nē pro miratimit tē kēsaj liste. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputeti i fundit për fjalë, deputeti Eqrem Kryeziu, e ke fjalën.

EQREM KRYEZIU: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Si zakonisht, e kërkoj lejen tuaj t'i përshëndes dy përjashtimet impresive, dy ministrat që janë të pranishëm këtu dhe, natyrisht, edhe këta kolegët deputetë.

T'ju them të drejtën, unë kam qenë shumë konfuz kur e kam marrë këtë propozim edhe jam paraqitur me modestinë më të madhe, që nuk është shumë e madhe, meqë po e theksoj në fund të fjalimit, me shpresë se ndoshta po kuptoj diçka, mirëpo në fakt edhe më konfuz jam tash pas paraqitjes së fjalimeve këtu. Para së gjithash, kryeministri e ka quar propozimin dhe thirret në ligj. E dyta, komisioni thotë pikërisht ky nuk është i mbështetur në ligj. Del se Kabineti i kryeministrit nuk e ka pasur parasysh bazën ligjore. Kjo mund të jetë teori, por për mua është pak e pranueshme, të them të drejtën.

Në qoftë se Qeveria e ka quar një propozim me nënshkrim, do të duhej një kurajë shumë e madhe edhe një argumentim shumë më i fuqishëm i Komisionit parlamentar, që thotë nuk je i bazuar në ligj. E dyta, këtu dolën disa teori se ka mundësi që e para nuk është e mbështetur në ligj, e dyta se jo janë grupet e interesit, e treta se jo mos i ka ra pishman Qeveria, me këtë strukturë, t'ju them të drejtën, ne s' mund të manipulojmë me gjëra të tilla. Mirëpo, tani ku është e vërteta? E vërteta, do të thotë vogëlsia ime ka pasur durimin e madh për t'i shqyrtuar çivitetë e këtyre njerëzve edhe shikoni çka kemi në praninë e tyre. Dua të them se kurrësi nuk mund të vijmë në përfundim se nuk kanë lidhje me biznes. A janë të komunitetit të biznesit, ajo çka përcakton nocion juridik pjesëtar i komunitetit, askush nuk na ka thënë këtu, dhe shikoni çka kemi këtu. Kemi një ish-drejtoreshë të ndërmarrjes në Deçan. Nuk mund të thuhet që s' ka lidhje me biznes, kemi një avokat aktual, që gjithashtu është një biznes i caktuar, kemi një zotëri që është drejtor i Inspektoratit komunal prej vitit 2004, që në qoftë se e njeh dikush biznesin, më mirë se drejtori i inspektoratit, absolutisht nuk ka shans ato ...as vetë bitismëni t' i di.

Kemi tjetër një menaxhues të resurseve njerëzore në Malishgan, tjetrin, kemi një menaxher kryesor të NSHB-së, tjetri jo vetëm që di edhe japonisht madje, po është edhe editor i gazetës "Biznesi Kosovar"

Tjetri ka shkollën e lartë, i diplomuar në Shkollën e Lartë të Biznesit dhe ajo çka është më dramatike, zonja dhe zotërinj, këtu e kemi edhe babajn e civilizimit njerëzor, kovaçi. Dëshëm e s' dëshëm, ne jemi krejt produkt të kovaçit, që është zbulimi më i madh i njerëzimit edhe tash Komisioni Parlamentar, thotë burra, ne ta lemë.

Edhe mua, në grupin tim parlamentar më thanë- a ka licencë tha që është kovaç? More zotërinj, kur njeriu është babë e babagjysh e katragjysh e stërgjysh kovaç, kur s' ka pasur ide çka është licenca, ku Agjencia e Biznesit Kosovar, as s' ka pasur shans për të ekzistuar, ti tash i lyp licencë. Kështu që, unë po ju lus për t'i ndërprerë tërësisht këto teori shumë interesante, shumë dinamike, por për fat të keq veç mua të paktën po më lënë seç herë e më naiv. Unë ju propozoj që ta votoni këtë listë, të paktën, unë sipas biografive po i njoh që janë njerëz të merituar. Ju faleminderit shumë.

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputet! Përgatitemi për votim. Lus deputetë edhe regjinë, të përgatiten për votim. Kemi prezencë të mjaftueshme në sallë, janë 74 deputetë, përgatitemi për votim, pra votojmë Propozim vendimin e Qeverisë së Kosovës, për emërimin e anëtarëve të Bordit të Pavarur për Rishqyrtimin e Ankesave.

Votojmë tash. Ju faleminderit!

Konstatohet se me 38 vota “kundër”, 20 “për” dhe 10 abstenime, Kuvendi nuk emëroi anëtarët e Bordit të Pavarur për Rishqyrtimin e Ankesave. Ju faleminderit.

Kalojmë në pikën e shtatëmbëdhjetë të rendit të ditës:

17. Shqyrtimi i propozimit për emërimin e anëtarëve të Këshillit drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës

Konstatimet hyrëse:

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, në pajtim me nenin 3 të Ligjit për themelimin e Institutit Gjyqësor të Kosovës dhe me dispozitat e Rregullores së Punës, ka shqyrtuar propozimet e institucioneve përkatëse për emërimin e anëtarëve të Këshillit drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim propozimet e institucioneve përkatëse, së bashku me dokumentacion dhe rekomandimi i Komisionit funksional, iu janë shpërndarë deputetëve.

Në emër të Komisionit funksional, ftoj kryetarin e Komisionit, deputetin Bahri Hyseni, ta marrë fjalën.

BAHRI HYSENI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, duke u bazuar në nenin 3.3, paragrafi 9 për themelimin e Institutit Gjyqësor të Kosovës, të paraparë në ligjin nr. 02-L-25, ka shqyrtuar me kujdes propozimet të cilat kanë ardhur nga institucionet të cilat kanë qenë të obliguara t'i bëjnë propozimet për kandidatët e tyre për Institutin Gjyqësor të Kosovës, dhe gjatë shqyrtimit ka konstatuar që të gjitha institucionet konform ligjit në fuqi i kanë bërë propozimet.

Vlen të përmendet se Instituti Gjyqësor i Kosovës nuk është funksional mbi 5 muaj, mu për shkak që Kuvendi i Kosovës nuk ka aprovuar propozimet që kanë ardhur nga këto institucione, duke marrë parasysh që nuk ka pasur të propozuar nga radhët e minoriteteve. Tani, në propozimin e ri, që e kemi para vetes, pas riemërimeve që kanë ndodhur edhe në Gjykatën Supreme të Kosovës, por edhe në Prokurorinë e Shtetit, kemi të emëruar apo të propozuar nga institucionet përkatëse edhe kandidatë nga radhët e minoriteteve. Prandaj duke marrë parasysh situatën që e kemi, domethënë, një institucion i cili nuk e ka bordin aktualisht, bordin i cili është përgjegjës për të monitoruar dhe për të mbikëqyrur, ndoshta është përgjegjës për të gjitha reformat në organet e drejtësisë, është gjithsesi e nevojshme që sot kandidatët të cilët janë propozuar, gjithsesi të votohen. Natyrisht, nëse nuk do të marrin edhe sot besimin, të jeni të bindur që ne kemi krijuar një situatë e cila nuk i shkon askujt për shtati, sepse aktualisht, domethënë, Instituti Gjyqësor i Kosovës vepron vetëm në pjesën ekzekutive, nuk kanë mundësi të marrin vendime, nuk kanë mundësi për të aprovuar politikën dhe obligimet tjera të cilat i kanë të përcaktuar me ligj.

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi rekomandon që të emërohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, anëtarët e Këshillit drejtues të Institutit të Gjyqësor të Kosovës, kandidatët në vijim:

1. Fejzullah Hasani, Gjykata Supreme e Kosovës,

2. Miodrag Paviq, Gjykata Supreme e Kosovës,
3. Osman Ismaili, Fakulteti Juridik,
4. Vesel Jashari, Prokuroria e Shtetit të Kosovës,
5. Radica Miliq, Shoqata e Prokurorëve publikë të Kosovës,
6. Destan Rukiq, Oda e Avokatëve të Kosovës,
7. Elmaze Syka, Shoqata e Gjyqtarëve të Kosovës, dhe
8. Rexhep Murati, Lidhja e Juristëve të Kosovës.

Duke ju lutur edhe një herë që të keni parasysh situatën që e kemi me Institutin Gjyqësor të Kosovës, kërkoj që deputetët t'i votojnë kandidatët e propozuar. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti deputet! Kemi 2 të lajmëruar për fjalë... Mirë, faleminderit, u shtua numri, atëherë supozoj që në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, deputeti Armend Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Grupi Parlamentar i LDK-së i ka shqyrtuar propozimet për Këshillin Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës, të bëhen nga institucionet të cilat janë përcaktuar me Ligjin për themelimin e Institutit Gjyqësor të Kosovës. Ne kemi shqyrtuar biografitë profesionale të propozuarve dhe duke u bazuar edhe në nenin 3 paragrafi 3 pikë 3 të Ligjit përkatës, mendojmë se të propozuarit i plotësojnë kushte për emërim, prandaj Grupi ynë unanimisht e përkrah listën me emrat e të propozuarve. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, me kartelë të deputetit Ahmet Isufi Donika Kadaj- Bujupi e ka fjalën.

DONIKA KADAJ- BUJUPI: Faleminderit i nderuar kryesues!

Edhe kjo listë që kemi përpara shkon në atë shkollën e këtij koalicioni qeverisë që të devalvojë çdo institucion që duhet të jetë i pavarur, edhe në këtë rast gjithë këta emra që kemi para nesh, janë emra politikë, që do të thotë që këta njerëz janë të vendosur që të vazhdojnë me mënyrën e tyre të punës, që t'i politizojnë të gjitha bordet, organet dhe institucionet që duhet të jenë të pavarura në këtë shtet të ri, pavarësisht që është një institucion i cili është në mënyrë indirekte, do të thotë, organ në funksion të gjyqësorit dhe i dimë problemet e mëdha dhe të shumta që ka gjyqësori, por po shihet që dikush këtu nuk është i interesuar për t' i zgjidhur këto probleme.

Prandaj, Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, nuk do të bëhet pjesë e devalvimit të institucioneve të pavarura të Kosovës dhe nuk do ta votojmë këtë listë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Për replikë është lajmëruar deputeti Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Ju kisha lutur deputetëve që ta konsultojnë ligjin, këto nuk janë propozime, as të Qeverisë as të Kuvendit të Kosovës dhe janë të përcaktuara në ligj qartë se kush dhe cili institucion i propozon. Ne si komision kemi pasur për obligim vetëm të shikojmë a i plotësojnë kriteret e bazuara në ligj, a e kanë përgatitjen profesionale dhe nga të gjithë anëtarët e propozuar a janë dy nga radhët e minoriteteve? Ajo ka qenë obligim i Komisionit për legjislacion. Nëse doni ua lexojmë ligjin, një anëtar, domethënë nga Qeveria e Kosovës....

KRYESUESI: S'ka nevojë ta lexoni ligjin.

BAHRI HYSENI: S'ka nevojë... Atëherë, ju lutem, që të mos bëjmë dilema këtu, sepse propozimet kanë ardhur nga institucionet përkatëse dhe ne nuk kemi obligim dhe nuk mundemi ta mësojmë askënd se kë e propozon Gjykata Supreme e Kosovës apo fakulteti juridik. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Për kundër-replikë, një minutë, deputetja Donika Kadaj-Bujupi.

DONIKA KADAJ- BUJUPI: Faleminderit, zotëri kryesues!

Unë nuk e di dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës a është kriter dhe a është në ligj që çdonjëri që propozohet të jetë i politizuar, të jetë pjesëtar i partive përkatëse politike, pjesëtar aktiv zyrtarë të partive politike. Prandaj nuk ke nevojë për të gjuajtur me dorë, kryetarët e degëve të partive përkatëse politike nuk është e thënë të jenë dhe nuk duhet të jenë, nuk është kriter, nuk është me ligj, përkundrazi është kundërligjore, prandaj nuk e votojmë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, deputeti Riza Smaka e ka fjalën.

RIZA SMAKA: I nderuar, zotëri kryesues!

Ministra dhe deputetë të nderuar,

Konsiderojmë se Komisioni për Legjislacion e ka bërë punën në mënyrë korrekte, në konformitet me ligjin dhe t'ua them, një ndër tjera, që kam qenë pjesëmarrës në një propozim që me të vërtetë lidhja konkretisht po flas, Lidhja e Juristëve të Kosovës, kryesia, në përbërjen complete e ka propozuar kandidatin e vet pa kurrfarë interference. E di edhe një rast tjetër nga Fakulteti Juridik që është propozuar një profesor eminent, po asisoj. Për dy, domethënë, e di kështu, si me thënë koinsidentalisht. Nuk dua kurrsesi të shkoj në sferën e polenizimit apo të replikave, veç po e them për hir të korrektësisë. Në anën tjetër, Këshilli drejtues i Institutit Gjyqësor të Kosovës është shumë i rëndësishëm dhe në rastin konkret janë propozuar persona që janë personalitete me dinjitet, me profesionalizëm, kompetentë dhe angazhohem që t'i votojmë. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, nuk kam të lajmëruar. Në emër të Grupit ... Po, je lajmëruar tani! Atëherë e ka fjalën Lulzim Zeneli.

LULZIM ZENELI: Është shumë e rëndësishme për Kuvendin e Kosovës të ketë informatën burimore, siç e kemi tash nga Komisioni funksional, e cila informatë mbështetet në legjislacionin dhe në përputhje me dispozitat ligjore. Ajo çka neve na mbetet si Kuvend i Kosovës është, pavarësisht se a na pëlqen individi apo emri që është propozuar, të korrespondojnë vendimet tona në përputhje me ligjin. Unë besoj, ashtu si edhe Grupi Parlamentar është i atij mendimi se propozimet që vijnë tash kanë një diskrepancë të madhe ndaj qëndrimeve që mori më herët Kuvendi i Kosovës me propozimin për Komisionin për Ankesa. Prandaj, do të ishte e rrugës që propozimet e tilla të trajtohen në nivelin parlamentar siç e ka rastin tash.

Unë besoj dhe jemi të bindur se çfarë interferimi tjetër, çfarëdo ngjyrosje tjetër, nuk është në funksion të misionit që mund ta ketë një komision apo një këshill që po e votojmë tash. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “ 7+” ftoj deputetin Xhezair Murati ta marrë fjalën.

ĐŽEZAIR MURATI: Hvala predsedavajući!

Meni je stvarno žao što ću morati ovoga puta da se ne složim sa mišljenjem predsednika Zakonodavne komisije, čiju stručnost nesporno uvek priznajem i posebno profesora Smake, dakle neću trošiti reči o tome koliko lično podržavam njegove kvalifikacije, ali ovde molim vas pozivam Skupštinu da malo porazmislimo o nekoj stvari koja naizgled izgleda sitnica, ali u pitanju je jedan zakonodavni promašaj. Naime, Zakonom o osnivanju instituta za pravosuđe Kosova, u članu 3. tačka 5. stoji: “iz ukupnog broja članova Upravnog odbora, najmanje 2 člana treba da budu iz redova manjina”. U predlogu koji smo dobili od 8, a treba 9, stoji predlog za 2 predstavnika srpske zajednice. Ako se pozovemo na Ustav, kao najviši akt, uvek idu u svim telima gde je jedan predstavnik srpske zajednice, ide i po jedan predstavnik ostalih zajednica. Ovde je to preskočeno, gospodo, i vrlo je primetno i mi govorimo ovde o stručnosti, o izabranima i ono i ovo, ali ostale zajednice nisu uključene. Niko u opšte ne vidi od visoko stručnih osoba da nisu zastupljene u ovom visokom pravosudnom organu predstavnici ostalih zajednica. Meni je žao što niko iz većinske zajednice to nije primetio. Žao mi je, jer stručnjaci to treba da vide a ne samo da pohvale i da podrže, nego da vide promašaje. Ja nisam pravnik, ali sam dugo u politici. Ovo je jedan non-sens koji mi ne možemo prihvatiti. Mi ništa protiv predstavnika srpske zajednice ne možemo i ne smemo da imamo. Ali da ne bude zastupljen i predstavnik ostalih zajednica, onda pitam ovaj zakonodavni organ – kako to da niko ne primeti a pozivamo se i na doktorske titule i na ono, i na ovo, i tako dalje. Mi smo protiv ovakve liste, samim tim što je uskraćeno pravo ostalih zajednica da budu prisutne u ovom visokom pravosudnom organu. Hvala vam!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Për replikë, 2 minuta, kryetari i Komisionit Bahri Hyseni e ka fjalën.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues, jo për replikë! Është shumë e vërtetë që neni 3 pika 5 thotë nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit Drejtues, së paku 2 anëtarë duhet të jenë nga radhët e minoriteve dhe në propozimin që kanë ardhur nga institucionet janë 2 anëtarë, por në këtë rast janë 2 anëtarë nga komuniteti serb. Ne nuk i kemi pasur mundësinë si Komision për Legjislacion për të kërkuar nga institucioni përkatës, sepse edhe ligji nuk e precizon nga radhët e minoriteteve dhe t'i themi, për shembull, Gjykatës Supreme të Kosovës, ju lutem mos e çoj një nga komuniteti serb dhe çojë një nga komuniteti turk apo komunitetet tjera. Unë plotësisht e përkrah shqetësimin dhe do të ishte shumë me interes po të ishte edhe dikush nga radhët e minoriteteve tjera, mirëpo koha në të cilën janë bërë propozimet ndërlidhet pak edhe me çështjen e reformave. Nuk e di shumë saktë institucionet përkatëse a kanë pasur edhe komunitete tjera, ndoshta edhe kanë pasur, sepse decidivisht kërkohet të jenë gjyqtarë të Gjykatës Supreme apo prokurorë të Prokurorisë së Shtetit. Prandaj, ne nuk kemi pasur asnjë mundësi që si komision të mos e pranojmë propozimin, sepse në ligj vetëm përmenden dy nga radhët e minoriteteve, pa e përcaktuar saktë, mirëpo, shqetësimi është me vend. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar” 7+” ose, për kundër replikë, deputeti Xhezair Murati, një minutë, e ka fjalën.

ĐŽEZAIR MURATI: Vidite, ja prihvatom određene razloge predsednika Zakonodavne komisije, ali ne mogu da prihvatom da to ne može da se primeti, da sve zajednice

predstavlja jedna zajednica manjinska, ako interesi tih zajednica dijametralno su suprotne, ako nisu dijametralno, ali jesu različiti. S toga, recimo uzeću u obzir zajednicu kojoj pripadam. Desetine i desetine advokata i šta ja znam, sudija na raznim nivoima i tako dalje. Nije mogla jedna institucija poput Vrhovnog suda Kosova da ne primeti to. Molim vas, to je veoma uočljivo i ne radi se ovde o hiljadama i desetinama, nego o po jednom članu iz ove obe grupacije. Samo toliko. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të SLS nuk ka të lajmëruar. Në emër të Grupit Parlamentar për Integritet, deputetja Vezira Emrush e ka fjalën.

VEZIRA EMRUŠ: Hvala lepa na datu reč! Ja se ponovo javljam povodom ove jako važne tačke gde danas imamo predlog Komisije za izbor članova Upravnog odbora Sudskog instituta Kosova. Imamo istu zabrinutost kao i prethodna Grupa “7+”, radi se o tome da moraju zajednice biti zastupljene ravnomerno, da jedna zajednica ako su dva člana, da jedan član može slobodno da bude iz srpske zajednice, ali ne na teret ostalih zajednica još jedan član.

Vi znate da se radi o jako važnom organu. Mi želimo da imamo svog člana ostale zajednice, kao što su Bošnjačka zajednica, ovde Goranska, Turska zajednica, Aškalijska, Romska i Egipćanska zajednica koje imaju pravo da imaju svog člana u ovom telu, zato što znam kakva je prilika kada su u pitanju ovi organi i ovi instituti i kako se dalje ovo radi.

Ova zabrinutost je kod nas velika. Mislim da će predsednik komisije, u koga ne sumnjam, u čiji rad ne sumnjamo, da razmotri ovo pitanje i ja imam predlog da ove članove, današnji ovaj predlog vratimo na razmatranje.

Jedan poseban razlog zašto sam se zabrinula, ja sam pogledala dosjea ostalih zajednica, kao što je Srpska zajednica, gde vidimo kada se radi o članu Miodrag Pavić, da živi i radi na Kosovu, da živi i radi na Kosovu, da je radio pri UNMIK-ovom sudu, njegov dosije, međutim kada je u pitanju drugi kandidat, Radica Milić, ja moram da izrazim svoju zabrinutost, vidimo da je rođena u Tutinu, vidimo da je završila fakultet u Kragujevcu, da radi kao pripravnik Opštinskog suda u Leposaviću od 3.2.2003, znači posle rata, od 2005. do 2006. radi kao stručni saradnik u Opštinskom tužilaštvu u Mitrovici, ne piše gde, pri UNMIK-ovom, da li pri UNMIK-ovom sudu, nemamo informaciju i da je imenovana za Opštinskog javnog tužioca do današnjeg dana. Mi znamo da nisu bile još imenovane sudije kada je u pitanju severna Mitrovica, izražavamo zabrinutost da to ne bude samo da neko u ovom institutu prima platu, a da nemamo od njega kao člana nikakav doprinos. Unapred hvala! Mi kao komisija nećemo da podržimo ovaj predlog. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Dhe për fjalë është lajmëruar zonja deputete Nekibe Kelmendi.

NEKIBE KELMENDI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar ministra,

Unë e kuptoj rëndësinë e emërimit sa më të shpejtë të këtyre anëtarëve të Këshillit drejtues të Institutit Gjyqësor, por plotësisht e mbështes diskutimin e zotit Xhezair Murati dhe të tjerëve, pse në këtë listë nuk janë përfshirë edhe anëtarët e komuniteteve

tjera pakicë, kur në të gjitha dokumentet relevante si në Kushtetutë ashtu edhe në pakon e Ahstisarit, thuhet se komunitetet pakicë, kush janë komunitetet pakicë në Kosovë.

Nga ana tjetër habitem se si nga Gjykata Supreme e Kosovës, të jenë 2 anëtarë e të mos ketë ndonjë anëtar të këtij Këshilli Drejtues të Institutit Gjyqësor, për shembull nga një komunitet tjetër që, siç është në Pejë që e kemi një hashkali, që e kemi një boshnjak, kemi edhe në Prizren, kemi edhe një turk, kemi edhe në vende tjera, pse mos të përfshihen edhe nga këto komunitete? Prandaj edhe unë personalisht, ndonëse ky përfaqësuesi i grupit parlamentar e mbështeti listën në tërësi, është e drejtë imja si deputete që të votoj ashtu siç mendoj se është e drejtë.

Propozoj që kjo listë të kthehet edhe një herë dhe nga Gjykata Supreme të hiqet një, në vend të tij të emërohet një minoritar tjetër, përfaqësues i minoritetit tjetër nga ndonjë gjykatë apo shoqatë, sepse të gjithë gjyqtarët janë anëtarë të shoqatave gjyqtare, të gjithë prokurorët janë anëtarë të Shoqatës së Prokurorëve. Kështu nuk do t'i hynim në hak asnjë komuniteti pakicë. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Lus deputetët dhe regjinë të përgatitemi për votim. Votojmë propozimin për emërimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës.

Në sallë janë 72 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

Konstatoj se me 45 vota “për”, 18 “kundër” dhe 6 abstenime, Kuvendi emëroi anëtarët e Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës, lista është lexuar nga kryetari i Komisionit, me mandat dyvjeçar. Ju faleminderit!

Kalojmë në pikën e radhës, pika tetëmbëdhjetë e rendit të ditës:

18. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës për rritjen e numrit të oficerëve korrektues në Burgun e Dubravës

Konstatime hyrëse:

Komisioni funksional për Buxhet e Financa, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Punës, ka shqyrtuar Propozim-vendimin e Qeverisë së Kosovës për rritjen e numrit të oficerëve korrektues në Burgun e Dubravës dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Propozim-vendimi i Qeverisë dhe raporti me rekomandimet e Komisionit funksional u është shpërndarë deputetëve.

Përfaqësues të Qeverisë, po i ftoj ta marrin fjalën.
E ka fjalën ministri Haki Demolli .

MINISTRI HAKI DEMOLLI: I nderuar, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Kërkesa e Qeverisë, respektivisht kërkesa e Ministrisë së Drejtësisë qëndron në lejin e mjeteve apo marrjen e vendimit të Parlamentit për 71 oficerë korrektues.

Siç e dini në përfundim e sipër është ndërtimi i burgut për dëshmitarë të dënuar të mbrojtur, i cili pritet që të realizohet apo të përfundojë diku në maj të këtij viti, apo

konkretisht në fund të këtij muaji. Për këtë qendër korrektuese janë dhënë apo janë shpenzuar diku afër 13 milionë euro dhe mendojmë se është apo ka qenë një objekt më se i domosdoshëm për Shërbimin Korrektues të Kosovës. Njëherit po ua bëj me dije se Qeveria e Kosovës dhe Komisioni i Financave apo Komisioni i Buxhetit, për këtë institucion ka lejuar që të pranohen 71 oficerë korrektues, por ende nuk është marrë vendimi në Parlament.

Ministria e Drejtësisë së bashku me Shërbimin Korrektues të Kosovës, është zotuar se stafi shtesë civil i cili është i domosdoshëm siç janë zyrtarët socialë, zyrtarët shëndetësorë apo punëtorët shëndetësorë, instruktorët, stafin teknik për mirëmbajtje do t'i sigurojë nga brendapërbrenda Shërbimit Korrektues, kurse ajo çka është e nevojshme është që të lejohet apo të miratohet vendimi për 71 oficerë korrektues.

Prandaj, mendojmë se është nevojë imanente që në Parlament të merret një vendim sa më parë për lejin e këtij stafi që të fillojë me punë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Ministër! Pra, dëgjuat arsyetimin e Qeverisë. Në emër të Komisionit funksional për Buxhet e Financa nëse ka... Nuk ka të paraqitur. Në emër të grupeve parlamentare, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së ftoj deputetin dhe shefin e Grupit Parlamentar, zotin Ramë Buja, ta marrë fjalën.

RAMË BUJA: I nderuar, zoti kryesues!

I nderuar zoti ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Mbështetur në arsyetimin që e ka bërë Qeveria e Republikës së Kosovës, gjegjësisht Ministria e Drejtësisë për këtë ndërmarrje, ne si Grup parlamentar e mbështesim pa rezervë. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, po besoj deputetja Nekibe Kelmendi e ka fjalën.

NEKIBE KELMENDI: Faleminderit, zoti kryesues!

Kjo kërkesë ka qenë parashtruar në muajin nëntor 2009 dhe është arsyetuar shumë bukur se po ndërtohet një objekt i ri, objekti për mbajtjen e dëshmitarëve bashkëpunëtorë të dënuar, që do të thotë se kjo ministri po zgjerohet, po merr kompetenca të reja ligjore. Nga ana tjetër në Raportin e progresit është kërkuar që të funksionalizohet posa të përfundojë ndërtimi i këtij burgu, mirëpo nuk e ka parë të arsyeshme as Qeveria as Kuvendi i Kosovës, atëherë me miratuar dhe ja tash duhet të miratohet ky rekomandim i Komisionit, meqë veç është miratuar nga Qeveria me një përmirësim se këtu nuk kemi të bëjmë me shtimin e stafit korrektues të Shërbimit Korrektues të Burgut të Dubravës, por me persona – 71 oficerë korrektues për funksionalizimin e një pavijoni të ri që po ndërtohet e që është i paraparë edhe me Kodin penal të procedurës penale të Kosovës, që të kemi edhe dëshmitarë bashkëpunëtorë që e zbulojnë grupin, bashkëpunojë, por që janë pjesë e grupit kriminal dhe duhet të dënohet. Prandaj, është diçka e re, nuk është fjala për rritje të stafit, por për funksionalizim të këtij burgu të dëshmitarëve të dënuar bashkëpunëtorë.

Nga ana tjetër, nuk e di, duhet të përmirësohet ky rekomandimi i Komisionit dhe të mos thuhet 71 pozita për Burgun e Dubravës, por shprehimisht, siç është thënë në Vendimin e Qeverisë të datës 12.3.2010, për Burgun për dëshmitarët e dënuar të mbrojtur në Dubravë se ka dallim, sepse Shërbimit Korrektues të Kosovës këtë vit iu kanë dhënë 162.000 euro

më pak me buxhet se sa vitin e kaluar. Faleminderit! Unë propozoj me këtë përmirësim të votohet.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së deputeti Haki Shatri e ka fjalën.

HAKI SHATRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Grupi Parlamentar i Aleancës e ka shqyrtuar këtë kërkesë dhe meqenëse është fjala për rritjen e kapaciteteve të caktuara në Burgun e Dubravës dhe duke marrë parasysh punët qysh po shkojnë, konsiderojmë se kjo kërkesë është e arsyeshme se ka nevojë edhe për njerëz tjerë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit parlamentar të AKR-së deputetja Rita Hajzeraj e ka fjalën.

RITA HAJZERAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Përsëndetje për të gjithë!

Duke pasur parasysh nevojën e madhe që ky grup të rritet, atëherë neve e përkrahim si Grup Parlamentar, mirëpo do të duhej që paraprakisht të përcaktoheshin disa kriterë, në bazë të të cilave do të përcaktohen edhe numri i oficerëve të cilët do të shkojnë në Burgun e Dubravës. Për shembull sa të burgosur apo një grup i burgosurve se sa oficerë apo sa numër të oficerëve do të duhej të kishte për bazë për vendin e tyre. Ky përcaktim i numrit apo ky përcaktim i kriterëve nuk do të ishte i vështirë duke pasur parasysh edhe përvojën e burgjeve tjera që i kemi në rajon dhe në Evropë. Po ashtu, do të mund të zgjidhej kjo çështje me shumë lehtësi përmes një udhëzimi administrativ që nuk do të ishte shumë e vështirë. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Besa Gaxherri e ka fjalën.

BESA GAXHERRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Lidhja Demokratike e Dardanisë përkrah rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, realisht duke pasur parasysh që vërtet Burgu i Dubravës edhe pa këtë pavijon të ri që tash është, ka pasur nevojë për ta përforcuar se ne po na ikin të burgosurit çdo ditë prej aty dhe po na sjellën kriminelët nëpër rrugë të Kosovës.... natyrisht ka nevojë pra për ta vënë në funksion edhe këtë pavijon të ri, me këta 71 oficerë korrektues dhe Lidhja Demokratike e Dardanisë e përkrah këtë rekomandim.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar” 7+” nuk shoh të lajmëruar. Në emër të Grupit Parlamentar SLS, po ashtu. Në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, ftoj deputetin Numan Baliq, ta marrë fjalën.

NUMAN BALIQ : Faleminderit, zoti kryesues!

Ja çu takode dati nekoliko razložnih priloga ovoj diskusiji. Podržavamo naravno napore Ministarstva pravosuđa vezano za povećanje kapaciteta, na isti način što nam se sasvim dobrim čini dosadašnje delovanje koje je bivša ministrica imala po ovom pitanju, posebno vezano za proširenje kapaciteta i izgradnju novog paviljona. Nadamo se da će novi ministar nastaviti sa ovim radom. U ovom smislu, s obzirom da potičem iz Dukađinskog kraja, ja bih ovde dotakao još dvije važne stvari koje se tiču osim ovih pitanja Kazneno popravnog doma u Dubravama, pomenuo bih još najmanje dva važna pitanja, gde bih zamolio ministra za pravosuđe da obrati pažnju na to. Ovo je možda

dobra prilika da se podsjetimo da zatvor u Dubravama spada u jednoj instituciji koja je vodila računa o upošljavanju drugih zajednica, da je tokom rata primljen određeni broj zajednica, oko desetak iz Bošnjačke zajednice i oko pet iz Aškalijske zajednice...

KRYESUESI: Regija, të ftohen deputetët!

NUMAN BALIĆ: ... ali da bi bilo veoma dobro da se taj broj dovede u odgovarajuću mjeru i da on bude u skladu sa posebno ovim novim prijedlozima koji će važiti za Zakon o civilnoj službi. Prema našim procjenama i radnicima koje tamo imamo, ima oko 450 do 500 ukupan broj radnika, a negde oko 15 radnika je iz redova drugih zajednica, mi smatramo da trebalo, ne smatramo nego s obzirom da onaj uzus 10% trebalo da ih bude najmanje trostruko više i zamolio bih da da do 50 radnika, evo moje su kolege iz grupe to već izračunali, zamolio bih da se vodi računa i da budu naravno u vezi sa predstavnicima ovih zajednica.

I još jedna stvar, koju bih takođe, s obzirom da me ministar sluša, obratio jeste Zakon o upotrebi jezika na ulazima i na paviljonima, odjelima ovog zatvora, KP doma u Dubravama, je primećeno da nema srpsko-hrvatskog ili za nas je to bosanskog govornog natpisa, nego su natpisi samo na albanskom i engleskom. Bilo bi vrlo dobro da se ispoštuje s obzirom da i prema zakonima Kosova i prema strukturi radnika i zatvorenika, da se takođe i ovaj službeni jezik nađe na mestima gde je potrebno prema zakonu Kosova. Hvala lepa!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Nuk ka të lajmëruar për fjalë më. Ftoj deputetit që të përgatiten për votim dhe votojmë propozim vendimin e Qeverisë, me përmirësimin që e dha deputetja Nekibe Kelmendi. Pra, regjia dhe administrata e Kuvendit ta cek këtë, pra për rritjen e numrit të oficerëve korrektues për Burgun për dëshmitarë të dënuar të mbrojtur.

Ftoj regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatohet se me 61 vota “për”, 1 “kundër” dhe 1 “abstenim” Kuvendi miratoi Propozim-vendimin e Qeverisë së Kosovës për rritjen e numrit të oficerëve korrektues për 71 pozita në Burgun për dëshmitarë të mbrojtur, të dënuar. Ju faleminderit!

Kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës, pika nëntëmbëdhjetë:

19. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për rritjen e numrit të nëpunësve në Agjencinë për Menaxhimin e Pasurisë së Sekuestruar apo të Konfiskuar.

Konstatime hyrëse:

Komisioni funksional për Buxhet dhe Financa, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Punës ka shqyrtuar Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për rritjen e numrit të nëpunësve në Agjencinë për Menaxhimin e Pasurisë së Sekuestruar apo të Konfiskuar dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Propozim-vendimi i Qeverisë dhe raporti me rekomandimet e Komisionit funksional iu është shpërndarë deputetëve.

Ftoj përfaqësuesin e Qeverisë, ministrin Demolli, ta marrë fjalën në emër të Qeverisë së Kosovës si propozues i çështjes.

HAKI DEMOLLI: I nderuari kryesues!

Të nderuar delegatë,

Pothuaj se kërkesa pak a shumë është e ngjashme, mirëpo me një dallim esencial. Ndonëse në rend dite theksohet shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës për rritjen e numrit të nëpunësve të Agjencisë, unë do t'ua kisha bërë me dije se nuk është në pyetje apo nuk bëhet fjalë për rritjen, mirëpo konkretisht bëhet për themelimin e një agjencioni krejtësisht të ri, sepse deri më tani nuk ka asnjë të punësuar në atë agjencion i cili agjencion themelohet konform Ligjit për administrimin e pasurisë së sekuestruar apo konfiskuar, i cili ka hyrë në fuqi me datën 1 janar të vitit 2010, konkretisht, sipas të cilit ligj parashihet themelimi i këtij agjencioni. Deri më tani ka qenë e pamundur funksionalizimi i këtij agjencioni në mungesë të buxhetit të ndarë për funksionalizimin e saj. Konkretisht ky agjencion do të ketë tri departamente dhe në të cilin departamente kërkohet që të angazhohen gjithsej 17 të punësuar duke përfshirë këtu edhe shefin e departamentin. Andaj kisha kërkuar prej Parlamentit që të lejojë të marrë vendimin për themelimin, për ndarjen e mjeteve sepse Komisioni për Buxhet i ka lejuar mjetet për këtë agjencion. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të Komisionit nuk shoh të lajmëruar. Kalojmë në përfaqësues të grupeve parlamentare. Ftoj shefin e Grupit parlamentar të PDK-ës deputetin Ramë Buja ta marrë fjalën.

RAMË BUJA: Edhe pse kemi të formuara shumë agjencione dhe vështirë po i kontrollojmë ne që po i themelojmë, por megjithatë nga arsyeshmëria që vjen nga Qeveria ne si Grup Parlamentar kemi vendosur ta përkrahim si të tillë çfarë është.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së ftoj deputeten Nekibe Kelmendi ta marrë fjalën.

NEKIBE KELMENDI: Faleminderit, zoti kryesues!

Sikur që e tha edhe zoti ministër, në bazë të Ligjit për menaxhimin e pasurisë së sekuestruar dhe të konfiskuar duhet të themelohet agjencioni dhe agjencionin nuk mund të themelohet pa pranimin e punëtorëve në atë agjencion, prandaj unë e mbështes në tërësi edhe këtë rekomandim të Komisionit i cili është i bazuar edhe në kërkesën e Qeverisë por prapë këtu kundërshtoj se nuk bëhet fjalë për rritje dhe duhet të thuhet – për lejimin e 17 punëtorëve, e jo rritje. Edhe atje në Burgun e Dubravës janë dy pavijone, i femrave dhe i meshkujve dhe nuk po rrisim kurrgjë por po pranojmë punëtorë për ta funksionalizuar. Edhe ky agjencion duhet të funksionalizohet, kostoja nuk është shumë e madhe, 586.000 euro e diçka, mirëpo ky agjencion do t'i sjellë buxhetit të Kosovës para jashtëzakonisht të mëdha dhe do ta shpague disa herë vetveten kështu që në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së unë propozoj që të miratohet rekomandimi i Komisionit parlamentar. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së deputetja Donika Kadaj-Bujupi me kartelën e Ahmet Isufit.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Duke dit shkallën e lartë të korrupsionit në vend, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës pret që shumë shpejt të shohim pasuri të sekuestruar dhe të konfiskuar dhe rikthim të saj në arkën e shtetit, atë që s'e kemi pa deri sot, fatkeqësisht prandaj konsiderojmë që do të thotë është e nevojshme, është e domosdoshme, derivon edhe prej ligjit dhe do ta përkrahim këtë rritje apo këtë punësim të nëpunësve të rinj të cilët besojmë shumë fuqishëm do të jenë në nivel të detyrës dhe në funksion të vetë Agjencisë dhe detyrave që ka. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-ës ftoj anëtarin e Kryesisë deputetin Ibrahim Gashi ta marrë fjalën.

IBRAHIM GASHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar i AKR-ës e mbështet krijimin e këtij agjencioni pa paragjykuar se sa do të ketë punë apo s'do të ketë, po sigurisht se vendi ka nevojë për një gjë të tillë.

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së deputetja Besa Gaxherri e ka fjalën.

BESA GAXHERRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Lidhja Demokratike e Dardanisë mendon se, ose edhe e përkrah këtë propozim duke pasur parasysh e vërtet ky agjencion duhet të vihet sa më shpejt në funksion dhe urojmë që të koordinohen të gjitha institucionet relevante që vërtet ne mendojmë se në Kosovë duhet shumë shpejt të fillojë për t' u konfiskuar pasuria dhe pasuritë e shumta të mëdha, andaj jemi për ta vënë në funksion këtë agjencion dhe jemi pro votimit.

KRYESUESI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar 7+ nuk ka të lajmëruar. Në emër të Grupit Parlamentar SLS gjithashtu jo. Në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, ftoj deputet Vezira Emrush ta marrë fjalën.

VEZIRA EMRUŠ: Hvala lepa na datu reč!

Evo, ponovo imamo predlog Vlade za osnivanje agencije, ne za zapošljavanje, kao što vidimo za povećanje broja, nego je po prvi put osnivanje Agencije na osnovu zakona o menažiranju, konfiskovanju imovine, u stvari oduzete uskladištene imovine. Podržavamo ovaj predlog, ali sa jednom napomenom, mi ponovo imamo samo jako, jako suvu pred sobom informaciju od strane gospodina ministra i od same Vlade i kao predlog od strane komisije, nemamo kalkulaciju da je to 17 zapošljenih, nemamo organizacionu šemu kako je zamišljena ta agencija, nemamo koliko će biti budžet za tu agenciju a znamo da sve ovde formiramo samo agencije koje faktički troše, međutim ova agencija, ako bude namenski radila, ona je agencija koja će donositi sredstva u budžetu Kosova i pošto nemamo takvu kalkulaciju, ja ovo dajem kao prilog u buduću da nam se ne daju ovakve suve stvari, nego da se dobro analizira, a ovo je formiranje jedne nove agencije, nešto novo što će biti korisno za kosovsko društvo, za građane gde će biti oduzeta ili konfiskovana imovina, koja će biti na nelegalan način na Kosovu doneta, uskladištena, prodana, preko sudskih organa, preko svih institucija, te molim da nam se u buduću daju prave informacije sa većim informisanim sredstvima i koje možemo da analiziramo i da vidimo koliko će ta agencija biti korisna. Mi ćemo kao grupa da podržimo ovu agenciju i puno hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Nuk ka të lajmëruar më për fjalë. Në sallë janë 68 deputetë. Përgatitemi për votim, pra votojmë për propozim-vendimin e Qeverisë së Kosovës për

lejimin e punësimit të 17 nëpunësve në Agjencinë për Menaxhimin e Pasurisë së Sekuestruar apo të Konfiskuar.

Deputetët dhe regjia të përgatiten për votim dhe votojmë tash.

Ju faleminderit! Pra, kemi 69 deputetë tani në sallë. Konstatoj se me 65 vota “për”, 3 “kundër” dhe 1 abstenim, Kuvendi miratoi Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për lejimin e punësimit të 17 nëpunësve në Agjencinë për Menaxhimin e Pasurisë së Sekuestruar apo të Konfiskuar. Ju faleminderit!

Kalojmë në pikën e radhës, pika e njëzet e rendit të ditës:

20. Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione për lejimin e afatit shtesë për shqyrtimin e dytë të Projektligjit për mbrojtjen nga dhuna në familje

Konstatimet hyrëse:

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, në pajtim me Rregullën 32 pika 6 të Rregullores së Punës të Kuvendit, ka kërkuar afat shtesë për shqyrtimin e Projektligjit për mbrojtjen nga dhuna në familje.

Ftoj kryetarin e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, zotin Ismet Beqiri, që para Kuvendit të arsyetojë kërkesën e Komisionit, nëse e sheh të arsyeshme.

ISMET BEQIRI: Zotëri kryesues, unë vetëm si informacion... Ne veç e kemi kryer punën. Do të thotë na është lejuar nga Kryesia dhe ne e kemi kryer punën, kështu që janë dërguar amendamentet që i kishim ndërmend dhe për arsyen për çka kishim kërkuar afatin shtesë, kështu që unë nuk di a legjitimohet ai afat që na është dhënë në atë kohë – dyjavëshi, apo, domethënë nuk ka nevojë, sepse e kemi kryer punën, ne kemi kërkuar nga Kryesia dhe Kryesia na e ka lejuar, ne e kemi kryer procedurën dhe ato tash në proces e sipër kur të bëhen gati, do të thotë nga Kryesia dhe administrata, realisht, domethënë, më nuk na duhet kohë, sepse e kemi përfunduar punën. Ka qenë i nevojshëm ai dy javë ditësh, arsyeja ka qenë e thjeshtë sepse kemi angazhuar ekspertë nga jashtë për ato amendamente që i kemi bërë. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Dëgjuat arsyetimet. Kryesia i ka lejuar 15 ditë. Ftoj deputetët me një votim formal ta miratojmë, me ngritjen e dorës. Kush është për?

A ka kundër? Jo.

Konstatoj që është miratuar vendimi i Kryesisë së Kuvendit.

Kalojmë në pikën e njëzetën të rendit të ditës:

21. Propozimi i Grupit Parlamentar të LDD-së për zëvendësimin e anëtarëve të komisioneve parlamentare.

Grupi Parlamentar i LDD-së ka propozuar deputetin Gani Geci për anëtar të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, në vend të deputetit Adem Salihaj, kurse deputetja Drita Maliqi, propozohet për anëtarë në Komision për mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë, në vend të deputetit Adem Salihaj.

Kërkoj nga ju, me ngritje dore, të deklaroheni për propozimin e Grupit Parlamentar të LDD-së.

Kush është për? Faleminderit!
A ka kundër? 2” kundër”.

Konstatohet se me 2 vota “kundër”, Kuvendi miratoi propozimin dhe vendimin e Grupit Parlamentar të LDD-së.

I kemi edhe dy pika shtesë, të nderuar deputetë, ju lus për mirëkuptim. Ta kryejmë seancën para pauzës. Pika e radhës e rendit të ditës është e njëzetedyta :

22. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarit në Bordin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit

Konstatime hyrëse:

Komisioni funksional për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Punës ka shqyrtuar Propozim-vendimin e Qeverisë për emërimin e anëtarit në Bordin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Propozim-vendimi i Qeverisë, së bashku me dokumentacionin dhe rekomandimi i Komisionit funksional, u janë shpërndarë deputetëve.

Radha e diskutuesve për përfaqësuesin e Qeverisë? Nuk ka. Në emër të Komisionit, deputetja, kryetarja e Komisionit, Myzejene Selmani e ka kërkuar fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti kryesues!

Duke marrë parasysh se Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Transport dhe Telekomunikacion, në pajtim me Rregulloren e Kuvendit dhe rekomandimin e propozimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, 30 mars 2010, për emërimin e kandidatit për anëtar të Bordit të Agjencionit Kosovar të Privatizimit, vendos që Kuvendit t’i paraqet, në këtë seancë, të miratojë Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, numër 4/117 të datës 30 mars 2010 me emërimin e kandidatit Naser Osmani, anëtar të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Për fjalë është lajmëruar edhe një deputet. Pra Shkumbin Demaliaj e ka fjalën.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Ka bërë mirë Komisioni që e ka prurë këtë propozim të Qeverisë, mirëpo po shihet haptazi se Qeveria po shkel mbi parimet e veta. Zotin Osmani neve e kemi kolegë të gjithë, mirëpo njëherë e ka shkarkuar nga pozita e zëvendësministrit dhe në mënyrë demonstrative dihet çka ka ndodhur në Kuvend dhe po na vjen shumë mirë që Qeveria i paska ra pishman vendimeve të veta dhe i ka pëlqyer zoti Osmani të jetë pjesë e një bordi shumë të rëndësishëm në kuadër të mekanizmit që është në këtë rast Agjencia e Privatizimit që mbikëqyret nga Ministria e Financave. Zotit Osmani i urojmë suksese dhe po na vjen mirë që Qeveria e ka zbutur zemrën në këtë rast, njëherë për ta shkarkuar në atë formë e sot e propozon për ta emëruar në një pozitë tjetër. Kaq kisha!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Lus regjinë dhe deputetët që të përgatiten për votim. Pra, votojmë Propozim-vendimin e Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarit në Bordin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit. Votojmë tash.

Ju faleminderit! Konstatoj se me 46 vota “për”, 14 “kundër” dhe 5 abstenime, Kuvendi emëroi zotin Naser Osmani, anëtar në Bordin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, me mandat dyvjeçar. Në sallë ishin 72 deputetë.

Pika e fundit e rendit të ditës:

23. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarit në Komisionin Kosovar të Konkurrencës.

Konstatime hyrëse:

Komisioni funksional për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Punës ka shqyrtuar Propozim-vendimin e Qeverisë për emërimin e anëtarit në Komisionin kosovar të konkurrencës dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Propozim-vendimi i Qeverisë, së bashku me dokumentacion dhe rekomandimi i Komisionit funksional, i është shpërndarë deputetëve.

Të lajmëruar për fjalë nuk ka. Shkojmë në votim. Ftoj deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Ju faleminderit! Konstatoj se me 46 vota “për”, 11 “kundër”, 7 abstenime, Kuvendi emëroi zotin Gani Asllani, anëtar në Komisionin kosovar të konkurrencës, me mandat pesëvjeçar.

Në sallë janë 72 deputetë. Ju faleminderit dhe mirupafshim në seancat e ardhshme!

Përgatiti:

Njësia e Transkripteve